

8SH-31

Ø 76



SKËNDER DRINI

KENGAE DRITES

ROMAN

891.P83-31

Ø 76

SKËNDER DRINI

S

KËNGA E DRITËS

~~52498~~

SHKURIMI I SHKËRITËS

7692

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KAPITULLI I

Diku në brigjet e Drinit...

Kantieri i ri bie në sy menjëherë nga barakat me pupulit, që nuk kanë pasur kohë t'i suvatojnë përjashta. Baraka pupuliti! Baraka të thjeshta punëtorësh, prodhim i djersës dhe i punës! Kush i sheh ato dhe nuk ngazëllon? Baraka pupuliti! Të gjata, të hirta, me dritare katërkëndëshe, nëpër qoshet e të cilave dalin cepat e shtretërve të punëtorëve. Rreth e qark tulla, gurë, togje pupuliti të posashkarkuara nga maqinat, sheshe llaçi dhe betoni të ndohtura nga balta. Trarët e posashkarkuar kanë shkarë pak më tej se ç'duhet dhe bëhen shkak që të zemërohen shoferët, ndërsa më tutje, një tub i pa mbyllur mirë, hedh një shatrvan të gëzuar cirkash uji mbi njerëzit dhe mbi maqinat; Punëtorët zgjasin duart si fëmijë e lozin me rrebeshin e ujit. Aksionistë që mbartin shtretërit dhe raftet në një fjetore të posambaruar. Muret aty ende kundërmojnë erën e shëndetshme të gëlqeres, xhamat nuk janë pastruar dhe dera nuk puthitet si duhet. Po punëtorët përveshin mëngët dhe baraka shkëlqen si pasqyrë. Shefat flasin me zë të lartë, ngandonjëherë bëhen nevrinë; teknikët vërtiten me skicat nëpër duar, poshtë e lart minatorë me baromina në krah. Minatorët mbahen ca më të madh dhe ecin lirshëm. Më tutje specialistët kinezë bëjnë punë vullnetare jashtë orarit. Tjegullat fluturojnë që poshtë gjer në majë të një barake të gjatë. Atje lart duket një kinez i shëndoshë, që rrjeshton tjegullat mbi çati po me atë kujdes që do të vinte një fëmijë në shtat.

Një kantier i posangritur! Një kuadër i posanisur!
Njerëzit hëpërhë kërkojnë ato më të nevojshmet, më të domosdoshmet. Më vonë ja plotësojnë të metat hap pas hapi, penelatë pas penelate! Dhe kuadri dalëngadalë merr jetë, tregon përditë e më shumë shëmbëllimin e vet të vërtetë. Po piktorët nuk kënaqen kurr, nuk i lëshojnë penelat nga duart.

Rreth e përçark vjeshtë, vjeshtë e artë me zhurmë motorësh dhe gjemime minash në vënd të bubullimave...

* * *

Diga është ndër frontet kryesore të ndërmarrjes. Diga e lartë ku do të përplasen ujërat, ku do të ndalen të çuditura ato ujëra që brodhën lirisht që nga motet e lashta. Jo shumë larg saj nxin gryka e madhe e portalit të tunelit që i shëmbëllen gurmazit të stërmadh ngushtë, përshkon me gjemime të mbytura atë copë vend ku e kanë lejuar të kalojë. Gjysma tjetër e shtratit të Drinit është ngritur si një bankinë për sondat. Sondat! Një pyll sondash! UKS që ngrejnë e ulin me një durim të pabesuar pykën e rëndë goditëse, me ato katër qoshe të mprehta si dhëmb çatall, sonda 300. KA e M. 300, që vërtisin e vërtisin pa pushim shtangat drejt thellësive; motorë, rripa transmisioni, motopompa argjile dhe uji, tuba të zinj që shtrihen si damarë të fortë anëkënd truallit; vagoneta, betonatriçe, kamionë që ngrejnë cirka balte, buldozerë që grinden me skarpatën e malit... Më tutje përgje tubash, thasë çimentoje, kodra zhavorri dhe argjili. Dhe zhurmë. Shumë zhurmë. Secila maqinë bërtet për vete, secili motor kërcet për vete, secila sondë shfryn si ja ka ënda. Mbi të gjithë zhurma e mprehtë rrotullore e pistoletave në udhën e ngushtë, që po zgjerohet në kurrriz të malit. Pranë maqinave njerëzit... Punëtorë nën kubetë trekëndëshe të sondave, punëtorë pas vagonetave, pranë pompave, në kabinat e buldozerëve dhe të maqi-

nave. Njerëz, maqina, zhurmë! Zhurmë e pandërprerë.

Njerëzit mbajnë vesh. E ndajnë zhurmën, e zgjedhin, pastaj marrin atë që u takon. Për ta ajo nuk është zhurmë, as «këngë maqinash», siç e përcaktojnë poetët, ajo është thjesht gjuha e hekurit që punon.

Maqina ka fjalën e vet, është një qenje e gjallë. Dhe ai që i rri mbi kokë, e di mirë kur ankohet dhe kur shkon së mbari, ashtu siç e di ai punëtori i vjetër i sondës n° 1 në krahun e mëngjër të digës. Sonda ankohet? Shpimi nuk ecën...

* * *

Punëtori ngre pak mbi ballë kasketën e lerosur me vaj dhe vështron përreth i pakënaqur. Pastaj ulet mbi një arkë kampionesh. Do edhe njëzet minuta të mbarojë turni dhe ai nuk ka shpuar as dyzet centimetra. Të tjerët kanë ecur revan...

Që kur futi tubin e rrethimit e pa që do ta kishte pisk punën. Tubi as që pyeste fare për babin dyqind kilesh që i binte mbi kokë. Pesha e rëndë rrihte pa pushim tubin e çeliktë, por pothuaj nuk arrinte ta rraste fare në dhe. U deshën pesë orë për ta futur tubin e rrethimit në dhe. Pesë orë! Pastaj shpimi!.. Një ngatërresë në vete shpimi... Kurrë nuk i kishte shkuar kaq ters.

— Prapë nuk ecën?

— Nuk ecën, shoku inxhinier, — u përgjegj punëtori dhe psherëtiu, — të kërkova gjithandej...

— Ishim në mbledhje. Pastaj mendova që pas konsultës që bëmë bashkë, çdo gjë duhet të vinte në rregull.

— Me sa ma pret mua, sonda ime nuk po shpion në zhavorr, po në shkëmb të gjallë, shoku Zef, shkëmb dhe çfarë shkëmbi! A nuk mund të jetë ndonjë damar i zgjatur i malit, një damar që arrin vetëm te sonda ime?

— Ndonjë protuberancë? E pamundur! Projekti e

përcakton zhavorr, shoku Brahim. Vazhdo edhe pak, pastaj shohim e bëjmë me ata të turnit tjetër.

Inxhinieri u largua. Punëtori i hodhi sytë prapë nga sonda. Ajo regëtinte dhe blokohej çast pas çasti. Sa blokohej ajo, ndihmëssondisti vraponte te motori dhe ndalonte xhirot. Nga gryka e pusit rridhte argjila gulshe, gulshe...

* * *

Atë e quanin Brahim Jergucati. Shokët e punës i kishin vënë emrit të tij një «xha» dhe ai për ta ishte «xha Brahimi». Por në të vërtetë nuk dukej sa për një «xha». Shkurt, qe një burrë në moshë, vjetët e të cilit nuk i kuptoje dot.

Në sektor dinin pak hollësira nga jeta e tij. Ai s'fliste kurrë për vete. Në përgjithësi nuk hynte në biseda të parëndësishme. Kishte fjalë pak, fliste më shumë me krahë, me vegla...

Kush mundahej të gërmonte në të kaluarën e tij mbetej i pakënaqur. Nuk nxirrte gjë veç atyre që dinin të gjithë: Hidrocentrali «Lenin», Ulza, Shkopeti, Bistrica...

Kuriozët i tundonte më shumë e kaluara e largët e këtij njeriu. Pëshpëritej se kish punuar një kohë në një post me përgjegjësi diku në një rreth, dhe s'dihej për ç'arësye kish nisur nga zanati i parë. Në rini qe marrë me hekurin... Disa mendonin se kushedi, ç'gabim kish bërë dhe i kish shkarë këmba.

Po kuriozë e gojkëqinj në kantier kishte pak, fare pak, numëroheshin me gisht. E shumta e punëtorëve kish përpara syve vetëm atë xha Brahon, komunist të orëve të para, atë xha Brahon, që vërtitej nën kubetë e sondave, që gjindej ku prishej një pompë, ku s'ecte një motor. Se ai ishte një xha Braho me shumë profesione, dhe për të cilin s'kish rëndësi kur fillon dhe mbaron tetëorëshi. Ata njihnin një Xha Braho të qetë, të heshtur, pa kur ish

nevoja një agjitor të flaktë të së resë, një mbrojtës të së drejtës. Njihnin një xha Braho me kasketë të rrasur thellë mbi sy, që s'ta vinte fort veshin se e kish mendjen te maqina, njihni atë njeri që ndjehej keq kur ish i detyruar të rrinte pa punë me duart mbi gjunjë. Atëherë duart i dridheshin si prej ndonjë tiku nervor, sikur të kërkonin ndonjë pincë, apo ndonjë çelës dymbëdhjetësh. Siç rrinte ai ashtu i përqëndruar mbi maqinë, të linte të kuptoje se n'ato orë për të nuk ekzistonte gjë tjetër në botë veç saj. Lëvizte maqina, lëvizte edhe ai. Duart, sytë, muskujt e fytyrës, gjithë organizmi i tij, lëvizte pothuaj në harmoni me maqinën. «Xha Brahoja është lidhur me maqinën me rrip transmissioni», — bënin shaka punëtorët.

Po ai nuk qe automat. Ai nuk ecte pas maqinës, ajo shkonte mbas tij. I bindej atij. Ajo kishte forcën, ai trurin...

E dinin të gjithë që nuk i pëlqente të fliste për vete dhe nuk e ngacmonin. Po për të tjerët fliste. Dhe kur ish fjala për diçka të bukur, të lartë ai merrte flakë si baroti. Pak fjalë po të gjitha i zinin vënd mirë. Zakonisht atij i zinin vënd fjalët më mirë se kujtdo në sektor «E tha xha Brahoja dhe pikë!». E mbanin vesh, e dëgjonin. Ai kish një autoritet të natyrshëm.

... Shtanga ishte blckuar përfundimisht. Ndihmëssondisti hodhi sytë e lodhur nga Brahim Jergucati. Djalë i ri ai... Posa kish lënë shkollën. Shkolla dhe jeta nuk afrohen gjithmonë shpejt me njëra-tjetrën. Ndihmëssondisti dukej i lodhur dhe i mërztur. Xha Brahoja bëri një gjest me dorë. Djali shpejtoi të ndërpriste rrymën.

Përtej në rrugë oshëtinë boritë e autobuseve që sillnin turnin tjetër. Xha Brahoja nuk luajti nga vendi, vetëm se rراسi pak më fort kasketën.

Ndihmëssondisti shtriu krahët e përveshur të xhupit dhe u bë gati të ikte.

— Tash e vejnë për fije të tjerët, — tha, — na po e lamë një herë...

...

— Natën e mirë, xha Braho!

— Natën e mirë, Sami!

Ai nuk luajti prapë nga vendi. Djaloshi ngurroi një cast duke e parë që nuk po ngrihej, po pastaj u përzie me punëtorët që kishin lënë punën.

Brahim Jergucati ngriti kokën që i rëndonte plumb dhe e ndoqi me sy. «Ai nuk duhej të ikte, — mendoi. A thua e ha merakun ç'do të bëjnë ata të turnit tjetër me këtë shtangë dembele?» Psherëtiu. E harroi ndihmësin. Zu të përshkonte me mend gjithë atë ditë të lodhshme. Larg në rrugë përziheshin zërat gazmorë të atyre që iknin dhe vinin.

Kryesondisti u ngrit, hodhi kasketën përdhe, pastaj e lidhi tubin me çengelën e karukullës. Kavoja u tendos, u hep na pak, motori i sondës regëtiu me mundim, pastaj tubi i madh doli nja dy pëllëmbë në sipërfaqe. Xha Brahoja e shkurtoi levën dhe e nxori edhe më. E përsëriti disa herë këtë manevër dhe tubi mbeti pezull në ajër dhe zu të vërtitej si ato kukllat kur i zënë nga koka.

Punëtori u ul dhe pa koronkën. Nuk i kishte mbetur asnjë dhëmb.

Brahim Jergucati psherëtiu thellë. E ndërroi koronkën dhe e vuri tubin në grykë të pusit.

Nëpër sondat e tjera po ndërrohej turni. Erdhën dhe te ai.

— Ç'ka, xha Braho? Nuk e ha?

—Nuk e hante!

Ai i shqiptoi me nervozitet tri germat e fundit të fjalës. U foli pa i vështruar fare. Madje i vinte inat që erdhën. Le ta linin të qetë.

— E po, na e lër neve, tani. Dorzona turnin. Mbase na ecën...

«Mbase», — pëshpëriti me vete xha Brahoja. — Mbase! — përsëriti ai me inat. E kishte zët këtë fjalë.

Ai e lidhi babin e rëndë me ganxhën e karukullës. Goditje! Goditje! prapë goditje! Xha Brahoja ngre dhe ul levën e komandës. Babi i bie me zemërim kokës së tubit. Tubi fshihet në dhe.

Punëtorët e tjerë qëndrojnë krahvarur përpara son-
dës. U vjen edhe zor t'i flasin.

— Po lerna, xha Braho! Ik, je lodhur gjithë ditën.

Ai nuk i dëgjon, bën sikur nuk i dëgjon. Babi i
rëndë hahet me kokën e tubit. Është babi i vetëm në
gjithë sektorin që është kaq i zemëruar. Një bab dyqind
kilesh...

Se kush u shqit nga errësira dhe ju qas pranë.

— Të të ndih, xha Braho?

— Jo, jo! Nuk është punë ndihme. Po të jetë për
ndihmë kam këta të turnit.

— E po, natën e mirë, atëherë!

Brahim Jergucati luan levën, luan levën... Nëpër
natë humbasin siluetat e stërmëdha të punëtorëve, që
kanë lënë turnin.

* * *

Kur e la punën kish vajtur shumë vonë. Ai
u drejtua mekanikisht nga menca. Menca kish dy orë
që ishte mbyllur. Pranë kuzhinës kundërmonte erë vaji
të padjegur mirë. Më tutje një qen kërciste nëpër dhë-
mbë të mbeturat e darkës.

«Prapë nuk kanë gjë në terezi këta të mencës, —
mendoj xha Brahoja — duhet t'ja mbledhim edhe një
herë atij përgjegjësit... Papastërti». Kish zënë ta gë-
rryente uria. Futi duart në xhepat e kominosheve dhe
gjeti një biskotë të fortë. Zu ta përtypte me ëndje. Qeni
lehu kur i kaloi pranë, por nuk u nda nga kockat. Bra-
him Jergucati ju ngjit së përpjetës që të çonte nga
klubi. Kush e di, mos ishte ende shitësi...

Ecte me zor, në një vend gati sa nuk rrëshqiti. Toka
e lagur nga shirat shkiste për qamet. «Duhej bërë një
shkallë aty. Njerëzit shkojnë edhe natën këndeje. Një herë
sikur e patën nisur...

Klubi që mbyllur. Ai vështroi nga plasat e kanatave
se mos kishte dritë (nganjëherë në të rrallë, kur vono-
hej, shitësi flinte në dyqan). Pastaj u largua menga-

dalë. «Edhe klubi duhej të qëndronte hapur. Njerëzit punojnë natën, duan një kafe, një paketë cigare...»

Brahim Jergucati qeshi me vete. Ju duk sikur kishte dalë këtë natë vonë për të ndrequr gjithë prapësitë. Po më pas u vrenjt. Nuk i erdhi mirë që i pa të metat vetëm kur i ndjeu në lëkurë. Pse nuk i kishin rënë më përpara në sy? «Hej, xha Braho, xha Braho! Sa duhet që të shkëputesh nga vetja!» —

Në barakën e gjatë të punëtorëve kishte dritë në të gjitha dhomat. I përshkoi ato një nga një.

Në dhomën e parë se kush po lexonte gazetën. Xha Brahoja nuk kishte patur kohë të lexonte atë ditë.

... Aeroplani i gjashtë u rrëzua në provincën Nge An. I shtati, një F 104, në Kon Ko. Numri i sotëm i aeroplanëve të rrëzuar i shpie në 2100 aeroplanët piratë të shkatërruar nga forcat e armatosura dhe nga popullsia e Republikës Demokratike të Vietnamit.

— Heu, ua lumsha krahët! — bërtiti dikush nga dhoma.

Në kthinën përtej bëhej zhurmë. Perdet ishin pak si mënjanë dhe ai pa mbi tryezë ca gurë dominoje dhe gjysmat e duarve të lojtarëve.

— Pesë me gjashtë!

— Dopjo gjashtë!

Gurët e dominos fluturuan përpjetë nga lojtari gjaknxehtë. Sa do t'i ketë dhembur dora!..

Xha Brahoja buzëqeshi: Bardhi «sa një vinç»...

Dhomën e tretë e kaloi shpejt e shpejt. Në të katërtën s'e kush këndonte me një zë të mallëngjyer:

«Hajredin trimi ja dha të thirrmes

Vall ku janë-o shtatë malet e Dibrës?»

«Lleshi! Llesh Kalia!»

Mbajti vesh. Nuk i interesonin fjalët, donte të dëgjonte vetëm melodinë. I tingëlloi në vesh si e trishtuar. «Ç'ka Lleshi? Mos është mërëzitur për shtëpinë? Ka pesë muaj që s'ka vajtur...»

Ju kujtua se i kishin dhënë dy herë leje të vende në shtëpi dhe ai nuk kishte pranuar. Në tunel, ku punonte Llesh Kalia në këtë kohë, një njeri vlente një thesar.

«Sidoqoftë duhet t'ja mbush mendjen të shkojë në shtëpi... Pesë muaj pa vajtur...»

Po ti, sa ke, xha Braho?

Shtyu derën e dhomës së vet. Shokët ngritën kokën nga shtretërit. Ai ju afrua me radhë secilit dhe i shikoi kapakun e librit. Pjesa më e madhe ishin libra të tijtë, materiale të partisë.

Punëtorët e lanë leximin dhe zunë të vështronin me dhembshuri.

— Prapë nuk eci diçka sonte, xha Braho?

— Eh, eh! Asgjë me rëndësi.

— Darkën e ke mbi tryezë, xha Brahim, — tha një lumjan që flinte në shtratin e fundit. — Ma preu mendja se e kishe da me ndejë pa darkë sonte. Vetëm groshë e mish. Supën s'mund e pruna...

Brahim Jergucati vështroi andej nga ishte buka dhe një valë e ngrohtë kënaqësie i përshkoi gjoksin. Ai tani nuk ndjente më uri...

— Mezi u bind sonda të shpojë — foli sikur të shfajsohej për vonesën. U ul në tryezë. Fytyrat e punëtorëve u fshehën pas librave.

KAPITULLI II

Mëngjez. Në tunel është qetësi. Vetëm ajri i ngjeshur që humbet nga tubat e prish heshtjen me një zhur-zhu pa ndërprerje që u ngjet zërave të bletëve në roitje.

Minatorët janë mbledhur në hyrje të tynelit. Një mbledhje e thjeshtë. Njerëzit bisedojnë për punën. Portali ka një barrë vështirësish.

Inxhinier Ilia qëndron në këmbë përpara tyre dhe merr e jep me gjallëri.

— Po të plasim minat poshtë portalit, — thotë ai, — është rrezik të na shembet pjesa e sipërme e shkëmbit. Ajo do përforcuar me armaturë të brendshme. Projekti kërkon të futen në shkëmb afër dyqind e pesëdhjetë copë shina hekuri... Kjo kushton një djall e gjysmë. Ç'thoni shokë? Mos Keni ndonjë mendim?

Ai i vështron me guxim, i nxit me sy. Ai është me të vërtetë shok me ta. Një inxhinier punëtor. E ka filluar shkollën me kazmë në dorë në kanalën e Çukës, gati fëmijë atëherë. Pastaj e ka vazhduar në të gjitha veprat me rëndësi të pesëvjeçarëve. Ka mësuar vetë. Mëso dhe jep provime. Kështu gjer në fund të shkollës së mesme. Diplomë nuk ka ende, por jeta i ka dhënë një dokument tjetër, të ashpër, të thjeshtë, të saktë. Është inxhinier me atestim. E ka pikë të dobët atestimin. Ja thotë kujtdo. Po universitetin, ama, do ta mbarojë. Është në vit të tretë. Ilia, një inxhinier punëtor...

Pas tij qëndron brigadieri i minatorëve, Llesh Kalia. Vështron ballin e lartë të portalit. Aty duhen futur dyqind e pesëdhjetë shina L Nr. 42. Dyqind e pesëdhjetë shina dekovili...

Si brigadier nuk gëzon ndonjë respekt të madh në administratën e kantierit. Madje shefi i llogarisë, Zaimi, betohet se i ka tërhequr vërejtjen njëqind herë për evidencat e punëtorëve. Po si minator... Sa dëgjon pistoletën Llesh Kalia harron që është brigadier dhe se duhet të kontrollojë të tjerët, harron të plotësojë edhe evidencat e shefit të llogarisë. Pistoleta shpon shkëmbin, Llesh Kalia harron detyrat e veta «administrative». Po për disa gjëra kanë të drejtë të mos e duan. Ai nuk ja var shumë ngritjes tekniko-edukative të brigadës, është ndër të fundit që interesohet për këto gjëra. Po në përgjithësi nuk e kritikojnë shumë. Brigada e tij është në pararojë. E, për çudi, i pari i saj gjithë kohën punon. Llesh Kalinë nuk e ka inat vetëm Zaimi, por edhe ndonjë brigadier që i pëlqen «të drejtojë».

Llesh Kalia vështron portalin. Ai rrudh ballin. Një blanë e thellë plage shtrihet e mblidhet mbi rrudhat e viteve. Një histori e vjetër minatori...

— Shinat kanë halle, shoku inxhinier, — thotë ai, — halle me okë! Duen ledha e miklime shumë ato. Duen me jau prue tefin drejt, duen jasteqe betoni e ç'nuk duen! Kam punue unë me shina! Kanë halle ato të plasmet!

— Ke ndonjë mendim, Llesh

— Kam, por...

— Nuk ka «por». Folë pa frikë.

— Mos, he burr, se nuk më tutet syni për këso punësh! Unë them të fusim anкера të thjeshta. Anкера të çame në fund ku mund të hyjnë copa konike hekuri. Mandej t'u shtrëngojmë kokat ankerave me bullona. E mjaftojnë pesëdhjetë copë.

— Gjeologët nuk do të binden kurr! — u hodh tekniku i turnit. Ata kanë thanë se edhe dyqind e pesëdhjetë shina s'janë shumë. E jo ma ankerat e thjeshta...

— Gjeologët nuk e njofin këtë shkamb sa e njof unë. E di çfarë shkambit asht? Çelik! Mandej unë kam punue dikur njetit me anкера, madje në një shkamb ma të dobët. Nuk pat asnji rrezik.

Inxhinieri zu të vinte poshtë e lart nëpër tunel. Ankerat i kishin rënë në mendje edhe atij, por donte të bindej edhe nga minatorët. Donte të dinte në ishin përdorur gjetiu dhe ç'fat kishin pasur. Tani që dëgjonte se si fliste Llesh Kalia i dukej çudi që kishte ngurruar aq shumë për ato anкера të plasura.

— Me ankerat i kursejmë shtetit një goxha shumë, — foli ai, — pastaj edhe kohë duhet katër herë më pak. Do ta shtroj në këshillin teknik.

— Shtroje, shtroje, — tha një minator, — Llesh Kalia ja di zemrën shkambit.

— Ç'thoni për barominat gjashtëdhëmbëshe? Si ju duken? — Pyeti Ilija.

— Me nam! — tha një mirditas. Ku ka kenë përpara ai kovaçi jonë? Asht me ja puthë ato duer.

— Kështu mendoja edhe unë, — tha inxhinieri. — Me gjashtë dhëmbë rritet fuqia brejtëse dhe pakësohet fërkimi. Pastaj ajri del më kollaj. I pashë mbrëmë si punonin. I lumtë kovaçit tonë. E ka bërë vetë kallëpin.

Heshti një copë herë pastaj u kthye nga minatorët.

— Ç'keni për të thënë ndonjë gjë?

— Ajër ka pak, — tha një minator.

— Ajri humbet udhës, — ja pat një tjetër. — Tubat nuk lidhen mirë njëri me tjetrin, pastaj dhe i lenë pa kujdes kur ndërron vendi i punës.

— Dje u ndërpre ajri pothuaj një orë rresht, — foli një djalë i ri. Kjo punë po na ngjet shpesh. Pse nuk na pajisni me dalta dhe me vare? Në rast avarie do t'i bënim vrimat me krah.

Inxhinier Ilia i pa me radhë të gjithë minatorët. Fytyra të ashpra minatorësh, të zeshkëta, me pamje të çiltër dhe burrërore.

Ilia i vështron se si aprovojnë fjalët e shokut të tyre. Kush bën me kokë, kush ngre kaskën lart, kush thërret.

— Dhe duhet shpjegue që nuk asht punë normash, — buzëqeshi Llesh Kalia. Ai do të thotë që nuk nisen nga pagesa.

— Na e kemi shoshitë së bashku një kët punë.

— Gjë që bëhet — tha Ilia. — Do t'u kërkoj veglat dhe do t'i mbajmë pranë për çdo çast. Po difektet në maqineri po pakësohen përditë e më shumë. A ju bien ndërmend ditët e para në tunel?

— Me atë kohë jemi lule — ja pat Lleshi.

— S'ke ç'i bën. Një pjesë e mekanikëve dhe e motoristëve tanë nuk kishin fare praktikë...

Inxhinieri ngriti supet. Pastaj vështroi orën.

— Erdh koha të ndezim minat — tha.

Plasja e mëngjezit bëhej pathuaj në një kohë në të gjithë sektorët, pak përpara se të fillonte turni i parë.

Ilia desh të largohej, po u kthye papritmas nga Lleshi.

— Ah, harrova. Zaimi m'u ankua prapë për ato letrat, — qeshi dhe iku.

Llesh Kalia shau nëpër dhëmbë. Minatorët u ngritën të fshihen nëpër strehime. Kontrolli i minave ndërpreu qarkullimin. Për disa çaste qetësi. Qetësi e thellë. Pastaj një gjëzim shurdhonjës doli nga gryka e tunelit së bashku me tymin dhe me copërat e shkëmbit. Dhe pa mbaruar jehona e saj, ja dhanë gjëmimet e tjera matanë malit në sektorin e shkëmbit. Oshtima e plasjes u ngjit përpjetë luginës së Drinit dhe humbi tutje. Ishte një plasje e zakonshme e çdo mëngjezi. Një plasje në seri.

* * *

Për të mos penguar punën në portalin e madh kishin hapur një hyrje ndihmëse për në tunel, një shtreg siç e quanin minatorët. Portali dhe shtregu kishin nisur pothuaj paralel. Asnjëri nuk e pengonte tjetrin. Shtregu ishte nisja e tunelit që humbiste në gjirin e malit. Që aty tuneli kish ecur përpara rreth dyzet metra; në dalje afër njëzet e pesë. Shpohej në dy drejtime, nga anët e malit përnjëherësh. Kështu fitohej kohë.

Llesh Kalia u prin minatorëve për në tunel nëpërmjet shtregut. Një pjesë do të punojnë brenda, të tjerët jashtë, te portali.

Minatorët rrëmbyen veglat. Nisi zhurma e punës. Kërcisnin pistoletat, kërcisnin vagonat në krahun tjetër. Nxirrnin jashtë «prodhimin». Po, pikërisht «prodhimin»...Gjuhë e zanatit...

Brigadieri ja kishte kthyer pistoletën tavanit të tunelit. Shpimi më i vështirë. Shpim nga poshtë lart. Duhej gjithë ajo fuqi për ta mbajtur barominën të puthitur në shkëmb.

Trupi shulak i Llesh Kalisë është përkulur hark, si në ndonjë mundje. Koka prapa, gjoksi përpara. Dorzat e pistoletës i çikin krahërorin leshtor. E ka zberthyer

er xhupin. Në tunel bën ftohët, por atij i rrjedhin djersët çurkë.

Disa hapa më tej shpon Frani nga Mirdita. Bën shaka dhe qesh me shokët pa ja ndarë sytë veglës. Është i dobët kockë e lëkurë por shumë i fuqishëm dhe i gjallë zhivë. Një nga ata tipa që gjallëria e tepërme nuk i lë të vënë mish.

— Më ka dalë një shkamb si tul buket, — thotë ai dhe fërkon duart.

— Kqyr e ngulja dhamët mbasi t'ra nafaka n'derë se je ba si me pasë hangër hardhuca gjithë verën, — e shpon dikush nga minatorët. E dëgjojnë të gjithë megjithëse është gjithë ajo zhurmë. Veshi i minatorit e ndan fjalën nga zhurma për mrekulli.

— Kam dek gazit dje, — rifilloi Frani. — Erdh një asi t'rijsh prej Puket e m'lypi me e pa pistoletën. «Shkele qat vegël» i thashë për çelsin. Dhe i pukjani e shkeli. Pistoleta zu të dridhet si mitraloz, ai u tremb dhe e lëshoi përdhe. Ishte prej Puket.

Po Zenel Mazllumi as që ngre kokën t'i përgjigjet. Ai e di që Frani kërkon ta ngacmojë si pukjan.

— Je kah na rrenë, mor mirditas, — ja preu dikush. — Ai pukjani me të vërtetë që u trem, por as iku, as e lëshoi doret pistoletën.

— Kujtoi se asht mitraloz «sharrs», — vazhdoi avazin gjithnjë duke qeshur tjetri. — E pra, kta pukjanët i bajnë për trima...

— Mos shit burri, — e kundërshtoi ai tjetri, — edhe ty ndoshta t'ka ndodh ksisoj herën e parë...

— Edhe mue, besa, — foli Lleshi, — e s'kam qenë fort i vogël atëherë...

Në tunel erdhi kryetari i bashkimeve profesionale të sektorit. Ishte një burrë i gjatë, i dobët, me flokë të dendur dhe të zinj si pendë e korbit. Ai bënte shaka me Lleshin, mundahej të fliste në dialektin e Dibërës. Po ai ishte nga Konispoli dhe mirret vesht ç'përgjasim kishte...

— Or Llesh: Kalia, bre! A je n'shpejë, bre bajraktar i Fushë Alies?

— Hajde byjrum, — ju përgjegj dibrani po me shaka.
Lleshi ja la dikujt në dorë pistoletën dhe i doli përpara me buzë në gaz atij që erdhi. Kur qeshte Llesh Kalia, qeshte gjithë tuneli...

— Mirë se të gjeç!

Llesh Kalia e vuri buzën në gaz prapë.

— Ç'thonë punët?

Kur fliste së mbari ai, prite ndonjë kritikë, apo ndonjë gjë tjetër të re.

— Shkojmë si asht ma mirë.

— Po me sigurimin teknik?

«Nisi me i kallxue kambët, — mendoi brigadieri, — po ma hedh te ato plagosjet...»

— Jo keq, — u përgjegj Lleshi. — Mundohemi...

— Kohët e fundit dy aksidentet që ndodhën këtu rrodhën thjesht nga pakujdesia. Ti shoku Llesh për punë nuk e ke shokun, po me njerëzit nuk mirresh dot vesh. I len në harresë, epesh mbas punës, aq të bëjnë njerëzit. Ti harron që gjithë këtë e bëjnë për njerëzit...

— Plagosje të lehta kanë pasë, shoku Sadik, e jo varrë pushkë!

— Për fat të lehta. Por dije që nuk duhet të ketë asnjë gërvishtje. Pastaj shpeshherë që kam kaluar këndej kam parë të punojnë edhe pa kaskë.

— Po ç't'u bash? Nuk u merr vesht koka! Njimijë herë u kam thanë.

— Nuk mjafton. Duhet t'ua bajsh, si i thonë... e-dukata. Po, po! Edukata.

Llesh Kalia psherëtiu. Edukata...

— Ilia posa më tha për dy propozimet e tua të reja. Ajo puna e përdorimit të mjeteve të thjeshta teknike më pëlqeu. Nuk është halli se ne kemi frikë nga avaritë dhe mund të mbetemi pa ajër. Ajri do të vijë përherë e më në rregull. Është gjetiu puna, te njeriu, te shqetësimi që ndjen ai nga ndërprerja e punës, te forca që duhet të ketë...

— Njeriu duhet të hahet edhe me maqinën dhe

LIBRARI E JETËS
7692

duhet t'ja dali edhe asaj, — foli Lleshi. — Po kur e bam qat propozim, nuk e tjerren aq hollë. Patëm vetëm hallin e punës.

— Çdo gjë duhet tjerrur hollë, Llesh, duhet analizuar. Kështu thotë partia.

— Drejt e ka.

— Duhet lidhur çdo gjë me politikën, me njerëzit. Lleshi pohoi me kokë.

— Po iki, — tha kryetari i bashkimeve profesionale. — Kam një mbledhje tani. Turnin e kam pasdreke. Mbaj vesh për ato që të thash, or Llesh Kalia.

— Mos ki dert!

Lleshi rrëmbeu prapë pistoletën. Sot duheshin hapur gjithë ato vrime minash në tavanin e tunelit. Punë e vështirë...

Pistoleta i dridhet në duar, ai e shtrëngon fort me dorzat si zakonisht të mbështetura në gjoks. Më shumë e mban me gjoks se me duar. Me gjoks... Një jetë të tërë me gjoks! Atij i pëlqen kjo lloj jete. Të lehtë nuk e kupton, nuk ja ndjen shijen.

Baromina i është ngulur tavanit si ndonjë kundërajror. Grindet me shkëmbin. Pluhuri i imtë bie si push i hollë mbi minatorin. Bien edhe leskra të holla shkëmbi. Të bardha, të mprehta, si leskra xhami. Shkëmb i fortë ky i tunelit...

Llesh Kalia e njej gurin, kënaqet me bardhësinë verbonjëse të pluhurit. I bardhë, i bardhë si mielli i situr në shtatë sita. I ngjan alabastrit.

Llesh Kalia ja di huqet shkëmbit; ja di forcën, ja ndjen bukurinë... Duhet të jetosh me shkëmbinjtë për t'jau kuptuar bukurinë. Të huajve ajo nuk u hyn në sy fare.

Shkëmbi ka dobësinë e vet. Baromina gjurmon, zgjedh damarët, shmanget ndonjë çikë, regëtin, përpelitet, pastaj bën udhë përpara.

Llesh Kalia buzëqesh. Kur buzëqesh ai, tuneli mbushet me dritë...

— Hej, Llesh! — thërret një punëtor, — ma ke

ngritë barominën si gjermani kundërajrorin në Fushë Alie...

Edhe kjo një histori në vete. Një histori e luftës. Shoku e ngacmonte.

Llesh Kalia e kish shtënë në dorë i vetëm kundërajrorin gjerman. Fare i vetëm. Një ditë dhjetori binte një llohë dëbore për qamet... Llesh Kalia nuk donte ta ripërtërinte këtë histori, por fytyrat e dy fricëve i dolën përpara mu në grykë të tunelit.

Lleshi buzqeshi me vete. Dy fricë si dy plepa, bavarezë ndoshta, me helmata dhe me automatikë në gjoks. Pas tyre tyta e gjatë e kundërajrorit. Një tytë e ftohtë që sillej në erë e kërkonte gjahun. Llesh Kalia po kthehej nga një detyrë zbulimi. Kur ja, kundërajrori... Duhet ta kishin sjellur atë ditë. Më përpara s'kish kundërajror. Ai qe zvarrisur dhe u kish dalë fricëve nën hundë. Qe zvarrisur pa urdhër, u kish dalë përpara pa urdhër. Ata të dy mënjanë, ai në të kundërtën. Grykë në grykë.

— Kaput! — Kishte thirrur me gishtin në këmbëzën e automatikut. — Kaput! Kaput! — u kishte thirrur edhe dy herë të tjera. Qe e vetmja fjalë që dinte. Po fjalë me peshë...

Kush do të shtinte më parë? Llesh Kalia kishte në favor befasinë, frikën që u hyri fricëve kur u mbiu përpara si ndonjë xhind. Gjermanët kishin lëshuar armët. Atëhere ai i kish kthyer në kafshë për tërheqje ushtarët e «lavdishëm» të rajhut. Ndërsa vetë rrinte pas tyre si qehja. E pati vështirë sa zbriti nga kodra, më pas gjeti kafshë.

Kush nuk e mban mend Llesh Kalinë kur u kthye në çetë mbi ndenjësën e hekurit të mitralozit që e tërhiqnin mushkat?

... Baromina ngeci. Ai e tërhoqi poshtë. Nje vorbull ajri dhe një gulsh pluhuri të bardhë. Fytyrat e dy fricëve sakaq u zhdukën.

Në ekran vetëm faqja e zhubravitur e shkëmbit, plot thepa dhe pluhur alabastri.

— Ajër ka pak o brigadier, — i thërret një minator i vjetër, — pash zotin, çka asht kështu?

— Lene zotin, Bexhet, nuk na hin në punë!

Ai bërtiti fort. Kështu bërtiste gjithnjë kur i përmendnin punë feje.

— Na asht mësue goja, — foli minatori, — ec e hiqe tash!

— Ajër ka boll, — thirri Lleshi.

— Po, erdhi boll tash...

KAPITULLI III

Lidja mbante vesh Zef Mërtirin. UKS-të buçisnin, inxhinieri ishte afruar shumë pranë vajzës dhe po i shpjegonte punën e bërë gjer atë çast. Pranë tij luante kokën në shenjë aprovimi një burrë që kish arritur të dyzetat. Ai tregonte në mënyrë tepër shprehëse kënaqësinë që i sillnin fjalët e Zef Mërtirit. Ishte një nëpunës, një nëpunës me detyrë jo fort të përcaktuar, se herë shqyrtonte normat, herë hiqej si skicograf, apo inventarizonjës. E quanin Palush Stajka.

Zef Mërtiri zu t'i fliste Lidjes për procesin e shpimit me UKS.

Vajzës i interesonte shumë kjo, në këtë sektor do të punonte.

— Pyka e rëndë hap një pus afërsisht dyzet metra të thellë, ti e pe projektin në zyrën teknike, apo jo?

— E pashë, — foli Lidja, — por të them të drejtën shumë gjëra i kam të paqarta. UKS-të janë diçka e re për mua. Nga sondat e tjera marr erë deri diku. Një kohë mendoja të specializohesha për naftën.

— Për mendimin tim sondat goditëse janë më të thjeshta se të tjerat. Nuk kanë shumë avaze. Pyka e rëndë çel pusin, kovat e pastrojnë, argjila i vesh paritetet për të mos u shembur dhe ta bën gati për beto-

nim. Në fillim çelim pusët kryesore, pastaj sekondaret. Një po, një jo! Nuk mund të hapen të gjithë njëherësh, se kanë largësi të vogël nga njëri-tjetri, dhe është rrezik të shemben nga goditjet.

Lidja vështronte punëtorët. I bëri përshtypje të madhe mosha fare e re e pothuaj gjysmës së sondistëve. Gjysma tjetër dallonte mirë nga rinia. Aty sikur nuk kishte breza ndërmjetës.

— Tani të lutem me shkoqit pak projektin konkretisht, — foli Lidja.

— Me kënaqësi, — tha Zef Mërtiri.

— Askush nuk mund ta flasi më qartë, — buzëqeshi Palush Stajka.

— Siç e dimë në digën që do të ngrihet këtu, nuk do të vendosen turbinat. Ato do të jenë në krahun tjetër, në një digë më të vogël. Kjo që do të ndërtohet këtu do të shërbejë për të pritur ujërat, për t'i ngritur ato në lartësi. Diga do të jetë prej zhavorri dhe do të mbushet përbrenda me argjil. Kjo, siç kuptohet, do të jetë mbi nivelin e shtratit të lumit. Asaj kemi kohë për t'ja nisur. Ndërsa ne tani po bëjmë, si të thuash, një digë nën shtratin e tij...

— Të kuptoj, — tundi kokën Lidja, — filtrimet...

— Po, filtrimet. Po të mos i pengonin këto, ujërat do të na humbisnin nën digë përmes shtresave të zhavorreve. Në shpojme zhavorret, konglomeratet gjer në gëlqeroret... Gjer aty do të arrijë perdja nëntokësore e digës, një perde çimentoje dhe betoni...

— Shumë e qartë, të lutem vazhdo, Zef.

Asaj ju duk sikur ai kishte ndryshuar ca, ishte bërë më i vrazhdët. Nuk ishte më ai Zef Mërtiri që kishte njohur në shkollë, i butë, me një natyrë gati prej vajze. Ajo kishte qenë dy vite më poshtë se Zef Mërtiri, megjithatë kishin patur shumë miqësi. Ai dhe e kish dashur... Vetëm kishte qenë një dashuri e njëanshme, që s'kishte shpërthyer, që kishte mbetur në zemrën e Zef Mërtirit, student i vitit të fundit. Dhe që ajo të mos shpërthente, që ai të mos i hapej, kishte qenë

shkaktare vetë Lidja. Ajo kishte qenë gjithnjë e matur dhe nuk i kish dhënë rast të fliste. Lidja nuk kish ndjerë dashuri për të, dhe po qe se ai do t'i hapej, druhej mos humbiste edhe miqësinë e tij. Kjo qe diçka tepër delikate që ajo me zor ja kish dalë në krye. Qe diçka që nuk e kuptonte si ja dilte mbanë, ashtu si nuk kuptonte pse nuk ndjente asgjë për atë djalosh të pashëm, të zgjuar dhe që dukej se e donte shumë.

— Ky lloj betonimi bëhet rrallë në botë, — vazhdoi inxhinier Zefi. — Numërohen me gishta vendet që po ja dalin. Edhe francezët, që janë mjaft të specializuar në këtë fushë, përtojnë t'ja hyjnë. Është një punë me shumë përgjegjësi.

— Inxhinier Zefi është ekspert për këto lloj punësh, — ndërhyri Palush Stajka.

Lidja i hodhi një vështrim të shpejtë atij që foli.

«Mos është servil, ky?» — mendoi për një çast.

Po Palush Stajka fliste krejt natyrshëm. Ose të paktën kështu dukej.

«Mbase një admironjës?..»

Mendimi i dytë iu duk më i arësyeshem.

— Mos të tremb kjo punë, Lidje? — pyeti inxhinieri papandehur.

— Jo, Zef. Nuk më tremb. Po me sa shoh unë do të më duhet të derdh shumë djersë për ta ndjerë veten të sigurtë.

— Patjetër, patjetër!

Ai tani kaloi në rolin e mësonjësit. Po Lidja bëri sikur nuk e vuri re.

Zuri të frynte erë. Erë me kokrriza rëre nga të brigjeve të Drinit. Era vinte si ndonjë shtëllungë e madhe dhe përplasej me fuqi pas malit, njerëzve dhe maqinave, një erë që doli papandehur nga lugina.

Kubetë e sondave u tundën, zunë të lëviznin, kavot e çeliktat filluan të shmangeshin nga pak.

— Ruani vertikalishtetin! — u dëgjua një zë. — Rrezikojmë pusët!

— Po të mos ruajmë vertikalishtetin, pykat do të

shpojnë shtrembër, a kupton? — i thirri Lidjes në vesh Zef Mërtiri.

Asaj ju duk se do të qe më mirë sikur ai të ndihmonte punëtorët që mbanin fort sondat, në vend që të jepte shpjegime.

Po inxhinieri nuk i dha shumë rëndësi erës. Nuk luajti nga vendi.

— A nuk ka rrezik të rrëzohet ndonjë UKS nga era?

— Edhe mund të rrëzohet. U kam thënë në këshillin teknik që t'i fiksojnë sondat mirë mbi shina. Një fiksim që të ketë një farë lëvizshmërie në përputhje me kërkesat e shpimit. A është më mirë të humbasim kohë apo të kemi avari? Unë anoj nga siguria...

— Më e mira do të ishte një zgjidhje në mes të dyjave, — vërejtí Lidja.

— Atë që thotë inxhinier Zefi, e thotë fjala e fundit e teknikës. Ai qe një vit për specializim në vendin më të përparuar të Evropës për diga mbi zhavorre.

Lidja u kthye nga Zef Mërtiri. Jo, ai s'kishte ndër mend t'ja priste fjalën Palush Stajkës.

«Djall o punë, — mendoi Lidja, — mbase i pëlqen ta lavdërojnë...»

Lidja kërkoi të kalonin në krahun tjetër, nga sondat rrotullonjëse.

Po u doli përpara Bardh Shkoza brigadier i betonimit dhe sekretari i partisë i sektorit. Bardhi buzëqeshte. Lidjes iu duk edhe më i madh se ditën që e kishte parë për të parën herë. I pëlqente ky njeri.

— Shumë mirë, shoqja inxhinierë, shumë mirë. Ju jeni dallëndyshja e parë në shkrepat tona; dallëndyshja e socializmit.

Sekretari i partisë ju duk si një çisternë energjike. Fliste shpejt, ngutej, gjithë fytyra dhe trupi merrnin pjesë në të folurën e tij, sikur donin të harxhonin energjinë e tepërme që zotëronin. Lidjes ju duk i rrëmbyer, po ajo pak a shumë kështu i pëlqente njerëzit.

— Një dallëndyshe nuk e sjell pranverën. — vërejtí Palush Stajka, — duhen edhe të tjera, shoku Hamdi.

— Eh, eh! Në at krah fli ti! Të shohish pas pak si do të mbushet me dallëndyshe këtu.

Sekretarit i shkëlqyen sytë e zinj.

— Dhe dallëndyshet do të qëndrojnë përherë këtu. Atëhere pranvera ka për të qenë e përjetshme këtu, — qeshi Zef Mërtiri.

— Ku punohet me shpirt ka pranverë të përjetshme, — tha sekretari.

Lidja gëzohej tek e ndjente të fliste kështu. Ajo kish vënë re se njerëzit që ishin të rrahur me jetën, ata që kishin bredhur me punë anakënd, përdornin një gjuhë tjetër, një gjuhë plot figura të gjalla, dhe nuk mund t'u afroheshe pa stonuar. Fjala dhe jeta shkojnë paralel kur pasqyrojnë njëra-tjetrën...

Sekretari i partisë u nda me Lidjen shumë miqësisht. Afërsisht kështu e përfytyronte Lidja një sekretar partie të veprave të mëdha.

— Tani mbeti pezull ajo puna e puseve sekondare, — vërejti Bardh Shkoza.

— Mbeti pezull? Pse, mos e kemi pasë ndonjëherë në rend të ditës? Hiq dorë nga marrëzirat. Nuk më pëlqejnë aventurat. Dhe besoj se këtë mendim do të ketë edhe shoqja Lidje që do të drejtojë tani punimet te ju.

Bardhi u kthye nga Lidja.

— Mos mbaj shpresa kot, — foli inxhinieri, — e njoh mirë Lidjen. Nuk shkel në dërrasë të kalbur.

Bardhi rrudhi buzët pastaj iku pa u folur.

— Ç'është kjo punë pusesh?

— Asgjë, Lidje. U është shkrepur të gjithëve të bëhen heronj. Një marrëzi e rrezikshme. Po unë nuk e hëngra. M'u qep e m'u qep... Edhe tani nuk e lëshoi pa qëllim atë fjalë. Dësh, si i thonë, të «të përpunojë» edhe ty.

— Kam përshtypjen se është njeri i mirë...

— Shkenca s'ka të bëjë me përshtypjet e tua, Lidje.

— Natyrisht që s'ka të bëjë, — u skuq ajo.

U duk prapë sekretari i partisë. Po ashtu i gjallë, po ashtu i ngutur...

— Harrova, — tha, të lutem drejtohu tek unë për çdo nevojë. Dhomën ta pashë. Nuk është kushedi çfarë, por hëpërhë... Të na falësh.

— Nuk kam asnjë nevojë, — u përgjegj Lidja, — dhe sa për dhomën nuk e dua më të mirë.

Ajo u përmbajt, se në të vërtetë që zemëruar. Kur po i fliste sekretari i partisë, solli ndër mend bisedën me shefin e kuadrit edhe me drejtorin. Kishin dashur ta linin në zyrën teknike. Këtë propozim ajo e kundërshtoi me të madhe. Ju duk sikur nuk kishin besim shumë te ajo. Betonimi që një proces me rëndësi. Ju duk sikur ata pranuan ngaqë nuk kishin ç'të bënin. Apo mos ishte vetëm një përshtypje kjo? Tërthorazi përgjegjja që i dha sekretarit të partisë lidhej me këtë. Ajo donte t'u tregonte të gjithëve se mund të jetonte dhe të punonte njësoj si të tjerët.

— Mirë, — tha Hamdiu, — këtu jemi. Ne do të mbajmë lidhje me njëri-tjetrin.

Lidjes i ngjiti në zemër, i ngjiti po aq sa Bardh Shkoza.

— Të kalojmë përtej, Lidje, — bërtiti Zefi.

— Ajo mezi e dëgjoi nga zhurma e maqinerisë. Zuri të ecte me kujdes mes tubave dhe pëllgjeve me ujë e me argjil. Ju ndotën këmbët.

«Këtu duhen çizme, — mendoi».

Pompat e argjilës gunzhinin, një bab rrihte me furi tubin e rrethimit, sondistët lëviznin si bletët në këmbët e sondave. Lidja ecte mes tyre. Ata ngrinin kokat një çast, pastaj harroheshin prapë në punën e tyre. Ndonjë seç pëshpëriste... Në çipat e buzëve të dikuj ndriste gazi. Lidja i kuptonte pas mënyrës së saj. Mbase të hidhura, mbase pak ironike?..

Inxhinieri me Palush Stajkën nuk po e ndiqnin dot. Ajo ecte tani pa çarë kokën për baltën prej argjili. Në një farë vendi u pengua pas një tubi, për pak

sa s'u rrëzua. U skuq dhe vështroi rreth e rrotull me turp.

— E kemi fajin ne, shoqe, — i thirri dikush nga e djathta, — e bëjmë lesh e li vendin e punës.

Ai që foli erdhi dhe ngriti tubin.

— Ç'punoni ju? — pyeti Lidja.

— Me sondat... Kryesondist.

— Cila është sonda juaj?

— Numër njëshi. Ja, ajo në ball.

Lidjes i zunë sytë një flamur të kuq mbi kubënë e sondës.

— Shpim rekord, — i foli Zef Mërtiri Lidjes. — Punën e një muaji në katërmbëdhjetë ditë!

Kryesondisti po merrej me shtangat. Nuk e ngriti kokën kur e lavdëroi Zef Mërtiri. Vetëm ndihmësit e tij të rinj sikur u krekosën ca.

— Njeri i çuditshëm, — i pëshpëriti pothuaj në vesh Lidjes Zef Mërtiri. — Enigmatik.

— Enigmatik, — përsëriti Palush Stajka.

Lidja fërgëllloi nga inati. «Ç'vesh që paska!»

— Thonë se ka qenë njeri me pozitë, por ktheu në zanatin e parë. Nuk e kuptoj. Mund të jetë edhe gënjeshtër...

Zef Mërtiri po e mërziste. I lëshonte mendimet për njerëzit si simitet e pjekura. Desh t'i përgjigjej diçka, por Zefi nuk i la kohë.

— Përgëzime, shoku Brahim, — i tha kryesondistit, — të uroj që mos të të lëvizë kurrë flamuri nga kulla!

— Urim i padrejtë, shoku inxhinier, — ja pat tjetri, — të mos lëvizë flamuri nga sonda ime do të thotë të mos më arrijë askush mua në realizimin e planit.

Zef Mërtiri u zu ngushtë. — E po, ç'të të uroj?

— Më uro thjesht, për fitoren që arritëm kësaj radhe.

Lidjes ju duk prapë se edhe këtu njerëzit mbanin një farë ftohtësie ndaj Zef Mërtirit.

— Inxhinierja e re! — e njohu ai xha Brahon me Lidjen.

Brahim Jergucati u drejtua. Tani ai dhe shtanga që mbante në dorë ishin paralel njëri me tjetrin.

Vajza i zgjati dorën kryesondistit. Ju duk sikur dora i lëvizi vetë në drejtim të tij... Pastaj zuri ta pyeste për punën me sondat.

Tjetri e la të priste gjersa fshiu mirë e mirë pëllëmbën e ndotur me vaj.

— Nga të folurit me dukeni vlonjate, — tha ai.

— Nga Vlora jam, — u përgjegj Lidja.

— Gjë e mirë një kantier si i yni. Njerëz nga të katër anët e Shqipërisë! Po të më pyesnin mua, gjithnjë kështu do t'i bëja organikat e kantierëve. E dini që kam takuar dje një saldator nga Konispoli? Nuk i kish rënë akoma brisk fytyrës, çun i ri...

— Kështu mendon edhe partia, shoku Brahim, — tha Lidja, — nuk janë kot gjithë këto aksione, gjithë këto vajtje-ardhje jug e veri. Ta njohim njëri-tjetrin, t'i qajmë hallet bashkë, dhe bashkë të ndërtojmë.

— Kështu kalitet klasa punëtore, shoku Brahim...

— Kështu kalitet, — përforcoi Palush Stajka.

Lidjes i erdhi në majë të hundës. «Nuk kishte punë tjetër ky njeri veçse të përsëriste fjalët e Zef Mërtirit?»

— Pas tri-katër turnesh pusi merr fund, — tha kryesondisti, — tani po shpojme matanë brezit të gëlqerorëve.

— I kini kampionet këtu? — pyeti Lidja.

— Ej, Sami! Të lutem sillna kampionet e fundit.

— Thirri Brahim Jergucati.

Ndihmëssondisti solli katër copë kampionesh. Lidja zu t'i vështronte me shumë interes ata cilindra gëlqerorë.

— A keni takuar ndonjëherë në shtresa ndërmjetëse? — pyeti.

— Rrallë o pothuaj aspak, — u përgjegj xha Brahoja. — Shpimet tona u përgjigjen pothuaj qind për qind të dhënave të gjeologëve. Këtu shtresat janë të përcaktuara dhe të ndara shumë mirë njëra nga tjetra.

Ai fliste. Lidja mendonte për të; mendonte për të

tjerët. Ku ishte «enigmatiku»? Këtu çdo gjë ishte e thjeshtë dhe pa zbukurime. Ajo mendoi se do t'i donte këta njerëz. Ajo i donte gjërat e thjeshta dhe pa zbukurime. Pastaj papritmas ju kujtua si kish ardhur në hidrocentral, ju kujtua dita e parë:

«Ajo mbante vesh padashur ç'flisnin pasagjerët në ndenjësën e pasme. Nu e tërhiqte ai peizazh fushash vjeshte të vonë dhe me fqinjnin i kish sosur gjithë muhabetet që të lejon një njohje e rastit.

Maqina çante me të shpejtë përpara. Kodra të brejtura rrathë-rrathë nga tarracat e ngushta, fusha si të arnuara nga ngjyrat e vjeshtës, ara të korrura gjer rrafsh me tokën, të ndriçuara butë nga shkëlqimi i diellit, konture të afërta dhe të largëta malesh, si të tretuara në pafundësi... Dhe kudo shtyllat e tensionit të lartë. Ato e ndjekin maqinën, maqina i ndjek ato.

I vështronte shtyllat e humbur në vegime të turbullta. Ato i ngjallnin në shpirt një ndjenjë të pashpjeguar pafundësie. Sikur i zgjerohej krahërori, kur i ndiqte me sy ato, e atdheu i dukej i madh, i paanë. Ato shtylla e shtynin të mendonte larg, të humbte në krahasime. I donte ato shtylla gjigande. Shtyllat, përgjasimi i kohëve të reja... Se kush këndonte andej nga fundi. Një këngë gjeologësh. Autobusët mbartin edhe këngë me vete... Këndonte keq, po çiltër dhe me gjithë zemër. Këngëtarit i mungonin shumë gjëra për të qenë këngëtar, po shpirt kishte me të tepërt.

Pas fronit të saj bisedonin.

— Po ikin dallëndyshet...

— Po troket dimri. Shtegëtojnë...

— Edhe ne shtegëtojmë, apo jo?

— Poezi po bën?

— Si të thuash... Një farë shtegëtimi, hidrocentral në hidrocentral.

— Po edhe kështu prapë ndryshon. Ne nuk breddhim botën, ama. Kërkojmë vetëm tokën tonë. Sot nuk na ngroh dheu i huaj, s'na hyn në punë.

— Gjë që dihet... A mos desha të them unë atë?

Lidja ktheu kokën prapa dhe vështoi ata që flisnin. Njëri ishte një çunak i parritur mirë, tjetri një emblemë fuqie, një goxha djalë që dilte tre pëllëmbë mbi kokat e të tjerëve e që e kishte shumë pisk me kollaron që i shtrëngonte qafën e trashë. Po ai kishte dy sy të butë që nuk i shkonin atij alamet trupi, ashtu siç nuk i shkon një notë e ëmbël një akordi të fortë. Trupi i tij sikur rrezatonte fuqi, sytë diçka tjetër, të ëmbël, të mirë.

«Qenkan punonjës të hidrocentralit, — mendoj Lidja, — mbase do t'i kem shokë pune».

Vajza zu të mendonte padashur për shtëpinë. Kishte vetëm nënën dhe një vëlla. Me nënën ishte ndarë mirë. Ajo kishte nxjerr vetëm një: «Eh, moj bijë, po merr rrugët e veriut?» «Po i marr, mama!» «Merri bijë, merri. Shkel në gjurmët e babajt andej...» «Eh, nënë mos na përmallo tani!» E kish mbyllur bisedën i vëllai. Dhe me kaq kishte marrë fund. Ajo qe nisur. Po tek vinte këmbën në autobus i erdhën edhe një herë në mendje. «Gjurmët e babajt». Ai qe vrarë partizan shumë më larg vendit ku do të shkonte Lidja, po për nënën andej qe veri. Veriun ajo e lidhte me vdekjen e të shoqit.

— Ishe me leje, ti Bardh?

— Jo, kishim mbledhje në ministri...

— Paskan thirrur edhe brigadierë?

— Edhe punëtorë të thjeshtë madje. Pse, ç'kujton ti? Vija e masave.

Ky që fliste kështu ishte trupmadhi. Dhe atë e quanin Bardh...

«Duhet të jetë nga veriu, — se si mendoj padashur Lidja. — Po e ka kthyer gjuhën krejt. Mbase ka punuar në jugë...»

— Te ne do të vijë edhe një inxhinierë, — vazhdoi trupmadhi mbas Lidjes. Ma thanë dje.

— Vajzë? S'ma ha mendja!

— Kështu si të them. Ma treguan edhe emrin, po e harrova. Kishte një emër si të vështirë... Nuk ja mbaj mend.

Vajza u drodh. Zemra nisi t'i rrihte me vrull, sikur të kishte ndonjë arësyje të fortë ta bënte këtë.

«Të kthehem, — tha me vete, — t'i pyes mos e quajnë Lidje?»

Po ajo nuk u kthye. Biseda pas ndenjësës së saj heshti. Në krah të djathtë të rrugës u hap lugina e gjerë e Drinit. Gjithë ato ujëra, gjithë ato ujëra...

— Paska rënë shi maleve. Drini gjithmonë ngryset kur bie shi.

— I ngrysur duket më i rreptë...

Ndërkaq Lidja mendonte për digën, për njerëzit, për kantierin...

Ja kish ënda që kantieri të ishte larg, i humbur mes malesh dhe pyjesh. Kish një ide të mjegullt për kantieret e largëta, një ide që e joshte, që e ftonte për gjithë ato gjëra. Andej heroizmi dhe sakrifica ishin binjakë, andej ashpërsia i vinte në provë njerëzit. Andej njerëzit vinin në provë vetveten...

Pothuaj të gjitha mendimet e saj ridhnin ose nga leximet, ose nga përfytyrime të guximshme mbi heroikën, mbi ritnin e etjes për të bërë diçka. Eh, mendimet e saja! Ajo kish qenë gjithnjë e rreptë, kërkuese ndaj vetëvetes, prandaj e kish patur pisk me to. Mendime që presin të shpërthejnë, që presin të bien mbi një shkëmb dhe ta bëjnë udhë, të bien në të errët dhe të bëjnë dritë... Mezi ç'kishte pritur të mbaronte shkollën. Ishin mendimet ato që s'e linin të qetë. Nëpër auditore nuk mund të shpërthenin aq lirshëm dhe aq frytshëm sa në jetën praktike. Jeta është kaq herë më e madhe se një auditor, se një universitet...

Autobusi e pakësoi shpejtësinë, këngëtari i ndali diku gjeologët edhe ata të dy pas fronit të Lidjes zunë të përgatisnin plaçkat.

— Do të vete një herë drejt e në zyrën e kuadrit, — tha trupmadhi.

Vajza u kthye me rrëmbim.

— Të kuadrit të hidrocentralit?

— Po.

— Ma tregoni edhe mua, ju lutem, — tha. — Jam emëruar këtu.

Ata të dy luajtën pak nga vendi për ta parë më mirë. Lidjes ju duk sikur nuk ua mbushi syrin. Ajo gjithmonë mendonte se nuk ua mbushte shumë syrin të tjerëve.

— Posi, shoqe, posi. Ta tregojmë ne zyrën e kuadrit.

Zbritën. Trupmadhi e ngriti si pendë valixhen e rëndë të vajzës. Lidja kërkonte me sy kantierin.

— Kantieri nuk duket, — shpejtoi të fliste çunaku, — është pas bërrylit të malit, po sondat do t'i shohim për pak. Po ç'keni ardhur të bëni këtu?

— Do të punoj, — tha Lidja si pa të keq.

— Është fillimi, — foli trupmadhi. Këtu nuk kemi asnjë vajzë përveç atyre që punojnë në menca. Po ju, me se do të mirreni? Mos do të punoni me pistoletë?

— Në mos me pistoletë, me matrapik, — ja ktheu Lidja.

Ata të dy u panë sy në sy.

«Kjo qenka e zanatit», — mendoi trupmadhi.

Ai qëndroi papritur edhe la valixhen përdhe.

— Pritni, pritni, — bërtiti si i hutuar. — Mos jeni inxhinierja e re?

— Po! — u përgjegj Lidja duke qeshur.

Trupmadhi i ra fort supit të çunakut.

— A nuk të thashë unë, Baftjar!

Pastaj i zgjati dorën Lidjes: Unë jam Bardh Shkoza.

— Bardhi «sa një vinç!» — plotësoi çunaku.

Kaloi një eskavator i rëndë. Kova i tundej ritmikisht dy pëllëmbë mbi dhe. Eskavatoristi kishte nxjerr kokën në dritare dhe fishkëllente. Pastaj një varg Tat-rash të ngarkuara rëndë me zhavor e mbushën rrugën me zhurmë.

— Kantieri është pas bërrylit të malit, — përsëriti Bardhi «sa një ving.»

Lidja psherëtiu me zemër të lehtësuar.

* * *

Shefi i kuadrit se nga kishte vajtur. Bardhi e futi vajzën në zyrën e shefit të llogarisë.

Lidjes i doli para sysh një kokë gjysëm tullace që nuk lëvizi fare nga shkresat. Madje Lidjes ju duk sikur u zhyt më shumë në to.

— Të ulemi pak këtu, shoku Zaim, sa të vijë shefi i kuadrit...

— Ju lutem, ju lutem.

Gjyslykët me rrathë të ndritshëm nikeli reflektuan ca shkëndija drite po ai nuk e prishi prapë terezinë.

— Shoku Zaim, ke njerëz të huaj në zyrë...

Shoga e nëpunësit lëvizi, kapakët e syve ju përpëliten dy a tri herë si me frikë dhe habi, pastaj ai u ngrit në këmbë dhe i afroi një karrige Lidjes.

— Do të punojë te ne, — tha Bardhi. — Inxhinierja e re.

— Urdhëroni! Gëzohemi shumë! Zo... zo...

Lidjes ju duk se desh ta quante zonjushë. Ç'kuptim kishte kjo?

— Urdhëroni, shoqja inxhinierë! — e nxori fjalën më në fund nëpunësi, — uluni. Shefi i kuadrit do të vijë për pak... sapo doli.

Ai fliste shpejt, po i theksonte fjalët në mënyrë të veçantë.

Bardhi, që mbeti në këmbë, u mbështet pas tavolinës.

Letrat u shtynë tutje, ca penda e lapsa u rrotulluan mbi letrat dhe kallamari ment ra. Po Zaimi u hodh me shkathtësi dhe e priti pa rënë përdhe.

— Ja, jemi ngushtë, — tha ai sikur të shfajësohej për diçka, — nuk jemi rregulluar akoma mirë. Gjer

tani ma kanë ndërruar zyrën tri herë. Kantier i ri, ju lutem...

Fjalën e fundit e kishte në gojë vazhdimisht. E thoshte me shumë njerëzi, por përsëritja të velte. Lidjes ju duk si i trembur, si i shushatur. Pse kishte frikë ai?

Nëpunësi nuk dinte ç'të bënte. Një herë nisi të shfletonte dosjet, pastaj zuri të mprichte lapsat. Të gjitha këto i bënte lehtë dhe pa zhurmë. Ç'do gjë e bënte me një delikatesë që binte në sy. Ai përpiquej shumë të mos e shqetësonte tjetrin.

— Më falni, — u ngrit ai, — do të vete te drejtori. Ju mund të rrini sa të doni.

Bardhi «sa një vinç» buzëqeshi, Lidja gogësiu e mërzhitur dhe ja nguli sytë trupmadhit.

— Tip më vete, — ngriti supet ky — s'mirret vesh... Këtu asnjëri nuk e thërret Zaim, por «Zaho, modë e vjetër.» Do ta njihni vetë...

— Nuk ndjehej rehat në karrige, përpëlitej si zog, — vërejti Lidja.

— Kështu bën gjithnjë kur vjen ndonjë i huaj...

— Mbase mendon si e si ta presi më mirë dhe nuk ja del? Ka shumë nga këta njerëz.

— Nuk ja del? Të shohësh si i pret punëtorët e thjeshtë! Nuk e ngre kokën nga letrat ashtu siç bëri kur hymë ne. Po a nuk ju duk edhe ju si «modë e vjetër..?»

— Ju lutem ta lemë këtë muhabet, — tha Lidja. Tjetri heshti.

— Në ç'vend punon këtu inxhinier Zefi?

— Zef Mërtiri? Ai djali i pashëm?

— Po, Zef Mërtiri. Ju e mbajtkeni këtu për djalë të bukur.

— Kije inat dhe foli hakun. Për i pashëm të merr në qafë.

Vajza lëvizi dorën.

— Ç'hyn këtu kjo?

— Në digë punon, — foli tjetri. — E njihkeni?

— Po, kam bërë shkollën me të. Ai ishte nja

dy vite më lart. Sa mirë që qenka këtu! Flitej se do ta çonin në Elbasan.

Hyri Zaimi.

— Shefi i kuadrit po vjen. I dërgova fjalë. Ju lutem... Lidja ja qepi sytë. Asaj nuk i pëlqeu sjellja e këtij njeriu. Megjithatë nuk ju duke se shtirej. Besonte se të sjellurit e tij qe organikisht e lidhur me natyrën e tij. Po ku ta dish? Mbase edhe ndonjë dobësi... Sidoqoftë ai njeri nuk i pëlqeu.

— Dalim, — i tha Bardhit.

— Urdhëroni, ju lutem!

Aj ja hapi derën me shumë njerëzi.

— Eh, — qeshi Bardhi, — ç'do të ketë hequr gjersa e gjeti shefin e kuadrit. Vë bast që ka vajtur vetë ta kërkojë. Lidja tundi kokën. Bardhin «sa një vinç» sikur e njihte prej kohësh... -

Këto sillte ndër mend Lidja aty përpara sondave. Kështu kish filluar për të dita e parë në hidrocentral. Ajo nuk dinte çfarë të mendonte për mbresat që kish patur. Sidoqoftë ajo nuk e kish ndjerë veten aq të huaj aty. Kish ndjerë që ajo mund të futej pak nga pak në jetën e kantierit të madh, të shkrihej me të. Të shkrihej! Kjo kishte rëndësi. Dhe ja tani puna, kantieri, punëtorët... Lidja mendonte për të ardhmen. Ajo do të ishte në krye të këtyre njerëzve. Do t'i mësonte, do t'i udhëhiqte, do t'i urdhëronte. Plane, udhëheqje, urdhëra, mësim! «Ti ke nevojë vetë Lidje të mësosh nga këta njerëz, — i tha vetes.

— Ku humbe kështu, Lidje? Ç'ke?

— Asgjë, Zef.

— E qartë, e qartë! Tani fillojnë kokëçarjet. Nuk është si në shkollë këtu.

— Më mirë. Njeriu sikur ndryshket pa kokëçarje. Ç'do të bëheshin njerëzit po të mos kishin nevojë të vrisnin mendjen për asgjë.

— Të lumtë! Për një gjë të tillë s'më ka rënë në mendje të mendoj kurrë.

Gryka e Drinit ushtoi sërish nga era. Një luginë gjithë teka...

Lidja ndjeu të ftohtë. «Veç, çizmeve më duhet edhe një xhup i mirë, — mendoj, — një xhup me pambuk. Kështu do ta ndjej veten edhe më të qetë në mes të punëtorëve».

U ndanë. Palush Stajka mori andej nga tuneli.

Në ranishtë u ngrit një vorbull tymi. Erë. Erë e fortë dhe krisma maqinash. Pas malit plasën një varg minash. Pushuan... Boritë e automobilave grindeshin për udhë të lirë. Bori «Tattrash», «Skodash», «Lumver-dhash»...

Lidja ndjeu në shpirt gëzimin e veprës së madhe, atë gëzim që ndjejmë kur i përkasim diçkaje madhështore, diçkaje me përpjesëtime të habitshme.

— Lidje! — i pëshpëriti Zef Mërtiri. — Sa mirë që jemi bashkë!

Ajo nuk e kishte mendjen te ai. E kishte harruar. Ai tani sikur i përkiste një krisme të largët të një gjëmimi që qe shuar...

KAPITULLI IV

Xha Brahoja buzëqeshte. Kryetari i komitetit profesional dukej i mërzitur ndërsa sekretari i partisë zjente. Ai gjithnjë zjente, edhe nga gëzimi, edhe nga hidhërimi.

— Atë Ahmatin e gjeta dy herë në gjumë, mbrëmë, — tha kryetari i komitetit profesional.

— Duhet marrë një vendim për të, — foli sekretari i partisë së sektorit, — na e ka prurë në majë të hundës. Duhet të mblidhemi...

— Të marrësh vendim është gjë e thjeshtë, — foli i menduar Brahim Jergucati.

— Ai është neglizhent, është kapadai, grindavec, dembel...

Sekretari i partisë foli me zemrim të madh.

— Ti, Hamdi, je një sekretar partie tepër gjaknxeh-të, — tha xha Brahoja. — Një sekretar partie shumë i mirë, — shtoi ai pas pak, — po ja që je gjaknxeh-të...

— Ma kanë thënë gjithandej, — bëri një lëvizje padurimi me dorë Hamdiu.

— Dhe sa për atë Ahmatin... të gjitha mund të jenë ashtu si thoni. Doni t'ju them të drejtën? Hiç fare s'më pëlqen ai njeri. Po a bën ta gjykosh tjetrin vetëm me përshtypje? Me mbresa?

— Ç'përshtypje, xha Braho? Si flet kështu? Ai është i zhytur në llum gjer në grykë!

— Pse e latë të bjerë, atëhere?

Balanca e zemërimit anoi nga Brahim Jergucati.

— Kemi punuar me atë njeri...

— E di, shoku Sadik, e di. Këshillime, nxjerrja para kolektivit, këndi i emulacionit...

— Mos janë pa vlerë?

— Nuk them ashtu, kam njëzet e pesë vjet që pu-noj... S'mund të them unë ashtu. Po përpara asaj që duhet bërë, më duket e vogël. Ne na duhet të punojmë për edukimin e punëtorëve më thellë, më larg dhe në mënyrë të organizuar. Dhe sa për t'u mbledhur, mund të mblidhemi. Po ama do të shqyrtojmë atë që thashë unë. Për Ahmatin nuk mund të vendosim ne, por kolektivi. Dhe mbase ndreqet...

— Ai është i pandreqshëm...

— Mundet, Hamdi. Po t'i shkrehim gjithë armët një herë...

— S'ka plumb që e shpon atë.

— Me sa di unë, Ahmati ka punuar dje në dy turne.

— Se mos e bëri me qejf atë punë. E zu bulluri, si i thonë. S'pati kush të qëndronte në turnin tjetër. Dy sondistë të sëmurë. Do të kërkojë t'ja paguajmë orët e tepërta...

— Duhet t'ja paguajnë pa i kërkuar, Hamdi. Pastaj

është punë tjetër, në i merr, apo jo. Po le të kthehemi prapë te neglizhenca e Ahmatit, Sadiku e gjeti në gjumë, apo jo?

— Në kokërr të qejfit!

— Po a beson që punoi ai pasi e zgjove?

— Rezultatet e shpimit thonë të kundërtën...

— Dhe ishe i bindur ti, Sadik, se kështu do të ndodhte?

— Po, e dija që do t'ja këpuste gjumit prapë.

— Atëherë pse nuk vajte ta zëvendësoje? Ti ke edhe kategori të lartë në shpime.

Në sytë e xha Brahos ndritën ca shkëndija zemrimi.

— Fantastike! — thirri kryetari i komitetit profesional, — ai të flejë dhe unë t'ja bëj punën!

— Mundet që Ahmati nuk rezistoi dot më, — tha xha Brahoja. — Ai ankohet shpesh se është sëmurë. Po unë nuk e kam fjalën vetëm për atë, po në përgjithësi. Duhet ndërruar mënyra e punës me njerëzit, stili, si i thonë... Erdhën kohë të reja... E reja me të renë. Pastaj ne sikur s'i njohim mirë gjithë njerëzit. Edhe ata që i njohim, pak i njohim. Kur na del diçka e papritur çuditemi dhe sikur pyesim veten si është e mundur të ndodhë kështu. Ja, ngrihet mbrëmë brigadieri i brigadës së dytë të çimentimit dhe kërkon me të madhe t'ja paguajnë nja tri orë që nuk ja kishin futur në bordero. E pesëmbëdhjetëditëshin mori afër 700 lekë të reja... Nejse... Po si i kërkonte ato tri orë? «Paguamni, o krisi dhe iki!» Në një kohë të tillë të flasi kështu! A nuk sheh ai çfarë bëhet në të katër anët e vendit! Nuk ndjen gjë kur fshatarët e Jugut u dërgojnë malësorëve të Veriut mijëra bagëti? Kur njerëzit punojnë me muaj nëpër aksione? Me muaj dhe me vite!.. Çfarë t'i thuash atij brigadierit? Asgjë tjetër vetëm se është fyell fare nga politika.

— Ai është koprac! — tha Hamdiu.

— Ai është lekist! — e pasoi kryetari i komitetit profesional.

— Ai është individualist, — vazhdoi Hamdiu.

— Tamam! Po ç'janë këto në fund të fundit? Bota e vjetër, kokë e këmbë! Ja ku dolëm te edukimi, te puna me njerëzit. Për mua ky problem është si ato rrugët bashkëqendrore të një qytetit të madh. Ngado të nisësh, në qendër se në qendër vjen! Ç'kemi bërë ne gjer tani? Nga kjo ta fillojmë punën.

— Kur ta lëmë mbledhjen? — pyeti Hamdiu.

— Në pesë do të ishte tamam koha. Nesër pasdite në pesë...

— Po, në pesë mirë është, — tha Hamdiu. — Mendoj që të shikojmë edhe punën e komisioneve për revolucionin tekniko-shkencor. Vetëm këto dy gjëra. Asnjë më tepër!

— Mirë u pafshim atëherë, — nxitoi xha Brahoja.

— Një minutë! e ndali Hamdiu — Ka nja tre a katër ndihmësdistë që nuk janë regjistruar në kurset e kualifikimit. A nuk bën t'u dërgoni nga një letër e t'u caktoni kurset? Do të ishte diçka e mirë... Ata nuk do të kenë nga të bëjnë bisht. Hëpërhë mendojnë ndryshe. Edhe ai ndihmësi yt po kështu, xha Braho.

Heshtje. Asnjëri nuk po lëvizte nga vendi. Hamdiu u përtyp e u përtyp, së fundi e nxori atë që desh të thoshte:

— Xha Braho, duhet të ndjekish shkollën, — tha. — Ti e di që së shpejti hapet teknikumi këtu.

— Ehu! Shkolla për mua tani është si kofini pas të vjeli.

— Duhet shkolla edhe njëqind vjeç qofsh. Këtu s'e ke drejt, xha Braho. Unë e them përpara të gjithëve që prej teje mund të mësojë kushdo për shumë gjëra të jetës, kam mësuar dhe përpiqem të mësoj edhe unë, po këtu ti e shkel...

— Dëgjo, Hamdi, — ngrysi vetullat kryesondisti, — ti e di si e kam mbaruar shtatvjeçaren unë. Nuk kam bazë për shkollën e mesme. S'vete Brahim Jergucati të tallen me të. Më kanë dalë thinjat tani. Pastaj ju e dini që unë përpiqem, lexoj materialet e partisë, shtypin. Pyes dhe s'më vjen turp të pyes Po deshët të më

fusni në shkollë, dërgomëni në ndonjë kurs partie.

— Pse, më lehtë të duket kjo?

Fliste vetëm Hamdiu, kryetari i komitetit profesional nuk bënte zë. Megjithatë ai dukej që ishte i shqetësuar: i binte tokës me majën e këpucës.

— Nuk them se është më lehtë, por unë jam komunist i vjetër. Pak a shumë janë gjëra me të cilat jam marr në jetën e partisë. Atje them se nuk mbetem në baltë.

— Shkolla...

— Të lutem mos më bëj agjitacion mua, — e ngriti pak zërin Brahim Jergucati. — Unë e di ç'është shkolla dhe askush më shumë se unë nuk e ka provuar ç'do të thotë kur të mungon ajo. Më kuptoni, besoj... Pse ta zgjasim këtë muhabet?

Hamdiu e zuri për krahu me dashuri.

— Nuk të bëj agjitacion, — i tha, — unë s'jam i zoti të të bëj agjitacion ty. Për atë punë ti na e kalon të gjithëve, sado që ke vetëm shtatëvjeçaren. Por them që ta marrim shtruar. E ke bërë shkollën shkel e shko? Dakord! Ke boshllëqe? Dakord! Po a nuk mund të mbushen ato? Po të duash ti, xha Braho, bën mrekullira...

Kryesondisti vështronte përdhe dhe tundte kokën. Diçka i digjte thellë në shpirt, i digjte sa herë e kujtonte këtë gjë. Por ajo kish shkuar tani. Ajo që shkoi, shkoi. Pastaj ç'i duhej teknikja atij? Ai edhe ashtu me praktikë ja dinte të gjitha të fshehtat zanatit.

Kështu po mendonte xha Brahoja.

— Kështu pra...

— Mirë u pafshim! S'di ç't'ju them...

Ai u dha dorën shpejt e shpejt dhe u largua drejt sondave.

Ata të dy morën poshtë nga kantieri. Zunë të flisnin për Brahim Jergucatin.

— Njeri i fortë...

— Njeri i qartë politikisht.

Hamdiu ndaloi hapin dhe u kthye e vështroi kryetarin e komitetit profesional në fytyrë.

— Ai e kupton thellë politikën e partisë se ka edhe një përvojë të madhe. Të kishte shkollë do t'i kishte shokët të rrallë. Çfarë intuïte që ka!

— Edhe kështu si është të rrallë i ka shokët...

— Po!

— Do t'i mbushet mendja vallë?

— Xha Brahua këtu ka ngecur, — tha i mërzhitur sekretari i partisë, — ka ngecur keq. Ndoshta duhet t'ja vëmë detyrë partie. Po duhet ta mendojmë mirë këtë punë, sepse ne s'mund ta lëmë xha Brahon në baltë.

— Nuk po të kuptoj...

— E kam fjalën që puna jonë s'mbaron vetëm me të mbushur mendjen atij të vazhdojë studimet. Madje ndoshta këtu fillon. Ajo që ka rëndësi është si ta ndihmojmë paskëtaj.

— Ç'është e vërteta e ka të vështirë.

— Kemi edhe të tjerë si ai, po nuk kundërshtojnë. Një motorist më zuri në udhë sot për këtë punë. Më pyeti kur do të regjistrohej. Dhe ku ai, ku xha Brahoja nga niveli. Po e di si është puna? E ka lënë zvarrë njëherë e një kohë këtë gjë dhe zvarrë kërkon ta shpjegjë... Pastaj ka edhe sedër.

— Ndoshta, — u hodh kryetari i komitetit profesional, po unë nuk e kam vërejtur. Megjithatë mendoj që kjo lloj sedre për xha Brahon nuk ngre shumë peshë.

Ecën një copë udhë pa folur. Arritën përpara zyrave të kantierit. Sadiku desh të futej brenda, shoku i tij e zuri për krahu.

— Xha Brahoja më bëri të mendohem thellë, — tha, — ai është si ajo pasqyra e mirë që reflekton pastër çdo objekt. Ai di të futet lehtë në shpirt, di të bëjë për vete. E di që shpeshherë, kur dua të vendos për diçka, më vete mendja te ai? «Sikur ta bisedoja edhe me xha Brahon». Prandaj e pata aq vështirë t'ja nisja çështjes së shkollës me të. Ndoshta e vure re.

— Nuk të duket një çikë ëndërronjës, xha Brahoja?

— Thjesht ëndërronjës? Aspak! Ai është një ëndë-

rrojës i një kallëpi të ri, nga ata që ëndrrat i vënë në jetë.

Kryetari i komitetit profesional u fut në zyrën e vet, ndërsa Hamdiu mori poshtë nga parku i automjeteve.

KAPITULLI V

Lidja qëndronte pranë UKS-ve. Dy sonda e përfundonin edhe për pak orë krejtësisht shpimin. Pastaj ajo më e vështira, betonimi... Ajo kishte dashur t'i thoshte Zefit mos ta linte vetëm në betonim. Kishte dashur... Vetëm kaq.

Për aq kohë sa kishte në kantier i kishte hyrë punës mjaft mirë. Ditë të lodhshme pune, të pleksura me një farë ankthi dhe nervozizmi për të arritur sa më shpejt atë që duhet të dijë një inxhinier me profil të tillë. Kishte mësuar shumë, por sa pak që kishte ditur! Kokën e kishte plot formula, plot teori. Në praktikë ajo po krijonte skedarin e tyre, pastaj mendohej t'i fuste në punë. E shihte që jo gjithshka që kishte mësuar përputhej pikë për pikë me jetën. Këto ditë pune në kantier i mbushën mendjen se shkolla i kishte dhënë metodën, i kishte hapur dyert për të mësuar vetë, për t'u thelluar më tej. Kjo vlente po aq sa vitet e Universitetit, e mbase më shumë. I bënte përshtypje të thellë përvoja e njerëzve të thjeshtë, e punëtorve të sondave, e teknikëve. Shkenca te ata nuk i kalonte mbase caqet e praktikitetit dhe eksperiencës, por shtjellohej me një zhdërvjelltësi të habitshme. Punëtorët ishin mjeshtra të vërtetë për të ndarë në një kohë shumë të shkurtër të nevojshmen nga e pavlefshmja, dhe për ta futur në punë menjëherë. U ndihte eksperiencia. Po në fund të fundit a nuk është çdo gjë eksperiencë? Eksperiencë e ngritur gjer në abstraksion nga mendimi njerëzor?

Shoku Enver në një fjalim me rëndësi ngrinte me të madhe problemin e të mësuarit nga populli. Lidja vetëm tani e kuptonte siç duhej vlerën e këtyre këshillave. E vërteta ndjehet që prej së largu, por, kur e provon, ndjehet akoma më mirë.

Erdhi Bardhi «sa një vinç».

— E treta dhe e pesta po i japin fund, — tha. — Kovat mezi nxjerrin nga një grusht sllom.¹⁾

— Shumë mirë, shoku Bardh.

— Kur mendoni t'i futemi betonimit?

Lidja u skuq.

— Si të them, — tha, — mbase menjëherë, por për këtë do të bisedojmë me shokët inxhinierë.

Bardhi tundi kokën.

— Ndoshta inxhinier Zefi do të qëndrojë këndeji. Në çimentim nuk ka shumë punë tani. Pastaj ky sektor ishte i tij...

— Po kështu më thanë edhe në drejtori. Mirë do të jetë po të vijë.

«Asaj nuk i vjen rëndë, — mendonte Bardhi «sa një vinç», — nuk i vjen rëndë për atë që s'e di dhe nuk mundohet ta fshehë. Nuk ka sedrën e Zef Mërtirit».

Atij i kujtohej se si kishte vepruar me aq doreza, me aq takt e dhelpëri Zef Mërtiri, për të njohur shpimin pa u pikasur që kishte gjithë ato boshllëqe.

— Edhe inxhinier Zefi nuk ishte aq i shkathët në fillim, — tha Bardhi, — u bënë gjithë ato prova për UKS-të...

Inxhinierja vështronte transhenë. Argjila i dukej e hollë.

— Mbase duhet trashur, Bardh, më duket se viskoziteti është i madh.

— Ashtu më duket. dhe mua, — tha Bardhi i çuditur. Për të kuptuar argjilën duhej një farë eksperiencë shpimesh.

1) Sllom = gurishte, zhavorre, materiale që nxirren nga pusët.

— Le të ndërrojnë raportin e përzjerjes!

Brigadieri shkoi nga punëtorët e argjilës. Lidja u kthye drejt udhës kryesore. Dy veta po afroheshin te diga.

— Njëri është përgjegjësi i mencës, — tha Bardhi.
— Po tjetri? Duket si i huaj. Përgjegjësin e mencës e kemi poet.

— Sa mirë! — tha Lidja. — Poet... Një përgjegjës poet duhet të jetë diçka shumë e mirë.

— Ashtu duhet të jetë, po ama, nganjëherë ja var punës së kuzhinës.

— Epo, nuk thonë kot që poetët jetojnë në qiej, — e ngacmoi Lidja.

— Ehe, sot çdo gjë duhet të qëndrojë e kapur fort pas tokës, — u përgjegj brigadieri.

— Drejt e ke, Bardh!

Përgjegjësi i mencës i njohu me të huajin. Ishte gazetar, korrespondent i «Zërit të Popullit».

— Ju jeni inxhinierja e re? — hyri menjëherë në bisedë gazetari. — Më kanë folur shumë për ju në drejtori.

Lidja ngriti supet.

— Nuk e di çfarë mund t'ju kenë thënë atje. Nganjëherë ata të administratës i idealizojnë gjërat, i fryjnë. Për mua s'kanë ç'flasin shumë. Posa kam ardhur. Mbase i nxit fakti që jam vajzë.

Lidjes i erdhi inat. Ishte i katërti gazetar që i dërgonin. Sikur donin t'u bënin surpriza gazetarëve. Ajo ndjente se nuk ishte e drejtë një gjë e tillë. Ç'kish këtu ndonjë gjë të jashtëzakonshme që i dërgonin gazetarët asaj?

Ata të katërt zunë të ecnin përpara sondave.

— Asgjë nuk kuptoj ç'bëhet këtu, — foli gazetari, — asgjë nuk kuptoj: Kam qenë edhe një herë një muaj më përpara. Po ka shumë ndryshim. Këtu të mirren mentë nga lëvizja dhe nga puna. Gjithë këto maqina... Diçka me përpjesëtime të habitshme.

— Epoka jonë! — tha Lidja duke vështruar larg.

Gazetari u ndal me rrëmbim.

— Po sikur të shkruanit diçka? Epoka jonë... Ndoshta një skicë, një reportazh të shkurtër...

— Nuk e di, — tha Lidja, — nuk e kam provuar. Mbase mund të shkruaj diçka me kohë, por nuk ju premtoj.

— Dëshironi të njiheni me procesin e punës? — pyeti Bardhi.

— Po, diçka në përgjithësi. Edhe herën tjetër m'i shpjeguan disa gjëra.

— Në dy-tri shkrime për hidrocentralin kam gjetur gabime, — tha Lidja, — gabime teknike. Disa herë gazetaret nuk thellohen shumë në procesin e punës.

— Mundet, — buzëqeshi gazetari, — ne i japim më shumë rëndësi njeriut dhe kjo kuptohet. Po kur të gjeni gabime na shkruani. Unë sot kam në plan të flas me punëtorë pararojë, me teknikë, me inxhinierë. Dua ca tipa të gjallë për një reportazh të gjatë.

— Për të gjallë nuk ke ku i kërkon më shumë se këtu, — u përgjegj Bardhi «sa një vinç».

Lidja vështronte përgjegjësin e mencës. Një djalosh i ri, i shkurtër, i lidhur mirë. Tepër i gjallë, sytë i lëvizin në katër anët. Duket ëndërronjës, por ëndërrimi te ai sikur ka një natyrë tjetër, i përshtatet gjallërisë së tij.

— Ja, mund të fillojmë me ju, ju lutem, — vazhdoi korrespondenti.

Lidja qeshi me gjithë zemër.

— Gazetarët janë si rrodhet, apo jo? — u mundua t'ja blente mendimin korrespondenti.

— Pak a shumë, — u përgjegj buzëgaz Lidja.

— Pra?

— Unë s'kam asgjë se ç't'ju them, — foli Lidja. — Përshtypjet e mia si dhe ato që ndjeja ditët e para ja kam dhënë korrespondentit të gazetës «Puna». Po që se mendoni të shkruani për mua si për një punëtorë të dalluar do të ishte një padrejtësi ndaj të tjerëve dhe ndaj së vërtetës. Për kaq kohë sa kam unë këtu, nuk kam pasë mundësi t'i jap asgjë punës.

Gazetari ngriti krahët.

— Më vjen keq, por... si të doni!

— Pse nuk nxirrni një vjershë të poetit tonë? —
pyeti Bardhi papritmas. — Ne kemi një poet shumë
të mirë...

— Jo vjershë por poemë, — rrudhi buzët përgje-
gjësi poet. — Unë kam një poemë për dritën, për hi-
drocentralin.

— Në rregull, — tha gazetari, — në mes të repor-
tazhit një fragmet poeme për dritën. Në rregull...

— Ai i di përmendësh vjershat, — tha Bardhi, —
një ditë më ka deklamuar treqind vargje përmendësh...

Natë motorike.

Prozhektorët shpojnë errësinën.

Lumenj drite hahen me tisin e natës.

Rrezet bien me forcë mbi maqinat, mbi digat, mbi
njerëzit.

U ndrisin fytyrat

Fytyrat e ashpra

U ndrisin shpatullat, krahët,

Ato krah që po ngrejnë lumturinë pak nga pak...

Përgjegjësi poet i nxirrte fjalët si krisma. Ai vazh-
doi të deklamonte. I këndoi shtyllave gjigande që «mate-
shin me qiellin» kolonave të eskavatorëve, atyre «kra-
hëve, moderne të punës socialiste», plasjeve të eksplozi-
vit që «prishnin qetësinë shekullore të natyrës», etj, etj.

— Bukur, — tha gazetari, — bukur. Vetëm duhet të
kesh kujdes nga hiperbolizimet.

— Ç'të bëj? — foli përgjegjësi poet. — Unë çdo gjë e
vështroj në përpjesëtime të habitshme, heroikën të pa-
shoqe, shkëlqimin të mahnitshëm, shoh triumfin e meka-
nizimit. Maqinat më duket se nxjerrin një zhurmë të lartë
shurdhonyjëse për veshët e armiqve. Kështu i përceptoj
unë, krisma me zë shumë të lartë...

— Tridhjetë oktave, — u tall pa të keq Bardhi.

— Joo! Aq lart nuk vete, — buzëqeshi Lidja. —
Ule pak, shoku brigadier.

— Koha po më ikën, — u ankua gazetari.

— Nuk janë të vlefshme për ju këto që dëgjuat?
— Mjaft të vlefshme, shoqja inxhinierë, por unë dua diçka më konkrete, tipa të gjallë të punës, heronj... Të paktën një të vetëm të zgjedh sot.

— Mund të zgjidhni më shumë se një, — foli Lidja, — punëtorët e përsosur kanë zënë të bëhen diçka e zakonshme te ne. Kemi plot të tillë. Dhe më duket se është më zor të gjesh negativin e portretit të tyre, — shtoi ajo duke qeshur. — Por ju gazetarët nuk lodheni shumë pas tyre.

— Ashtu është, nuk lodhemi shumë pas tyre. Dua të bëj një artikull të gjatë mbi një punëtor të mirë. Dua gjithë jetën e tij...

— Një artikull portret? — foli Lidja.

— Po, pak a shumë ashtu. Një artikull portret... Në drejtori më dhanë disa emra...

Ai rrëmoi nëpër xhepa.

— Brahim Jorgucati!

— Jergucati! — e ndreqi Bardhi «sa një vinç».

Gazetari e rregulloi shpejt e shpejt mbiemrin e sondistit.

«Vetëtimë janë këta gazetarët,» — mermëriti Lidja.

— Vështirë të nxjerrish gjë nga xha Brahoja, shoku korrespondent, — tha Bardhi «sa një vinç».

Gazetari buzëqeshi.

* * *

«Ecën dhe vështron ngandonjëherë trastën që i varret në kurriz. Ajo bie erë qepe dhe djathi të njomë. E shtrëngon fort dhe ecën pa pushim. Trasta mban përbrenda trashëgimin e një jete të tërë, erë qepe dhe thërrime misërnikeje... Ai i hedh hapat me ndrojtje, si në të errët, sikur bën një zbulim çap pas çapi. Prapa krahëve, shungullimi i derës, që përplasët fort pas gardhit i cili epet prej erës, prapa krahëve sytë e së ëmës që treten në pafundësi... Dhe ai i sheh sikur e ndjekin

prapa. Sytë e nënës! Vallë mos e ndjekin pas vetëm ata? E ndjek një jetë e tërë, një jetë e tërë që bie erë qepe dhe thartire... Ç'mund të kuptojë tjetër ai në ato tetëmbëdhjetë vjet? Ecën dhe përpiqet të sjellë ndër mend diçka të gëzuar, diçka të mirë. E pamundur! Mbase gëzimi dhe lumturia ekzistojnë vetëm si emra? Po ai kishite parë tek-tuk ca fytyra që shkëlqenin... Te ato gëzimi tingëllonte brenda qeses së të hollave... Një oxhak i lartë vjell tym. Rreth e qark baraka të ndërtuara keq. Diku një radio çirret në kupë të qiellit, më tutje dikush shan në një gjuhë të panjohur për të. (Njeriu e kupton të keqen edhe në gjuhën e panjohur...) Selenica...

Ai futet zyrë në zyrë dhe kërkon punë. Nëpunësit vështrojnë trastën e tij. Ajo dëshmon për një krah pune të lirë. E i flasin trastës; e përcjellin zyrë në zyrë. Po, trastës!

— Emri?

— Brahim Jergucati!

— Vjeç?

— Tetëmbëdhjetë!

— Profesion?

Ngritje supesh.

— Zanati!!

Prapë ngritje supesh.

Brahim Jergucati çuditet. I duket se ai nëpunësi që e flet keq shqipen, kënaqet që nuk ka asnjë zanat.

Djaloshi vë gishtin në letrën e kontratës. E pështyn gishtin, e ngjyen me bojë, pastaj drejt e në letër.

Ai pas tryezës buzëqeshi i kënaqur. Është i bindur që ka të bëjë me trastën. Trasta, talisman ogurzi!

Dhe Brahim Jergucati u bë punëtor, një lloj punëtori që nuk dinte ç'është një çelës tetësh dhe në ç'punë hyjnë sigurecat. Një punëtor që s'i kishte rënë akoma brisk fytyrës dhe që dorëzonte rrogën gjer në dhjetëshen e fundit në shtëpi. Atë kohë që një gjysmë punëtori dhe gjysmë fshatari. Dhe gjysma më e mirë i takonte këtij të fundit. Fshatari dhe punëtori sikur grindeshin përbrënda qenjes së tij, secili kërkonte të fitonte

më shumë vend. Ai ishte një punëtor që s'ë kishte shumë të qartë se ç'ishte punëtori, që nuk e dallonte këtë të fundit nga bujku. Ç'po bënte ai në minierë? Mbarthe kallëpët e serës me një karrocë dore, siç kishte mbartur një kohë pleh në arë. Ah, po, ata që rrinin pranë maqinash ishin të një kallëpi tjetër... Po as ata ai nuk i fuste në llojin e punëtorëve, ishin shumë të lartë për të, ata njihnin të fshehtat e hekurit dhe të zjarrit...

Më të shumtit e punëtorëve të djeshëm ishin qytetarë. Ai u rrinte larg. Sikur trembej prej tyre. Ca edhe talleshin me të, talleshin pa të keq. Ajo trasta e tij ishte një ekzemplar vërtet i rrallë... Ai zemërohej, ishte gati të godiste... Kishte dëgjuar të jatin që thoshte se duhet të godasësh gjithnjë po deshe të rrosh. Jeta e tij kishte qenë një zinxhir goditjesh të shpërndara në adresa të ndryshme. E shumta binin mbi atë vetë...

Brahim Jergucati nuk kuptonte pse talleshin ata njerëz, pse nuk e linin të qetë. Në të vërtetë ata nuk talleshin me të. Talleshin më shumë me vetëveten, me fatkeqësinë e tyre. Atyre nuk do t'ua mbante të talleshin me të, do t'u vinte keq.

Punëtori e respektonte naivitetin e fshatarit në atë kohë si diçka të shenjtë. Naiviteti! Një e metë! Po një e metë e papërlyer nga llomishtet e kohës.

Flinin në ca baraka. Baraka u thëncin! Hynte era nga të katër anët, hynte shiu, hynin derrat e drejtorit. Një kope derrash të pajtuar në mencën e fëlliqur të punëtorëve. Edhe ata ndryshonin nga kafshët tona: i kishin sjellë nga Italia.

Një herë u bë një rrëmujë e madhe në minierë. Sabotim! Fjalë tepër e rëndë për gjuhën e Brahim Jergucatit. Miniera u mbush plot me karabinierë. Punëtorët i rrasën si sardelet në një barakë. Tri ditë brenda! Herë pas here hapej porta dhe thërritej një emër. Personi që thirrej dilte avash, avash. E merrnin në pyetje. Brahim Jergucati kishte frikë në fillim. Nuk kuptonte ç'donin nga ai. Donte të shkonte në shtëpi. Kishte tri ditë që kishte ikur e diela...

Ato ditë dëgjoji edhe fjalën komunist. E dëgjoji nga vetë italianët. Kërkonin komunistët. Pikërisht kështu, ata kërkonin vetëm komunistët, njerëzit me bindje të tjera nuk u interesonin. Vetëm komunistët mund të lëftonin, pra edhe në planin patriotik. Komunistët... Më vonë ai do ta dëgjojë këtë fjalë përherë e më shpesh, në gëzime dhe në hidhërime, duke ngritur një dolli të thjeshtë dhe duke pritur ta pushkatojnë. Do ta dëgjojë gjithnjë...

I mbajtën pothuaj një javë mbyllur, pastaj i liruan. Po karabinierët nuk u larguan nga miniera. Brahim Jergucati zuri të kërkonte komunistët. Jo vetëm për kërshëri... I kërkonte siç mund të kërkohej diçka e panjohur që ta ndjell zemra për mirë, siç kërkohej një gjë që ndiqet, një gjë që përmendet duke pëshpëritur, një gjë që ngjall admirim. Atë kohë punëtori tek ai sikur kishte nisur të zërë rrënjë mirë në tokë të virgjër dhe fshatarit nuk i takonte më «gjysma» më e mirë. Ai zuri të vinte më rrallë në shtëpi, dhe e harroi diku trastën. Ishte në minierë një punëtor i vjetër, një nga ata që mund t'i vesh pa frikë si emblemë të klasës punëtore. Llazi e quanin. Ai nisi t'i mësonte Brahim Jergucatin komunizmin. E nisi komunizmin me germa e alfabetit. Njerëzit që e mësojnë kështu komunizmin, e mësojnë tepër ngadalë, po në fund ai bëhet si një qenje e dytë, e pandashme për ta. Kështu dhe me Brahim Jergucatin. Erdhën gjermanët. Jeta u vështirësua. Jeta nuk ngrinte peshë fare. Pushka kërciste anëmbanë, flakët e luftës dukeshin që larg. Brahim Jergucati lexonte traktet duke i bashkuar rrokjet...

Në minierë kishte një grup të fortë komunistësh, Llazi në krye. Kishte hyrë në valle edhe Brahim Jergucati, por e hiqte atë modesti. Gjer atëhere s'i kishte takuar të bënte ndonjë gjë të madhe. Ndante trakte, Bënte rojë, çonte letra, vëzhgonte.

Dhe në një punë të tillë e zunë me presh në duar. Një tufë traktesh. Trakte të shkrojtura me dorë, të shkrojtura keq nga duar jo shumë të stërvitura, po trakte që të ngrinin lart, të bënin hero.

Brahim Jergucatit i erdhi keq që e kapën kështu. Nuk i kishte vajtur mendja që mund ta kapnin me trakte. I vinte plasja! E zunë pikërisht kur do t'u hynte punëve të mëdha.

Gjermanët kishin fjalë pak. Flisnin më shumë me dru dhe me hekur të skuqur. Ai shtrëngonte dhëmbët dhe i binte të fikët orë e çast. Tri ditë e tri net e torturuan në Selenicë, pastaj e nisën për në një vend tjetër. Po kamioni ra në pritë. Disa batare të forta dhe fricët heshtën. Brahim Jergucatin e nxorën nga maqina në flakë. Ai kishte humbur ndjenjat, përbrenda tij përplitej kujtesa e dërmuar nga torturat: Dera e vjetër e gardhit të kasollës, fshatari me trastën në shpinë që kërkon punë, Llazi Vasili që i mëson alfabetin me një durim shembullor. Përmendet diku larg, në një zabel. «Llazi, Llazi! Unë asnjë fjalë nuk nxora»!

Ai i hap sytë dhe vështron partizanët rreth e për-qark. Gjaku i rrjedh prapë nëpër damarë, si me shungullimë, si me potere. Mbi kapat e shokëve shkëlqejnë yjet e kuq...

«Llazi! Unë asnjë fjalë nuk nxora!»

• • •

Pastaj lufta, çeta, udhët e maleve... Ai shkel ne gjurmët e të tjerëve. Dëbora, tufani, dielli janë e njëjta gjë. Për partizanin nuk ka të lehtë dhe të vështirë. Çdo gjë e mendon si një pengesë në kapërcim e sipër. Sa pengesa të tilla... Pastaj plagët e luftës... Në Opar i vdiq komisari në krahë, në Kurvelesh e varrosi me duart e veta Fatimenë, partizanen më të vjetër në çetë. Fatimeja! Dy sy si bajame, të zinj, të zinj... Eh, ç'sokoleshë Fatimeja! Në Martanesh i ngrinë këmbët dhe shpëtoi për një qime pa ja prerë, dhe më e madhja në Dovolan... Në Dovolan mbeti gjysmë dite i plagosur. Po kthehej nga një detyrë ku e kishin ngarkuar për të rivendosur lidhjen me forcat e tjera partizane. Operacioni

i dimrit, prova e dimrit. E qëlluan nga një përrua. Plumbin e parë e ndjeu, të dytin jo. I pari e zu në llërë, i dyti në gjoks. Dhe ai eci pothuaj dyqind hapa me mendimin që kishte marrë vetëm një plagë. Kur e ndjeu të dytën, nuk qëndroi më dot në këmbë. U shtri mbi bar. Pylli oshëtin, njolla gjethesh të vetmuara mbi dëborën e trashë. Gjethe që kanë mbetur me kryeneçsi mbi degët e drurëvet, e që njollosin herë pas here qilimin e dëborës. Dëbora e bën për vete, do ta mposhtë. Ai fërkon sytë dhe ngrihet me këmbë e me duar. Dhe ecën... «Çdo të ndodhte po të mos mundej të ecte njeriu?» Ecën. Dhe ja, një bazë partizane. Aty mund të dremisi pa frikë. Një dremitje ato çaste vlen një jetë të tërë.

Ditët kalojnë. Luftë, përpjekje, sakrifica. Liria nuk është larg. Duhma e sajë ka zënë t'i dehi njerëzit. Dhe ajo shpërtheu një ditë prej ditësh.

Dita e çlirimit. Ai i dëgjon këngët e britmat e gëzimit përmes dritares së hapur të spitalit. Kësaj radhe ka ngrënë dy copa mortaje në shpatull dhe në kofshë. «Ej, motër, ngrema pak kokën të shoh». «Nuk lejohet». «Pak, vetëm pak». «Nuk lejohet.» Atëhere qëndro në dritare dhe tregomë ç'bëhet jashtë!»

Dhe infermierja tregon. Infermierja flet, fjalët e saja shndërrohen në lotë. E para herë që po qan Brahim Jergucati!

Ndenji dy muaj shtrirë. Ç'kohë që ajo për të! Vitet e luftës nuk kishin qenë asgjë përpara atyre dy muajve. Ankth për të parë lirinë. Muret e spitalit janë tepër të ngushta, zënë aq pak liri... Dhe ja, një ditë del. I verdhë, i dobët, mezi hedh hapin gjer përtej lulishtës së spitalit. Në një qoshe dy të sëmurë, me krahët dhe me kokat e lidhura me fasho flasin gjermanisht. Robër të plagosur. «Këta na kanë mjekuar ne me plumba» — pëshpërit.»

Te porta e pret një veturë gjysmë e shkatërruar, ai merr të eci në këmbë, po e ndalojnë. «Shok, shoku Brahim: Ju po ju presim». vetura çan udhët e Tiranës. Bunkerët janë gjallë përpara sheshit të ministrive, as

telin me gjemba edhe s'e kanë hequr. Shtyllat e telefonit dergjen të mbështetura buzë trotuareve, ndërsa dritaret i kanë hedhur xhamat përdhe si luks të tepërt.

Ja liria! Ai psherëtin. Liria hyn edhe në atë psherëtim gjithë shpirt.

Automobili ndalon përpara një ndërtese të bërë sho-shë nga plumbat. Këtu dikur ka qenë bashki. Njerëz të armatosur lëvizin nëpër shkallë, hyjnë zyrë në zyrë. Nuk i lënë armët askund. Futen me to. Në male nuk qenë ndarë kurr nga ato. Zakon i maleve. Pushka, forca e tyre!

E pret një oficer. Brahim Jergucati i kujtohet që ka qenë për ta parë në spital. Po nuk ja mban mend emrin.

Oficieri tërheq një kolltuk të madh nga fundi i zyrës dhe i thotë duke qeshur.

— Ulu një herë në kolltuket e borgjezisë, shoku Brahim.

Brahim Jergucati ulet.

— Do të pushosh një muaj në Durrës, — i thotë oficeri, — pastaj drejt e në Selenicë. Do të drejtosh minierën, do ta ngresh në këmbë...

— Unë të drejtoj minierën? Unë s'kam asnjë klasë shkollë!

— Ky është urdhëri. Ti ke punuar atje. Sa për shkollë... Kemi revolucionin... Nga brezi i vjetër i komunistëve nuk kemi asnjë në minierë. Do të shkosh ti.

Brahim Jergucati, lufton, ngul këmbë, po ai tjetri nuk tundet. Urdhër!

— Po në asnjë mënyrë të mos nisësh pa marrë veten, — thotë oficeri.

Brahim Jergucati ja mban që të nesërmen për Selenicë. Drejtor! Ai ulet po në zyrën e drejtorit italian. Që aty duket miniera e shkatërruar. Sa punë ka përpara!

Qëndronin të dy mbi një breg të ngritur, gazetari dhe xha Brahoja. Poshtë këmbëve të tyre rridhte me rrëmbim Drini.

Gazetari i zgjati një cigare Brahim Jergucatit.

— Po si ndodhi që e le punën drejtonjëse. Pate vështirësi? Nuk ja dole?

— Oho! Sa për vështirësi as mos pyet. Atë kohë isha gjysmë i verbër. Megjithatë nuk kisha frikë. «Do të punoj drejt dhe ndershëmrisht, — thosha vetes, — dhe kaq mjafton». Po më pas e kuptova që aq nuk mjaftonte...

Punoja gjithë ditën në minierë, rropatesha. Gjithë kohën punoja me kazëm, mes punëtorëve. Zyra kishte një gisht pluhur. E hapja s'e hapja një herë në dy ditë. Çdo të bëja në zyrë? Në ç'punë hynte zyra n'atë kohë? Përpiqesha me mish e me shpirt të mëkëmbja minierën, përpiqesha «të mbaj pushtetin». Ju më kuptoni ku e kam fjalën? Të gjithë përpiqeshim atë kohë të mbanim pushtetin.

— Ju kuptoj!

Gazetari nxori një shtëllungë të madhe tymi nga goja.

— E vjetra i ngjan rrjetës së merimangës; të mpleks pa e kuptuar, të hipën në trup si mikrob, si virus, po unë dëgjoja fjalën e partisë, mësoja nga ajo. Imuniteti më i mirë... E pata vështirë atë kohë në minierë, për besë, e pata vështirë. Mjete s'kishim, njerëz s'kishim. Po armiq kishim me bollëk. Inxhinierë të klasave të përmbysura, pronarë, ndonjë intelektual mendjefyçkë, tregëtarë. Villnin vrer, vreri i tyre sajonte rrjetën e merimangës. Unë u vura fshesën u mbështeta te punëtorët.

Më pyetët në ja dola në krye. Vitet e para mund të them se s'lashë gjë mangut. Më pas jo, nuk ja dola. Ju thashë pak përpara se dhe unë si gjithë të tjerët përpiqesha «të mbaj pushtetin». Po e dini si e kryeja unë

këtë punë? Me «gjoks» partizance. Po më vonë kohët zunë të ndryshonin. Nuk ecej vetëm me gjoks, duhej edhe dituri. Unë asokohe isha gjysmë analfabet. Edhe kohë s'kisha për të mësuar, edhe dëshirë s'kisha. E kuptoni, mbeta prapa...

Shokët e qendrës dhanë e muarën po s'më sollën dot në udhë. Atë kohë kisha ca ide të mjegulluara për arësimin, nuk më bënte edhe aq përshtypje padituria. Shkurt, përtoja të rrok librat në moshën tridhjetveçare. Pastaj se mos kisha lerë unë për drejtor? Jo, or vëlla, jo! Mua më kishin vënë drejtor nga halli, nesër do të gjenin njeriun që duhej. Kështu mendoja atëherë.

Miniera u rimëkëmb, filloi prodhimi, u rritën edhe telashet e mia. Shpeshherë padituria ime i bënte të buzëqeshnin njerëzit. Shkurt, unë s'isha për atë vend. Kisha mbetur prapa... Ju e kuptoni. M'u desh ta lë atë vend. Tani më vjen keq që nuk vazhdova në punën drejtuese; më vjen keq që nuk mësova. Por kot nuk thonë «Kur vij në mendtë, ikin dhentë». Dhe mua më ikën gjithë ato vite.

U ktheva prapë në zanatin e parë. Vitet e para, kur unë shtyja karron në minierë dhe vështroja mjeshtrit me ankth dhe me zili, më lindi në shpirt dashuria për hekurin, për maqinat. Kjo më mbeti gjithë jetën.

Gazetari shkruante e shkruante. Nuk donte t'i shpëtonte asnjë fjalë. Shkruante dhe mallëkonte veten që nuk kishte mësuar stenografi.

— Vetëm një gjë më ka mbetur peng, — vazhdoi Brahim Jergucati, — që nuk pata mend në kokë të mësoja me kohë.

Heshti. Po ai edhe kur heshte ishte i gjallë, shprehës. Mos vallë gazetari që nuk po e ndalon dorën po shkruan pikërisht këtë?

— Shtatëveçaren e mbarova shkel e shko. Ku me shkollë nate, ku me korrespondencë. Të them të drejtën pak përfitova. Nuk mësoja siç duhej. Klasën e shtatë e mbarova në Ulzë. Kur mbaroi hidrocentrali mbarova shtatëveçaren edhe unë. Pastaj stop në vend.

— Po tani? — tha gazetari duke ngritur kokën.

«Ky e dika mirë punën,» — mendoj xha Brahoja.

— Tani? Do t'ja nisim prapë, — u përgjegj kryesondisti. Do t'ja nisim prapë me ç'duket. Këtu u hap shkolla teknike. Ma vunë si detyrë partie ta mbaroj. Dhe, që të jem i singurtë me ju, po ju them se përpara dy muajsh s'kishte burrë të ta mbushte mendjen. Jo se s'ja di vlerën shkollës, e kisha gjetiu hallin. Unë bazë nuk kisha, mendoja se ose do të turpëroheshja ose mund të kaloja shkel e shko. Më rroftë mundimi, se gjë s'kisha për të mësuar! Ah, po! Dëftesën do ta kisha në xhep... Që të flas edhe më hapur kjo ishte edhe punë sedre, turpi. «Si? Xha Brahoja që ligjëron aq bukur nëpër mbledhje paska vetëm shtatëvjeçaren?» Kështu mendoja se do të flisnin njerëzit. Kështu mendoja se do të flisnin njerëzit. Kështu më kanë folur në Ulzë... pse mos të më flasin këtu? Pastaj unë e di ç'hoqa në Ulzë... Algjebra, gramatika... Vetëm hartimet i bëja mrekulli... «Ke një stil si të Xhek Londonit», — më thoshte mësuesja e letërsisë. Unë Londonin nuk e kisha lexuar. E lexova më pas nga kureshtja. Po ju e kuptoni. Çfarë Londoni isha unë... Përpara një jave, takova rastësisht brigadierin e minatorëve, Llesh Kalinë. Ngutej, nën krah një tufë librash... «Ç'ke nën sqetull, or Llesh?» e pyes. «Qitape,» — përgjigjet ai. «E ke marrë me qejf?» «Me qejf e me droje. Po do të më ndihmojnë shokët, Ilija». Ai iku, unë po mendoja aty në rrugë. Ç'të keqe ka, — thosha me vete, — nëse vete? Do të përpiqem me gjithë forcat. Po nuk qeshë i zoti të kaloj, s'ka gjë. Sidoqoftë diçka do të mësoj ». Dhe fillova. Kështu...

Gazetari shkruante pa pushuar. Herë-herë ngrinte kokën dhe vështronte xha Brahon.

— Unë nuk e lidha rastësisht me hidrocentralet, po i ndoqa vetë. Po ndërtohej hidrocentrali «Lenin». O burra për Tiranë! Që ditën që braktisa trastën, e kam ndjekur të ren me ankth. A kish gjë më të re se drita për ne? Pastaj drita mbetet gjithmonë e re...

— Drita mbetet gjithmonë e re...» shënon gazetari.

— Po paskëtaj, shoku Brahim? Ç'keni ndër mend të bëni?

— Do të ndjek dritën, — buzëqesh xha Brahoja. Këndeje do të ndërtohen një varg hidrocentralesh.

«Do të ndjek dritën,» shënon gazetari.

KAPITULLI VI

Lidja u mësua shpejt në kantier. Atë thërrime frike që kishte pasur në fillim se qysh do t'ja dilte me punëtorët, e kapërceu menjëherë. Ditët e para e kontrollonte veten për çdo gjë, vështronte vjedhurazi të tjerët dhe mendohej të dukej edhe më e thjeshtë nga ç'ishte. Atë e trembte mospërfillja. Në fillim druhej se ndonjëri mund t'ja kthente fjalën dhe ta bënte për pesë para. Apo nuk mund të kishte lloj-lloj njerëzish aty në kantier?. Po me kalimin e kohës Lidja mori mësimin më të thjeshtë në jetën e saj: Mospërfillja e punëtorve nuk u drejtoka kundër një vajze, edhe kur kjo është mbi ta, po kundër të mbajturit me të madh, kundër dembellekut, kundër paaftësisë. Dhe ajo kishte shumë kujdes të mos hiqej si «intelektuale», punonte me gjithë shpirt që të mos e quanin dembele, mësonte gjithë natën për të mos qenë e paaftë. Ditët e para dukej sikur Lidja dëshirën për t'i bërë njerëzit për vete e kishte kthyer në një qëllim në vetëvete. Në vështrim të parë këtu kishte diçka që sikur nuk shkonte, por po ta shihje më thellë, vajza kishte të drejtë. Ajo nuk e kërkonte afërsinë e të tjerëve për qëllime personale, e donte për hir të punës. Pastaj ajo ndodhej në mes të një kolektivi të panjohur...

Në kantier erdhën edhe pesë vajza të tjera, po këtë prej tyre i futën nëpër zyra, vetëm e pesta filloi punën si muratore.

Katër të parat u hipnin autobusëve posa mbaronin punën dhe iknin në qytet. Lidja u interesua në mënyrë të veçantë për Martën, muratoren. Vajza ishte nga Oroshi, një goxha vajzë, e gjallë dhe e qeshur, që kishte mbaruar shkollën e rezervave të punës.

Kohën e lirë Lidja rrinte shpesh me Bardhin «sa një ving» dhe me dy teknikë nga Vlora. Rrinte dhe me të tjerë, por sidoqoftë nuk kishte në kantier njeri më të njohur se Zef Mërtirin.

Në fillim u suall shumë ftohtë me inxhinierin, sado që e kishte pritur mirë lajmin se ai punonte në atë kantier. Zef Mërtiri shpeshherë e mërziste, po ajo nuk dinte të thoshte me saktësi çfarë të mete kishte ky njeri. Po a kishte vallë të meta ai? Lidja që e kënaqur që nuk i kishte dhënë rast t'i hapej kur kishin qenë në shkollë... Atëherë Zef Mërtiri i vinte në konvikt, e çonte në kinema, e gostiste me ndonjë gjë dhe i bënte biseda të gjata për të ardhmen. Ai, si të thuash, kishte fituar mbi të ca të drejta më shumë se djemtë e tjerë, dhe afërsisht quhej si i preferuari i Lidjes. Por asgjë më shumë se kaq...

Nga ajo kohë Lidja mbante mend vetëm bisedat e tija më me rëndësi. Zakonisht ato nisnin me një «Unë» që përsëritej gjatë gjithë bisedës. E përdorte shumë këtë fjalë. Lidja do të donte të ishte në numrin shumë ai përemër.

Kur e takoi në kantier, Lidja mendoi se mund të kishte me të atë shoqërinë e përparshme. Por nuk ndodhi krejt kështu. Ata u takuan miqësisht, por secila palë qëndroi në pozitat e veta. Djali në ato të një njeriu që nuk ja kanë hapur shtegun, vajza në ato pozita të atij që nuk mund t'i kapërcejë caqet që ka ngritur vetë. Zef Mërtiri ju duk edhe më i ftohtë. I kishte rënë edhe një hije intelektual: «Sikur të mbante syze?... mendonte Lidja. Po syzet nuk plotësonin ndonjë gjë të man-gët të inxhinierllëkut. Ditët e para ju duk sikur punë-torët nuk ndjenin ndonjë dashuri për të. Por këto ishin vetëm dyshime... E pra, në të vërtetë, ai sillej aq ko-
rekt...

Për Lidjen ishte gjë e madhe të humbasish dashurinë e njerëzve. «Ja, — mendonte ajo, — ata të urrejnë dhe ti futesh mes tyre, jep urdhëra, kërkon llogari. Dhe ata lëviznin duart, lëvizin kokat, por, zemra nuk lëviz fare. Janë të ftohtë ndaj teje, të ngathët dhe tallës. Tmerrësisht tallës, me një tallje të hollë e delikate, aq të natyrshme, aq të zgjuar. Ec e kuptoje atë... E tmerrshme mos të të duan njerëzit!»

Herë-herë i dukej sikur Zef Mërtiri i kundronte punëtorët si maqina. Kur kërkonte llogari ai përdorte fjalë të tilla: «Libri i normave kërkon që në turn të bëhen kaq metra shpim. Pse nuk keni zbatuar grafikun? Ose: «Për një montim motopompe parashikohen gjashtë orë. Pse keni thyer disiplinën teknike?»

Lidjes i dukej njësoj sikur të thoshte: Ky motor ka një kapacitet prej dyzet kuaj fuqi, nuk mund të ketë tridhjetë e nëntë!

Pse nuk kërkonte fjalë të tjera Zef Mërtiri për t'u marrë vesh me punëtorët?

Ai i dukej herë-herë i mbyllur në vetvete, i ftohtë dhe i zhytur në një farë profesionalizmi. Po për i zoti... Ajo mendonte se qe një inxhinier i aftë. Të tjerët kishin rezerva. Dëshironte ta njëhte mirë atë njeri. Në shkollë kishte qenë nxënës i shkëlqyer. Shokët thoshnin se mësonte meqë nuk duronte t'ja kalonte tjetërkush. E akuzonin për egoizëm. Po a studjonte tani?

Lidjes i dukej se Zef Mërtiri ishte i mërëzitur, sado që nuk e bënte veten. Po nga se mund të mërëzitej ai? Ndoshta pse nuk ndodhej në Tiranë? Po atëherë pse ja hyri inxhinierisë? S'kishte ndodhur ndonjëherë që të ndërtoheshin hidrocentralet nëpër qytetet, por gërxeve dhe luginave.

Një pasdreke Zef Mërtiri i vajti në dhomë.

— Mund të hyj Lidje? — foli ai që prapa derës.

— Urdhëro!

Lidja la librin mbi komodinën e thjeshtë, që ja kishin bërë zdrukthtarët me ca copa dërrase jashtë përdorimit dhe u ngrit.

— Oh, oh! Këtu vika erë shtëpi, — tha inxhinieri duke i hedhur një sy të shpejtë dhomës. Sa mirë je rregulluar! E keni në gjak ju vajzat...

— Nuk duhet ndonjë mjeshtëri e madhe për të vënë ca letra e ca fotografi në mure, — u përgjegj Lidja. Më shumë është punë kujdesi.

— Ti e ke dhomën vetëm, Lidje, unë kam edhe dy të tjerë brenda...

— Dhe me siguri ja lini punët njëri-tjetrit e nuk bëni asgjë, — qeshi Lidja.

— Ashtu, ashtu, s'bëjmë asgjë.

— Këtu jam mirë, — tha Lidja. Por do të më pëlqente të kisha edhe një shoqe. Vetëm mërzitem... Ja kam vënë syrin njërës.

— Dy shoqe janë si dy gjysma krijese që plotësojnë njëra-tjetrën.

— Preferoj shoqe «të plota», Zef, — u përgjegj Lidja, me një «gjysmë», njeriu e ka pisk kur do t'i duhet të punojë vetëm. Po ulu, pse rri në këmbë? Ulu këtu në shtirat. Sot më premtuan të më sjellin karrige dhe një tavolinë. E di që kam vendosur t'i bëj model barakat e punëtorëve të mi?

— Pashë ca ndryshime. Tavolina, karrige, fotografi dhe panorama nëpër mure. Po pastërtia vende-vende çalon...

— Ajo nuk vjen përnjëherësh, Zef, por shpejt do t'ja arrijmë edhe asaj...

— Sa mirë! Ti je entuziaste. Sa mirë...

— Pse, ti nuk je entuziast? — ja ktheu vajza.

— S'do mend që jam.

— Më hidhet zemra peshë kur mendoj që jam përfshirë në lëmin e atyre që po bëjnë një punë kaq të madhe.

— Në shoqërinë tonë nuk ka punë «të mëdha» dhe punë të vogla — vërejt i inxhinieri.

— Kë të drejtë, por do të ishte hipokrizi po të thuash se ndjen të njëjtin gëzim si kur punon për të ngritur një barakë, ashtu edhe kur merresh me një ndërtim gjigand si ky i yni.

— Thonë se puna që ke për shpirt të sjell kurdoherë gëzim, sado e thjeshtë goftë.

— «Pse «thonë»? A nuk e ka provuar ky vetë ndonjëherë?»

— Mbase nuk u shpreha siç duhet dhe nuk më kuptove, — tha vajza. — Nuk e kam fjalën për punë «të ulëta», apo «të larta» por për fuqinë që mund të ushtrojë mbi njeriun madhështia e një vepre me përpjestime të tilla si kjo jona.

Ai tundi kokën, megjithatë nuk u kuptua në ishte në një mendje me vajzën, apo jo.

— Po ndonjë gëzim tjetër, a ke Lidje?

Ai e vështrroi me një farë përmallimi.

— Kemi shumë kohë pa u parë, — vazhdoi ai. — Ke ndryshuar...

— Koha ecën, — pëshpëriti Lidja e menduar.

Për disa çaste asnjëri nuk foli. Heshtje! Por heshtnin në sipërfaqe, përbrenda vlonin.

Ai: «Kjo ka ndryshuar shumë. Edhe më përpara ka qenë e hedhur, por tani është bërë shpuzë fare. Interesant! Vajzat tona po ndryshojnë shumë. Interesant... Një vajzë e vetme në gjithë kantierin dhe ta ndjejë veten për bukuri. Një kohë nuk e mirrja me shumë seriozitet forcën e gruas. Gjer vonë po kështu... Mos do të më bëjë të ndërroj mendje kjo çupë e bukur inxhinierë? Mbase është ndonjë përjashtim?... Po kohët e fundit kam parë gjithandej vajza të forta, që qëndrojnë mirë në postin e tyre. Kohët e fundit sikur po ikin jashtëzakonisht shpejt! Dhe unë sikur nuk po mund të ndjek kohën... Lidja rend me të, mbase përpara saj, xha Brahoja po kështu, qindra të tjerë po kështu, mua sikur më kanë ngjirë këmbët në beton. Edhe unë kërkoj diçka, përpiqem për diçka, por se ç'më mungon... Guximi?... Ndërsa këta të gjithë kanë guxim me bollëk... Guximi po bëhet tipar dallonjës për këtë kohë. Unë...

Ka ndryshuar... Është dobësuar pak, por është bërë më e bukur. Këta sy si në të perënduar më kanë lënë aq net pa gjumë... Po tani? Mos do më nxjerrin prapë

andrralla? Nuk më ka dashur. Vajza që dashuron e ndjen tjetrin pa ju shfaqur. Ajo s'ka dashur kurrë t'i shfaqem. Ajo nuk më ka dashur... Çudi! Çfarë mendon kjo vajzë? Sytë e saj të perënduar janë e vetmja gjë që sikur s'është në harmoni me qenjen e saj tërë zjarr.

Ajo: «çfarë i mungon këtij njeriu? Ai i ngjan atij që është i pakënaqur, se nuk ja kanë dhënë vendin që meriton në jetë. Ç'vend meritonte Zef Mërtiri? Po a mund të bëhet fjalë sot për vende?

Heshtjen e theu Lidja.

— Më dukesh si i mërzitur, Zef. Mbase gabohem, por kështu më dukesh gjithnjë.

— Jam pak i mërzitur, — tha Zefi. — Unë, si të thuash, s'jam i prerë për punë në prodhim. Më shkon më shumë puna kërkuese, shkencore. Ëndërroj laboratorin, punën e gjatë në kërkime, kalkulimet, teorinë...

— Unë nuk shoh ndonjë gjë të keqe në «ëndërrimet» e tua, — tha Lidja. Pse jo? Në një të ardhme mund të të plotësohet fare mirë dëshira. Por nuk shoh asnjë arësye që të jesh tani i mërzitur. Pastaj ti vetë more degën e centraleve elektrike. Më kupton ku e kam fjalën... Po çfarë pune shkencore do t'i hyje? — Pyeti ajo pas pak.

— Do t'i hyja, apo i kam hyrë (fjalët e fundit i theksoi fort) kjo nuk ka rëndësi. Por dije që gjithë jetën kam ëndërruar të shkruaj një vepër me vlerë që të ketë peshë kudo...

«Oho, ky vdes për një thërrime lavdie, — mendoi Lidja».

— Një vepër teorike? — pyeti ajo jo pa të keq.

E ndjente që një bisedë nuk mund të përfundonte mirë po të vazhdonte në atë rrugë, por s'qe e zonja të ndalej. Gjuha sikur vërtitej vetë nëpër ato shtigje dreharake.

— Natyrisht, teorike! Kurrën e kurrës nuk do t'ja hyja një vulgarizimi praktik...

— Dhe në ç'punë do të hyjë një vepër e tillë? Po qe në atë nivel aq të lartë sa ëndërron ti, ajo shumë-

-shumë mund t'i nevojitej një grushti specialistësh. Po a nuk do të ishte më mirë të punoje një libër që ta mirrnin vesh të gjithë sondistët e Shqipërisë?

Ai e zuri për krahu dhe i dredhoi pyetjes:

— Ndoshta nuk më quan të aftë për punë shkencore, Lidje?

— I shkreti ti! — nuk ju durua vajzës. — Ç'them unë dhe ç'thua ti! Nuk ka rëndësi, besoj, se ç'mund të mendoj unë dhe të tjerët për aftësitë e tua. Rëndësi ka si i sheh gjërat ti, si i kupton, nga nisësh? Këto kanë rëndësi. Po a ke punuar ndopak për këtë vepër teorike?

Ajo ndjente dëshirën ta poshtëronte, prandaj u tall aq haptas.

Po ai nuk e kapi ironinë.

— Kam punuar, — tha, — po pikërisht, kur kisha ndër mend t'i vihesha punës seriozisht, më ngatërruan me një djall kursi.

— Çfarë kursi ishte ai?

— Kurs kualifikimi për punëtorët. Thua sikur s'ka teknikë apo inxhinierë të tjerë që mund ta bëjnë shumë mirë.

— Për çfarë inxhinierësh e ke fjalën?

— Ja, si të them, për ata që s'mund të merren me punë shkencore, që kanë më shumë kohë.

— Domethënë ti i ndan në dy grupe inxhinierët dhe teknikët, në ata që janë të zot dhe në ata që s'janë?

— S'do mend. Kjo punë kërkon një farë prirjeje. Nuk është punë bakalli.

«Punë të vogla dhe punë të mëdha», — solli ndër mend Lidja fjalët e Zef Mërtirit.

— Zef! — foli ajo papritmas me shumë seriozitet, — do të jem shumë e kënaqur po të më lesh të të zëvendësoj unë në atë punën e vogël, kursin...

— Lidje! Më fal! Unë... Unë.

Desh t'i thoshte që ai s'e kishte pasur parasysh atë kur kishte folur ashtu, por fjala i mbeti në grykë.

Më vonë Lidja u pendua që nuk ja përplasi mirë e mirë në fytyrë gjithë çfarë i vlonte përbrenda. Ai Zef

Mërtiri nuk ishte në udhë të drejtë. Ndoshta Zef Mërtiri qe shumë i talentuar, po sa të kishte ato mendime në kokë, s'do të nxirrte gjë në dritë kurrë!

Disa ditë më vonë ajo pati edhe një rast tjetër për t'u zëmëruar me të. Ndodheshin në zyrën e nëndrejtorit. Shefi i kuadrit ankohej për disa ndërmarrje të rrethit që po dërgonin në hidrocentral vetëm punëtorë të kategorive të ulëta. Ai tregonte me zemërim se ato ndërmarrje nuk kishin dërguar asnjë punëtor me kategorinë e pestë e lart. Ç'ishte kjo? A nuk do të thoshte se shokët drejtonjës të këtyre ndërmarrjeve e shihnin punën thjesht nën prizmin e interesit të tyre të ngushtë lokal? Kësaj nuk i thoshin të kuptuar revolucionar të situatës!

Nëndrejtori i jipte të drejtë shefit të kuadrit duke tundur kokën. Lidja hidhte herë pas here ndonjë mendim. Vetëm Mërtiri vështronte jashtë dritares pa u interesuar fare se ç'flitej në zyrë. Ai me Lidjen kishin ardhur për punë të tjera, por i gjetën ata të dy duke folur dhe pritën aty. Do t'u jepnin fuqi tjetër punëtorë, prandaj i kishin thirrur.

— Shoku Zef, — filloi shefi i kuadrit, — në çimentim kemi caktuar katër motoristë dhe një pompist. Mos ju duhen më shumë?

— Hëpërhë mjaftojnë, — u përgjegj Zefi pa e pasur fort mendjen aty.

— Pompistin ta kini kujdes, — vazhdoi shefi i kuadrit, — kemi të dhëna jo të mira për të. Është pijanec dhe dembel. Me një fjalë me sjellje shoqërore jo të mirë.

— E ç'më duhet mua? — tha Zefi i mërzitur. Le të pijë sa të dëndet po pati qejf, po në punë e dua qefull, ama. Pastaj me këtë punë ka kush të mirret. Është organizata e partisë, bashkimet profesionale...

— Ç'flet kështu, shoku Zef? — kërceu nëndrejtori. Ti je kuadër, ti je njeri politik. Ne të gjithë jemi njerëz politikë.

— Ashtu, ashtu, ama mua m'i rrasin gjithë ata me bishta...

— S'e ke drejtë, shoku inxhinier, — nuk e ke drejtë... Ç'ke që nxelesh kështu?

Këto dy ngjarje ngritën për një farë kohe një radhë telash me gjemba mes Lidjes dhe Zef Mërtirit. Megjithatë Lidja kishte mbetur keq, sepse as ishte ajo që e linte në «hall të vet» Zef Mërtirin, as ajo që i afrohej si duhej.

KAPITULLI VII.

Fryn erë shumë, një erë e tërbuar që ka nisur që në mbrëmje. Era ulurin pas qosheve të mprehta të portalit dhe futet me uturimë në tunel sikur ta shtynte ndonjë kompresor gjigand. Erë dhjetori, erë e marrë...

— Kështu nuk mund të punoni të lidhur, — i bërtet në vesh inxhinier Ilia Llesh Kalisë, — era do t'ju çojë shtregull nga t'i dojë qejfi. — Është çmendur sot...

Lleshi vështron litarët që varen mbi faqen shkëmbore të portalit. Pesë litarë... Propozimi i tyre për anкера të thjeshta që pranuar. Tani duheshin hapur vrimat. Po ishte aq lart, aq lart...

— Pasnesër na presin për plasjet poshtë portalit, — tha brigadier Lleshi. E kemi zgjatur tërkuzë punën e ankerave. Nuk kemi fytyrë me bajt ma tepër. Duhet të ngjitemi me litarë.

— Kështu në asnjë mënyrë — foli inxhinieri, — nuk lejoj asnjëri të punojë kështu. Të pushojë era një herë.

— Kjo erë nuk pushon menjëherë, shoku inxhinier, — ndërhyri një minator i atyre anëve. — O zgjat tri ditë, o një javë!

— Tri ditë!

Llesh Kalia tundi kokën me zemërim.

— Sot për ne tri ditë janë tre vjet, pasha bukën!

Atë çast se ç'kërciti fort, pastaj krisma u zgjat, siç mund të ndodhë kur përlan me vete furtuna diçka të rëndë.

Ilia e tërhoqi brigadierin.

— Vështro! — i thirri.

Dhe Llesh Kalia pa se si po e mirrte me vete era e tërbuar gjysmën e çatisë prej llamarine të një barake argjili.

— Ajo vetëm pullaz ka pasë, i ka hi era në katër anët. Qysh mos e marrë me vete? Na len ta provojmë një herë.

— Mos më bëj të zemërohem, Llesh. Në asnjë mënyrë nuk do të punoni kështu. Më sëmbon në zemër që nuk mund t'i mbarojmë ankerat për pasnesër, por nuk mund të luajmë me jetën e njerëzve. Merr vesh, or Llesh, mos u bëj i marrë! Ec, luaj vendit! Dërgoji shokët të punojnë brenda në tunel. Mbase pushon era...

— As që e ka at mendel!

Ilia tundi grushtin në erë me zemërim. Nuk u muar vesh kë desh të kërcënojë, Llesh Kalinë apo erën.

— Futuni në tunel dhe pikë! Unë kam punë në drejtori, por po pushoi era sadopak, këtu më keni; përndryshe do të punoj atje pothuaj gjithë paradrekën.

Ai iku.

Llesh Kalia nuk luajti nga vendi, nuk luajtën as ata të tjerët që do të vareshin me litarë. Tutje litarët dridheshin dhe përdridheshin si gjarpërinj mbi faqen shkëmbore të portalit.

— Pasha bukën, — bërtiti fort Llesh Kalia, — nuk jam kah e la të hapun këte ditë! Kush të jenë burrë të vijnë mbas meje!

Ai u turr mbi kodrinë duke u ngjitur me një zhdërvjellsis që binte në kundërshtim me moshën e tij. Arriti kështu kurrizin e shkëmbit ku ishin lidhur fort litarët. Ata të katër pas tij...

Lleshi rrëmbeu një prej litarëve, e shkoi për beli, pastaj krahaqafë.

— Pistoletën, — bërtiti sa kishte fuqi. Po mezi e ndjeu edhe vetë zërin e vet.

Shokët e tij u turrën dhe nuk deshën ta linin të zbriste poshtë.

— Zgjidhu, — i thanë, — do të zbresim ne! S'është punë për ty kjo, je në moshë!

— I kam dhambët për mrekulli-i-i! — u tall Llesh Kalia duke bërtitur me sa fuqi kishte. Kush don me ardhë me mue mos t'ja bajnë të gjatë!

Ata të katër u lidhën me litarë. Nuk e zgjatën me Llesh Kalinë. E dinin ç'mendje kishte. Një kokëshkretë që s'e kishte shokun... Llesh Kalia u lëshua i pari poshtë. Mbahej pas litarit dhe njëkohësisht e lironte atë nga pak. Pistoletën e kishte vënë përpara duarve. Tubi i ajrit peshonte një djall e gjysmë dhe e pengonte shumë. «Budallallëk, — mendoj Lleshi, — mund të ma kishin lëshue ma vonë pistoletën!»

Tubi i ajrit rëndonte për kjamet dhe e tërhiqte poshtë me fuqi minatorin. Lleshi vazhdoi të zbriste. Sa më shumë zgjatej litari aq më shumë e tundte era. Kur litari u tendos i tëri, ja kishte rjepur duart dhe ja kishte bërë gjak.

Ngriti kokën lart. Katër minatorë të tjerë po zbrisnin pas tij. Po ata nuk i kishin marrë me vete pistoletat. Kishin mësuar nga gabimi i tij.

Llesh Kalia buzëqeshi, pastaj hapi çelësin e ajrit. Baromina u ngul në shkëmb fare pak. Por era dhe presioni i ajrit të pistoletës e lëvizën dy pash përtej minatorin. Ky u mundua më kot të mbante drejtpeshimin, era nuk e linte të zinte vend. Ai i hapi këmbët fort për të zënë sa më shumë sipërfaqe. Ashtu i përkulur dhe i lidhur siç ishte, ngjante me një lojtar cirku. Baromina hyri nja dy pëllëmbë në shkëmb. Tani era nuk qe e zonja ta lëvizte më si përpara minatorin, sepse e mbante baromina, po për t'i nxjerrë punë, i nxirrte sa të duash.

Zu të ndjente dhembje në ije dhe në sjetulla ku kishte lidhur litarin. Po e harroi menjëherë dhembjen. Baromina kishte humbur e tëra në zemër të shkëmbit.

Llesh Kalia u hodhi një sy shokëve. Pothuaj edhe ata e kishin mbaruar nga një vrimë. «Mbeten edhe dyzetepesë të tjera, — mendoi si vetëtima Llesh Kalia».

E tërhoq pistoletën. Era nisi të tallej rishtas me të, gjersa e nguli mirë barominën.

E njëjta gjë edhe me të tjerët. Ndodhte që ata përplaseshin njëri me tjetrin dhe u ngatërroheshin litarët dhe pistoletat.

Llesh Kalia mbajti vesh. Ju duk se një nga shokët kishte nisur të këndonte. Po, po! Një këngë e vjetër, pothuaj e harruar, kënga e rrugës Kukës-Peshkopi. E pikërisht atje kishte nisur të varej për herë të parë nëpër shkëmbinj.

Sqetullat dhe beli pothuaj i ishin mpirë fare. Eh! Moshë e plasur! Një kohë kishte qenë petrit me fletë, sot nuk ja mbushte mendjen vetes.

Llesh Kalia hidhte sytë herë pas here nga shokët. Kishte frikë mos shembej ndonjëri poshtë, kishte frikë mos blokoheshin pistoletat, kishte frikë mos epej ndonjëri. Se ai atë punë e vështronte si një lloj lufte... Po andej gjëmonin pistoletat, gjëmonte kënga, një këngë që hahej me erën, me zhurmën. Këngë dhe furtunë.

Lleshi vështroi padashur poshtë. Një njeri shikonte andej-këndej nën këmbët e brigadierit dhe nuk kuptonte ku krisnin pistoletat. Ai ishte i mbërthyer kokë e fytyrë me shall, me peliçe e me kokore. Në dorë shtrëngonte një tufë letrash. Zaimi!

Lleshi pati shumë qejf ta trembte me ndonjë guralec. Harroi gjithë mundimet e asaj pune. Mrekulli! Zaimi!

Po nuk pati nevojë ta trembte, shefi i llogarisë u tremb vetëvetiu. Ngriti kokën dhe, me të parë minatorët e varur në shkëmb, s'pa nga iku. Pa, si iku!...

Brigadierit i erdhi për të qeshur me të madhe. Po në vend të gazit i doli një sharje. «Ka ardhur prapë për shkresa; asht i zgjuet «moda e vjetër». Punën e vet ua ndan të tjerëve. Rezili!»

Llesh Kalia ja mbylli ajrin pistoletës. Nuk mundej

më. Krahët i qenë bërë si dy drurë pa jetë. I mirreshin mendt dhe i vinte për të vjellë. Sytë i ishin mbushur me pluhur. Kërë dhe thërrmia shkëmbi. Kërën ja gostiste era, thërrmiat pistoleta. Po tani më e madhja kishte mbaruar...

Era fryn posi e çmendur. Llesh Kalia mendonte për sondat dhe për maqineritë e tjera. Kjo furtunë mund të sjellë dëme. «Vallë a do të kenë marrë masa?»

I erdhi prapë për të vjellë. Mendja nisi t'i vinte vërdallë si më parë. Tani era e lëvizte sa andej-këndeje. Si ndonjë të dehur. Po pistoletën nuk e lëshonte nga duart.

Ndjeu se dikush i zuri krahun.

— Hej, mirditor!

Lleshi u mundua ta merrte veten.

Fran mirditasi kishte ardhur gjer pranë Lleshit, po litari nuk e linte të afrohej mirë. Frani zgjati dorën dhe tërhoqi Lleshin drejt vetes. Pastaj e mbajti disi pezull me krahun e djathtë.

Tani, lart mbi kurrizin e shkëmbit, kishin hipur plot minatorë. Më të shumtët ishin shtrirë barkas për të mos i përparë era. Jepnin e merrnin me duar, bërtisnin, po asnjë zë nuk vinte gjer poshtë. Me sa dukej ata e kishin fjalën për brigadierin që nuk ishte mirë.

— Tërhiqni litarin! — Bërtiti sa mundi Frani.

Ai i shihte vetëm kokat atyre të shtrirëve. Trupin e kishin pas kurrizit të shkëmbit.

Ata lart nuk e kuptuan. Fran mirditasi bërtiti edhe një herë, pastaj luajti dorën, siç mund të bëjë ai që ngre diçka.

Llesh Kalia e mblodhi veten. I erdhën forcat. Trupit të tij të kalitur i mjaftuan ato pak çaste që të pushonte.

— Ç'ke me litarin, mor cub Mirdite? — bërtiti. — Më lësho! — Tjetri e lëshoi si me pahir.

Lleshi zgjati pistoletën. Baromina fërkoj buzët pas shkëmbit të prefët. Era punë e madhe...

I dha fund edhe asaj vrime. Pastaj vështroi poshtë. U drodh. Ìlia...

As ai nuk e kuptoi pse u drodh. Ai nuk kishte frikë nga njeri. Po ja që u drodh.

Inxhinieri bërtiste sa mundej dhe bënte me dorë që të ngjiteshin lart. Ata të pestë punën e tyre...

Inxhinieri vërtitej si i shkalluar nën këmbët e portalit.

«Ilia! Shpirt njeriut, Ilia, — mendonte Lleshi».

Pistoleta i dridhej fort në duar. Vrima ishte në të mbaruar.

Vështroi poshtë. Disa punëtorë po i qasnin murit një alamet shkalle hekuri. E kishin bashkuar copa-copa. Lleshi e ndjeu hekurin se si takoi shkëmbin mu nën këmbët e tija.

— Ah, tash po! — tha Llesh Kalia, — tash po!

Ai po bëhej gati të hiqte barominën nga vrima e fundit kur ajri u pre krejt.

«Kot u mundove, Ilia, — mendoi brigadieri, — mbaruam punë». Ai buzëqeshi, pastaj kërkoi me këmbë shkallën e hekurt. Zbriti poshtë. Ilia ju derdh përsipër me ç'i erdhi në gojë.

— Bërtit sa të duesh e më shaj sa të duesh, — ja ktheu Lleshi me një fije zëri. — Nuk kam dert!

Ai u shtri në kurriz i dërmuar nga lodhja e madhe.

— Dotë përgjigjesh, — thirri me të fortë inxhinieri, — do ta kesh rëndë!

Po ai ishte i inatosur vetëm në fytyrë. Thellë në shpirt ngazëllente.

— A din ç'ka, o shoku Ilia? — tha Lleshi me buzën në gaz. — Tash ban mirë me u ba gati me futë ankerat!

— Or, po ti qenke dibran i luajtur mendsh!

— I trenue thomi andej nga na, shoku inxhinier.

Nëpër shkallë po zbriste minatori i fundit kur u dha «Gazi» i drejtorit të ndërmarrjes.

Doli drejtori, doli edhe Lidja.

Ilia zbriti me vrap nga lartësia.

— Më njoftuan, shoku inxhinier, se këtu te ju po ndodhin gjëra të pabesuara. Po punoni krejt në kundër-

shtim me sigurimin teknik. Shefi i llogarisë erdhi te unë si i prishur mendsh nga ajo që kishte parë këtu.

«Ah, modë e vjetër», — belbëzoi Lidja.

— Këtë punë e bënë në kokë të tyre, — u përgjegj Ilia.

— Paskemi ardhur vonë, — ju kthye drejtori Lidjes. U vonova te ti në digë. Po ku janë ata bandilla? Duhet t'i bëj për pesë para!

Ilia vështroi rreth e rrotull dhe nuk pa gjë. Minatorët qenë bërë erë sa kishin parë drejtorin. U dogji ardhja e tij.

— Ku janë? I përpiu toka, apo u avulluan?

Drejtorit i ndriti fytyra. Sa mirë që qenë zhdukur! Nuk i bënte zemra t'u fliste as atyre trimave, as Ilias. «Jeta është e çuditshme, — mendonte ai atë çast, — nga një herë je i detyruar t'u bërtasish atyre që me gjithë shpirt do t'u ngulje medaljen e trimërisë në gjoks».

— Hipni në maqinë, inxhinier! — tha drejtori, duke i hapur derën e «Gazit» Lidjes.

«Do të më bëjë për ujë të ftohtë atje në zyrë, — mendoi Ilia».

Vajza që hutuar pas asaj faqes vrima-vrima të malit. Mendja i vajti te fëmijëria e hershme. Ju kujtuan ebbabilët... Kur ishte fëmijë ajo i nxirrte me një shkop të gjatë këta zogj të çuditshëm nga çerdhet e tyre në dhe. Edhe vrimat në portal, vrime ebbabilësh ishin... Për t'i hapur ato, njerëzit kishin punuar si zogj të varur në hapësirë. Ebbabilët...

— Shoqja inxhinierë!

Ajo u kthye e trembur nga zëri i drejtorit. Pastaj vështroi edhe një herë portalin. Faqja e malit ishte e shkretë. Ebbabilët qenë trembur...

KAPITULLI VIII

Vërshonin punëtorë të rinj. Për ditë kishte nevojë për punëtorë të rinj. Frontet e punës zgjeroheshin me shpejtësi rrufeje. Donin krahë...

Shumica e punëtorëve u kishin kërkuar vetë ndërmarrjeve që të punonin në hidrocentral. Këtu thërriste partia.

Në sektorin e betonimit ditët e fundit erdhën dhjetë punëtorë të rinj. Tre pompistë, dy sondistë, dy motoristë, një ish-shofer dhe dy burra në moshë, pa profesion.

Shefi i kuadrit e porositi Lidjen në mënyrë të veçantë për këta tre të fundit. Shoferit ja kishin hequr maqinën kushedi për çfarë maskarallëku, ndërsa dy të tjerët kishin qenë përpara dy vjetësh në burg. Njëri për matrapazllëqe, tjetri për politikë. Agjitacion e propagandë...

Lidja mendoi mirë ku t'i vendoste këta të tre. Shoferin e caktoi të punonte në vagona. E quanin Sandër. Sandër Delia. Qe një atlet me trup të bukur që mund ta marrje pa frikë për model anatomie. Dukej i shkathët e çapkën. Në cipat e buzëve kishte përherë të gatshme një rezervë ironie. Dy të tjerët, Loro Kini dhe Jashar Lica, kishin punuar pak kohë në komunale si punëtorë të thjeshtë.

Po shtroheshin shinat e para rreth nyjes së betonit. Ata të dy do të mirreshin me atë punë. Disa puse ishin në përfundim e sipër. Edhe pak niste betonimi.

Ata të dy e nisën punën urtë e butë dhe me një sjellje si prej njeriu që shtiret. Lidjes nuk i pëlqente që asnjëri prej tyre nuk guxonte ta vështronte në sy dhe që ishin aq të gatshëm ta kryenin urdhërin e saj pa hapur gojën mirë. «Këta njerëz nuk guxojnë të të shohin në sy. Nuk e kanë ndërgjegjen të pastër!»

Ata të dy punonin shumë mirë. Megjithatë sesi binin në sy në mes të puntorëve, si mish i huaj. E ata pra, nuk bënin asgjë veçan të tjerëve, punonin e mirrinin pjesë si të tjerët në jetën e kantierit. Kjo gjë e fuste

në mendime Lidjen. Pse ndryshonin ata njerëz? Çfarë mendimesh kishin? Ata nuk i dukeshin nga tanët. «Rreth njeriut që nuk është yti edhe ajri sikur kundërmon ndryshe, i rëndë, i ftohtë, armiqësor. Këtë njeriu mezi e ndjen, po e ndjen ama!»

Lidja mundahej të mos mendonte kështu për ta, por qe e pamundur ta largonte mendjen prej tyre. Krejt i huaj i dukej sidomos Jashar Lica.

Ndërsa ata të dy i bindeshin posa të hapte gojën, me ish-shoferin e kishte pisk punën. E kishte nisur ters me të që ditën e parë. Ajo i kishte thënë se do të punonte në vagona. «Unë due një vend ku ka lekë, — i qe përgjegjur ai, — mbasandej asht punë për ty o punoj në vagona apo në dreq. Unë jam mësue me lekë shumë nëpër duer...»

Lidja e kishte përmbajtur veten dhe i qe përgjegjur se do të paguhej sipas punës.

Ndodhte që ajo e thërriste për ndonjë punë dhe ai zbardhte dhëmbët, ose ngrinte kokën lart nga sondistët dhe qeshte me të keq, sikur të thoshte: «E shihni? Inxhiniere, jo shaka!»

Ajo i tërhoqi vërejtjen nja dy herë, por ai nuk ja vari fare. Herën e fundit ju përgjegj pa pikë turpi: «Ohu, sa kam pa femna unë!»

Femra! Kjo fjalë në gojën e tij tingëllonte në mënyrë shumë të ulët. Nën të fshihej një përbuzje e mbrujtur prej kohësh. Lidja u hutua atë çast. Nuk i kishte ndodhur kurrë në jetë ta ofendojnë aq rëndë. Ajo mend qau. Po të kishte qarë do t'i kishte marrë lumi të gjitha. Nuk do zinte vend më fjala e saj. Po ajo nuk qau. Ajo do ta kujtojë për shumë kohë duke u dredhur këtë çast. Se si e kishte përmbajtur veten... Në ato çaste vështrimi i saj takoi sytë e xha Brahos. Sytë e kaltër të sondistit bënë atë që mund t'i bëjë udhëtarit të dëshpëruar në shkretëtirë dukja e një oazi. Po, si një oaz ishin sytë e tij. Po nga oazi nuk shpërthente ujë por shkëndija përkëdheljeje dhe shkëndija zemërimi. Të parat i takonin vajzës, të dytat Sandër Delisë. Ish-shoferi

kishte ngritur kokën dhe e kishte vështruar me një farë përçmimi sondistin.

— Po, kam nanë, i qe përgjegjur ai pyetjes së xha Brahos.

— Po motër ke?

— Kam edhe motër. Po ty ç'të duhet?

— Po kushërira?

— Nji thes plot!

— E pra, të gjitha këto janë femra, — i qe kthyer xha Brahoja. — Mos e harro këtë, djalo, se nuk ta fal njeri!

Kaq kishte thënë e qe larguar. Lidja ja pat zili atë mënyrë të sjelluri.

Ish-shoferit i pëlqente të binte në sy, i pëlqente ta rrethonin ndihmësondistët e rinj dhe të shtrinte mbi ta ndikimin e vet. Ai nisi t'i mahniste të rinjt me shpejtësinë e «Skodës» së tij, të mburrej si kishte transportuar nën tallash mallrat e matrapazëve, madje si kishte futur në një kasetë të veçantë veglash një femër nga Durrësi në Tiranë. Ai ja skuqi veshët një ndihmësondisti që guxoi të shprehte një farë mosbesimi për mundësinë e kasetës për të mbajtur femra. Sandër Delia ja kishte shtrënguar veshin fort dhe i kishte thënë me të madhe: «Po të tha Sandri, mos e rrëmo ma gjatë. Me t'thanë unë se në vend të femnës kam futë një ka, duhet ta besosh. Nuk ka pallavra me mue!»

Punonte në nyjen e betonit. Herë shpejtonte, herë vonohej. Kështu prishte rrugën e vagonistëve të tjerë. Kur nxitonte s'pyeste për çfarë kishte përpara, dhe vagonisti përballë shpëtonte për një qime pa u shkelur. Sandër Delia mirrte atëherë përpara edhe vagonin e tij edhe një të dytë dhe shtynte i vetëm tre vogona.

«Atij i pëlqen të mbahet me të madh, — mendonte Lidja, — të mburret për forcë fizike. Djalli e merr vesh ku do të dali...»

Punohej në nyjen e betonit. Atë ditë Sandër Delia merrej me shina. Punonte me zor, sikur t'i kishte duart të lidhura. Por për të folur nuk humbiste asnjë rast. Hidh një fjalë këtej, hidh një fjalë andej. Barceleta të shkurta, me shumë kripë, madje aq sa nuk mbanin më.

Lidja zjente nga inati. Hidhërohej më shumë se Sandër Delia po molepste me fjalët e veta dy ndihmësondistë të rinj. Lidja kishte vënë re se ata të dy rrinin vazhdimisht me Sandër Delinë. Ishin si dy satelitë të vegjël që vërtiteshin në orbitën e ish-shoferit.

Lidja u turr me zemërim andej. Tek e panë të ngutej. Loro Kini e Jashar Lica zgjatën kokat.

Një herë kam transportuar me «Skodën» time nja dyzet fshatarë sikur të ishin vullnetarë për hekurudhën Rrogozhinë-Elbasan... Si ja kam hedhë atë ditë kontrollit...

— Shokë! Është kohë pune. Lërimi llafet!

Lidja e mbajti me zor zemërimin.

— Kohë pune? — bëri si i çuditur Sandër Delia.

— S'mbarron kurrë ujët e detit dhe puna e shtetit!

— Nuk është puna e shtetit, — bërtiti vajza, — është e jotja, e të gjithëve. Dhe... Dhe nuk ke pse krenohesh me ato që tregon.

— Ajo është punë për mue, — shfryu Sandri.

Pasdreke Lidjes i ngjau edhe diçka tjetër e papëlqyer me këtë njeri. Kishte mbaruar turni. Punëtorët nxitonin drejt autobuzeve. Nxitonte dhe Lidja. Kishte punë në qytet.

Punëtorët qenë grumbulluar përpara derës së maqinës, por askush nuk po hynte brenda. Shtyheshin, ankoheshin dhe i suleshin dikuj. Sandër Delia kishte zënë dy kanatat me duar dhe nuk linte asnjëri të futej në maqinë. Ai e përballonte për mrekulli trysninë e punëtorve.

— Kadalë! Kadalë! S'la me hi kend pa biletë!

— Nuk je fatorino! Liro rrugën!

— Jam shofer unë, nuk mund të lejoj çrregullime,
— tallej Sandri.

— E dimë, e dimë, çfarë shoferi je!

Sandri ngrinte herë pas here krahun dhe linte të kalonte ndonjë të njohur. Të tjerët shtyheshin, bërtisnin. Sandër Delia qeshte.

Lidjes i zunë sytë xha Brahon. Kryesondisti kishte qëndruar më një anë dhe vështronte ç'bëhej. Për çudi nuk po ndërhynte fare.

Erdhi shoferi i autobusit dhe i foli Sandrit të lironte rrugën. I foli me të mirë, ama. (Ai nuk mund të harronte që kishte qenë shofer. Në mes shoferëve ka një solidaritet të madhërishëm).

Shoferi i autobusit i tha Lidjes të hynte nga dera e tij, se do të ziheshin vendet dhe do të mbetej në këmbë.

Lidja nuk pranoi.

Autobusi po mbushej. Sandër Delia e liroi rrugën dhe zuri për vete dy vende në krye të maqinës. Nuk la njeri të ulej në vendin bosh. «Asht i inxhinieres,» — thërriste me zë të lartë e me një mënyrë provokuese. Kështu i tha edhe xha Brahos: «Asht vendi i inxhinieres sonë të dashun, more mik!»

Lidja mbeti keq. Të ulej apo të mos ulej? Po ngurrimi i saj zgjati aq sa nuk qe e mundur të binte në sy. U ul në ndenjese me të shpejtë, duke ndjerë mbi vete sytë e të gjithëve.

— Oh, urdhëroni, uluni. Na nuk mund të lamë në kambë një damë...

Lidja mendoi ç'ti përgjigjej. Po a duhej t'i përgjigjej? Po! Ai duhej mundur me armët e veta.

— Një vepër e bukur bëhet dy herë e bukur kur kryhet nga një kavalier si ju, — u përgjigj Lidja.

Asaj i erdhi të qeshte me të madhe. Ku ishin ata? Në ndonjë mbrëmje vallëzimi?

Po qeshën të tjerë për të.

Ish-shoferi e kyçi gojën. Mbeti keq. Maqina u nis.

Lidja ndeshi sytë e xha Brahos. Oazi kishte zënë gjithë shkretëtirën...

KAPITULLI IX

Nisi betonimi. Një punë pa ndërprerje, një punë zinxhir... Vonesa më e vogël është katastrofë, vonesa më e vogël është humbje. Çimentoja ngrin menjëherë, duhet shpejtuar. Betoni nuk lidhet po ngriu çimentoja.

Shpejt! Shpejt! Shpejt!

Puset e para që po betonohen. Katër puse...

Vagonat derdhin betonin me shpejtësi mbi bunkerët e futur në grykën e puseve. Një varg vagonësh që vijnë e zbrazen njëri pas tjetrit, një varg vagonësh që i përpin dheu... E ai ka shumë uri, gjë s'e ngop!

Të gjithë lëvizin me një shpirt, me një puls. Këtu duhet një shpirt i fortë, një puls i hekurt.

Vagonat shkojnë e vijnë brenda rrethit, një rrethi që duhet respektuar me rreptësi. Kohë! Kohë! Koha gjë e madhe!...

Lidja është si në ethe. Vështron minutë për minutë orën. Kur s'duhet ajo ecën tmerrësisht shpejt... Pastaj vështron ato që ka përreth, drejtorin e ndërmarrjes, inxhinierët e tjerë, specialistët kinezë, Zef Mërtirin... Më tutje duken plot punëtorë që kanë mbaruar turnin në sektorë të tjerë, po kanë qëndruar për të parë betonimin. Betonimi! Punë e madhe betonimi!

Drejtori i ndërmarrjes tinës vështron Lidjen. E vështron dhe buzëqesh. Brenda përbrenda është i mallëngjyer. «Këto çupat tona... Këto çupat tona që një kohë shkonin vetëm perin në gjilpërë...»

Lidjen e shqetëson Sandër Delia. Ish-shoferi mbetet prapa. Kështu pengon edhe të tjerët. Sikur bie ritmi.

Zef Mërtiri është i qetë. Në të vërtetë ai po e drejton punën. Lidja e ka zili. Don që të jetë edhe ajo aq e qetë. Por, ç't'i bësh... Qetësia e tij dhe buzëqeshja e Bardh Shkozës bëjnë punën e tyre. Vështron ata, siç vështron orën. Pastaj specialistët kinezë... Kur pushojnë këta njerëz? Gjithnjë në këmbë, gjithnjë në këmbë!

— Shoku Li! Atë punë e bëjnë punëtorët tonë!

— i thotë drejtori një kinezi trupvogël që ka hipur mbi bunker, — e bëjmë ne.

Shoku Li buzëqesh. Nuk ka vend ku nuk është stërpikur me cirka betoni.

— Njësoj është, buzëqesh shoku Li. Shqiptari, kinezi, njësoj!

Ai i shqipton fjalët me një theks të veçantë.

Bardhi «sa një vinç» i qaset Lidjes.

— Mos u druani, — thotë, — nuk do të na plasi puna në dorë, do t'ja dalim.

— Ritmi nuk po ndiqet si duhet, Bardh. Ai Sandri...

— Megjithatë, megjithatë!

— Mbase duhet zëvendësuar?

.....

Njëri nga vagonat doli nga shinat. Betoni u derdh përdhe. Vagonisti se ç'shau nëpër dhëmbë. U vra duke u përpjekur me gjithë shpirt për ta mbajtur vagonin të mos vithisej. U turrën edhe të tjerë, po ndërkohë vagoni që rrëzuar. Sandër Delia kryqëzoi krahët. Ishte rruga e zënë...

Se kush deshi ta ngarkojë prapë botonin e derdhur.

— Shoko, shoko! — thëriti specialisti Li nga gryka e bunkerit, — nuku duhet ai beton. Nuku duhet.

— Betoni duhet të jetë i pastër si floriri, — foli Zef Mërtiri.

Punëtorët e zbrazën vagonin.

Rruga u hap. Lidja vështron orën, vështron orën... Është si në ankth. Është puna e saj e parë serioze. Këtë ditë nuk do ta harrojë gjithë jetën. Dita e parë e betonimit!

Papandehur pushoi zhurma e betonierës, heshtën motopompat, mbeti gërhitja e çrregullt e sondave. Qetësi, qetësi e thellë. Gjithë ai kantier i gjallë heshti si nga ndonjë dorë magjike.

Lidja ndjeu zbraztëtirë në stomak, pastaj si të fikët. Mendoi për ndonjë qark të shkurtër, apo për ndonjë avari tjetër. Atë çast gjithë qenja e saj pyeste vetëm një gjë: sa kohë do të mungojë korrenti?

Po zhurma rifilloi, kantieri u ngjall, u përtri, u përtri

edhe zemra e Lidjes. Po nuk shkoi shumë dhe diçka shkrepri në shtyllën ku merrej korrenti dhe kantieri heshti prapë.

— Korrenti u pre!

— Kontakt!

Volantet e pompave, që ende silleshin për inerci, sikur e bënin gjendjen edhe më të rëndë.

Lidja shtrëngoi instiktivisht krahun e Bardhit «sa një ving».

— Betoni, Bardh!

Në atë thirrje përmbledhej gjithë ankthi i punës, gjithë shpirti që ajo i kishte kushtuar punës.

— Qark i shkurtër?

— Ose kontakt, ose këputje filli, — u përgjegj shpejt e shpejt brigadieri, — duket se atyre të nënstationit u dogji që e prenë korrentin.

Elektracistët nuk ndodheshin aty. I kishin mobilizuar të gjithë për barakat e reja gjysmë ore larg. Duhej gjithë ajo kohë që t'i lajmëronin.

Bardhi nxori nga xhepi një pincë të izoluar. Pastaj kërcëu në këmbë dhe ju vu prapa një «Lum Verdhe» që po bëhej gati të nisej. Dha e mori me duar edhe me kokë me shoferin dhe maqina bëri andej nga shtylla ku kishte ndodhur kontakti. Karrocëria zu të ngrihej avash-avash, për një metër e arriti majën e shtyllës. Bardhi u kacavar me shumë shkathtësi nëpër anën e prapme, pastaj doli mbi parapetin e korrocërisë. S'kishte kohë për të kërkuar shkallët.

— Është këputur — bërtiti fort Bardh Shkoza.

— Kujdes, — thirri duke vrapuar drejt tij drejtori i kantierit, — tension i lartë...

Poshtë shtyllës punëtorët merrnin e jepnin me njëri-tjetrin.

— Ah, ata elektracistët janë si ciganët me çadra...

— Duhet doreza, është rrezik.

— Ku pyet Bardhi?

— Ju veproni keq, shoqja inxhinierë, duhet të keni të paktën një elektracist këtu për çdo rast.

— Po, keni të drejtë, — pëshpëriti Lidja.

— Cirk! — thirri Sandër Delia. — Çfarë akrobati ky brigadieri jonë!

— As ti nuk i len gja mangut për klloun! — thirri dikush nga turma.

Ish-shoferi kërkoi me sy të keq atë që fohi.

Zhurma rifilloi, maqinat nisën punën. Njeriu u lidhi arteret. Bardhi «sa një vinç» zuri të zbriste nga karrociera. Punëtorët u shpërndanë si vetëtima nëpër vendet e tyre. Lidjes ju bë sikur dalloj një nënqeshje të ligë në buzët e **Jashar Licës. Vetëm ju bë?**

Edhe në krahun tjetër të digës punohej me ngulm. Po çimentoheshin disa puse. Çimentoja futej në puset me anën e tubave me presion. Pastaj mbushte atje thellë në tokë vrimat dhe zgavrat e zhavorreve. Xha Brahoja e kishte nisur i pari çimentimin. Puna po ecte mbarë. Kryesondisti ishte në qejf.

«Or Sami, — i thoshte gjithë gëzim ndihmësit, — thith, thith!»

— Jo thith, po përpin si dreqi! — ja ktheu djaloshi.

— Ku ta gjejmë të na i zërë të gjitha të çarat!

Erdhi Zef Mërtiri. Atë ditë ai rrihte në dy krahë, si i thonë. Te betonimi dhe te sektori i vet.

— Si ecën puna?

— Bukuri, shoku inxhinier.

— Sa është presioni?

Xha Brahoja vështroi instiktivisht manometrin.

— Ai i mëparshmi. Gjashtë atmosferë!

— Mos duhet luajtur?

— Nuk e besoj. Thithja duket normale.

Zefi u largua.

— Tani ulu edhe pusho pak, — i tha xha Brahoja ndihmësit, — je lodhur shumë sot.

— Unë jam i ri, — tha djali i prekur, — ulu ti.

— Ulu, kur të them, ulu!

— Thash se shpëtova nga kursi, — tha djali, — po ma kishin njit edhe mu.

— Domethënë nuk të pëlqeka kursi?

— E ç'ka kam me mësue unë aty? S'ma merr mendja se ka aty ndonjë ma t'zotin se ti.

— Këtu ke vetëm praktikën, — buzëqeshi xha Brahoja. — Praktika pa teorinë është e mangët, është si ai njeriu që sheh vetëm me një sy. E atje ka edhe më të zot se unë, në një shkollë tjetër mund të ketë edhe më të zot se ata. Dituria është det i gjerë. Lum ai që ja rrëmben të fshehtat. Pastaj, megjithëse ti më quan të zotin, po të tregoj se edhe unë kam ndjekur një kurs kualifikimi përpara dy vjetësh në Bistricë. E mua nuk më regjistroi asnjëri. Shkova vetë. Dhe dije se do t'i futem shkollës prapë edhe unë... Dhe ku ti, ku unë!..

— Po nuk kam as kohë... — vazhdoi të kundërshtonte djaloshi.

— Eh, kohë! — psherëtiu xha Brahoja. — Kohë ka gjithmonë, por njeriu duhet të dijë ta rrokë si duhet atë. Po ne, disa herë, në vend që ta shtrëngojmë fort, e lëshojmë me të dyja duart.

— Edhe njërin nga ndihmësat e sondës fqinje e lajmëruan për kurs, — vazhdoi Samiu, — nuk u shpëton gjë atyre të komitetit profesional.

Brahim Jergucati buzëqeshi.

— Çimento! — thirrën nga sonda numër pesë. — Çimento!

Brahim Jergucati u afrua andej. Sonda numër pesë ende nuk e kishte përfunduar gjithë pusin.

Xha Brahoja u ul në gjunjë dhe mbushi pëllëmbët me ujët e turbull që dilte nga gryka e pusit. Ujët vinte si ngjyrë hiri i çelur.

— Me sa duket komunikojnë pusët, — foli xha Brahoja.

— Të lajmërojmë inxhinierin.

— Mirë. Po tani për tani të pakësojmë presionin me radhë nëpër sondat që po mirren me çimentim. Nuk

i dihet nga komunikojnë. Mbase duhet ndryshuar edhe raportin e përgatitjes së çimentos.

Erdhi Zef Mërtiri.

— Të gjitha sondat gjashtë atmosferë presion, — urdhëroi ai. (Kishte sonda që punonin me presion më të lartë).

— Unë mendova t'i gjurmojmë me radhë... Kështu humbasim kohë.

— Bëni si ju thonë, — foli i vendosur inxhinieri.

Brahim Jergucati rراسi kasketën në kokë dhe u drejtua nga sonda e vet.

— X —

Betonimi vazhdonte. Lidja e kishte marrë veten si duhet. Vetëm Sandër Delia e pengonte për të qenë krejt e lumtur. Ah, ai Sandër Delia!

Ish-shoferi ishte si një hallkë që nuk lidhej mirë në zinxhirin e transportuesve, një hallkë që ecte si i tekej, herë kërcente përpara, herë mbetej prapa.

Erdhi Zef Mërtiri.

— A i keni tërhequr tubat? — pyeti me një frymë.

— Tubat? — Lidja i ra me pëllëmbë ballit.

— Po të ngrijë betoni, s'ka gjë që i ngre lart. Kjo është kaq e thjeshtë...

Lidja u skuq. Një qortim i fshehur në fjalët e tija...

Gjendjen e shpëtoi përsëri Bardhi «sa një vinç».

— Betoni nuk ka arritur tubin e parë, shoku inxhinier, mos u shqetësoni aq. Edhe ne e kemi kujdes atë punë.

Erdhi vinçi. I tërhoqën tubat një njeje më lart. Zunë t'i zhvidhosin. Zef Mërtiri hoqi xhupin dhe rrëmbeu një çelës të madh. Zuri të punonte me ngulm. Lidjes i vinte mirë kur e shihte ashtu.

«Në punë bëhet copë, — mendonte ajo. — Atë që

e ka, e ka. Por mbase kjo është më e mira. Meqë ka këtë, të tjerat mund t'i fshijë...»

«Me të tjera» atë çast ajo kuptonte gjithë ç'nuk i pëlqente te Zef Mërtiri.

Poshtë, pranë nyjes së betonit, Sandër Delia grindej me vagonistin që kishte pas. Vagonisti ankohej se e pengonte me ngadalësinë e tij.

— Asht punë për mue, mos i fut hundët në qull!

— Në qull? Ti je tamam qull. Nuk je i zoti për asgja, veçse me u kapardisë...

Sandri u turr nga vagoni i vet dhe e shtyu përpara me tërbim. Se kush thirri. Tre vagonistët përballë u hodhën jashtë shinave. Një përplasje, dy, tre! Sandër Delia i vuri përpara të tre vagonat me beton duke i shtyrë si i marrosur. Vagoni i kreut sikur nuk lëvizi në fillim, pastaj u lëkund, shkau dhe më në fund lëvizi me vrullin e të tjerëve, me shpejtësinë e të tjerëve.

— I çmendur! — thirrën vagonistët.

— Për pak na këpute kambët. Ti je me u lidhë!

Sandër Delia ja doli t'i çojë të gjithë vagonat përpara puseve. Pastaj i shkarkoi vetë një nga një.

«Ai ka sedër, — mendonte Lidja, — ka forcë të madhe. Po sedra e tij i ngjan një lëmshi të ngatërruar që nuk i gjendet filli...»

Ai i ktheu vagonat prapa me mospërfillje, sikur të kishte bërë një punë krejt të zakonshme, duke i shtyrë nga larg me një dorë, e duke i arritur pastaj me hapa të mëdhenj kur pakësonin shpejtësinë.

Vagonistët nuk i mbajtën mëri, madje mund të thuhet se e vështruan me një farë admirimi. Nganjëherë njeriu e çmon padrejtësisht veprën e gabuar, sepse i pëlqen e jashtëzakonshme. Lidja kishte ftohtë. I dukej se dimri kishte ardhur herët dhe ja kishte nisur tepër seriozisht. Ajo harronte që kishte hyrë janari. Janar... Brigjet e Drinit vende-vende kanë vënë kornizë të hollë akulli. Era që lirohet nga gryka e ngushtë si nga ndonjë gjyryk vigan, shpërndahet me potere nëpër gjithë luginën. Lart në qiell një trekëndësh patash të egra.

KAPITULLI X

Mbledhje kolektivi. Jashtë. Punëtorët janë ulur në shesh pas barakave ku nuk i merr era. Janë ulur në shesh edhe drejtori i sektorit dhe nëpunësit e tjerë. Një mbledhje kolektivi, siç shihej një mbledhje tepër e nxehtë punëtorësh, që dallon për sinqeritet. Mbledhjen e kishin kërkuar një grup punëtorësh me një fletërrufe sa dy faqe gazete. Në shenjestër Ahmati dhe Sandër Delia. Si njëri si tjetri nuk kishin vënë mend. Këshillat, kritikrat, puna edukative me ta kishte shkuar bosh. Dhe ja, tani mbledhja...

U ngrit kryetari i komitetit profesional.

— Shokë! Raport s'ka... Do të flasim lirshëm.

Një zë: Shumë mirë! Raport s'ka!

— S'duam raporte sot!

— Qetësi, shokë! Jemi mbledhur sipas dëshirës suaj, për të shqyrtuar sjelljen e Ahmatit dhe Sandër Delisë.

— Shumë mirë, shoku Sadik. Këtë mbledhje e kemi organizuar ne. Shpesh i bëni ju vetë pa na pyetur.

— Ej, ej! Mos na ngatërro ti, Mazllum!

— Kush e don fjalën? — pyeti kryetari i komitetit profesional.

— Unë.

U ngrit një sondist nga ata të çimentimit, ishte nga grupi i atyre që kishin vënë fletërrufenë.

— Do të flas për Ahmatin, — tha. — Ka bukur do vjet që e njof. Gjithmonë ja ka pasë anda me notu në ujë të turbullt. Asht sondist me kategori të pestë, por si punon? Si asht ma zi! Sa herë e kanë zanë në kokërr të gjumit në orar të punës. Sa të dësh! Pa pyeteni sa e realizon normën?

Sondisti bën një lëvizje nervoze me dorë.

— Ahmatit duhet me ja tregue vendin, — vazhdoi ai. — Po na turpnon. Ne kemi pothuej fëmijë që punojnë dy herë sa ai. Kaq kam.

— Ahmati ka sjellje të keqe morale, si i thonë, — e pasoi një tjetër. Asht mbytë në borxhe. Ban edhe matrapazllëqe e rren njerëzit. Kur u banë shitës biçikletash «Mifa», ti Ahmat? Me sa di unë ke shitë nja pesë copë deri tashti. Edhe sahata ke shitë.

Një zë: Tamam dyqan me komision!

Të qeshura dhe pëshpëritje.

Një zë: Ahmati është grindavec. Me kë nuk është ngatërruar!

— Ngreuni, shokë, ngreuni. Ama flisni me radhë, — tha kryetari i bashkimeve profesionale.

— Qe, se u ngrita, — u përgjegj punëtori. Ahmati nuk ka zënë miqësi me asnjëri. Kujt nuk ja ka prishur qejfin ai? Ai zemërohet edhe po t'i shkelish hijen e trupit. Është kapadai. Pardje, po të mos e ndaja, për pak sa nuk u mbyt me një nga shoferët e parkut. I ra më qafë. Donte t'i zinte radhën te berberi. Mjaft më! Mendoj të mos punojë në kolektivin tonë!

— Ahmati më ka kërkue revolen, — tha një tjetër. «Ma nep sall dy ditë, — m'u lut, — e m'lyp shka të duesh!»

— Revolen?

— Si urdhëron, shoku drejtor, revolen.

— Po përse do t'i hynte në punë arma?

— Nuk besoj se ka patur ndër mend ta shkreppte, se, si thotë populli, «duhen një pendë që t'i tërheqish kambzën», por, me sa kuptoj unë, ma ka kërkue për kapadaillëk...

— Nuk kam kërkue revole! — kërcëu Ahmati.

— Qetësi! Qetësi!

Një zë: E ka kërkuar, kam qenë edhe unë aty.

Një zë: Tamam si thotë Marku.

— Vazhdojmë, shokë!

— Ky njeri është si i huaj për ne — filloi sekretari i partisë, — as lexon shtypin, as vjen nëpër mbledhje, as që pyet çfarë bëhet rreth e rrotull. Sjellja e tij nuk përkon me atë të klasës punëtore. Ahmati harxhon më shumë kohë për të lyer flokët me brilantinë se sa për

t'i hedhur sytë shtypit. Ne morëm inisiativë që mos të lëmë të na kalojë pa lexuar asnjë nga materialet e partisë. E Ahmati? Ahmati ose pin, ose, luan katër orë rresht bilardo a domino.

— Këtij njeriu i kemi dalur hakut, — përfundon me nervozizëm sekretari i partisë.

— Me leje?

— Urdhëro!

U ngrit një minator shtatgjatë si ndonjë plep.

— Duhet pyetur shoku Ahmat, çfarë ka ba me gruen, — tha.

— Unë s'kam pasë grue kurr! — kërcëu Ahmati. — Dola edhe me grue tash!

— Si the? — Ndërhyri brigadieri i tij. — Po a nuk më ke kërkuar leje për të parë gruan?

— E ke marr ters. Të kam thanë se due me marr grue, me u martue. Jo me pa gruen! Qe dokumenti. Jam beqar!

Një zë: Shket si ngjala!

— Dokumenta s'ka për martesën tënde, se je i zgjuar ti, Ahmat. Është e dyta grua që merr dhe lëshon pa vënë kurorë. Mos mendo se je nga një vend i largët dhe nuk të dalin të palarat! Dhe kur e bën këtë punë Ahmati? Atëhere kur partia ngre me të madhe emancipimin e gruas. Ai nuk pyet për fjalën e partisë, ai është armik i përparimit. Mirë tha shoku sekretar. Ky njeri, është si i huaj për ne. Jo më larg se pardje më takoi të shoh një rast që më theri në zemër. E gjej Ahmatin duke biseduar me një plak. Fliste me plakun si ndonjë rrugaç. U zunë. I kam si nëpër vesh fjalët e plakut. «Hallall partisë që nuk po mund t'ja shkeli besën, se ti don plumbin ballit!»

Plaku ishte i jati i vajzës që kishte mashtruar Ahmati. Po a e dini se çfarë ndodhi më në fund? Plaku i hoqi xhakëtën. «Bjere këtu, — i tha, — këtë ta kam pasë falë unë, kam pasë ndër mend me t'pasë si birin tem, por gjarpni s'futet në gjil!»

Një zë: Bre! Na kujtuem se e ka shitë!

— Tani thom, a e meriton ky njeri të punojë mes nesh?

Lidja hodhi sytë rreth e rrotull për të parë çfarë përgjegje do t'i jepnin punëtorët. Kishte qëndruar afër Ilias. Inxhinieri ndiqte me interes të madh çfarë thuhej. Ai nuk e njihte Ahmatin dhe nuk kishte ç'të fliste për të. Por aq të qarta dhe të sigërta ju dukën fjalët e punëtorve sa ai formoi një ide të qartë për këtë njeri.

Zef Mërtiri rrinte si mënjanë. Sikur nuk e interesonte shumë kjo mbledhje. Pranë tij i pandashmi Palush Stajka.

«Uh! — i vinte plasje nga ai njeri! — Sikur është sasia e Zefit! — pëshpëriti Lidja, — hiye, Zefi paska nevojë për të, s'bëka dot pa të!»

Kryetari i komitetit profesional i dha përgjegje xha Brahos. Ai tregoi me hollësi si ishte punuar me Ahmatin. Tregoi sa herë qe këshilluar, sa herë i ishin dhënë materiale për të lexuar, ç'formë emulacioni qe përdorur, si e kishte trajtuar kolektivi, ç'masa disiplinore kishin përdorur.

Një zë: Ahmati ta marri prapë gruan, të bëjë autokritikë!

Një zë: Drejt e ka. Vetëm ashtu mund të qëndrojë mes nesh.

— Shumë mirë. Edhe na kët mende kena!

Ahmati u ngrit në këmbë. Për kë ishin thënë gjithë ato të zeza gjer tani, për të? Nuk i besohej! Ai kishte një fytyrë aq të qetë, një moskokçarje për t'u çuditur...

Autokritika e tij vlejti vetëm për t'i ndezur më shumë punëtorët. E nxorën nga radhët e tyre.

— Do të më shihni! — u kërcënua ai dhe krisi e-iku.

Askush nuk u shqetësua për të. Pastaj i erdhi radha Sandër Delisë...

Mbledhja mbaroi. Sekretari i partisë, Bardh Shkoza dhe drejtori i sektorit po ecnin bashkë. Ata i arriti kryetari i komitetit profesional.

— Ahmati do të ngrejë gjithë botën në këmbë, — tha ai. — E njoh mirë unë. Do të na mbushi me fletërrufe, do të ankohet gjithandej. Edhe në Tiranë do të vejë. Dhe e dini si shkon e flet nëpër zyra? «Kam ardhur shokë t'ju tregoj si e përdorin në aksh vend klasën punëtore...»

— Nga është ky njeri? — pyeti drejtori i sektorit.

— Nga Shishtavec!

— Aha, kuksjan!

— Kërkova hollësira për të andej, — tha sekretari i partisë, po ende nuk më erdhën gjë.

— Aq sa i dolën atij mjaftojnë edhe për një dënim më të madh, — vërejti drejtori. — Po ti, shoku Sadik, ç'ke? Mos t'u duk i padrejtë vendimi i kolektivit?

— Po të më dukesh i padrejtë, a do të rrija unë pa folur? Kurrën e kurrës! Ne kemi një kolektiv tamam revolucionar, kemi edhe një organizatë partie shumë të pjekur. Nuk shkasim lehtë. E kam hallin gjetskë unë. Si u fol për Sandrin? Meqë Sandër Delia ka këto e këto të meta, kolektivi propozon që ai të punojë në tunel për t'u riedukuar. Dhe kur përmendim tunelin, të gjithë nënkuptojmë punën më të vështirë. Po daleni, xhanëm! Po të kemi ndonjë punëtor të keq në tunel, ku duhet ta dërgojmë për riedukim?

Ata të dy u vështruan sy ndër sy.

— Unë mendoj se duhet folur ndryshe, — vazhdoi kryetari i komitetit profesional. — Është e drejtë se njerëzit duhen dërguar për riedukim në sektorët më të vështirë, porse në ato sektorë ka kolektivë heroike punëtorësh, revolucionarë të vërtetë që çajnë malet! Puna ndikon mbi njerinë; po njeriu mbi njerinë ndikon më shumë. Besoj se u shpreha qartë...

— Shoku Sadik ka të drejtë, shumë të drejtë, — foli sekretari i partisë.

— Megjithatë brigada e Llesh Kalisë është më e mira. Po Llesh Kalia sikur s'merr vesh nga puna me njerëzit, — tha drejtori.

— Mundet, shoku drejtor, por ai, si i thonë, është një shembull i gjallë, dhe një shembull i tillë vlen më shumë për të mobilizuar njerëzit se sa një okë fjalësh dhe organizimesh burokratike.

— Kështu e kam dëgjuar të flasë edhe xha Brahon, — u hodh Bardhi.

— Xha Brahoja është vetë një shembull i gjallë, — tha sekretari i partisë, — ai priret shumë pas shembullit personal të njeriut.

— Po ç'është ai grumbull para «Zërit të masës»?

— Ndonjë fletërrufe e re! — u përgjegj Sadiku.

Ahmatil! Ky emër dilte nga goja e punëtorëve që largoheshin të zemëruar nga «Zëri i masës». Ahmatil! Një fletërrufe, me të vërtetë rrufe. Po kur e vuri, xhanëm?

— E ka shkrojtur më parë se të bëhej mbledhja, — tha kryetari i komitetit profesional. — E ka ditur ç'e priste. Sa njeri i poshtër! A nuk ju thashë?

— Tregoi lëkurën e vet, — tha Bardh Shkoza, — lëkurën e vet... Një egoist shpirtvogël... Asgjë tjetër... Ata i shtrënguan dorën njëri-tjetrit.

— Atëherë te kisha, pasdreke!

— Posi, në katër!

Populli kishte vendosur ta bënte kishën kinoteatër. Do të punonin punë vullnetare.

KAPITULLI XII

Brahim Jergucati u drejtua nga klubi. Atë pasdreke e kishte marrë malli të bënte një lojë shahu me Ilian. Xha Brahoja luante rrallë, ndërsa inxhinieri ishte një ndër ata që nuk i shqiteshin shahut. Ili luante më mirë se ai, po ishte gjaknxehëtë dhe e humbiste gjithnjë në finale.

Dhoma e shahut qe e vogël, me dy tavolina, se s'kishte shumë që jepeshin pas kësaj loje, por qe një vend i qetë dhe shumë i rehatsëm. Edhe spektatorë kishte pak, vetëm njëri nuk ndahej, Zaimi. Po ai nuk luante kurrë vetë. I pëlqente vetëm të vështronte. Rrinte dy-tri orë si qiri përpara tavolinës (nuk i mbështeste bërry, lat mbi të) rrinte drejt dhe pa u përkulur në asnjë anë. Herë pas here u mirrte leje lojtarëve të rregullonte ndonjë gur që kundërshtari gjaknxehtë e kishte nxjerrë jashtë katrorëve në një mënyrë të papërcaktuar. «Me leje ta rregulloj pak?» Ose «Ju lutem, të vendosim rregull». Kështu thoshte ai, «të vendosim rregull», sikur s'kishte të bënte me figura shahu, po me dosje llogarie. Pastaj rregullonte gurin apo kalin, duke e shtyrë lehtë me gishtin e vogël (po, po, me gishtin e vogël) ku i zgjatej një thua i madh. Kur mbaronte lodra Zaimi do të bënte një lloj komenti që edhe në balancën e farmacistit po ta vije do të peshonte një lloj për të dyja palët. Komenti zakonisht niste kështu: «Ju shoku... luajtët shumë mirë me filat; ndërsa partneri i juaj dha një shembull të bukur manovrimi me kuaj. Mendoj që po të luhej pa gabime...»

Pastaj shefi i llogarisë nxirrte nga xhepi një shami në formë trekëndëshi dhe fshinte gishtin që kishte shtyrë ushtarin e pabindur.

..... Xha Brahoja kaloi nëpër sallën e bilardos. I zunë sytë Sandër Delinë. Ish-shoferi po qëndronte në një stol dhe ndiqte me interes lojën e dy të rinjve. Nuk ju përgjegj përshëndetjes së xha Brahos. «Mbase nuk më pa, — mendoi sondisti». Pastaj se si i shkoi ndër mend që Sandri kishte dy ditë që s'po shkante në qytet mbrëmjeve. Mbase i vinte turp...

Sondisti përshkoi edhe sallën e ping-pongut, pastaj hyri në të ndarën e shahut. Të dyja tavolinat ishin të zëna. Ilia kishte ulur kokën dhe po mendohej. Dhoma binte erë duhani të fortë.

Xha Brahoja buzëqeshi duke parë Zaimin. Shefi i llogarisë rrinte në atë pozën e vet të zakonshme. Nuk i lëvizte asnjë muskul, asnjë tipar edhe sikur të ndo-

dhnin çudira; edhe sikur të humbisnin kalatë, edhe sikur të sharronin mbretëreshat, apo të ngrinin duart lart-mbretërit.

Brahim Jergucati qëndroi pas shpinës së inxhinierit. Vetëm Zaimi e vuri re.

Partneri i Ilias ishte një djalë i ri, po me sa dukej nuk luante keq. Kishte dy fila dhe pesë ushtarë, kundër kalit, kalasë dhe pesë ushtarëve të Ilias. Inxhinieri dha një «shah» me kalë. Djali luajti mbretin, pastaj u shkëmbyen shpejt e shpejt gjithë figurat dhe ushtarët.

— Remi, — tha djaloshi.

— Remi...

Ilia ishte nxehur dhe as që po e ngrinte kokën nga tavolina.

Ai gjithnjë nxehej, kur humbiste dhe kur fitonte...

— Një lojë e barabartë, dy kundërshtarë të denjë,
— bëlbëzoi Zaimi. Dy filat e vlenin kalin dhe kalanë.
Një lojë e barabartë...

«Pacifist, — se si i erdhi në mendje xha Brahos,
— pacifist»

Ilia u kthye dhe desh të thoshte diçka. Dhe ashtu, spec i kuq në fytyrë siç ishte, s'premtonte asgjë të mirë, po i zunë sytë xha Brahos dhe u ngrit në këmbë gjithë kënaqësi.

— Ku je, more xha Braho? Bëjmë një lojë?

— E bëjmë, — buzëqeshi tjetri.

— Ah, sa mirë! Tani do të shohim një lojë me të vërtetë të fortë, — foli Zaimi.

— E si do të përfundojë? — pyeti me të keq Ilia.

— Them se remi. Nuk i lini gjë njëri-tjetrit...

— Po ty, si s'të kemi parë të luash një herë, shoku Zaim?

— Hem, hem!

Zaimi u turbullua, u skuq.

— Ju lutem të rregulloj pak këtë gur — tha mekanikisht.

Ilia dhe xha Brahoja u vështruan sy në sy. Të

gjithë gurët ishin në vendet e tyre. Fliste forca e zakonit...

Nuk kishin shkëmbyer më shumë se katër-pesë lëvizje, kur andej nga bilardoja u dëgjua zhurmë dhe shamatë.

U ngritën...

Ahmati!.. Po ky, ç'do këtu?

Ahmati po grindej me përgjegjësën e klubit, një ish-minator, që kish mbetur invalid nga një minë.

— Nuk mundesh me luejt përpara tjerve, more shok, — i thoshte përgjegjësi i klubit, — mbasandej, me ç'di unë, ti nuk punon ma këtu.

— Nuk punoj? Të shofim a nuk punoj! Kanë dhanë urdhën ata të mëdhejt. Ju këndeji jeni peshq të vegjël...

— Nuk më duhet gja puna jote, unë shikoj rregullin e klubit, nuk mund të luejsh përpara tjerve.

— Mor, o kam me luejt, o përndryshe ke me fluturue edhe një herë si ke pas fluturue atje në Ulzë.

— Për mue rroftë partia që më shetiti gjithë Evropën për të më mbajtë jetën. E sa për të më fluturue ti... Ma kadalë.

Ahmati bëri një hap drejt tij. Xha Brahoja u sul andej, por një dorë e fortë e hoqi anash. Sandër Delia e zuri në gjoks Ahmatin dhe e ngriti pezull.

— Po të mos dalish jashtë, — i bërtiti, — do të të baj me ju dhimbt qenit.

Ahmati hodhi një vështrim prej gjarpëri, pastaj doli me të shpejtë.

— Kokëkrisuri! — shfryu Ilia.

Xha Brahoja e shikoi me dashamirësi Sandrin; po ai e pa ftohtë.

Ilia e zuri për krahu sondistin. «Eja xha Braho...» Zaho «modë e vjetër» as që kishte lëvizur nga vendi.

— E di Ilia? Sikur ta lëmë lodrën për një herë tjetër? M'u prish qejfi fare...

— Si të duash. Edhe mua sikur m'u vel diçka...

— Pse? Pse? — belbëzoi shefi i llogarisë.

Xha Brahoja u nis drejt e te sekretari i partisë. E gjeti Hamdiun vetëm në zyrë.

— Ai kishte ardhur prapë këndeje, — foli Brahim Jergucati, pa hyrë mirë brenda, — ai, Ahmati...

— E pse shqetësohesh, xha Braho?

— Tha se kishte folur me «të mëdhenj» se ne ishim peshq të vegjël, dhe se do të punonte prapë këtu. Nuk ma merr mendja të gabojnë ata të rrethit. Po të ishte ashtu siç tha ai Ahmati, ku vete vendimi i kolektivit?

— Ahmati gënjen, — tha Hamdiu, — ka gënjyer edhe andej nga qendra. U është paraqitur si viktimë. Më morën në telefon sot për të ditur si qëndron çështja. U çuditën shumë për sa u thashë. U njoftova dhe lajmet e reja që kam marrë nga Shishtaveci sot në mëngjez.

Hamdiu nxori nga sirtari një letër.

— Organizata e partisë njofton se është e vërtetë që ka ndarë dy gra dhe, ç'është më e bukur, është familje kulaku.

— Njeri i rrezikshëm, gjarpër... Paraqitej komunist i flakët...

— Dhe ne flasim për vigjilencë... Asnjëri nuk e dinte se ishte kulak. Dhe çfarë fletërrufesh që shkruante! Gjithë marksizëm!

Xha Brahoja i tregoi ç'bëri Ahmati në klub, dhe si e përfshiu Sandri për gryke.

— Sandër Delia? Interessant...

— Po, edhe më pëlqeu fort...

— Atë duhet ta mbajmë afër, — tha sekretari i partisë, — ai është yni. Më ngjan se ka shkarë pa ditur as vetë se si...

— Ke shumë të drejtë. E ndjej edhe unë që është yni.

Në zyrë bënte shumë ftohtë. Brahim Jergucati mbërdhiu.

— Pse s'ke vënë sobë, Hamdi?

— Unë dal e hyj orë e çast, — foli tjetri, — nuk mund të lë zjarrin vetëm. Zyra është gjithë dhogë, dhogë pishe.

— Sidoqoftë kështu nuk rrihet. E po, mirë u pafshim...

Zuri të ecte ashtu kot përmes kantierit. Kur e kishte turnin natën shpeshherë i shkante gjithë dita ters. Të flinte nuk mundej më shumë se katër orë. Edhe të lexonte nuk i bëhej paradreke. Ju kujtua që nesër kishin formën e edukimit.

«Megjithatë duhet të vete të lexoj, — tha».

Kishte për të studjuar një leksion «Mbi revizionizmin në B. Sovjetik dhe Evropën Lindore që e kishin punuar dy javë përpara. Udhëheqësi i formës së edukimit i kish porositur ta pasuronin temën me lëndë të marrë nga vepra të tjera dhe nga shtypi periodik.

Xha Brahoja solli nëpër mend blokun ku kishte shënuar bibliografinë. E hapi, pastaj me të në dorë u drejtua nga biblioteka e ndërmarrjes.

KAPITULLI XIII

Ditët e fundit të janarit. Të ftohtë dhe akull. Era lëpihet me tërbim pas luginës së Drinit, pas sondave, pas njerëzve: Dimri në kulmin e acarit...

Këputen linjat, ngrijnë tubat, ngrin ujët dhe argjila, ngrin çdo gjë që mund të ngrijë. Po puna vazhdon. Njerëzit kanë zjarr brenda përbrenda vetes...

Tubat i shkrijnë me ujë të valuar, me flakë. Ngrijnë prapë, i shkrijnë prapë. Dimri dhe njerëzit bëjnë secili të vetën. Një lloj gare...

Mëngjez. Brigada e parë në turn. Llesh Kalia se ç'flet me sa fuqi ka andej nga hyrja e Shtergut. Po minatorët janë më thellë në tunel dhe nuk i lë të dë-

gjojnë zhurma e kompresorëve dhe e pistoletave. Një eskavator i mesëm ngarkon maqinat brenda në tunel dhe kur ngrë kovën ja kalon me zhurmë gjithë makinerve të tjera.

Lleshi bëri më tutje.

— Fran, more! Fran!

Mirditasi e dëgjon. Kthen çelësin e pistoletës dhe i qaset brigadierit.

— E kam fjalën për at Sandrin, për at të riun. Më kanë dhanë njimijë porosina për të. Nuk e kam lanë kot afër teje. Mos ju ndaj.

— Mos ki dert. Ma ke thanë nji herë...

— Po, por m'u duk sikur nuk po ja varke fort...

— Përkundrazi! E kam shtruar muhabetin me të. Nuk punon keq, megjithqë nuk merr vesh nga zanati.

Minatorët punojnë në të mëngjër të portalit. Një shkëmb masiv që duhej lëvizur nga vendi. Gjer tani kishte qenë i paprekshëm për stuhitë, për kohërat. Po kohërat ndryshojnë, i ndryshojnë edhe shkëmbinjt...

Kishin çelur tre galeri të vogla në zemër të shkëmbit. Do t'i mbushnin me eksploziv për ta hedhur të tërë përnjëherësh në erë.

Nga grykat e galerive dilnin fjolla të holla tymi. Kishin bërë ca plasje të vogla brenda tyre për t'i zgjatur ato në thellësi të shkëmbit. Ishte gjithë ai masiv...

Sandër Delia hyri pothuaj këmba-doras në galerinë e parë. Atë ditë merrej me pastrimin e galerive.

— Ej, Sandër! — i thirri Frani nga pas, — po ta kesh pisk bjeri burisë!

Sandri qeshi. E çuditshme! Që kur kishte ardhur këtu kishte zënë të qeshtë më shumë. I ngjante sikur minatorët gjasonin më shumë me shoferët. Se Sandër Delia nuk donte të besonte asnjë çast se nuk ishte më shofer... Edhe sikur mos të zinte timonin kurrë më me duar, ai shofer se shofer do të mbetej. I bëhej zemra mal kur i thërrisnin minatorët: «Ej, ti, shofer!...»

Sandër Delia doli nga galeria pa hyrë mirë.

— S'ka burrë që futet brenda, — tha. — Gjithë gaznat janë shtru kambkryq në tunel e nuk duen me dalë.

— S'mund të presim gjersa t'i teket tymit të dali jashtë, — tha Llesh Kalia, dhe u rras brenda në tunel me pistoletë në dorë. Ndenji mjaft kohë brenda, pastaj tymi dhe gazrat zunë të delnin jashtë tunelit të vogël.

Atë çast erdhi aty edhe Lidja. I zunë sytë një njeri që po shkruente shpejt e shpejt kokulur mbi një gur të sheshtë.

— Aha! Poeti ynë! Ç'po thur ashtu, poeti ynë?

Përgjegjësi i mencës ngriti kokën.

— Po shkruaj çfarë pashë tani këtu, — tha. — Diçka si poezi në prozë...

— Aha! Qenke në shërbim të muzave sot. Na e lexo, të lutem.

— Lexoje, lexoje, — tha dhe Llesh Kalia që mendohej të shkundte gjithë atë pluhur që kishte përsipër. Poeti u ngrit në këmbë. Nisi të lexonte:

Si një këngë kreshnike

(Poezi në prozë)

Si një këngë e maleve, si një këngë kreshnike... Kumbimi i saj përfshin gjithë brigjet e Drinit. Është një këngë e fortë, një bukuri e ashpër; ajo na pëlqen, ajo rron me ne... Jehona e saj nuk pushon as ditë, as natë. Kënga e punës! — Njerëz; maqina; zhurmë! Kolona të larta eskavatorësh që përkulen ritmikisht, me kilometra damarë të zinj tubash që u shpien jetë pistoletave. Flakë saldatriçesh... Preludi i ditës së nesërme...

Maqina! Maqina! Maqina! Koha e socializmit! Po heronjtë ku janë? Heronjë! Ne i kërkojmë ata gjithnjë sipas përfytyrimit tonë, pa ditur që na sillen rrotull. Heronjtë, njerëzit tanë të thjeshtë...

— Mina-a-a-a! Mina-a-a-a-a!

Masivi dridhet lehtë. Tri shpërthime brenda tri

tuneleve të vogla. Minator Lleshi mban vesh gjëmimet. Tri gjithsej. Malet këtu nuk e përcjellin oshtimën si në shkrepat e Dibrës.

Po më mirë kështu, se me gjithë ato shpërthime që bëhen këtu, do të kishte njëzet e katër orë osh-tima malesh.

Minator Lleshi del nga vendi ku është strukur. Si gjithnjë pas shpërthimesh ja ka ënda t'ja thotë me gjithë shpirt këngës:

Vallë ku janë-o shtatë malet e Dibrës?

Po i bie shumë shkurt. E thotë, a s'e thotë dhe vargun e dytë të këngës dhe turret në tunel me lopatën e shkurtër në dorë.

— Hej, Llesh! Ktheu prapa! Tuneli është gjithë tym dhe gaz!

Nga tuneli dalin fjolla të holla tymi, sikur përbrenda tij të ndizte llullën qikllopi Polifem.

Lleshi tund kokën. Lleshit i hanë duart për punë. Lleshi do të sulet brenda pa pyetur për gazrat. Shokët nuk e lënë. Presin të dali tymi. Po tymi dhe gazrat kryeneçe, sikur duan të prehen përjetësisht në gjirin e malit.

Lleshi tregon shenja padurimi. Vështron andej-këndeje i shqetësuar. Pastaj rrëmben pistoletën dhe rraset në tunel. Tubi i ajrit zgjatet si ndonjë gjarpër i zi dhe humbet së bashku me minatorin në zgavrën e malit. Dëgjohet një rrapëllimë e mbytur si ajo që bën ujët kur del me presion nga çezma dhe nga gryka e ngushtë e tunelit zënë të dalin tymi dhe gazrat e eksplozivit. Fjollat e para dalin shumë ngadalë, si me përtim, pastaj tymi dhe pluhuri që del jashtë bëhet më i dendur, si ato gulshet që vjellin oxhaqet e fabrikave.

— Lleshi po i zbon përbindshat, — buzëqeshin minatorët.

Rrëmbejnë lopatat e shkurtëra. Tuneli duhet pastruar. Do të mbushet me dinamit gjer thellë në zemër të malit. Nesër këtu do të ketë një shpërthim vigan.

Zhurma e ajrit të kompresuar pushon. Nga gryka

e tunelit del një njeri i tëri i bardhë. I janë zbardhur rrobat, koka, vetullat e trasha, madje edhe qerpikët e syve.

Lleshi buzqesh si ai që ka bërë ndonjë faj: Shkëmbi thërmohet si miell buke...

Heu, Llesh, sa mirë e the! Ne edhe shkëmbin do ta bëjmë miell buke!

Minatorët bëjnë shaka, pastaj humbasin brenda tuneleve. Heronjtë. Njerëzit tanë të thjeshtë...»

Poeti mbaron së lexuari. Është një përgjegjës poet shumë i dashur, po ka një të folur... Kur flet ai duket sikur zbresin bubullimat.

— Shumë mirë! — e lavdëroi Lidja, — por më tingëllon më shumë si skicë...

— Po at kangën teme ku e gjete? — u hodh Llesh Kalia. — Unë s'ja kam shkrepë asnjëherë sot.

— Eh, këta poetët! — e ledhatoi Lidja përgjegjës in e mencës.

— Në mos paç kënduar sot, ke kënduar ditët e tjera. E pothuaj gjithnjë atë këngë. Mos ke mall për Dibrën?

— Nuk këndoj prej mallit. Dibra njikëtu asht. Me dashtë i hypi «Skodës» të shtunën mbasdite e sosem në darkë atje. Kam kohë edhe me u kthye për punë. Më kanë thanë sa herë edhe ata të drejtorisë me shkue, m'asht lutë edhe xha Brahoja, por unë nuk mund të luej pa i dalë drita tunelit.

— Ngrimë! — tha Lidja. — Vjen me mua, ti poet? Po hë, se më ra nëpër mend. Ku djallin të shkoi mendja te llulla e Polifemit?

Përgjegjësi i mencës qeshi — E mirë, është... skica?

— Aq e mirë, sa edhe po të më servirësh gjellën më të keqe në drekë do ta ha pa nxjerrë zë.

Tjetri nuk e kuptoi në tallej, apo fliste seriozisht.

— Ju që shkruani u kenj shumë borxhe këtyre trimave, — tha Lidja. Shumë borxhe... Nganjëherë më mbushet mendja se pena e shkrimtarit nuk do t'ja dali kurrë të përshkruaj forcën e tyre...

Tjetri zu të përmendi emra romanesh, novelash.
 — Të mira janë, të mira, — tundte kokën Lidja,
 — po jeta ka diçka më shumë, diçka më shumë...
 Dhe ajo më ngjan shpesh e pakapshme...
 Poeti u ndal dhe e vështroi me vërejtje.
 — Ti mund të shkruash fare mirë, — i tha.
 Lidjes i ndritën sytë.
 — Tani për tani vetëm skica... planesh dhe prerje
 skematike.
 — Për pak e mora për skica letrare.
 — Kam punë me Ilian, — foli Lidja.
 — Marsh për në tunel, atëherë — bubulloi përgje-
 gjësi poet.

* * *

Brenda tunelit kishin ngritur shpejt e shpejt një dhomë të vogël me dërrasa, si zyrë për personelin teknik. Lidja pa aty dy vajza fare të reja, një inxhinier faqembushur gjithë gaz dhe me një shprehje naive në sy, dhe më tutje Ilian të kërrusur mbi planin.

— Lidje, — tha inxhinieri, — na erdhën plot shoqe tani, një kohë ishte vetëm ti.

— Sikur s'të pëlqen, — e ngacmoi Lidja.

— Ç'thua? Vajzat janë zbukurimi i jetës sonë, — ja ktheu ai po me të njëjtën mënyrë.

— Prapanik! — bëri sikur u zemërua Lidja, — po të ishin për zbukurim do të qëndronin pas vitrinave dhe jo këtu.

Ajo jau shtrëngoi duart fort vajzave. Nuk ju dukën aspak të mpira dhe i erdhi mirë.

— Sot erdhën në kantier edhe trembëdhjetë shoqe të tjera, — tha përgjegjësi poet.

— Shumë mirë! Pritni sa të bëhemi një armatë e tërë, pastaj e dimë vetë ç'duhet bërë me shokët e Ilias.

Të gjithë qeshën. Inxhinieri faqembushur doli jashtë.

— Më fal se të solla gjer këtu, Lidje, — tha Ilia pak si i vrenjtur, — po atje te ti s'vjen dot njeriu me letra dhe me plane. Nuk të lë era atje. Ja se si e kam hallin... Kam frikë nga ndonjë shmangje e tunelit... Gjer dje kam qenë krejt i qetë, por sa më shumë që afrohet koha e bashkimit të të dy fronteve të punës, aq më shumë më zë frika. Nuk kam provuar një gjë të tillë tjetër herë.

Lidjes i erdhi mirë që ai i foli kështu, që i kërkoi ndihmën e saj. Ilia ishte njeri i drejtë, ishte siç duhet të jetë në të vërtetë njeriu.

Lidja u përkul mbi planet. Dhe ata të dy zunë të hahen me një gjuhë inxhinierësh.

— Gjithë devijimi që mund të dali, — tha më në fund Lidja, — nuk mund të kalojë shmangjen e lejueshme. Kot që merakosesh, Ilia. Tuneli nuk është aq i gjatë sa për t'ja pasur frikën.

Përgjegjësit poet e gjithë kjo i dukej tepër prozaike dhe as që po e ndiqte ç'flitej. E kish mendjen te muzat e veta...

Përkundrazi dy vajzat nuk ja ndanin sytë Lidjes.

— Ke të drejtë, Lidje, — tha Ilia, — më shumë më futi frikën Zefi. «se i bën kalkulimet njëqind herë nuk është keq, Ilia. E keqja mund të ngjasë gjithnjë.» Nuk më bënë aq përshtypje fjalët sa mënyra se si i thoshte.

— S'qenkemi vetëm për zbukurimin ne, shoku inxhinier, — u hodh njëra nga dy vajzat.

Ishte një leshverdhë e këndshme, me tipare të mprefta dhe sy të zgjuar, një vajzë fare e re. Kur qeshte i bëhej një gropëz në faqe. «Te ne ç'do gjë po rritet shpejt, — mendonte Lidja, — edhe fëmijët po rriten shpejt».

Ajo kishte harruar që disa muaj përpara ndryshonte fare pak nga leshverdhja me tipare të mprefta.

Dolën nga tuneli. Lidja i futi krahun përgjegjësit të mencës.

— S'të kam parë t'u fusish krahun djemve të tjerë, — tha ai.

— Epo një poet është gjithnjë më i preferuar, —
qeshi Lidja.

Ajo e ndjente veten shumë të gëzuar kur bënte shaka. Pastaj shakaja të shpëtonte nga shumë telashe. Po ajo e shifte që dashur padashur po fitonte ca zakone djemsh. Kjo ishte e pandalshme gjersa ishte gjithë ditën mes tyre.

— As Zef Mërtirit nuk të kam parë t'i fusish kra-
hun...

— Hesht, poet me mendime të këqia!

Lidja po vështronte Sandër Delinë. Ai binte në sy menjëherë që ishte i ri aty. Pistoleta i dridhej në duar dhe ai mbështetej mbi të me gjithë trupin. Ai nuk dukej aspak i këputur.

— Ç'kemi? — pyeti Lidja.

Ajo priti t'i përgjigjej me ndonjë batutë të le-
zetshme.

— Mos është punë e vështirë, kjo?

Ai i ktheu çelësin pistoletës.

— Unë i kam shumë inat ata që qahen, — tha.

— Shumë mirë. Edhe unë i kam shumë inat ata që
qahen.

— Do të kisha ikë prej këndeje, po të mos ishte
kështu...

Ktheu çelësin. Pistoleta buçiti.

Lidja foli prapë. Sandri i ktheu rishtas çelësin.

— Ti nuk mund të ikish nga kantieri se i ke
inat ata që qahen, apo jo?

— Po, nuk mund të iki.

— Nuk mjafton, duhet të qëndrosh këtu nga da-
shuria për gjithë këtë vepër...

Ajo u përmbajt. Ju duk se u shty shumë; pastaj
sikur po bënte moral... Po sikur t'i përvishej ai?

— Nuk e di, — u përgjegj Sandër Delia. — Tash
për tash vetëm se i urrej ata që thyhen dysh...

U afrua Fran mirditori.

— Informacion politik në pushimin e drekës, — tha.

— Mirë! — u përgjegj Sandri.

— Ma kanë ngarkue mue punën politike, — i shpjegoi Lidjes, — ndoshta duen me më marrë me të mirë... Me më edukue... — Një tingull i hollë ironie në zërin e tij. Po një ironi pa të keq...

Vajzës ju kujtua sa kish ngulur këmbë xha Brahoja për këtë në mbledhjen e komitetit profesional. Shumë e kishin kundërshtuar, madje edhe ajo vetë «E di si më duket kjo, xha Braho? Sikur me një dorë i jep një dackë, me tjetrën e përkëdhel».

Po Brahim Jergucati kishte arritur t'i bindte të gjithë për t'ja ngarkuar Sandër Delisë punën politike me brigadën. «Po natyrisht, Hamdiun do ta ketë për-krah. Ta shohim, kam besim te ai».

— Nuk mendoj, — u përgjegj Lidja, — ti nuk do lejoje njeri të të përkëdhelte.

— Ashtu është, po ndonjëherë ke nevojë edhe me të përkëdhelë dikush, se përndryshe bahesh i egër. Unë jam rritë me njerë.

Asaj ju duk sikur u mallëngjye, sikur mund t'i kërkonte të falur për sjelljen e tij të keqe ndaj saj. Prandaj shpejtoi të ikte. Nuk mund ta dëgjonte duke i kërkuar të falur. Më mirë kështu. E harruara, e harruar! Pse ta ngacmosh atë?

— Mirë u pafshim, — tha Lidja, — përpiqu të shohësh dhe të kapish nga jeta e këtushme anët më të mira. Është mirë të bëhet informacioni. Po, mirë është! Atëhere bëje pa menduar pse ta kanë vënë në kurriz.

Ajo zu të largohej.

— Prit — thirri Sandër Delia, — prit. A nuk më thue sa vjeç je?

Lidja vështroi një hop e menduar.

Njëzet e pesë u përgjegj ajo. Ç'hyn mosha këtu Sandër? Zemra zuri t'i rrihte fort. Priste vetëm kur do t'i përgjigjej keq Sandri. Pyetja e tij ju duk e dyshimtë.

Po ai e vështroi me sy të çakërdisur, pastaj u kthye me të shpejtë në vendin e punës.

Lidja i futi krahun sërish përgjegjësit të mencës që s'e kishte çelur gojën gjithë kohën.

Ç'ke? Ç'ke kështu? foli ai si i trembur.

— Asgjë, — u përgjegj vajza, — vetëm se jam e kënaqur nga vetja. E para herë që jam e kënaqur nga vetja...

Era dhe zhurma e maqinave ngriheshin gjer në qiell.

— Me vra-a-a-ap! — bërtiti Lidja.

Ata u larguan sa u hanin këmbët nga ai vend ku mbështilleshin dhe çmbështilleshin korrentet e ajrit.

KAPITULLI XIV

— Lidje, po të duash vemi në kinema sonte — i tha Zef Mërtiri.

Ora po i afrohej pesës. Zefi kishte hyrë brenda në dhomë së bashku me thëllimin e të ftohtit.

Ajo u ngrit dhe la librin mbi tavolinë.

— Gjithnjë duke lexuar të gjejë...

I hodhi një sy titullit. Një libër mbi kalkulimin e trarit.

— Autori është i njohur mirë edhe jashtë — tha.

«Jashtë! Jashtë! Si shpesh e përdor këtë fjalë!» Lidja ngrysi vetullat.

— Të pyeta në do të shkojmë në kinema?

— Paska ardhur aparatura?

— Po, erdhi.

Heshtje.

— Prap nuk m'u përgjegje, Lidje,

— Vetëm do të shkojmë në kinema?

— Ç'ka për t'u çuditur këtu?

— Asgjë! Vetëm se mendova se mbase nuk mund të ndahesh nga Palush Stajka...

Ajo u skuq nga zemërimi. E ndjeu që do t'i vërsulej që kur u fut në dhomë.

— Ç'do të thotë kjo, Lidje?

— Ç'do të thotë? A do të ta them hapur si një shoqe e vjetër?

— Folë! — e nxiti ai.

— Do të thotë se ai të ngjitet si hije prapa; do të thotë se ti s'bën dot pa të, se të pëlqen kur të përkëdhel; kur të rreh krahët, kur ta pranon çdo fjalë me sy mbyllur. Vetëm kur vjen te unë nuk e ke Palush Stajkën, përndryshe jeni si binjakët Siamezë... Njerëzit kanë zënë të flasin, të qeshin pas krahëve. Më vjen turp...

— Nëse rrimë bashkë nuk ka asgjë të keqe, — u revoltua ai. — Kush mund të guxojë të tallet me mua?

— Po kur të lëvdon ai në sy? Po kur përsërit fjalët e tua? Si nuk e kupton?

Fjalën e fundit e zgjati shumë; sa gati e ndau në rrokje.

— Sipas teje më pëlqejnë lajkat, përkëdheljet?

— Po, kështu mendoj. Unë nuk e kam zakon t'i fsheh ato që mendoj.

— Nuk jemi zënë ndonjëherë bashkë, — tha Zefi i ngrysur në fytyrë. Ta lëmë këtë bisedë. Me kohë do ta kuptosh që është një keqkuptim.

— Nuk jemi zënë se kam qenë e pasinqertë ndaj teje më përpara. Për shumë gjëra që nuk duhej t'i lija të kalonin unë nuk bëja zë fare. Po kështu edhe ti me mua. Po tani nuk ja fal më vetes...

— Ti ke ndryshuar shumë, — foli ai, — dhe nuk e di a për mirë a për keq. Nuk je më ajo që ke qenë! Ke marr ca maniera punëtorësh... Edhe në sjellje; edhe në të folur. Ta përplas çdo gjë në fytyrë pa takt. Nuk e pritja nga ti. Unë nuk kam njeri më të afërt se ti këtu. As këtu, as atje... Unë... Unë...

Ai doli përjashta pa arritur ta ndalonte ajo. Po a desh ta ndalonte ajo? Çudi me atë njeri. Sikur nuk jetonte këtu. Si tha ai? «Nuk e prisja nga ti, Lidje!» ja vlerësimi t'i kritikës shoqërore!

Gati po errej. Në dhomën e punëtorëve që nxehtë. Soba e madhe prej llamarine bubullonte. Përqark saj të mbeturat e karpentierëve: dhoga, ashkla, copa anjesh.

Lidja gjeti aty vetëm Ilia.

— Mirë mbrëma, Ilo!

— Oho! urdhëro, urdhëro — ja ktheu ai.

— Ku i ke këta bandillët?

Lidja bëri me dorë nga shtretërit bosh.

— Ca në film, ca në klub. Të tjerët mund të jenë shtruar në ndonjë qoshe.

— Po ti, Ilia?

Ai nuk i dha përgjegje një herë. I ndihmoj të hiqte xhupin, i afroi karriken pranë zjarrit, pastaj u ul përballë saj.

— Unë? Mos mendo se rri larg atyre gjërave. Edhe unë si të tjerët jam. Po filmin e kam parë. Xha Brahon nuk e kam në klub për të bërë një shah, pastaj kur bën ftohtë më pëlqen të shtrihem në shtrat me një libër në dorë. Jashtë fryn duhi, xhamat kërcasin, kërcet edhe soba, t'i lexon. A ka gjë më të mirë?

Ai bëri me kokë nga librat që i kish vendosur mbi një etazher të vogël sipër kokës.

— Më të shumtat vepra politike janë. Ke edhe plot libra teknike.

— Së shpejti do të kemi edhe veprat e plota të shokut Enver, — tha Lidja. Më thanë se janë duke u shtypur.

— E di. Në to do të jetë gjithë jeta e popullit tonë, lufta, qëndresa, udhëheqja. Gjë e madhe! Një vepër e tillë është një busull. Do të desha që ato të dilnin të lidhura bukur, shumë bukur.

— Mos u merakos Ilia, bukur do të dalin!

Lidja pat të nxehtë dhe u ul mbi shtrat larg sobës.

— Zaimi nuk ulet kurrë mbi shtrat, — qeshi inxhinieri — në këmbë rri e mbi shtrat nuk ulet.

— Nuk është pus me të këqia ai Zahoja ynë, {ka

edhe anë të mira. Nuk është mirë të ulesh mbi shtrat, po ne e shkelim.

— Ne nuk mund të mbajmë këtu aq karrike sa jemi, do të zinin gjithë dhomën. Po Zaimi ka hall tjetër... Druhet mos i ngjitet ndonjë gjë... Seç ka një ide prej budallai për punëtorët ai.

— U marrtë të keqen! — bërtiti Lidja. — Tani pas-tërtia është shembullore. Muajt e parë më kanë thënë se nuk ishte edhe aq pastër.

— E di Lidje se ç'më ka ndodhur njëherë? Vjen një fshatar nuk di se nga, për të punuar në kantierin tonë. Flinte në një dhomë me mua andej nga fundi. Të gjithë punëtorët turreshin në banjë sa vinte e shtuna, ai nuk tundej. Kaloi një javë, kaluan dy, kaluan tri. Ai as që kishte ndër mend të bënte banjë. Shokët e vunë përpara. Po ç'i punuan, të shihje! Na doli që qenka gjynah të lahet njeriu vazhdimisht, u dashka munduar trupit! Kështu e kishte mësuar me vite, prifti atë dukagjinas të shkretë. Ne e futëm në banjë. Njëherë, dy herë, pastaj shkante vetë. Tani më kanë thënë që zë e grindet kur prishet ndonjëherë banja.

— Ne na ka takuar barra të ndreqim ato prapësira që na la trashëgim e kaluara, — tha Lidja. — Ne duhet të jemi të rreptë me ta. Edhe më e thjeshta ka rëndësi. E shpeshherë ne duhet ta nisim edukimin e njeriut nga më e thjeshta.

— Ne duhet të jemi të rreptë edhe për gjënë më të vogël — foli inxhinier Ilia, — partia kërkon që mos të nënvleftësojmë asgjë.

— Interesant, Ilia. Që kur kam nisur punën këtu, çdo gjë më duket dritë, — çdo gjë e krahasoj me dritën.

— Kjo shprehje është shumë e gjërë, — tha ai, — të fut në mendime. Dritë... E di Lidje që edhe njerëzit ndryshojnë sipas dritës? Tani e kam fjalën për dritën elektrike, — sqaroi ai. Kam vënë re që punëtorët ndryshojnë këtu nga njëri-tjetri edhe sipas kohës kur i janë vënë dritat në fshat. Kuptohet, kjo nuk është absolute, por, që ngre peshë asnjë nuk mund ta kundërshtojë.

— Ky është një mendim praktik, Ilia, ka të vërtetë brenda përbrenda...

U çel dera. Jashar Lica dhe Loro Kini.

— Nuk i arritëm autobusët, — thanë. — Për një gjysmë ore nisat një autocisternë. Të ngrohemi pak.

— Ngrohuni, posi!

— Të bredhish shkrep më shkrep dhe të japësh dritë, — vazhdoi inxhinier Ilia.

Ata të dy u vështruan sy në sy.

— Zogj shtegëtarë... — tha Lidja, — zogj të dritës...

Këtë e dëgjova ditën e parë që erdha këndeje.

— Ka njerëz që po bredhin anakënd me vite, ndërtojnë, lënë gjurmët e tyre në katër cepat e vendit tonë. Sot këtu, nesër atje... E dikuj që prehet te oxhaku dimrit, që i sjell gruaja kafën me tabaka, as që mund t'i shkojë mendja se ka njerëz të tillë.

— Ju, shoku inxhinier, sikur qenkeni kundër komoditetit. Njeriu ka nevojë edhe për një çikë rehati, apo jo? Përse përpiqet atëherë partia kaq shumë? Për t'i përmirësuar jetën popullit!

Ilia u kthye avash-avash nga Jashar Lica.

— Ne po ndërtojmë për njeriun, — tha, — për popullin. Po ndërtojmë për t'ja bërë jetën më të rehatshme, më komode, siç folët ju. Po ne komunistët kemi një mendim tjetër për rehatinë. Jemi kundër jetës së amullt, pa përmbajtje. Nuk mund ta mendojmë atë si bakalli borgjez që hap ruletat, shet mallra gjithë ditën dhe në mbrëmje mbyllet në shtëpi me gjithë familjen pa pyetur ç'bëhet në botë. Zjarri le t'u bjerë të tjerëve, ai nuk tundet nga shtëpia. Shtëpia për të është një «kështjellë për gjithë familjen», ai ndihet i qetë vetëm brenda saj. Pa provoni t'i luani një gozhdë nga vendi? Do t'i prishet qetësia, nuk do ta zërë vendi gjersa ta rregullojë siç qe. Ai jeton me traditën, ajo për të përfaqëson të përjetshmen. E pse jeton ai, vallë? Ç'ideale ka? Kujt i shërben jeta e tij? Ju nuk mund të përgjigjeni... — Sa mirë e the, Ilia, «Kështjellë për gjithë familjen.» Dhe të përfytyrosh Shqipërinë në kështjella

të tilla! Kështjella të huaja, të ndara, armike — mendime të huaja, të ndara, armike! Secila me një botë më vete, indiferente ndaj gëzimit dhe mjerimit të fqinjit më të afërt! I qofshim falë revolucionit që u sheshoi pirgjet!

Për disa kohë asnjëri nuk foli. Ndjehej vetëm era dhe soba që bubullonte.

Heshtjen e theu prapë Jashar Lica.

— Unë shpreha diçka, si të thuash, në parim... — tha.

— Ju kuptova mirë. Gjithkush duhet ta ketë të qartë «komoditetin borgjez» dhe «jetën socialiste». Dhe sa më të qartë ta ketë këtë aq më mirë ecën përpara.

— Keni shumë të drejtë.

Jashar Lica mori një pamje të menduar.

— Keni shumë të drejtë, — përsëriti ai pas pak në pozën e atij njeriu që ka bluajtur mendimin një kohë në kokë.

Pastaj u kthye nga Lidja.

— Shoqja inxhinierë, kam nja dy propozime në lidhje me punën që më duket se janë interesante.

— Urdhëroni!

Lidja ja nguli sytë.

— Do t'ja paraqes me shkrim komisionit për shpikje dhe racionalizime, — tha Jashar Lica.

— Pse ta zgjatni kaq! Mund të m'i thoni edhe mua. Ndoshta mund t'u ndihmoj për t'i vënë në jetë sa më parë.

— Jo, jo! Me shkrim e kam më lehtë...

Ai u ngrit në këmbë menjëherë.

— Dëgjohej një zë burie, — tha Loro Kini që s'e kishte hapur gojën fare gjer atëherë.

Dolën që të dy. Megjithëse e shtynë derën fort nuk arritën ta mbyllin. Era e tërhoqi në anë të kundërt. Ajo solli në dhomë edhe fjalët e ngatërruara të Loro Kinit: «Shpikje... Ti dërdëllis kot... Me shkrim...»

Ilia u ngrit dhe mbylli derën.

— Ç'janë këta të dy?

— Punëtorë në sektorin tim. Kanë qenë në burg të dy.

— Ai që fliste m'u duk thëngjill i mbuluar. Ndoshta është vetëm përshtypje... Propozim! I dëgjove ç'thanë? Lidja pohoi me kokë.

— Me ato propozimet me shkrim ai deshi të zhdukte përshtypjen e fjalëve të para që foli.

— Kështu m'u duk edhe mua, — tha Lidja e menduar.

Inxhinieri u ngrit dhe i futi dru sobës. Duke mbyllur derën e saj dogji gishtin dhe e futi në gojë me një gjest prej fëmije.

Lidja qeshi me gjithë shpirt.

— Mos qesh — ja pat Ilia buzagaz, — të futurit e gishtit në gojë fillon që nga kohët më primitive. Kështu i fusnin gishtat në gojë njerëzit e lashtë kur përzhiteshin në mishin e djegur të mamuthit.

Lidja nuk pushonte së qeshuri.

— Ah, — tha Ilia pas pak, — edhe xha Brahoja dogji pak dorën sot. I ra ujë i valuar.

Lidja u pre. Gëzimi u shua menjëherë në fytyrën e saj.

— E dogji shumë?

— Gjithë shpinën e dorës.

— Ku është tani?

— Ku do të jetë? Te sondat! Mjekut i mbeti në dorë modelari «B» me pesë ditë pushim. Xha Brahoja krisi te sondat. Dhe gjithë këtë javë turn nate ka...

Heshtën. Prozhektori i varur jashtë barakës tundej nga era. Vazhda e fortë e dritës e lante qoshe më qoshe barakën.

Lidja ja kishte ngulur sytë prozhektorit. Mendonte për xha Brahon. Sa herë e kishte patur pisk në punë, sillte ndërmend atë njeri. Vajza i qëndronte afër, donte të futej në skutat e fshehta të shpirtit të tij. Po xha Brahoja s'kishte shumë skuta të fshehta. Njerëzit si ai i kanë të gjitha në shesh. Lidja e mbante për hero të vetin xha Brahon. Njeriut i pëlqen të gjejë heroin e

vet dhe ca më shumë i pëlqen ta zbulojë pak nga pak, siç zbulohet një kontinent. I pëlqen pastaj që kontinenti të jetë i pafund, për të pasur ç'të zbulosh çdo ditë, për ta pasur si objekt frymëzimi. I pëlqente që për çdo zbulim ai të rritej pa ndërprerje përpara syve të saj. Dhe Brahim Jergucati rritej, rritej...

— Po, e dogji shumë dorën? — pyeti mekanikisht prapë Lidja.

Ilia i ra supit.

— Të thashë, vetëm kurrizin e dorës. I kalon shpejt.

— Ilia! Vjen të shkojmë nga sondat?

Ajo u ngrit menjëherë nga shtrati.

Ai e vështroi në sy dhe u mallëngjye. U ngrit dhe hoqi gozhupin nga varseja.

— Vij, posi! — tha.

KAPITULLI XV

Në kantier u duk sërish gazetari. Njeriu afrohet përherë me elementin e vet, dhe gazetari kishte gjetur prapë përgjegjësin e mencës. Kësaj radhe kishte vënë në shënjestër Llesh Kalinë. E kërkuan kudo brigadierin po ai se nga kish humbur. E kishte turnin pasdreke. Ndërkohë përgjegjësi i mencës i propozoi heronj të tjerë gazetarit.

— Vemi në tunel. Diçka interesante. Njëmbëdhjetë karpentierë gollobordas që posa kanë ardhur nga Peshkopia. I qëruan hesapet me tërmetin dhe o burra në kantierin tonë! Më e bukura është se të gjithë një mbiemër kanë. I thërresin të «njëmbëdhjetë Mazllumët» ose «skuadra e futbollit».

— Jo, jo! Kësaj radhe vetëm Llesh Kalinë, — ngulte këmbë gazetari.

— Ai artikulli për xha Brahon qe mrekulli...

— Mrekulli? Ta merr mendja! Nuk rastis çdo ditë me një jetë si të tijën.

— Me ç'shoh unë, duke ngulur kaq shumë këmbë për Llesh Kalinë doni ta përsërisni «mrekullinë».

— Poshtë lavdia! — thirri gazetari duke qeshur. — Unë, shoku poet, do të bëj një cikël artikujsh portrete. Këtë dua.

— Dëgjo! — tha përgjegjësi i mencës, — a nuk vemi te kovaçët?

— Ç'janë këta? Ndonjë skuadër basketbolli me një mbiemër?

— Aty afër. Lër për ta ca vend të bardhë në gazetë. Mos u nxito. Rezervoji për më vonë.

— Për më vonë, mirë, — foli gazetari. — Tani Llesh Kalinë.

— Mos u mërzit. Nuk humbet Lleshi!

Ata u ngjitën në të përpjetën e kodrës ku ishte farka. Ndjehej që aty se afër ndodhej një farkë. Çekani mbi kudhër... Çekani mbi kudhër...

— Punojnë burrë e grua, — tha përgjegjësi i mencës, — i kanë ndjekur prapa gjithë hidrocentralet. Edhe fëmijët farkëtarë i kanë bërë, po ata punojnë në një sektor tjetër.

— Si punë tradite, — foli gazetari.

U futën në farkë. Një tufë xixash erdhën gjer te dera.

— Ej, mik! Hiqe atë të shkretën, se të bahet shoshë prej xixash! — foli farkëtar, një burrë i shkurtër, i nxirë nga bloza dhe tymi.

Gazetari hoqi pardsynë.

— E kam djegur edhe një, — tha. — S'durojnë zjarr këto dreqe.

Fshatari fshiu dorën në përparse dhe ja zgjati gazetarit.

— Ky shoku është gazetar, or Fehmi. Desh të shinte: ç'bëhet te ju.

— Mirë se ka ardhë, or voc, — u hodh e shoqja,

një grua e shëndoshë topolake me një përparse të trashë, që i arrinte gjer në grykë.

— Si ja çoni? — pyeti gazetari.

— Mirë, i qofshim falë partisë, — thanë ata të dy me një gojë.

«I qofshim falë partisë! Sa mirë, — mendoj përgjegjësi i mencës, — dikur njeriu i varfër i falej zotit, një zoti që s'ndjente, që s'jepte... Një toke shterpë».

— Me ç'punë mirreni?

— Me baromina, or voc! Qe, ene maqina; qe, ene veglat tona...

— I kemi ba vetë ato, — shpejtoi gruaja, — puna jonë do vegla apostafat.

Gazetari vështroi limat, darët dhe vegla të tjera që i kishin modifikuar ata për punën e tyre.

— I bajmë barominat me xhashtë dhamë... — tha gruaja.

Gjashtë dhëmbëshe, — shpjegoi përgjegjësi i mencës. — Kjo është diçka e re. Kështu thonë inxhinierët.

— Nga jeni ju, — pyeti gazetari. — Nga Burreli?

— T'lumtë goja, or voc. Nga Batri Burrelit.

Gazetari nxori blokun dhe shënoi diçka shpejt e shpejt. Ata të dy nuk ja ndanin sytë dorës që shkruante.

— Zanat, or burr, zanat! — I ra me bërryl të shoqit gruaja topolake.

— Pse, ju nuk e dini këtë zanat?

— E dimë, or voc, e dimë. Por jo q'ashtu shpejt si rrfeja, se na kërleshën gerrat njana m'tjetrën dhe s'ka burrë që i nda.

Gazetari qeshi.

— Kemi msue të dy bashkë n'Ulzët, or voc...

Burri fliste më pak. Ai vetëm i aprovonte me një të luajtur koke të thellë fjalët e së shoqes.

— Kimi msue nja m'nja me cullët. Ishim një dynja mbrapa...

«Kanë mësuar një për një me fëmijët!» Përgjegjësi i mencës pati një dridhmë të dytë kënaqësie. «Te ne mosha s'është më mur pengese. Po shkrihet në një çë-

shtje përparimi, pune, mësimi. Një m'një me cullët...»

— Ku i keni fëmijët tani? — pyeti gazetari.

— Cullët kur rriten u dalin krahët e fluturojnë, — psherëtiu gruaja. Ktu i kimi tash një herë, knej...

— Or Fehmi, — tha përgjegjësi i mencës, — as na bën një barominë ta shohi ky shoku?

— Nji barominë? Dhetë, or voc!

Farkëtari rrëmbeu një hekur të gjatë, e futi në maqinë; pastaj lëvizi një levë. Hekuri ra përdhe i ndarë dysh. Farkëtari e futi në zjarr. Ajri me presion i hidhte xixat gjer lart në tavan. E futi hekurin e skuqur edhe një herë në maqinë. Kokës së zjarrtë të hekurit ju afrua kallëpi gjashtëdhëmbësh. Zuri ta brente. Farkëtari hoqi hekurin. Zhurma pushoi.

— Maqinë për sevda! — tha ai, duke tundur kokën. — Shifi dhambët e barominës. As dantisti nuk ja ban ma të mira.

Gazetari u përkul poshtë maqinës. Një grup hieroglifesh kineze dhe poshtë tyre me shkronja latine «Shan-gai, Made in China».

Farkëtari e nxori hekurin nga ujët.

— Don ujë... Unë e digjoj qysh pin ujë...

«Hekuri paska shpirt, — mendoj përgjegjësi i mencës, — njeriu e ndjen rregëtimën e tij. Për mjeshtrin e vërtetë çdo gjë që zë me dorë ka shpirt. Përndryshe... Përndryshe ai nuk do të ishte mjeshër i vërtetë.»

Gazetari nxori një paqetë cigare.

— Jo, or voc, — tha farkëtari, — na kini ardhë n'konak.

Ai edhe e shoqja nxorën të dy përnjëherësh nga një paqetë cigare «Diamant».

— Mirë, po marr një «Diamant».

E ndezi cigaren pastaj e pyeti në kishin qenë shumë gazetarë në farkën e tij. Ai donte të dinte se sa ishte shkrojtur për ta.

— Kon qenë, or voc, kon qenë, — tha gruaja, — boll konë qenë.

— Nji herë erdhën edhe prej radios, — e ndoqi i

shoqi,— m'pat zanë turpi me ta. Kishin edhe një gramafun për bela. «Ngjo, ti shoku Femi, — më thanë, — ti puno edhe sillu sikur t'mos kesh asnji t'huej këtu mrena». Unë nisa me punu, ata kurdisën gramafunin, një gramafun me dy rrota t'vogla sypri...

Nisa me punu n'baromina. Bjer n'çekiç e bjer n'lymë. Lësho ajrin n'votër e nepi ujë hekurit. Gruja ndihmonte me sa mundej. Po një dakik u hutu e unë teveqeli i hoqa një t'shame, t'letë (koci i vjetër ja nep kaj herë qesim). Ata t'radios m'bane shej t'la punën. Ma prunë gramafunin afër. I shkelen një sustë, rrotat nisen me u sjell edhe unë ngjova me vesh t'mi gjith zhurmën e farkës. Heu! Fort u çudita, burro! Ngjova majin mbi hekur, hekurin kah shkimej n'ujë, xixat e zjarrit tuj levis për hava. Mrekulli. E n'fund ngjova edhe at fjalën e idhtë qi i hoqa grues! Kceva me ja kap për duersh gramafunin. «Mor dreqen, — u thash, — m'marruet, he u thafshin krahët». «Do ta nisim për Tiranë, — m'doganisën ata, — e do t'i kallxojmë gjithkuj. qysh i flet grues...» Ishin pika e djemve ata t'radios...

Gazetari qeshi me gjithë shpirt.

— Ja një ditë e fituar, — tha ai kur dolën jashtë. Do të bëj një shkrim të mirë. Do ta nis pikërisht te «shpirti i hekurit, të cilin e ndjen mjeshtri i vërtetë».

— Shumë mirë do të bësh. Ju gazetaret nganjëherë shkruani standard. Përpiquni pak. Kështu duhet të dalë një tjetër «mrekulli».

— Tani Llesh Kalinë, — tha gazetari.

* * *

E gjetën në klub. Po pinte një kafe.

— Gjithë mëngjezin po të kërkojmë, — foli përgjegjësi i mencës.

— Kam bredh gjithandej sektor m'sektor, — u përgjegj Lleshi — m'u tek me i ra kantierit kryqetërthuer. Tash u ula me pi një kafe. Ç'ka po merrni ju?

— Kafe, — tha gazetari, — ndoshta dy kafe.

— Kafe dua edhe unë, — shtoi përgjegjësi i mencës.

— Edhe nga një dopjo konjak sipri, — thirri Llesh Kalia.

— Atëherë teke, — kundërshtoi gazetari.

— Mirë, teke pra!

— Shoku Llesh! Ju keni qenë dje në qytet, — nisi gazetari.

Lleshi: Po, isha në qytet.

Gazetari: E kam fjalën për atë gjygin shoqëror që demaskoi atë klerikun reaksionar.

Lleshi: Mos na prek ma at plagë...

Gazetari: Mbase duhet ngarë me të tepërt bile. Plaga dhemb po ta ngasish, dhembja na duhet për të gjykuar më rreptë kohërat.

Lleshi: Mesele e vjetër...

Gazetari: Unë pikërisht për të erdha. Diç më thanë...

Llesh Kalia nxori një shtëllungë të madhe tymi, aq të madhe e nxori, sa për disa çaste humbi mes saj.

Gazetari lëvizte në karrige nga padurimi. Përgjegjësi i mencës vriste mendjen për «meselenë e vjetër». Si s'e kishte marrë vesh ai? Në kantier ngjarjet bënin udhë me shpejtësi të rrufeshme.

— Dëgjova për një mbledhje në qytet, — tha Llesh Kalia, — po nuk ja vara. Po kur mora vesh emrin e Dom Nikoll Gjergjit mu ertsue çdo gja përpara syve. Unë nuk e dijshe që ai ishte këtu, nuk e dijshe, madje, që ishte gjallë.

— Ajo që kishe folur ti në mbledhje u kishte lënë përshtypje të thellë të gjithëve.

— Ai duhej demaskue, — foli me zemërim Llesh Kalia, — ndjeva se te disa njerëz, për këtë klerik, ishte krijuar përshtypja si për ndonjë shenjt. Shenjtin deshta me e zhvesh lakuriq... Deri në katërdhetën ai ka qenë prift në katundin tonë. Kishte ma shumë se pesëmbëdhjet vjet aty. Fshati jonë ishte shumë fanatik, e mbajshin si zotin.

Ai na e kërkoi motrën shërbyese. Ishte tembëdhjet vjeç atëherë. Na ishim të vorfën, të vorfën e pa krah.

Plaku ja dha megjithëse vëllai i madh e kundërshtoi sa munda. Prifti e mbajti në qelë një vit, dy vjet. Tatës i kishte thanë se tash e qet vetë nuse. Kjo e kishte marrë mendsh plakun. Me ç'ka t'ja bajshim pajën na?

Vitet kalojshin. Dom Nikolla hidhte nga një pare në një arkë me bira dhe i rriffe krahët motrës: «Qe paja yte Gjelinë, po grumbullohet pak nga pak». Kaluen pesë vjet. Na atëherë nuk i lejshim çikat me mbushë as të pesmbëdhetat... Gjelina i kishte mbush njizetat. «Or tatë, — i thotë një ditë vëllai i madh, — luej kambët e shko te padri, motra po na plakët murgeshë». Tata shkoi te prifti. Dom Nikolli e priti si jo ma mirë, me kafe, me raki e me duhan «Tarabosh».

Po për Gjelinën asnjë fjalë. Nuk i ra ati krahu. Kur desht me u çue, tata i lypi vajzën... «Ka kohë, — e përcolli Dom Nikolli, — ka kohë». Më kujtohet që ai i kishte përmendun historinë e një «shejtneshe» që ishte martue gjashtëdhjet vjeç dhe kish pas madje edhe fëmijë. Tata nuk kish mujt me ja prish priftit. T'ishte për të as që kishte për të shku ma te Dom Nikolli. Por vëllai i madh i rrinte mbi krye. «Shko tatë, shko. Katundi asht mbushë me fjalë». Unë isha i ri atëherë, por ç'ka ndijshe m'randonte si plumbi. Dhe tata shkoi prapë. Tri herë shkoi. Prifti e përcillte përherë e ma keq. Herën e fundit e kërcnoi se do ta mallkonte. Plaku u fjalue keq me priftin. Dhe ai ja pagoi. Ja pagoi një të dielë, ja pagoi me mallkim. Në fund i vuni edhe gurin e pendesës. A e dini ç'asht guri i pendesës?

Llesh Kalia i jetonte ato çaste, vërtetë i jetonte. I nxirrnin sytë shkëndija, dhe fytyra i kishte marr një pamje të egër, si atij njeriut që ka etje për shpagë.

Gazetari tundi kokën. Kishte dëgjuar për «Gurin e pendimit».

— Plaku hoq opingat, gurin n'shpinë e përçark kishës. Shkelte mbi gur t'thepisun, shkelte mbi ferra, shkelte mbi hithra. Guri katërdhet okësh në shpinë. A të mbajë gurin, a të ruhet prej ferrash? Në rrethin e dytë të kishës i plasi gjaku kambësh. Ai ecte. Vëllai i madh nuk duroi ma, ja lëshoi përtokë gurin e e

mori n'shpi plakun. S'kaloi as një javë e e gjetëm vllan dekun mu n'derë t'kishës, bri ati guri që s'kish lanë me e bajtë plaku. Mauzerren e kish me grykë kah gjoksi ku i rridhte një curil gjaku përmes një plage t'hollë. Dom Nikolli qiti lajmin se ka vra vedin për pendesë pse kish thye urdhnin e kishës, por na e dijsim se qe dora e priftit aty. Em vlla s'kish rrugë aty pari, e kishin vra njetit dhe e kishin sjell te dera e kishës. Prifti nuk mund duronte me ja thy kush fjalën. E vrau edhe Gjelinën ma vonë. E vrau pak nga pak, e fishku n'qelë dhe e futi në dhe. Dhet vjet shërbyese. Katundi shkonte ma larg... Më kanë thanë se motra e kish pasë çilë një herë at arkën ku fuste pare Dom Nikolli. E pat çilë e pat mbetë ngri. N'vend t'florinit kish mbrend do pare Austrie qi s'vyejshin send. Kështu thonë... Nuk shkoi shumë dhe e futëm në dhe edhe plakun. Tri vdekje për pak vjet... Unë atëherë zhgula prej katundit. Me pasë ndej aty rrezik s'kisha me ba hije as unë mbi dhe. Këto i thash të tana atje n'mbledhje për priftin. Veç për punë t'arkës së pareve nuk fola. S'mujshe me thanë një gja që s'e kishe pa me sy të mi. Punën teme e kishin mblue vitet me harresë, unë fola për tjerët.

Heshti dhe vështroi tutje xhamave të klubit. Era bënte kërdrinë jashtë, ngrinte vorbulla tymi dhe pluhuri. Lëvizte dera, tundeshin kanatet e dritareve. Era...

— Tmerri i ditëve të errësirës, — vërejti përgjegjësi i mencës.

— Ne kurrë nuk mund ta kuptojmë ashtu si duhet atë kohë të egër, — e pasoi gazetari. — Na duket e pabesueshme... Çfarë kohe! Mesjeta vetë!

— E pata shumë të zorshme, — pëshpëriti Llesh Kalia — u mendova gjatë. Kishin kalue ma se tridhetë vjet...

— Më thanë që Dom Nikolli e kishte mohuar, kishte bërë sikur nuk të njihte...

— Po, dhe me çfarë gjakftohtësie! Me u habitë! Po kah flitshe unë nisën me kja disa gra në sallë, populli bër-

titi e fjalë mbas fjale ai u zverdh, u pre, u qull si mos me pasë kocij përmbrenda...

— Një gjarpër, — tha përgjegjësi i mencës.

— Gjarpën e kalue gjarpnit. Ate ç'ka kanë punue m'ne ata nuk na ka punue as hasmi. Dhe çdo gja urtë e butë e me ungjill në dorë...

— Po a nuk të shkoi ndër mend t'i hiqje ndonjë plumb barkut ati shenjtori të rremë?

— M'shkoi, shoku gazetar, m'shkoi. Kjo qe arësyeja edhe qi zhgula prej katundit. Aty s'mund e vritshe. Kishe do tjerë n'shpinë, kishe edhe farefisnin kundra. Shqiptari thahet koc kur ka përpara diçka qi s'e shpon plumbi. Derisa isha unë në katund, Dom Nikollin nuk e shponte plumbi. Prandej u zhgula prej aty. Po nji t'kthyme m'thanë se asht transferu n'Pukë. Nisem për Pukë, në Pukë s'e kish pa kërkush. Me gjas ja kish ndi erën e qe largue pa za. Kah nuk e kërkova. N'Shqipni nuk i gjindej traga. Më thonë se ja kish mbajt për Itali. Atje s'mund e kërkova. M'u dote me kërkue bukë për robt qi kisha n'shpinë. Atje s'mund e kërkova...

Minatori humbet në një shtëllungë të madhe tymi. Përgjegjësit të mencës i bën shumë përshtypje ashtu. Me shpirt ai kërkon të ndjejë dhembjen e Llesh Kalisë, hallet e tija. Më kot. Është diçka e pamundur.

— Nuk më the gjë për familjen tënde, — tha gazetari.

Përgjegjësi i mencës i vuri gishtin në buzë.

— Kam gruen dhe një djalë, — u përgjegj shpejt e shpejt Llesh Kalia. — Rrojnë në Dibër.

Gazetari dhe përgjegjësi i mencës u varën poshtë kodrës.

— Nuk e kuptova pse ma bëre me shenjë? — pyeti gazetari.

— Ai nuk do që ta pyesish për familjen, nuk do. Kështu kam dëgjuar. I ka ikur një vajzë nga shtëpia. I është martuar pa lejen e tij.

— Dhe ai nuk e qas më në shtëpi?

— Nuk e qas!

— Interessant! Të flasësh me të, të duket si njeriu më përparimtar, më i kohës që mund të kesh parë.

— Dhe ashtu është. Mbase kjo është e vetmja e metë që ka. Po ku ta dish si është ngjarja?

— Po kolektivi? Ç'ka bërë? S'është munduar t'i afrojë?

— Në një kantier si i joni ca gjëra janë të vesh-tira. Këtu ke punëtorë që e kanë familjen në Konispol, apo në Vermosh. Është vështirë të punosh me ta. Kë-shtu edhe me Llesh Kalinë. Një grusht njerëzish e dinë po nuk janë marrë me të.

— Çudi! — tha gazetari, — nganjëherë edhe nje-riu më i mirë ka ndonjë qoshe të verbër...

— Mbase e ka fajin vajza?

KAPITULLI XVI

Frueri sikur desh t'ja kalonte atij Janarit acarmadh. Të ftohtin e shtonte sidomos era. Po të mos qe ajo do të ishte më lehtë. Era ta fuste të ftohtin në kockë si me gjilpëra.

Te sondat bëhej luftë me ngricën. Kampata ngjante me një vatër zjarresh. Zjarret ngrohnin damarët e mardhur të tubave; ngrohnin rezervuaret, pompat. Kudo zjarre. Dhe puna ecën.

Lidja dhe Bardhi «sa një vinç» shkojnë sa në një vend në një vend tjetër. Inxhinierja është nxirë me tym në fytyrë, ndërsa Bardh Shkoza i ka duart gjithë blozë pishë. Nën tubat digjnin pishë e copa gome. Kam-pata kundërmonte erë të keqe.

Lidja druhej për xixat dhe për thëngjiyt që rrë-mbente era. I hapte nëpër katër anët e kantierit. Ca i merre rrëshqanë në lumë. Për ato nuk shqetësohej njeri, për të tjerat po. Punëtorët i ndiqnin me vrap ato thërmia thëngjiysh që iknin larg dhe nuk ju nda-heshin pa i shojtur me këmbë.

Andej nga ora dhjetë pushoi era. Të ftohtit sikur ra. Tubat nuk po ngrinin më. Zjarret u shuan. Kam-pata i ngjante një fushe lufte pas betejës. Lidja u tha punëtorëve të pastronin sheshin e punës. Ajo u për-vesh edhe vetë dhe zu të largonte copat e anjeve, tubat, dërrasat e mjetet e tjera të shpërndara andej-këndej. Në dhjetë minuta u pastrua gjithë vendi. Atëherë Lidja u fut me Bardh Shkozën në barakën e personelit, prapa sondave!

— Po të vazhdonte ngrica do ta kishim pisk, — tha Bardhi.

— Nuk do të shpëtojmë pa ndonjë ngricë të gjatë, — tha Lidja.

— Edhe ato që kemi pasë gjer tani mjaft na kanë dalë, — foli Bardhi.

Ai u mbështet me bërryla në tavolinën e keqe.

— Si nuk e vumë një sobë këtu?

Lidja nuk i dha përgjegje. Në murin e barakës ishte varur harta skematike e puseve. Ajo çështja e puseve sekondare e shqetësonte fort. Hyri një nga ata inxhi-nierët e gjeologjisë.

— Na mpiu, — tha ai që posa hyri, — na mpiu, fare kjo erë!

Hoqi kokoren dhe u ul pranë Bardhit. I kërkoi një cigare.

— Prapë pusët sekondare? — qeshi me Lidjen, duke ndjekur vështrimin e saj.

Lidja e kishte biseduar sa e sa herë me të çështjen e puseve sekondare. Po të realizoheshin ato njëkohësisht me pusët kryesore do të rritej rendimenti qind për qind. Po kjo ishte punë me rrezik të madh. Dhe literatura më shumë vinte në dukje rreziqet se sa dobinë. Gjer atëherë asnjë s'kishte guxuar të bënte një punë të tillë. As Zefi s'kishte guxuar, madje kishte qenë i pari që kishte kundërshtuar Bardhin. mbase edhe e kishte ta-llur pak...

Kjo çështje kish vajtur gjer në drejtori, po edhe aty nuk doli gjë.

Zef Mërtiri nuk mirrte përgjegjësi për atë që mund të ndodhte. E lanë në heshtje. E harruan në zyrë, po jo Bardh Shkoza. Ai nuk la gur pa luajtur andej-këndeje, po sidomos e kërkoi me ngulm nga Lidja. Vajza nisi të ushqente shpresa të mëdha për shpejtimin e punimeve. E la mënjanë atë që thoshte teoria, u mbështet kryesisht në eksperiencën e sondistëve dhe në të dhënat e gjeologve. U muar më shumë se një muaj vetëm me verifikimin e kampioneve të nxjerra. Kampionet flisnin për shtresa të qëndrueshme gëlqeresh dhe masivesh zhavorri. Nga sa tregonin kampionet mund të mbështeteshe te mendimi i Bardhit. Po gjeologët ngurronin. Asnjë prej tyre nuk jipte një mendim të prerë. Gjatë ditëve të fundit Lidja qe si në ethe. Në një anë rreziku, në anë tjetër gjithë ai përfitim! Nuk ngurronte sepse i trembej përgjegjësisë, por vetëm se druhej se mund të prishte po aq punë, sa shpresonte se mund të fitonte. Çështje e ngatërruar...

Lidja largoi kokën nga prerja skematike e puseve. Bardhi «sa një vinç», po e përpinte me sy.

— Kampionet e fundit qenë më rezistentë, — tha Lidja, — i bëra vetë analizat në presë. Dhe këto kapin një zonë ku mund të hapen rreth shtatë puse sekondare.

— Po më tej?

— Edhe më tej afërsisht kështu është, dy më shumë, dy më pak. Me një fjalë e njëjta gjë.

— A keni folur më me inxhinier Zefin? — vazhdoi inxhinieri gjeolog.

— Ehu! Njëqind herë i kam thënë! Nuk do të më dëgjojë më! As që i bie ati krahu.

— Të flasësh më qartë, ai trembet, — tha Bardhi.

— Pse të trembet? — e ndërpreu inxhinieri gjeolog, — ai nuk mban asnjë përgjegjësi për atë punë. Është Lidja... Pastaj daleni. Kjo nuk është aq e thjeshtë, do menduar thellë. Nuk mjafton të hedhësh zaret edhe... Ku rafsha mos u vrafsha.

Të tre ja kishin ngulur sytë hartës me prerjen ske-

matike. Ç'kishte atje thellë në zemër të tokës? Burime të nëndheshme? Gaverna? Rrezik? Mister...

— Kryeinxhinieri nuk është kundra, — tha Bardhi, — po kështu edhe pjesa më e madhe e këshillit teknik, po të gjithë e nënvizojnë me të madhe rrezikun. Vetëm Zef Mërtiri kundërshton me të madhe. Zef Mërtiri, benjamini i hidrocentralit...

— Ai është një inxhinier që të nderon, shumë i talentuar, — sqaroi gjeologu...

— Nuk e di si i ka fituar këto merita, — tha Bardhi, — nuk kemi parë ndonjë gjë të madhe prej tij.

— Ai premtion shumë, dallon mes të tjerëve...

Bardhi «sa një vinç» u ngrit në këmbë me padurim.

— Mundet që ne të tjerët s'jemi në gjendje ta kuptojmë, — tha.

— Prit, Bardhi, — foli Lidja, — mos u nxe. S'na hyn në punë tani aftësia apo paaftësia e Zef Mërtirit. Kemi halle të tjera...

— Po sikur të bënim vetëm një provë, shoqja Lidje? Vetëm një?

Kjo ishte më shumë se një lutje, një përgjërëm. Ai alamet burri po i fliste me një zë të butë si prej fëmije...

Lidja u mallëngjye.

— Dëgjo, Bardh! Më duhet të studjoj edhe disa probleme të dorës së dytë dhe të jap fjalën që brenda dy ditësh do të jap përgjigje. Edhe unë mendoj që duhet hapur vetëm një pus një herë.

— Do të pres, — tha Bardhi, — por dy ditë ama! Dera e barakës u hap me zhurmë. Hyri nëndrejtori.

— Shtabi në veprim! — buzëqeshi ai. — Si i keni punët me ngricën?

— Gjer tani ja hodhëm, — u përgjegj Lidja, — ata të turneve të tjera do ta kenë më pisk.

— Eh, eh! Rinia e ka gjakun valë, s'ka ngricë që nuk shkrin.

Nëndrejtori u ul në stol. Nga fytyra dukej se diç kishte me rëndësi.

— Shoqja Lidje, — tha pasi ndezi një cigare, — erdha t'ju pyes nëse mund të ju ngarkojmë edhe me një barrë tjetër për nja dy javë... Megjithëse nuk është aspak e drejtë... Po ç'të bëjmë?

— Mund të më ngarkoni me çdo barrë që të doni, — u përgjegj vajza, — nëse ua merr mendja se mund ta kryej...

— Ja si është çështja... Zef Mërtiri do të shkojë disa ditë jashtë shtetit në një simpozium për digat. Inxhinieri që zëvendëson Zefin nuk ka as një javë në kantier, ashtu si edhe ai që ju zëvendëson ju...

— Dhe ju doni që të marr unë edhe çimentimin?
— e ndërpreu Lidja.

— Po.

— Do ta kryej, — tha Lidja, — ose më mirë të them do të mundohem...

Po ajo e diti si i nxori ato fjalë. I erdhi si bombë lajmi i nisjes së Zef Mërtirit. Atë e kishte parë në mëngjez. Nxitonte. Asgjë nuk i kishte thënë. Mbase i mbante mëri...

Koka i buçiti nga gjaku që ju ngjit përnjëherësh lart.

— Zefi do të vijë t'ju lërë detyrat dhe planin e punës.

— Kur niset?

— Nesër!

— Pasi të kthehet Zefi, ju mund të merrni disa ditë pushim, nuk keni qenë kaq kohë në shtëpi... — tha nëndrejtori.

Toni i tij ishte i thjeshtë, atror, por Lidjes i erdhi inat.

— Jemi në kulm të punës, — tha.

— E dimë, e dimë! Gjer tani shumë vetëve u kemi pasë borxhe, — nënqeshi nëndrejtori, — por dalëngadalë po lahemi me të gjithë. Ç'ti bëjsh? Kantier i ri...

Ai u kthye nga inxhinieri gjeolog.

— Po ju, kur do të niseni?

— Për ndonjë javë...

— Ju jeni pararoja, — psherëtiu nëndrejtori. — Ku të vini ju latën dhe piketat, atje do të ngulim sondat ne.

— Kur duhet të fillojë hidrocentrali tjetër? — pyeti Bardhi.

— Sa të mbarojnë këta shokët studimet, Bardh, këta e kanë në dorë.

Nëndrejtorit i qeshën sytë. Një farë përmallimi dhe krenarie në ata sy.

— Dhe zogjtë shtegëtarë prapë drejt veriut?

— Po, Bardh, drejt veriut! —

* * *

Doli nëndrejtori. Lidja mbet si e shushatur. Diç po ndodhte me të ditët e fundit. Po mendonte shumë për Zef Mërtirin. Herë-herë i dukej se i kishte zmadhuar tepër të metat e tija, sikur e kish shikuar si vazo kristali që s'duhet të ketë asnjë të metë, asnjë të gërvishtur, asnjë gjurmë zgjyre. Po pse mendonte ajo kaq shumë për të? Pse ja vinte në pah të metat kaq shumë? Mbase sepse e dinte që ai e kishte dashur dhe ndoshta e donte akoma? Se ai ishte më i afërti për të në kantier? Apo mendonte të bënte një provë me zemrën e saj? «Ej, Lidje, s'bëhen prova me zemër! Ajo ndjen vetë, flet vetë, zgjedh vetë!» Mos e donte ajo Zef Mërtirin? Përgjegjja ishte një jehonë e vagëlluar, e fshehtë, e pakuptueshme. Deti i paanë i shpirtit epej dhe mblidhej dhe në brigjet e forta mbetej vetëm shkumë. Shkuma nuk ishte asgjë; shkuma nuk tregonte asgjë. Ajo qëndron pak më gjatë se vesa e mëngjezit. Lidja kishte menduar për një dashuri që nuk shkrihet kurrë. Po ç'ishte kjo që ndjente ajo? Pse u pre ashtu kur e lajmëruan se do të ikte Zefi? Dashuri që nxjerr kokën dalëngadalë mes pyllit me dru mirti e lari? Deti i shpirtit të saj hëpërhë flet me

një gjuhë të pakuptuar. Rreh brigjet, rreth brigjet...

Inxhinieri gjeolog u largua pas nëndrejtorit. Bardhi «sa një vinç», mudohej ta vështronte Lidjen në sy. E kishte kapur turbullimin e saj.

Lidja kishte mbetur keq. Si e zënë në faj... Po ç'kishte bërë ajo?

U dha flokëve prapa duke u munduar ta zotronte veten. Bardhi «sa një vinç» rëndonte sa një shtyllë tensioni aty në barakë...

Ai bëri të delte dhe për pak mend u përplas me Zef Mërtirin. Inxhinieri ndjeu një shtrëngim të fortë në gjoks, sikur ju pre fryma. Ç'pat ajo derë që kërciti aq fort?

Lidja e ngriti me mundim kokën, sikur t'i rëndonte mbi shpatulla një kolonë eskavatori. Nga ana tjetër i erdhi mirë që inxhinieri dukej i sigurtë, i kënaqur. Në sy i ndriste besimi...

Zef Mërtiri përsëriti shpejt e shpejt pothuaj fjalët e nëndrejtorit.

Ajo heshte.

— Ç'ke kështu? Nuk gëzohesh, Lidje?

— Gëzohem, — u përgjegj Lidja, — kushedi çfarë të rejash interesante do të sjellish që andej.

— Do të shoh botë me sy, — tha ai, — pastaj ka rëndësi se nga gjithë të tjerët më zgjodhën mua.

Lidja ngriti kokën. A duhet të fali ai që dashuron? Ai që është i sigurtë që dashuron? Jo, nuk duhet të fali... Po Lidja nuk deshë t'ja kthente prapa ato fjalë vetëmburjeje, nuk deshë t'ja prishte tani përpara nisjes.

— Ku do të mbahet konferenca? — pyeti ajo sa për të shkuar radhën.

— Në Turqi. Një kohë lexoja që Turqia është praku i Azisë. Një vend me romantikë gati ekzotike. Do të të sjell një album të tërë që andej...

Ai nuk po u jepte asnjë rëndësi punimeve që do të mbaheshin në simpozium. U rregullua mirë e mirë në stol, pastaj zu t'i tregonte Lidjes ç'do të bënte në sektorin e çimentimit në mungesë të tij.

— Këto janë gjithë, gjithë ç'ke për të bërë, — po i thoshte, — unë do të vij menjëherë. Dhe kur të vij do të flasim shtruar një herë... Shtruar... Ç'do të të sjell nga Stambolli?

Ajo e vështroi me ca sy për të ardhur keq.

— Më premtove panorama, — tha, — kaq mjafton.

— Jo, jo! S'janë hiçgjë ato, — po nejtse!

Ai i shtrëngoi dorën fort.

— Mirë u pafshim!

— Udhë të mbarë!

Ai doli me të shpejtë. Lidjes ju duk baraka e ngushtë dhe bota sa një grusht.

* * *

Tutje, në sektorin e çimentimit, xha Brahoja po pinte një cigare me etje të madhe. Vështronte gjithë kënaqësi ndihmësin, Samiun. Djaloshi rropatej sa andej, sa kënde. Nuk pushonte asnjë çast. «Kaq e ka, — mendonte Brahim Jergucati, — kaq e ka, sa të të hyjë në shpirt maqina; pastaj ec e ndaju prej saj...»

Turni është më të mbaruar. Një ditë e ftohtë, e lodhshme. Xha Brahoja thihhte cigaren si i urritur. Kishte pasur aq punë gjithë ditën sa nuk kishte pasur kohë ta ndizte. Ngrica po u vinte hakut.

— Po ajo puna e kursit, Sami?

Tani që djalit i kish hyrë në shpirt shkolla dhe po e ndiqte me rregull, xha Brahoja e ngacmonte për ato ditët e para kur ai kërcente përpjetë sa t'i përmendje kursin. Xha Brahoja kish ndenjtur gjithë kohën me vare mbi kudhër gjersa e vuri djaloshin në vijë. Kudhra — ndërgegjja e Samiut...

— Ja inxhinierja — tha Samiu. Vallë asht në gjen-dje me ba ajo punën e Zef Mërtirit që shkon jashtë?

— E pse jo — Ju shkreh Brahim Jergucati.

— Lidja u kaloi pranë pa u folur. Xha Brahos ju duk ndryshe.

— Shoqja inxhiniere — thirri ai.
— O, xha Braho! U lodhët shumë sot?
— Pak. Po ç'ke kështu? Mos je sëmurë?
— S'jam e sëmurë. Po kush e di? Mbase edhe jam.
Si dukem?

— Si molla në bisk, po sikur je e mërzitur?
— Ç'kemi ndonjë të re? — i dredhoi pyetjes ajo.
— Ngrica!.. Dje edhe me shtangat nuk i kemi pasë
punët mirë. Dy nga ato me dimensione të vogla na u
çanë. Mbase nga ngrica.

— Mbase ka ndonjë shkak tjetër, — tha Lidja, —
mendoj se nuk duan t'ja dinë prej ngricës. Madje mos
kanë të nxehtë...

Lidja kaloi te sondat e tjera. U duk Bardh Shkoza.

— Xha Braho, — i foli Bardhi — pasi të mbarojë
turni keni vendosur të mbulojmë transhënë me dërrasa.
I ke parë ato traversat e vjetra, ato të gjerat? Jemi nja
tri veta që na shkrepni ta bëjmë vetë punën.

— Ato pas barakës së inxhinierëve?

— Po. I mblodha sot në mëngjez. Ato na mbarojnë
punë fare mirë.

— Do të rri edhe unë, Xha Braho, — u hodh Samiu.

— Mirë, — foli kryesondisti, — le të rrinë edhe
disa nga shokët.

Atij i erdhi mirë që Samiu nuk shfaqti ndonjë vë-
rejtje pse të punonin në një sektor që s'ishte i tyre.
Transheja ishte e sektorit të betonimit.

— Ndoshta rrinë edhe dy shokët e mi. Ganiu dhe
Pjetër Mëhilli...

— Mjaftojnë, Sami, mjaftojnë...

U ndërruan turnet. Bardhi, xha Brahoja dhe gjashtë
a shtatë të tjerë nisën të rreshtojnë dërrasat mbi tran-
shënë e hapur nga UKS-të. Këtu nuk kishte asgjë të
vështirë, asgjë për të menduar apo krijuar. Ishte vetëm
punë kujdesi. Duke vepruar kështu, Bardhi me shokë
donin t'u jepnin një mësim të mirë atyre që linin pas
dore sigurimin teknik. Punën e mbulimit të transhesë

e kishin shtruar disa herë në komitetin profesional. Po ja që të thjeshtave, (po atyre të thjeshtave që mund të shkaktonin shumë dëm) nuk ua varte njeri shumë. Pastaj ata shtyheshin edhe më larg: të inisiativat kolektive dhe personale. Duhet të shkonin paralel këto, dhe në gjithë frontet e punës.

E mbyllën krejt transhenë. Punëtorët që kalonin andej buzëqeshnin si me turp, (kjo ishte njësoj si të vinte fqinji të të rregullonte shtëpinë) pastaj qëndronin, mirrin nga një dërrasë dhe ndihmonin. Kur u mbulua transheja, xha Brahoja numëroi tridhjetë vetë për qark tij.

«Duhet shkëndija, — mendoj ai, — se ne kemi punëtorë të mrekullueshëm, njerëz të mrekullueshëm. Duhet inisiativa. Duhet të luftojmë për këtë, për inisiativën, të luftojmë me ngulm! Sa mirë bëri Bardhi!»

— Për njëzet minuta punë, — tha xha Brahoja, — ka më shumë se një muaj që po u lutemi atyre të sigurimit teknik, për njëzet minuta punë mund të ndodhi e keqja...

Ata po bëheshin gati të shpërndareshin, kur u dha kryellogaritari.

Zaimi qëndroi përpara xha Brahos. Shallë i trashë që i mbështillte qafën ja nxirrte kokën tepër të rumbullakët. Nuk e kish kokoren.

— Po këto dërrasa? Ku i keni marrë? — pyeti Zaimi.

— Janë jashtë përdorimit, — u përgjegj Brahim Jergucati. Ai e mbajti me zor zëmërimin.

— E kush i ka nxjerrë jashtë përdorimit?

— Nuk di kush i ka nxjerrë jashtë përdorimit, por di që këto dërrasa nuk hyjnë në ndonjë punë më të vlefshme se kjo.

— Planifikimin e bën tjetër kush, ju lutem. Dërrasat t'i hiqni menjëherë.

Brahim Jergucati u nxe. Punëtorët u revoltuan. Disa zunë të talleshin haptas me kryellogaritarin.

— Ty nuk të dhimbset më shumë se ne prona e përbashkët, — u hodh Bardhi, — po jeta e njerëzve vlen më shumë se çdo gjë. Po sikur të bjerë njeri në

transhe, mos do ta nxjerrish ti me partinë dyfishe? Pastaj kjo shkon krahas projektit të shpimit, i përket sigurimit teknik... Pavarësisht se nuk ja ka varur kush gjer më sot.

— Ju lutem, — i uli kartat Zaimi, — jemi jashtë rregullave, shokë. Materialet tërhiqen me rrugë shtetërore. Merret dëftesa te kryeinxhinieri, dëftesa firmohet nga drejtori i sektorit, i paraqitet magazinjerit, magazinjeri bën «dalje». Kështu, shokë!

Brahim Jergucati nxehej rrallë, por ky Zaimi po e luante mendsh.

— Ç'thua, more? Po cili magazinjer i ka pasë në ngarkim ato? Ato janë gjysmë të kalbura dhe i kanë ndarë për t'i djegur.

— Jo, ju lutem, jo! Kantieri ynë nuk është anarki. S'ka materiale të painventarizuara. I kemi në dosje të gjitha. Të gjitha në dosje! Hiqini dërrasat! Çdo gjë me rrugë shtetërore!

— Ejani të ikim, shokë, — foli xha Brahoja. — Ky po deshi le t'i heqi vetë dërrasat.

— T'i heqi, t'i heqi! E ishalla bie brenda në argjill!

— Kish me i ba mirë, një dush i duhet n'ket kohë!

— Çfarë burokrati!

Punëtorët i kthyen krahët shefit të llogarisë. Zaimi mbet vetëm aty përpara transhesë. I ngathët, i pavendosi, i palëvizshëm. Një manekin vitrine...

Xha Brahoja i përcolli punëtorët gjer te vendi i autobuseve. Ata arritën kur kishte ikur edhe maqina e fundit.

— Do t'ju takojë të prisni, — i erdhi keq xha Brahos. — E shihni ç'është burokracia, shokë? Një njeri i vetëm i bën të presin dyzet të tjerë!

Punëtorët e nisën me zor xha Brahon. Ç'kuptim kishte të priste ai aty?

Kryesondisti u kthye dhe mori për nga menca. Një tavolinë andej nga fundi qe e lirë. Ai u drejtua andej. Se kush e kapi për mënge. Sadiku, kryetari i bashkimeve profesionale.

— E pe Llesh Kalinë, xha Braho?
 — Jo. Pse, ç'ka ndodhur?
 — I erdhi i dhëndrri të punojë këtu. E ka minator.
 Ja caktuan në brigadë. U zu me nëndrejtorin...
 — Djall o punë! Si pleksen punët nganjëherë...
 Po kur erdhi ai?
 — Sot në mëngjes!
 Brahim Jergucati u ul aty.
 — Të lutem një pastičo dhe një mish turli, — i tha
 kamarieres.
 Nuk folën më. Ndihej vetëm tik-taku i lugëve. Mendimet e tyre ishin tretur larg...

KAPITULLI XVII

E shtyu lehtë derën. Dhoma e minatorëve ishte bosh. Hodhi sytë nga shtrati i fundit. Llesh Kalia që shtrirë i veshur mbi batanije. As këpucët nuk i kishte hequr.

Xha Brahoja u ul në tavolinë. Tjetri nuk luajti nga vendi.

— Shqiptari s'të pret kështu në shtëpi, or Llesh...

Shtrati luajti pak, por asnjë zë prej andej.

Brahim Jergucati nxori një cingare.

— Do dhe ti një?

Tjetri u ngrit ndenjurr.

— Nuk due, — tha buzëvarur.

— Unë pi një dyzinë pas buke, — foli xha Brahoja.

Llesh Kalia ja nguli sytë. «Kur do të fillojë? E ke marrë fort shtru, mor Brahim Jergucati. Hajt, nisja pra, të prishem edhe me ty!»

Ai burrë malesh kërkonte shkak për t'u zënë me njerëzit, fjala më e ëmbël i dukej pelin. Sa vetë e kishin kapur në rrugë sot? Zuri të mendonte për ata që i kishin rrahur krahët me të mirë dhe për ata që i kishin folur ftohtë. Pastaj i kishin thënë se do të bënë mble-

dhje kolektivi për për të, do ta nxirnin faqe të gjithëve. I kishin thënë se kishte shkelë këshillat dhe vendimet e partisë, se ishte kundër saj... I kishin thënë se çuditëshin si mund të arrinte gjer këtu një punëtor pararojë... «Kam njëzet e pesë vjet në punë të shtetit, — u qe përgjegjur ai, — dhe askush nuk m'ka rëndue kështu si ju! Po m'bani me mbledhë teshat e me ikë».

Xha Brahoja pinte duhan. Nuk e shqetësonte heshtja e tjetrit. Vetëm se dukej i menduar. Nuk i kishte pëlqyer që e kishin shtrënguar aq fort Llesh Kalinë për të marrë dhëndrrin në brigadë. Xha Brahoja i kishte marrë vesh të gjitha përpara se të vinte te Lleshi. Ata kishin menduar që posa të flisnin ata, Llesh Kalia do të përgjigjej si me sustë. «Po, dakord». Nuk e kishin lënë të mblidhte veten nga ajo e papritur, nuk e kishin vlerësuar si duhej çështjen. E kishin marrë fort lehtë... Me njeriun duhet punuar ngadalë, njeriu duhet prekur në tela, e duhet prekur butë që ato të tingëllojnë mirë, që ato të tingëllojnë drejt... Llesh Kalinë e kishin prekur ashpër. I kishin «urdhëruar telat». Nuk kishin brigada të tjera ku ta çonin hëpërhë? Pse drejt te e tija? Apo donin të tregonin sa të zot ishin për të zgjidhur çështje të koklavitura me shpejtësinë e vetëtimës? Nëndrejtori kishte menduar se kjo punë mund të zgjidhej sa çil e mbyll sytë. Ai kishte arësytuar pak a shumë kështu: «Partia thotë kështu. Llesh Kalia s'e bën dy fjalën e partisë, pra Llesh Kalia do të pajtohet me dhëndrrin menjëherë».

Po, Llesh Kalia nuk e bën dy fjalën e partisë! Po nëndrejtori kishte harruar gjithë ato vite hidhërimesh, pezmatimi dhe vuajtjesh që kishte hequr minatori për të bijën. Nuk kishte ditur t'i lente kohë Llesh Kalisë të mblidhte veten; t'i kapërcente ato, të thoshte me gojë atë që ndjente me zemër. Se ai me zemër ndjente atë që thoshte partia...

«Hajt, qite pra të shkretën, — bluante Llesh Kalia, — mos e mbaj ma. Qite! E di që po të përvëlton përmbrenda. Njerëzit e kanë shumë të lehtë të përzihen në punët e të tjerëve. T'u apin këshilla...»

Brahim Jergucati u ngrit, kërkoi me sy tavllën e duhanit, e shohti cingaren mirë e mirë, pastaj bëri të dalë.

— Ndal! — thirri Llesh Kalia. — Ku shkoni?

— Llesh! Ti ke nevojë për qetësi...

— S'kam nevojë për asgjë. Rri!

— Jo, flasim ma vonë.

— Ma vonë nuk ke kur... Nesër nuk më ke këtu...

— Unë erdha të të flas kryesisht për atë inisiativën tuaj, — vazhdoi xha Brahoja pa u dhënë rëndësi fjalëve të Lleshit.

— Inisiativën?

I kuq si gjaku në fytyrë, ngjante si një vullkan në shpërthim.

— Po. Sa gjë e madhe! Në një anë njeriu, në tjetrën teknika! Njeriu do të tregojë se mund t'ja dali edhe pa teknikën po që i zoti dhe po pat shpirt revolucionari. Sa kohë keni menduar të hapni vrima vetëm me vare, Llesh?

Llesh Kalia buzëqeshi.

— Me ba me m'pas folë kush tjetër, njitash kshtu, me ba me m'pasë folë...

— U plakëm, Llesh, — tha xha Brahoja dhe u ul pranë tij. — Sa vjet kemi që njihemi bashkë?

— Ma merr mendja nja pesëmbëdhjetë të mira...

— Besoj se pesëmbëdhjetë vjet shoqëri mjaftojnë për të ma dëgjuar një fjalë?

—

— Mos u tremb, s'të vë kushte të rënda.

— Folël!

— Ti do ta nisish nesër punën në tunel, dhe do ta nisish në atë formën e re...

— E pa mundun! — thirri minatori. — Nuk mundem... Ua thashë copë që do të iki! Pse nuk i bjen atij krahu, por dredhon?

— Llesh, ti ke nevojë për qetësi, — përsëriti Brahim Jergucati, duke i vënë dorën në sup.

— Unë kam nevojë për punë, — tha tjetri me inat.
— Kam nevojë edhe mos me më nga kush. Askush nuk e din ç'ka i vlon njeriut në shpirt... Po shko e shif një herë «Zanin e masës»?

— Fletërrufe?

— Po, sa gazepi!

— Kush e vuri atë?

— Zaimi!

— Shih, shih!

«Moda e vjetër po revolucionarizohet — mendoi xha Brahoja».

— Ai do të marri hak. E kam ba shpeshherë për pesë pare nëpër mbledhje. Ishte aty kur bamë fjalë me nën-drejtorin. U zuna edhe me të...

— Deti qartësohet kur pushojnë valët, Llesh. Lëri një herë mënjanë të gjitha. Nisja nesër...

— Gja që s'bahet. S'kam fuqi...

— Kaq e rëndë qenka për ty? S'mund ta falësh tjetrin?

— Ashtu si ma sollën ata punën m'duket se e urrej edhe ma shumë. Sikur pata ra në paqë një farë kohe, ma ngacmuen plagën...

Kryesondisti nxori paqetën.

— Na, ndize!

Tjetri e mori me rrëmbim cigaren. Paqeta ra përdhe.

— S'ka gjë. I mbledh unë...

— S'e kam dashtë vedin sa atë vajzë, Brahim. Dhe ajo iku... Iku të them! Ç'ka qesh unë që e rrita tuj lyp nëpër dyer të botës? Lyp, i thonë, kur kërkon punë derë më derë e kur fshatari s'ka një pëllambë tokë për ta punu.

— Ti e ke nxjerrë bukën me djersën e ballit, nuk ke lypur...

— Njisoj ishte në at kohë. Ajo iku...

— Sa kohë ka?

— Një vit. Ti nuk e din ç'ka don me thanë me të ikë natën? Kur gjithë mbramjen e ke pa në andërr nuse! Ti nuk e din ç'ka don me thanë me u zgjue të nesër-

men, me bërtit fort: Gjelinë! Gjelinë! E me t'u përgjegj
jehona e zbrazët... Ti del e kërkon te kroni, sillesh si
i marrë nëpër kopsht, lëviz gëmushat e barin e naltë,
(më kujtohet se kur ishte fëmi mshifej aty) hapesh andej-
-këndeje nëpër kojshi, kthehesh prapë në shtëpi. E kam
dashtë ma shumë se jetën teme, Brahim. Ajo ja kishte
këputë kryet seme motre, asaj të pafat. Unë dojshe me
e martue afër, ta kisha edhe vajzë, edhe motër. A i din
këto, ti xha Braho? A mund t'i shkruiej këto unë në
përgjegje të fletërrufesë? A mund t'i kuptojë këto Zaimi
dhe ndonjë tjetër?

Llesh Kalia buzëqeshi hidhur.

— Kaloj një natë dhe nuk më besohej se ajo ki-
shte ikë. Zgjohesha dhe kur e kujtojshe gjendjen më
ngrihej akull diçka në fyt, në parzëm. Akull, akull! Hej,
ç'dert kam pasë!

Brahim Jergucati dëgjonte kokulur. Fliste prindi, ba-
baj. Ai ja ndjente plagën sikur ta kishte vetë mbi trup.
Dhe në të vërtetë ato ishin dy plagë: Motra, vajza!

Xha Brahoja u kthye nga minatori.

— Më thuaj diçka, të drejtën, Llesh, — tha, — me
të vërtetë kishe për të ikur që këtej?

— Nuk di ç'ka ban njeriu, kur dëshpërohet.

— Këto janë tri gjëra, — foli kryesondisti. — Puna
jote këtu, çështja e vajzës, njerëzit që të mërzitën. Të
tria kanë vendin e vet. Po kush qëndron në krye të
vendit, Llesh?

Minatori buzëqeshi.

— Bane mirë që erdhe, Braho...

Deti i shpirtit njerëzor! Valë, dallgë; tallaze! Pastaj
ç'do gjë vjen e paqtohet, zbutet. Triumfi i arësyes...

Jashtë u dëgjuan zëra. Minatorët! Në rresht për
një, të gjithë brenda! Gjithë brigada! I fundit Sandër
Delia. Dhoma e fjetjes u mbush plot. Një grumbullim
pa fjalë. Megjithatë kuptohej qartë se gjendja i ngjiste
kohës së vjeshtës së mbarsur me bumbullima. Minatorët
kishin punuar pothuaj gjysmën e turnit pa brigadierin.
I kishin dëgjuar fjalët. Ishin të shqetësuar...

Frani, Frani nga Mirdita në ballë të të gjithëve.

— Llesh Kalia, — tha, — na e ka ba t'padrejtë! Na e kem pasë zakon me i qa hallet së bashku! Ç'ka vjen e ndryhesh këtu si murgeshat? T'ka hi frika?

— Mos e tepro, Fran. Nuk tutet Llesh Kalia!

— Atëhere ç'ka je ndry? Ç'ka don me ba?

— T'merrna vesh, Llesh!

— T'qisim të drejtën në shesh.

— Ai «Zaho burokrati» don dru!

— Nuk i takonte atij fletërrufeja. Atij jo!

— Sekretari i partisë e tha haptas se nëndrejtori e kishte shkelur...

— Sekretari i partisë?

— Po, dora vetë!

— Po Llesh Kalia ç'thotë?

Heshtje. Të gjithë vështronin njëri-tjetrin. Kush do t'i sulej brigadierit?

Llesh Kalia e ndjente që tani e kishin me të, heshtja tani drejtohej kundër tij. Kundër të tjerëve ishin zbrazur mjaft. Një heshtje që flet shumë...

— Po të më flisnin ndryshe, — tha minatori, — po të ma lejshin në dorën teme këtë punë, nuk do të arrinte çështja deri këtu. Unë për gjithë jetën nuk do ta mohoj vajzën...

— Kur vjen ai?

«Ai» ishte dhëndrri i Llesh Kalisë.

— Për katër-pesë ditë. Shkoi të mirrte rrobat. Të lajmëronte në shtëpi.

— Si e morën vesh që ai ishte dhëndrri yt? — pyeti Fran mirditasi.

Minatorët vështruan njëri-tjetrin. Asnjë nuk e dinte.

— Po ua them unë, — ndërhyri xha Brahoja. — Ai i tha rastësisht Zaimit që kishte vjehrrin minator këtu. Pastaj kuptohet, Zaimi hyri në hollësira dhe desh të rregullonte «prapësirot» e kësaj bote...

— Zaimi!

Zaho «modë e vjetër»!

— Zaho me shall leshi në fyt!

Minatorët u shkrehën kundër shefit të llogarisë, pastaj u morën me gabimet e Llesh Kalisë. Folën gjatë, një mbledhje e vërtetë në fjetore!

Pulsi i të gjithëve rrihte njësoj. Lleshi i pruri këta njerëz këtu? Kush i nxiti? Ata kishin ardhur të gjithë një nga një, si ata ushtarët që e dinë vendin e detyrës. E kishin ndjerë që vendi i secilit në ato çaste ishte në këtë dhomë të thjeshtë minatorësh, e kishin ndjerë që ata ishin pjesë përbërëse e atij organizmi të madh që quhet kolektiv.

Xha Brahoja fluturonte. Atij i pëlqente spontaneiteti, natyrshmëria. I pëlqente kur njeriu e di ku e ka vendin, ku e ka detyrën. Ai besonte se kjo ishte dhjetë herë më e rëndësishme se çdo gjë që arrihet me të shtyra, me përgatitje. Në fjalët e tyre ai ndjente ndër-gjegjen e zgjuar të klasës. Ç'mund të kërkojë njeriu më shumë se ndërgjegje klase?

«Njerëz nga të katër anët, mirditas, gjinokastritë, pukjanë, kolonjarë, kurveleshas! Një ndërgjegje të përbashkët, — mendonte kryesondisti. — Ja kujt i them fitore unë!»

Ndoshta është e tepërt të thuhet, por atë ~~gast~~ atij sikur nuk i erdhi keq për atë që ndodhi. Ajo i kishte vënë në provë të gjithë.

— Aq të randë e ke me e marrë në brigadë, Llesh?

— Ma t'randë se rrasën e vorrit!

— Marrëzira! — u hodh xha Brahoja. — Le të punojë nga të dojë dhe ku të dojë ai dhëndrri yt; pa për t'u afruar me do të afrohesh. A do të më dëgjosh mua? Përpara qëllimit të jetës tënde kjo është një vërë në ujë! Mos ma luaj kokën! Në tunel të punojë, me ty të punojë. Ai ka gabimet e veta, ti të tuat. Jeta u heq me kohë një vizë të trashë përsipër dhe Llesh Kalia gjen përsëri të bijën dhe qetësinë e vet!

— A e dini ç'ka bajmë? — kërceu Fran mirditasi. — Kam nja dy shishe të mira këtu nën shtrat, edhe nja tri a katër po i blejmë...

— Pikës i ke rënë, — tha xha Brahoja. — Duhet la-

gur një herë për inisiativën... Lleshi mendon se duhet të filloni menjëherë.

— Si? thirrri brigadier.

— S'ka më mirë!

— A e thotë Leshi? Punë e kryeme.

— Jepi, Llesh Kalia. Na do t'i ngulim «fletërrufetë» me vare!

«Ne do t'i ngulim fletërrufetë me vare!»

Xha Brahos i hidhej zemra nga gëzimi. Vështronte Lleshin dhe gjithë fytyra i qeshte si një ditë me diell. «Ti kot e ke, or Llesh Kalia, kot e ke, — thoshin sytë e Brahim Jergucatit. — Ti s'ndahesh dot nga këta njerëz, kot e ke!...»

Jashtë po errej. Bënte të ftohtë. Po brenda minatorët po djersinin. Rakia më një anë, gëzimi në tjetrën. Gëzimi ngroh më shumë. —

KAPITULLI XVIII

Pusi i provës, pusi sekondar... Sonda godet, godet. Bardhi «sa një ving» drejt në këmbë sikur do të matet me kolonën e sondës... Lidja në këmbë... Pusi i provës, pusi sekondar... Ç'të ardhme u fsheh atyre?

Pesë metrat e para ecën mbarë. Po më tutje?

Lidja zë kavon me dorë. Kavoja ulet e ngrihet ritmikisht. Dora e ndjen pykën e hekurit tek rreh atje poshtë. Inxhinierja i kap gjithë kavot e sondave që punojnë. Kjo gjë mbase i bën të buzëqeshin punëtorët. Lidja at çast i ngjan fëmijës që vrapon duke prekur me gisht kangjellat e hekurta të një oborri. Lidjes i duket sikur ai të prekur i jep siguri. Kudo e njëjta goditje, e njëjta ritmikë, monotone, e pa ndërprerë. Vetëm se goditja e humbet fuqinë sipas thellësisë ku kalon pyka. Diku ajo është dhjetë metra, diku njëzet, diku i afrohet fundit.

Gap! Gap! Gap!

Sonda godet. Godet...

Kryesondistët herë pas here i hedhin «unazat e fejesës» kavove. Unazat, pece për t'u orientuar për thellësinë... Dhe kavot kanë të gjitha lidhka, janë të gjitha të fejuara...

Punëtorët qeshin. Lidja s'bën zë. Sa zor është të mbash mbi shpatulla përgjegjësinë e të gjithëve!

— Shoqja inxhiniere! — hidhet një sondist i ri, — e di ku e kam pa dje Markun?

— Hë, folë. Ku e ke parë?

— E kam pa andej nga «Pazari vjetër». Mos kujto se ishte vetëm. Nuk ban rrugë vetëm, ai, asht i squet. Kish përfshi një bukuroshe për belit që t'lente pa mend. Po i binte pash në pash...

— Marku përpëlitet si fugë. Marku zihet ngusht. Marku është një «fuçi birre» i turpshëm dhe i ndrojtur si çupë e mbyllur. Markun e kanë në shënjestër...

— Shife, shife! Hiqet edhe si shenjtor...

— Ai asht shejt me brina!

— S'len gja me ra në tokë!

Marku fryhet dhe më shumë, përpëlitet, kërkon të futet në guackë.

Nga turbullimi i bie një levë e rëndë nga duart.

Të tjerët e presin me brohori këtë çast.

— Asht hutu i shkreti...

— E ka mendjen te ajo!

— Ç'ka bane me te, brumbull? I kallxove si bahen shpimet me injektim?

— Ha, ha, ha!

— Hi, hi, hi!

— Jepi, Mark dashnori!

— Në ç'orë e ke parë Markun andej, Gjergj?

— Ta merr mendja që mbas mesnate!

Marku kthehet nga të tjerët. Fytyra i çelet me një shprehje zgjuarsie.

— Ma mirë pyteni Gjergjin vetë, ç'ka ka dasht në at kohë kah «Pazari vjetër»...

Brohoritje për Markun.

Lidja vë gishtin në buzë.

— Mbylle, — i tha sondistit të ri, — ta hodhi si burrat!

Të qeshurat zgjasin sa kënga e gjelave. Pastaj pushojnë.

..Bardhi «sa një vinç» ka qeshur me lot.

«Vetëm njeriu i mirë mund të qeshi me lot, — mendoi Lidja» — Pastaj fluturon gjetkë. Zef Mërtiri do të ishte aty pas një jave...

Sondat godasin... Godasin...

• • •

— Mos u bëj merak, do të eci, — tha Bardhi «sa një vinç.»

— Tani jam e qetë, — u përgjegj Lidja, — nuk më ndjell zemra keq.

Ajo qeshi.

— Mos më merr për supersticioze, po shpirti është nganjëherë aq i ngatërruar sa të fut në telashe. Eja të vemi njëherë nga çimentimi, Bardh.

Një pompë argjile nuk ecte mirë andej. Tekniku që po merrej me të qe bërë gjithë baltë. Pompa rridhte me shumicë...

— Kam ndërruar tri guarnicione, — shpjegoi tekniku, — i shqyen të gjitha si letra...

— Ma lësho mua, një herë.

Lidja kërkoi t'i sillnin fill të shprishur litari. Përveshi mëngët e xhupit dhe ju vu punës. Guarnicionin e vendosi së bashku me fillin, pastaj i shtrëngoi vidhat fort.

— Unë e provova një herë vetëm me fill, — tha tekniku.

Lidja i shtrëngoi të gjitha vidhat.

— Jepi një herë, — i tha teknikut.

Pompa rregëtiu, argjila e lëngët zu të vlojë brenda

saj me oshëtimë të mbytur. Guarnicioni në fill mbante për bukuri.

Tekniku hapi një rubineto uji. Lidja zu t'i lante duart. Të ftohtit gjer në palcë...

— Si t'u kujtua ta bashkosh fillin me guarnicionin? — pyeti Bardhi. — Ne nuk e kemi përdorur kurrë kësh-tu, ose fill, ose guarnicion.

— Anët e metalit m'u dukën të ngrëna, — foli Lidja, — vetëm guarnicioni nuk mund t'i mbushte ato. Të lutem ma gjej at brigadierin e çimentimit.

— Pompës i duhen ndërruar ca pjesë, — i tha Lidja brigadierit. — Nuk është punë që bëhet këtu. Shpjereni në oficinë. Ajo që ndreqëm ne është e përkohshme.

— Po nuk kemi me se ta zëvendësojmë gjersa ta ndreqim, — u ankua brigadieri.

— Merrni nga rezerva një herë, pastaj e ktheni pra-pë. Do të fas me ata të oficinës që ta bëjnë shpejt.

— Kur ta heqim pompën?

— Çfarë të të them unë? Ja, sa ta shihni që do t'u lërë në baltë.

Brigadieri deshi të largohej.

— Një minutë, — tha Lidja. — Grafikon e shpimit, ju lutem.

Ajo u mbështet pas barakës dhe zu të studjonte atë që i dha brigadieri.

— Pse s'ka ecur si duhet pesa? — pyeti.

— Mbet një shtangë brenda, — tha brigadieri, — mbet një shtangë brenda. Na e pruri shpirtin në fyt gjersa e nxorëm. Futëm të dytën, po e njëjta gjë. Edhe tani nuk po ecën si duhet.

— Ndërroni një herë raportin e argjilës, pastaj shohim e bëjmë. Më raporto çdo orë për të.

— Si urdhëroni!

— Tetëmbëdhjeta edhe njëzet e njëshi shpime rekord, — foli Lidja.

— Tetëmbëdhjeta, xha Brahoja.

— E di tetëmbëdhjetën...

— Njëzet e njëshi është Azis Martaneshi. I është qepur xha Brahos.

— Shumë mirë, — tha Lidja e kënaqur. — E dini çfarë po mendoj? Si thoni sikur të bëjmë një konsultë me ata të dy në mes të punëtorëve? Keni bërë gjëra të tilla? Një konsultë vendçe, si i thonë... Vetëm mendime dhe eksperiencë.

— Konsulta nuk kemi bërë këtu, — u përgjegj brigadier si i zënë ngushtë, — po kemi nxjerrë artikuj: «Si punoj unë» «Si arrita kaq metra shpim në kaq orë?», etj.

Lidja buzëqeshi.

— Të mirë janë artikujt, të mirë, po fjala e gjallë është tjetër. Do të flas me ata të dy, pastaj e vendosim.

* * *

Kryesondisti ja la sondën Samiut, pastaj i doli përpara Lidjes dhe Bardhit. Inxhinierja i hapi menjëherë punën e konsultës.

— Nuk jam kundra, konsultat janë të mira, — foli xha Brahoja. — Ata të bashkimeve profesionale kanë edhe një plan pune në lidhje me ngritjen teknike të punëtorëve.

— Por kanë bërë fare pak gjer tani me sa duket, — tha Lidja.

— Më mirë të themi që kemi bërë fare pak, — qeshi Brahim Jergucati, — se edhe ne të dy bëjmë pjesë në kryesi... Po ç'do të them unë në konsultë? Të rinjve po, mund t'u them shumë gjëra; por sondistëve të vjetër...

Ai tundi kokën.

— Të gjitha sondat janë njëlloj. Nuk ka maqineri më të shpejta apo më të ngadalshme. Sekret i është të bëhesh një me maqinën, të ndjesh siç ndjen maqina.

— Pikërisht këtë mund t'ua thuash, xha Braho. Pak është kjo? Ta bësh njeriun të jetojë me maqinën! Po kjo duhet shpjeguar, duhet shkoqitur. Duhet shembuj, analizë. Sepse si fjalë tingëllon tepër abstrakte...

— Mbase edhe poetike... — shtoi Bardhi «sa një vinç».

— Mund të jetë poetike, — shkoqiti Lidja, — por jo sepse është abstrakte. Poezia nuk duhet të jetë abstrakte...

— Dy gjëra të reja sot, — tha Xha Brahoja, — pusi juaj sekondar dhe inisiativa e minatorëve.

— A do t'ja dalin minatorët, xha Braho?

— Edhe ju, edhe ata. Të dy palët «jetoni me maqinën,» — vazhdoi të shprehej në mënyrë figurative kryesondisti.

Erdhi me vrap ndihmësi i tij, Samiu.

— Eja shpejt, — tha ai me një frymë, — shtanga ngeci.

Kryesondisti u mendua një çast. Bardhi edhe Lidja vështruan hijen e rëndë që i përshkoi fytyrën xha Brahos. Po më pas ajo u sqarua.

Brahim Jergucati u kthye nga ndihmësi.

— Ngeci? E pastaj? Nxirre! Pse je ti aty? Ç'më thërrret mua...

— Unë ta nxjerr? Vetëm?

Fytyra e ndihmësit djalosh mori një pamje prej budallai.

— Po, vetëm nxirre! Mos ka gjë për t'u çuditur këtu? Unë kam punë me shokët, do të shkoj...

Ndihmëssondisti u zbraps një herë, pastaj bëri hapa më të mëdhenj, së fundi ja dha me vrap andej nga sonda.

Lidja dhe Bardh Shkoza u panë sy në sy.

— Ja bëra me qëllim, — tha xha Brahoja, — le ta nxjerrri vetë. Mos presi çdo gjë nga unë.

— Nxjerrja e shtangave do zotësi të madhe, — vërejti Bardhi.

— Le ta mësojë, pra! Ai më ka parë mua disa herë në këtë punë. Janë mësuar t'ua bëjmë të gjitha ne të vjetrit. Po edhe nuk kanë faj. I kemi mësuar vetë kështu, si ato zogjt e pëllumbit, që i ushqen nëna në gojë. Pa ditur as vetë, ne i mbajmë ata si leva shpeshherë, sepse trem-

bemi ngaqë nuk kanë eksperiencë, ua presim krahët. Ata duhen lënë të fluturojnë, ata janë e ardhmja. Por edhe kur ua lëshojmë inisiativën në dorë, këtë e bëjmë me peshoren e farmacistit. Le ta nxjerrë vetë shtangën ndihmësi im...

— Mund të humbasin shumë orë punë, xha Braho...

— Do të humbasin sot, do t'i fitojnë nesër. Të rinjve duhet t'u rrimë mbi kokë për t'i mësuar, por jo për t'u lidhur duart. Ku shkoni ju tani?

— Nga kampata e betonimit, — u përgjegj Lidja.

«Një mjeshtër, një mjeshtër maqinash dhe njerëzish ky xha Brahoja».

— Do vij edhe unë me ju...

— Me gjithë mend e ke, xha Braho?

— Unë nuk bëj shaka me këto gjëra, — ja priti kryesondisti. — Ai le ta vrasì mendjen, le të përpiqet. Kam menduar shumë për këto... Ne të vjetrit nuk jemi të përjetshëm... Do t'ua lëshojmë stafetën të rinjve.

— Lëre xha Brahon, Bardh, ai di se ç'bën, — tha Lidja.

Bardh Shkoza u kthye nga sondat.

— Ai po vështron këndeje, — tha me një farë trish-timi.

— E sheh?... Pret nga unë. Të ikim!

KAPITULL PA NUMËR

Hidrocentrali! Një udhëkryq aksionistësh... Vijnë malet me tirqe e me xhamadane, me anën e preftë e fisnike të burrërisë në sy. Vijnë malet me hapin ritmik të lodrës dhe thirrmenë e fyejve. Malet... Ata sjellin me vete aromën e fortë të alpeve, sjellin diçka të pastër, të bardhë dëborë, si ngjyra e tirqeve të leshta; sjellin krahë të fortë, çika në përgjasim të shtojzavalleve, vajza të

shëndetshme, fytyrë rrumbullake si një boçe lule dielli.

Vijnë fushat, një jehonë gërnete që nis nga Myzeqeja, nga Vurgu dhe ngjitet avash-avash për në veri. Vijnë fushat, të plota, të shëndosha e gjithë gaz si një det gruri në të korrur. Vijnë fushat dhe kundërmojnë erë madërgone e borziloku...

Vijnë fushat, malet, kodrat. Atëhere ç'mbeti?

Shqipëria në ecje, Shqipëria në udhë...

Vargan maqinash, vargan njerëzish. Prijnë flamuret. Ja, një grup i ri aksionistesh... Vajza të ndrojtura, (ato luftojnë me ndrojtjen e tyre) që hedhin hapin si në boshllëk mbi asfaltin e udhëve. Janë mësuar vetëm shkrepave ato. Vajza që përpiqen më kot ta mbajnë drejt rreshtin, posa kanë zbritur nga maqinat.

Përpyekje e kotë! Rreshti mбетet i shtrembër, përpyekjet e tyre të ngathta të bëjnë të buzëqeshësh me mirësi. Hej, vajza! Mos u turpëroni! Pas tri-katër britma burish aksioni ju do ta mbani rreshtin siç duhet!

Ato tremben përpara maqinave të mëdha njëzet tonëshe dhe duke u përpyekur të ruhen i dalin në ballë rrezikut. I hapin sytë çark përpara eskavatorëve të fuqishëm, kërkojnë aty për aty sqarime, mblidhen kokë në kokë si delet syska. Dhe rreshti anohet, epet, bën lak.

Vajza që hap pas hapi e ngrejne nga një gisht shaminë mbi kokë. Ngrejnë rubat, ato grila të dritës. Se ato kanë ardhur për dritën këtu.

Vijnë aty ku do të burojë drita. Kur ka dritë bota është më e madhe...

Ç'sjellin ato me vete nga malet e tyre? Mall? Brenga? Thirrmenë e gëzuar të gruas që gjeti vendin në shoqëri?

Tek i sheh të ecin ashtu të ndrojtura, duke prishur radhën, duke kthyer kokën praptas nga një zhurmë, nga një buri automjeti, ndjen mallin që ndryejnë në shpirt këto krijesa malesh për tokën tonë. Ah, jo! Shqipëria qenka e madhe! Gjithë ato që kanë mësuar në gjeografi për sipërfaqen tonë bien kokëposhtë, sepse njeriu i thjeshtë madhësinë e merr me mend nga ato që sheh

mbi dhe. E ç'nuk mund të shohish në hidrocentral?

Pas tyre ca lisa, lisa shqiptarë... Akoma nuk u kanë rënë brisk faqeve gjak të kuqe. Ecin malet.

Lidja, xha Brahoja dhe Bardh Shkoza vështrojnë nga një qoshe e urës.

Aksionistët bëjnë përpara. Flamurin në ballë. E mban një plak, stap i drejtë, që ecën kokëlart, që e shtrëngon fort drurin e flamurit. E shtrëngon fort. A nuk ja shihni si i kanë kërcyer damarët mbi shpinë të duarve?

Një plak nga ata të brumit të vjetër, që mbajnë mend sa taborre hodhi kundër Dukagjinit Turgut pasha, një plak nga ata që vënë dorën në kobure kur dalin në fotografi e që u lënë amanet të bijve t'i shtrijnë sa më drejt në arkivol kur të vdesin. Se ata duan të rojnë drejt e të vdesin drejt!

— Shife bajraktarin e maleve, — qesh me mirësi xha Brahoja.

— Fisnik! Vështroja sytë, hundën.

— Alamet burri...

— Po ky mes të rinjve?

— Mos u çudit, — i tha Bardhi Lidjes, — ka pasur plot raste që kanë ardhur pleqt me të rinj.

— Nga janë këta? — pyeti Lidja.

— Duken dukagjinas.

Vargani çan përpara. Ecin malet. Në ballë plaku. Një plep lashtësie...

KAPITULLI XIX

Tuneli u zgjua me një zhurmë tjetër, të ndryshme nga ajo që shkaktonin pistoletat, me zhurmën e varesë së rëndë që rreh barominat.

Bam! Bam! Bam!

Dhjetë, pesëmbëdhjetë goditje të përnjëhershme. Duket sikur harku i tunelit epet dhe shtrihet sipas këtyre goditjeve.

Bam! Bam! Bam!

Forca, burra! Forca!

Shpejtojnë, shpejtojnë. Vetëm organizmi i tyre i mësuar duron një tendosje të tillë nervore. Ata kanë marrë një vendim, janë zotuar për diçka. Tendosja e nervave shpreh shqetësimin që kanë për të mbajtur fjalën.

Forca, burra, forca!

Vareja rreh dhe rreh barominën, vrima thellohet, minatorët nxitojnë te tjetra. U duhet të hahen me teknikën. Kush do të fitojë?

Kjo inisiativë lindi një herë nga nevoja. Pritej ajri, kishte ndonjë avari dhe njerëzit mbeteshin mjaft kohë pa punë. Atëherë, o burra, me vare. Po a mund t'ja dalin vetëm me vare? Ja inisiativa. Mos ishte kjo një lodër e rrezikshme? Mos ishte kjo një kthim prapa? Të hahesh me pistoletën e shpejtë që e hap vrimën për pak minuta?

«Revolucioni duhet t'ja dalë në çdo fushë, — thoshin minatorët. — Ne do të punojmë vetëm disa ditë me krah, për të provuar se njeriu është mbi të gjitha. Do të provojmë njëkohësisht edhe veten tonë. Kjo ka për të qenë edhe si një lloj «pune fizike» për ne. Na lini në punën tonë. Nuk do të rrezikojmë planin.»

Po drejtonjësit nuk mendonin kështu. Këshilli teknik shfaqti dyshime për përparimin e punimeve. Tani ishin ditë vendimtare për tunelin. Ishte punë ditësh bashkimi i dy fronteve të punës. Tani kërkohesh ndonjë racionalizim për të shpejtuar punimet, s'ishte koha për të bërë prova. Pastaj pse të lodheshin njerëzit pa qenë nevoja?

Sidomos kështu shprehej Zaimi, se në të vërtetë nga të tjerët nuk dilte njeri hapur kundër inisiativës. Minatorët kishin me vete Lidjen, xha Brahon, sekretarin e partisë së sektorit dhe kryesinë e komitetit profesional.

Sekretari i partisë së kantierit mundahej t'i mbushte mendjen Zaimit pse «duhet të lodheshin njerëzit». Ajo ishte një bisedë në të cilën Zaimi pohonte me kokë dhe mohonte me zemër. «Kësaj i thonë kthim në primitivizëm, — mendonte ai, — ...kësaj i thonë të ngrihesh kundër asaj që ke krijuar me duart tuaja për përparimin e punës».

Shefi i llogarisë nuk ishte as armik, as i huaj për ato që ndodhnin në kantier. Vetëm se ai vështronte çdo gjë së prapthi, sipas mënyrës së vet, dhe ajo mënyra e tij bënte erë myku.

Pat edhe ndonjë tjetër që tha se minatorët po kërkonin lavdi, sidomos ai Llesh Kalia. Pastaj ai e ka kollaj, se mos vret mendjen ai për njerëzit! Sa herë e kanë kritikuar se nuk pyet sa duhet për njerëzit?

Inisiativa fitoi, por duhet thënë me bindje se kishte shumë edhe ndër ata që e përkrahën, që nuk kishin varur shumë shpresa tek ajo.

• • •

Llesh Kalia godet me vare. Nuk godet vetëm barominën. Ajo është vetëm një copë hekur. Ai ka shumë hekura përpara sysh kur godet barominën.

Në ato të rëna pa ndërprerje, shfren një zemërim i madh dhe një besim i madh. Ai do që t'ja dali në krye asaj që ja ka hyrë së bashku me shokët. Thellë në brendësi të shpirtit ai këtë punë e vështron si një lloj përtëritjeje. Llesh Kalia nuk është romantik, por nuk i harron edhe kohët e para kur pistoletat numëroheshin me gishta. Atëhere të punoje minator ishte puna më e rëndë, më e vështirë. Më vonë partia solli teknikën, ua lehtësoi barrën njerëzve. Lleshi sillte ndër mend atë kohë për të vlerësuar më mirë të tashmen. Ndoshta Llesh Kalia shkante me mendime shumë larg, por nuk mund t'i urdhëronte të ndaleshin ato...

Ishte një ditë e madhe. Një ditë që fshin nga kuj-

tesa gjithë hidhërimet, fshin Llesh Kalinë gjaknxehtë e nervoz, brengat e ngjarjet e vjetra, një ditë që lë si përmendore në krye të tunelit atë që ishte robtuar njëzet e pesë vjet me gurin, minatorin.

I binte hekurit me vare dhe diç i trazohej përbrenda, diç i thoshte: «I tillë ke qëndruar gjithnjë, ti Llesh, minator i thjeshtë me vare!»

Njeriu ndjen më shumë kënaqësi kur dërmon shkëmbin me vare, se sa me pistoletë. I duket se kështu hyn drejtpërdrejt në luftë me natyrën. Është thjeshtë ai, minatori!.. Godiste me vare dhe dridhërohej. Godiste dhe fyerjen që kishte ndjerë një natë më parë, edhe kërcënimin, edhe vetëveten në ato pjesët më të këqia. Çekani i binte Lleshit nervoz, Lleshit që për një çast mund të formonte ndonjë mendim të keq për njerëzit, Lleshin që ishte mbyllur përbrenda në dhomën e fjetjes e nuk kishte qarë hallin me shokët. Por diçka tjetër nuk prekte: Minatorin!

Mendonte për të bijën. E kishte mohuar ai atë? Ai e kishte hequr nga mendja, po jo nga shpirti. Të keqen s'ja kishte dashur, por s'kishte dashur t'ja dëgjonte as emrin. Po emri i njeriut nuk qëndron shumë kohë pa u dëgjuar... Erdhi një kohë që Llesh Kalia nuk guxonte të rrëmonte në atë ngjarje. Ja kishte lënë në dorë kohës, së ardhmes. Puna e së bijës i dukej aq e ngatërruar dhe gjendja e tij aq në hall, sa nuk guxonte ta prekte atë pezishkë të ndërlikuar shpirti, se druhej mos prishte më shumë se të ndreqte... Po thamë që ja kishte lënë kohës... Ç'do të bësh, o Llesh Kalia?

Hëpërhë ai godet me vare...

* * *

Sandër Delia i mbante barominën. Hekuri gjashtë-këndësh i vriste pëllëmbët.

— Mos e shtrëngo!

Sandri ngrinte kokën dhe vështronte Llesh Kalinë.

Figura e minatorit zmadhohej, sa herë përkulej prapa, për të marrë hov, për ta goditur hekurin. Duke e vësh-truar, Sandri harronte këshillën e tij dhe vriste prapë duart.

— Mos e shtrëngo! — thërriste më fort brigadieri.

Duart e Sandër Delisë ndjenin barominën më shu-më nga duart e gjithë atyre që po bënin të njëjtën punë. Ishin duar të pamësuar. Dhe ai sikur nuk bëhej fort merak për to, sikur i pëlqente ta ndjente fort goditjen. Kështu i përshkonte gjithë trupin drithma e hekurit.

— Mos e shtrëngo! — porosiste me ton më të prerë Llesh Kalia.

Sandri buzëqeshi.

Llesh i la çekanin e rëndë përdhe.

— Lëshoma mue barominën të ta tregoj si mbahet, — i tha.

Brigadieri u ul në gjunj dhe rroku hekurin me të dyja duart. Sandër Delia u prek kur pa si e mbante ai hekurin, si diçka të shenjtë, të brishtë, që kërkon një kujdes si për të gjallin. Ai qëndronte në gjunj, me duart e shtrira përpara sikur po mbillte një pemë të njomë...

— Hajt, bjeri, s'kemi kohë! Ç'pret?

Sandri nuk pa gjë tjetër veç kokës gjashtëkëndëshe të barominës që nuk dridhej aspak, por qëndronte si e fiksuar në çimento.

Ec e mbaje tash.

Sandri bjer e bjer...

— Ej! Ty të flas! Ku ke hup?

— Njësoj asht, Llesh, — foli Sandri, — Më len.

Shofer, vagonist, minator... Ç'punë tjetër do të bënte? Ditët e fundit kishte zënë të mendonte për këtë. Kur i hoqën patentën kishte menduar se mund të bënte edhe pa maqinë, kishte menduar se nuk ishte puna se me çfarë profesioni do të merrej, po sa të ardhura do të siguronte nga ky zanat. Po më vonë ndjeu që ai ishte i lidhur si mishi me kockën me maqinën, dhe këtë e ndjeu aty në tunel, që ditën e parë. E ndjeu që kur

ushtoi në tunel ku ishte futur të ngarkonte gurët buria e maqinës së parë. Çfarë kumbimi! Ushtimë e ditëve gjithë vrull të së kaluarës... Atë ditë ndjeu të therurën e parë në shpirt. Më vonë ajo erdhi duke u rritur hap pas hapi; e ngacmonte vetë jeta. E ngacmonte një zbarë e pashtrenguar mirë, një shofer i ri që i mirrte kthesat keq, ndonjë kandelë apo pompë vaji që nuk epshin m'ërë. Ai grindej me shoferët, bërtiste, tundte grushtet dhe ankohej për maqinën që mund të shkonte dëm nga pakujdesia. Atë mund ta shanin për gjëra të tjera, por sa për maqinën, kije inat po foli hakun! E mbante si nuse me duvak. Ta kish ënda ta shihje.

Perde të reja, ndenjese të veshura me dok të dyfishtë, parafangat dhe xhamat që shkëlqenin nga pas-tërtia. Në mes bënte kotollumba një majmun llastiku. Ai sillte fat...

Për kujdesin ndaj maqinës Sandër Delia do të kishte qëndruar njëqind vjet shofer. Atë e kishte marrë në qafë tjetër gjë.

Ditën e tretë që erdhi në tunel u zu me një shofer. Parku i hidrocentralit kishte shoferë shumë të mirë, po mes tyre dilte tek-tuk ndonjë që ishte i ri, ose që s'ja varte shumë maqinës. Pra Sandri u zu me një shofer. Skapamentoja e «Lum verdhës» shkonte sa andej-këndeje si ndonjë copë teneqe. I ishin liruar vidhat.

— Hej, mik, — kishte thirrur Sandri, — po ta merr era skapamenton!

— S'kam ç'ka me i ba, s'kam çilca!

Shoferi kishte marrë të hipi në kabinë.

Sandri i del përpara.

— Prit, shtrëngoja me ndonjë mënyrë.

— Ehu! Kur të la punën!

Dora e fortë e Sandrit nuk e lë shoferin të futet në kabinë.

Ai shan diçka nëpër dhëmbë, pastaj zbret si pa qejf nga kabina. Hap kasetën e veglave, bën sikur kërkon çelësat. Në të vërtetë çelësa s'ka.

— Shoferi i mirë duhet të ketë një dyzinë çelësash, — thotë Sandri.

— Prit, mos e nis maqinën.

Ai se nga shkon dhe gjen një çelës anglez. Humbet nën maqinë. Aty e ndjen veten tamam në vendin e vet. Vidhat shtrëngohen, Sandri del.

— Mbathja tash! — i bërtet shoferit.

Këto sillte ndër mend Sandër Delia ndërsa rrihte barominën me vare.

— Lëshoma mue, Sandër, — tha Llesh Kalia. — Ta bajmë me radhë...

— Jo, jo! S'jam lodhë.

Në tunel u fut me zhurmë të madhe një «Zis». Buria kumboi.

Një goxha buri «Skode». Shoferët kishin shumë qejf t'i binin burisë në tunel, sepse ushtonte në mënyrë të veçantë.

Sandri ktheu kokën automatikisht andej, ndërkaq qe duke i dërmuar duart brigadierit.

— Më fal, Llesh!

Llesh Kalia lëmoi leskrën e përgjakur të lëkurës që i hoqi vareja dhe tundi kokën.

— T'merr malli fort për makinat?

...

— Ti Sandër ke mall për to, e shof.

Tjetri psherëtiu.

— Ani, s'ka gja, dueje punën tande! Ti ke rrëshqit për kurrja send. Njeriu që e don kaq fort punën e vet s'ka si me kenë i keq. Ma lësho mue at maj.

U ndërruan. Sandër Delia u ul në gjunj, në atë pozën e brigadierit që sikur po mbillte një pemë.

Llesh Kalia u hodhi një sy shokëve.

— Jepni, burra! — bërtiti ai.

— Jepni, burra! — ushton fort tuneli.

...

Erdh shefi i llogarisë. Në majë të gishtërinjve, duke shkelur vetëm mbi dhoga dhe vende të thata ai arriti përpara Llesh Kalisë me këpucët pa asnjë cirkë balte.

— Shoku Llesh, ju lutem pak të kontrollojmë një evidencë.

— Tash jam në punë, — u përgjegj Lleshi, — tash vij vetë në zyrë.

— Vetëm dhjetë minuta, — u përpoq tjetri.

— Dhjetë minuta janë një vrimë, — ja pat Lleshi pa i ndërprerë goditjet.

— Po lene një herë varenë...

Llesh Kalia godet edhe më shpejt.

— Evidenca duhet nisur urgjent.

Llesh Kalia i lëshon goditjet breshër.

— Ju lutem pak respekt për njerëzit.

— Hiq! Kam ma respekt për punën!

— Mos jeni zemëruar nga «fletërrufeja»? Po kjo është parimore.

— Qërohu me gjithë «fletërrufenë» tande!

— Do të ankojem!

Me gjithë zemërimin që e kapi, u largue prapë në majë të gishtërinjve, si ndonjë vajzë që vete në mbrëmje. Po nuk pati fat. Kaloi një «Lum verdhë» dhe ja hodhi poshtë gjithë ato kujdesë. Mbase ja bëri edhe kastile ai qerata shoferi, që qeshte si djalli në kabinë.

Zaimi, i hutuar, vështroi pantallonat e ndotura me baltë, si një e keqe që s'mund t'i ndodhte kurrë atij. Atë çast i shkante sa s'ka nofka «Zaho, modë e vjetër».

• • •

Ndërsa po linin punën, punëtorët e digës dëgjuan thirrje të forta andej nga tuneli. Një «urra!» e zgjatur, kumbonjëse që u hap nëpër gjithë luginën e Drinit. Pastaj varg minatorësh që dalin një nga një nga tuneli. Tundin kaskat e forta, tundin kaskat!

KAPITULLI XX

Bardh Shkoza u nis të shtunën pasdreke me lejë. Të dielën martonte motrën. Kishte dasmë. Lidja nuk e desh aspak ikjen e brigadierit, por nuk pati çfarë të bënte. Të hënën fillonte betonimi, prandaj nuk e desh.

Qe embytur me punë gjernë grykë; sektori i vet dhe i Zefit i hanin gati gjithë kohën, pastaj kursi i punëtorëve, ndonjë mbledhje apo konsultë, ndonjë kërkim llogarie... Ehu, sa ka puna!

Që kur iku Zefi atë e mundon edhe diçka tjetër, e ha përbrenda, i vlon, mirret me të. Do të ndryshojë procesin e betonimit. Kështu pakësohet shumë koha e punës. Në vend të vagonëve duhen përdorur kamionë të vegjël «riportabel».

Duheshin bërë ca ndryshime të vogla në nyjen e betonit, si dhe ca më të mëdha për puset. I bëri menjëherë skicat. A mund t'ja bënin shpejt? Duhej vendimi i këshillit teknik, urdhëra... Kështu shkante gjatë kjo punë. Pa të provonte ndryshe?

* * *

Doli. Kërkoi drejtorin dhe inxhinierin, po ata kishin vajtur në qytet. «Dje e pardje i shihja dhjetë herë në ditë. Tani që më duhen janë zhdukur».

U fut te dezurni dhe kërkoi në telefon nëndrejtorin e kantierit. Përtej xhamave të dhomës dukej krejt ofiçina si në pëllëmbë të dorës. Punëtorët, maqinat.

— Urdhëroni! Shoqja Lidje! Nga flisni?

Zëri i nëndrejtorit i erdhi i ngrohtë në vesh. Lidjes i erdhi fryma, ai do t'ja rregullonte.

— Flas nga ofiçina, — ju përgjegj Lidja. Pastaj ajo u mundua t'ja shpjegonte punën sa më shkurt.

«Po ç'është kjo punë vetëtimë? Pse s'e keni para-

qitur në këshillin teknik? Duhet parë. Nuk dua të ul vlerën e propozimit tuaj, por... Mendje i thonë, po të bëjmë në kokën tonë...»

Lidja e uli dorezën e receptorit. Mbet. Telefoni tingëlloi prapë, ajo nuk e luajti nga vendi.

— Shoqe, ta marr unë? — tha dezurni.

«Jam nëndrejtori. Kush je? Dezurni? Mirë. Ç'u bë inxhinierja? Aty është? Po pse nuk më përgjigjet atëherë?...»

Lidja mori receptorin.

— Alo!

— Të lutem eja pak nga unë dhe... mos u zemëro! Drejtorja që matanë. Ajo i hipi një «Zisi» dhe për pesë minuta që përpara saj. Nëndrejtori buzëqeshte te dera.

Lidja hyri brenda dhe u çudit kur gjeti tre nga inxhinierët e këshillit teknik.

— Ja, të mos na qortoni se nuk jemi operativë, — buzëqeshi nëndrejtori, — i thirra këta shokët, mirë që i kisha këtu. Ta shoshitin planin tënd.

Vajza u skuq. «Ky nuk ka besim te unë, — mendoi. — Kjo është një gjë kaq e thjeshtë, vetëm duhej kujtuar këshilli teknik!»

I erdhi të dilte jashtë dhe t'i vinte kapak asaj pune. Sikur të kërkonte të bënte një ndryshim të tillë Zef Mërtiri, asnjëri nuk do t'i shkonte ndër mend për konsultë. Megjithatë ajo qëndroi. U shpjegoi thjesht se çfarë kishte ndër mend të bënte.

— E kuptoni, nuk është ndonjë shpikje kushedi çfarë. Është vetëm frut i të vrarit të mendjes, diçka praktike...

Njëri nga inxhinierët shfaqti disa dyshime në lidhje me shkarkimin e materialit.

— Duhet bankina më të larta përpara sondave, — tha ai, — përndryshe s'bën.

— Bankinat janë gjë e lehtë. Pak zhavorr ka?

Ata pastaj thanë se Lidja kishte menduar mirë. Të betonosh me automjet, fiton shumë kohë.

— Atëhere jepni urdhër për bombolat, — i tha Lidja nëndrejtorit.

— Pasnesër do t'i keni gati — buzëqeshi ai. — Dhe do të vijmë t'ju shohim.

Nëndrejtori la dorezën e telefonit. Posa kishte folur me ata të oficinës.

Pasnesër! Lidja deshi të kundërshtonte, po e mbajti veten! Pasnesër! Hinkat nuk kishin as dy orë punë! Doli jashtë pa ditur ç'të bënte.

— Dy kamionë do t'i heqim nga lavatriçja për ju, — i erdhi që prapa zëri i nëndrejtorit.

Ajo nuk mund të priste gjer pasnesër.

Kaloi një «Tatër». Lidja i nxori dorën shoferit.

— Më ço pak në oficinë, — ju lut.

— Hip!

KAPITULLI XXI

Në ora katër erdhën dy «Zisat». Lidja bëri një provë betonimi me ta. Punëtorët ishin të sektorëve të tjerë, Lidja i mblodhi aty-këtu vullnetarisht. Bëri katër rrugë me maqinat bosh. Një «lojë» luftarake, një betonim pa beton. Sipas llogarive i doli gjysmë ore më shumë nga koha që mendonte. — Lidja mbeti e kënaqur. Nesër do të kishte punëtorë të specializuar.

E hëna i solli një të papritur. Në gjashtë e gjysmë pa në mes të punëtorve Bardhin «sa një vinç». U çudit, Bardhi ishte ai? Po, Bardhi, që bënte shaka me shokët dhe u ndante karamele. E Lidja që kishte menduar se mund të vinte pas tre-katër ditësh... Vajza bëri një llogari të shpejtë. Bardhi nuk kishte qëndruar më shumë se katër orë në shtëpi.

— Bardhi! Po ti?

— Ja, erdha, shoqja Lidje.

— Si erdhe? Po dasma?

— Dasmën sa e nuhata pakëz, — buzëqeshi Bardhi, — sa për t'mos ja prishur dhëndrrit dhe motrës, pastaj vrap e këtu...

— S'ke bërë mirë, — foli Lidja, — njeriu një herë martohet. Dasëm...

— Dasmën te unë ka kush e bën, më hante ai betonimi. Në një kohë tjetër mund të rrija, po sot s'më zinte vendi. Kërciste një lodër në oborr përpara dasmorëve e më ngjante sikur dum-dumi i saj më shtynte këndeje si kushtrim.

Ja, si ishte ky Bardhi! Një gjigand me shpirt të pastër. Lidja edhe çdo njeri mund të vështronte përmes tij si përmes një kristali.

Bardhi u interesua shumë për ndryshimet në betonim. Ai kishte qenë një ndër bashkëpunëtorët e Lidjes në këtë proces, ndoshta edhe më shumë se kaq. Bardhi e ndjente si detyrë të kërkonte të renë, t'i nxiste të tjerët ta përqaфонin atë, të militonte për të. Ishte nga ata që u pëlqejnë ndërmarrjet e guximshme, po që kanë një bazë të shëndoshë. Arësyeja dhe logjika e fortë përputheshin shumë mirë te ai me një fantazi të pasur. Kishte pasur shumë suksese në punë, po ai gjithnjë kishte mbetur një gjigand i mirë me shpirt fëmije.

Dhjetë minuta përpara se të niste puna, Lidja u shpjegoi edhe një herë punëtorëve kërkesat që shtronte mënyra e re e betonimit.

Lidja rregulloi sahatin dhe priti. Nisi betonimi. Maqina e parë doli me zhurmë nga nyja e betonit dhe u shkarkua te hinka e madhe e pusit. Betoni rrëshqiti poshtë mengadalë në grykën e pusit, sikur ta shtynin me zor. Iku maqina e parë, erdhi e dyta. Prapë e para, prapë e dyta. Zinxhir... Zinxhir...

Tani çdo gjë varej nga ata që furnizonin betonatriçet me lëndë të parë. Kishte ca ngatërresa më shumë këtu. Nuk ishte më si përpara kur përzierja e betonit bëhej me bazë vëllimi. Tani çdo gjë peshohej, edhe çimentoja, edhe rëra, edhe zhavorri. Kjo shtonte shumë cilësinë e betonit.

Lidja vështronte kronometrin. Me sa dukej ritmi
qe ngritur pak më shumë e dy herë.

«Duhet edhe një maqinë, — mendoj Lidja».

Pastaj ajo ja tha këtë Bardhit.

— Tri maqina e kanë zor të vërtiten këndeje, vendi
është i ngushtë. Ato mund t'ja dalin vetëm nëse res-
pektojnë me përpikëmeri itinerarin e lëvizjes.

— Ta provojmë, — tha Lidja.

— Ashtu është.

Një «Gaz» erdhi dhe u ndal në këmbët e digës.
Zbriti sekretari i partisë i ndërmarrjes.

Lidja vërejti se atij nuk i bënë aspak përshtypje
ndryshimet.

— Hë, si duket novacioni juaj, shoqja Lidje?

Vajza mori zemër prej buzëqeshjes së tij.

— Besoj se je e kënaqur nga djemtë tanë? — vazh-
doi ai po me atë buzëqeshje të mirë në fytyrë.

E kishte fjalën për punëtorët komunistë të oficinës
që ja kishin bërë hinkat Lidjes jashtë orarit.

Sa shpejt e kishte marrë vesht!

— Komploti u zbulua! — qeshi me gjithë zemër
sekretari i partisë.

— M'u duk diçka e thjeshtë, prandaj nuk e zgjata
shumë, — sikur u shfajësua Lidja.

— Megjithatë pati ndonjë të cilit nuk ju duk aq
e thjeshtë, për më tepër u shqetësua...

— Nëndrejtori, — tha flakë për flakë Lidja.

Sekretari i partisë qeshi me gjithë shpirt.

— E shihni që qenkeni prekur? Po mos i mirrni
punët kështu. Nëndrejtori e shkeli ca, po duhet të dini
çfarë përgjegjësi ka betonimi.

— A do të vepronte kështu nëndrejtori po të ishte
në vendin tim Zefi apo inxhinier Ilia?

— Më shumë jo, se po! Po këtu hyjnë shumë gjëra,
eksperienca, rëndësia e procesit, sigurimi nga pikëpamja
teknike...

— ...Dhe fakti që unë jam femër...

— Po, dhe fakti që ju jini femër, — qeshi përsëri

sekretari. Po nuk do të ndodhë më. Ai erdhi dhe më foli vetë. «E shkela me Lidjen. Dy herë e shkela. Një herë në telefon, pastaj me ata të tre që mblodha». Kështu tha.

Lidjen e thirrën specialistët kinezë andej nga nyja e betonit. Ata nuk ishin të kënaqur nga përzjerja e një betoniere. Lidja e pa që zhavorri ishte shumë i imtë dhe e pëlqeu mendimin e tyre për ta përdorur gjetiu.

— Po mendoja për ato që folëm, — tha sekretari i partisë kur u kthye Lidja. — Secili nga ne, edhe ai më i avancuari, ruan në vetëvete diçka nga konservatorja. Kjo na del papandehur, madje as nuk e kuptojmë shpesh që është e tillë. Dhe çuditemi kur bindemi që e kemi këtë. «Si është e mundur? Unë ta kem këtë mendim?» Prandaj, e shihni sa rëndësi ka ajo që thotë partia dhe shoku Enver, që ju duhet të jeni vetë në ballë të luftës për emancipimin! Shumëkush mund t'u fyejë padashur, mund t'u lërë pa dashur në plan të dytë të jetës dhe të aktivitetit.

— E kam vënë re një gjë të tillë, — u përgjegj Lidja. — Keni të drejtë.

Nga nyja e betonit shkonin e vinin maqinat, puna ecte zinxhir. Lidja nuk ja u ndante sytë. Ishte e kënaqur nga çdo gjë, nga puna, nga jeta, nga përpjekjet për t'ja arritur qëllimit, nga fjalët e këtij sekretarit të partisë që fliste aq ngrohtë!

Erdhi Bardhi «sa një vinç». Solli lajmin që pusi sekondar i kishte kaluar njëzet metrat.

— Ai pusi që hapet në kundërshtim me projektet e para?

— Po, ai.

— Kjo duhet sot, luftë mendimesh, prova dhe mendime për të çuar përpara punën, prodhimin. Guxim, guxim me mendje të shëndoshë! Ku ka pranim të amulltë të çdo projekti që sjellin inxhinierët e qendrës, nuk ka përparim.

Sekretarit të partisë se ç'i ra ndër mend dhe u kthye nga Bardh Shkoza.

— Po ti? Ç'bën këtu? Mua më thanë që kishe dasëm?

Lidja i shpjegoi shpejt e shpejt si qëndronte puna.

— Klasa jonë punëtoze tanimë po e krijon siç duhet profilin e vet, — tha shumë i kënaqur sekretari i partisë. — E po, urime, Bardh!

Zu të bjerë shi, një shi i hollë, i ftohtë dhe me erë. Shoferi ju afrua sekretarit të partisë.

— Futuni në maqinë, se do të lageni, — e këshilloi ai.

— Do të lagem? Po këta këtu nuk i zë shiu? Mbathja nga zyrat, nuk kam nevojë për maqinë!

Ishte e para herë që Lidja e shikonte të nxehej.

Shiu pushoi, kishte qenë vetëm një copë re e vogël atje lart në qiell.

— A ju shkon skena? — pyeti papritmas sekretari i partisë.

— Skena? — ngriti kokën Lidja shumë e çuditur.

— E keni fjalën për teatrin?

— Po, po! — luajti kokën me energji tjetri.

— Nuk e kam provuar asnjëherë...

— Provojeni! Tani kemi goxha vajza dhe gra këtu në punë. Në punë i kemi, në jetën shoqërore jo! Disa kanë të drejtë se jo kanë fëmijët, jo halle të tjera atje në qytet, po ka edhe plot prej tyre të cilat mund të na ndihmonin fort.

— Një minutë, — tha Lidja.

Betonimi i puseve kishte arritur gjer në atë shkallë që duheshin ngritur tubat nga thellësia. Ky proces u krye me shumë shpejtësi.

— Pra, provojeni skenën, — tha sekretari i partisë.

— Do ta provoj, — tha Lidja me vendosmëri.

— Më pas mund ta lini atë punë, — tha tjetri, — ju jeni shumë e ngarkuar.

— Mbase mund të lë profesionin e inxhinierit, — qeshi Lidja, — mund të bëhem aktore professioniste.

Sollën drekën me bidona të mëdhenj. Kur kishte betonim nuk ishte e mundur të hanin në menci.

— Hani edhe ju, — i tha Lidjes sekretari i partisë.

— Do të ha më vonë!

— Hani, hani! Është Bardhi këtu, pastaj jam edhe unë. Apo harruat që jam inxhinier?

Betonimi arriti prapë lartësinë e tubit të dytë. Lidja la bukën përdhe dhe u drejtua andej. Kur u kthye ajo, gjella ishte ftohur. Sekretari i partisë tundi kokën. Ndërkohë autovinci e kishte ngritur tubin lart dhe punëtorët po e ndanin nga pjesa tjetër që ishte brenda. Tutje, mbështetur para barakës, Lidja po përllante shpejt e shpejt gjellën e ftohtë. Një sy në pjatë, një sy nga sondat...

* * *

Jashar Lica dhe Loro Kini rrinin kokë në kokë pranë vagonave. (Lidja hëpërhë nuk i hoqi shinat për t'i pasur vagonat si rezervë për çdo të papritur).

— Nuk mjafton të ftohtit, po na, u gjet edhe shiu.

— Kështu është kur punon jashtë, Jashar...

Tjetri pështyu përdhe.

— Ty sikur nuk të bën aq shumë përshtypje. S'ankohesh më. U mësove duket.

Tjetri ngrii supet.

— Ç'dobi ke nga ankimet? — tha. — Mos i rregullojllon punët me ankesa?

— Jo, jo, po njeriu ka nevojë edhe të shfrenjë, të qajë hallin me shokun. Ti vetëm shtyn vagonin, ose mbështetesh pas bishtit të lopatës si elefanti pas pemës. Të paktën ai fle...

Tjetri qeshi.

— Më bëre edhe elefant, — tha.

— Unë nuk mund të qëndroj më këtu, — ja pat Jashari. Këtu është punë me tension të madh. Nuk e përballoj dot.

— Puna nuk është e lodhshme, — kundërshtoi tjetri. — Vetëm udha të mundon ca. Shko e eja çdo ditë.

— Këtu është punë me tension, — vazhdoi tjetri. Zhurmë si në ferr! Kush i duron gjithë këto maqina? Do të iki që këtu.

— Kjo është një vepër e madhe; do të ketë edhe zhurmë, edhe tension.

— Ti Loro je si ai topi i argjilit; që ngjishet nga ta shtypësh me gishta.

— Bukur mjaft! Një herë më quajte elefant, një herë top argjili. Ç'ke kështu, sot, që më fyen?

— Unë do të iki që këtu. Këtu të tërheqin prej hundede edhe çiliminjtë, edhe gratë. S'bën për ne ky vend.

Ai kishte plot arësye për të ikur. Që kur kishte dalë nga burgu kishte punuar nëpër ndërmarrje të vogla dhe në ndonjë punishte. Nuk kishte përpara syve industrinë e madhe, uzinat, fabrikat. Këto u sëmbonin në zemër. Nuk e duronte dot fuqinë e vendit që po rritej. Kishte qenë qetë atje në punishtet e vogla. Shihte dy-tre fytyra, jetonte i veçuar, nga shtëpia në punë, nga puna në shtëpi.

— Jashar, — kjo është vepër e madhe, — theu heshtjen Loro Kini. Me ç'kam dëgjuar unë, me këtë mund të krenohet edhe një vend i madh.

Jashar Lica u nxi në fytyrë.

— Krenarinë mbaje në xhepin e pantallonave, ku ruan tallonin e autobusit, — ju hakërrye.

Tjetri e vështroi i çuditur.

— Jashar! Ç'flet kështu si i dehur?

«Edhe ky s'është në terezi. Lëkundet. Tani ka filluar t'u pëlqejë puna e tyre. Të molepsi edhe ty komunizmi? Nuk thoshin më kot që është epidemi...»

Të gjitha këto që mendonte do t'ja përplaste me dëshirë të madhe në fytyrë atij Loro Kinit bullafiq. Sikur të mos kishte frikë...

I urrente të gjithë rreth vetes, të gjithë që s'mendonin si ai, të gjithë ata që ndjenin gëzimin e punës, dhe ishin të kënaqur me kohën. S'e duronte dot sidomos entuziazmin e punëtorëve.

— S'bën për mua kjo jetë këtu, — i përsëriti Loro

Kinit. — S'bën. Ti me sa duket je ndryshe.

Fjalët e fundit i tha jo pa ironi.

Ata folën gjatë e gjerë aty pranë vagonave. Folën avash-avash. Jashar Lica i vendosur, nevrík, por duke u ruajtur mos ta kalonte masën, tjetri i ngadalshëm, po që i largohej përherë e më tepër ndikimit të Jashar Licës.

Jashar Lica ishte armiku, tjetri i lëkundshmi.

KAPITULLI XXII

Shefi i llogarisë kërcëu nga «Gazi» mu përpara sondave, zbriti nga maqina si topi me hobe dhe ja mbajti nga çimentimi. Pas tij zbriti një llogaritar tjetër.

— Ku është inxhinieri? Ku është brigadieri? Ku është kryenormisti?

Shefi i llogarisë i nxirrte fjalët si mitraloz «Maksim».

Tundte një gyp letrash në dorë dhe lëvizte sa an-dej-këndeje.

— Këtu ka shpërdorime, — zuri të fliste me zë të lartë. — Shpërdorime me brirë.

Lidja dhe Bardh Shkoza u panë sy në sy. «Mos i kanë lojtur vidhat Zahos?»

— Pesëqind ton çimento për njëzet e katër ditël Pesëqind ton i përpiu dheu dhe ne s'kemi si e faktojmë! Kjo është e tmerrshme. Shesh me lule për ata që kërkojnë mjegull... Ku është çimentoja? Nën dhe? Kush ma fakton mua? Si t'ua tregoj unë revizorëve që do të më vijnë?

Brigadieri zuri t'i shpjegonte diçka, po Zaimi as që po i vinte vesh. Ai kërkoi evidencat për thithjen e puseve. U hodhi një sy si i etur, pastaj mbylli kapakun i kënaqur.

— E shihni shpërdorimin? Asnjë nga pusët nuk ka marrë njësoj çimento! Njëri ta zëmë tridhjetë ton, tjetri pesëdhjetë. Nuk jemi në rregull! Dolën të palarat...

— Çuditëm si nuk e kuptoni, — ndërhyri me nervozizëm Lidja, — që pusët nuk kanë thithje të barabartë. Njëri merr më shumë, tjetri më pak. Kjo është e qartë!

— Të njëjta duhet t'i kenë, shoqja inxhinierë, ka rregulla këtu...

Kur e kuptoi ai që po fliste mekanikisht ishte shumë vonë.

Lidja dhe Bardhi me të tjerët po qeshnin.

— E di si është kjo punë, shoku Zaim? Tamam si borderoja e rrogave ku nuk mund t'u paguajsh njëlloj të gjithëve, sepse nuk japin njësoj në punë, — u tall Bardhi.

— Ose më qartë, — tha kryenormisti, — barku juaj nuk zë aq sa i Bardhit «sa një vinç»...

— Ju lutem jo me shembuj nga personi im!...

— Shihni pusin numër shtatë, — foli Lidja, — përpin çimento si ndonjë i babëzitur! Ku ta dish çfarë gollesh dhe kavernash ka përposhtë? Po ne nuk mund të ndalemi, duhet ta ngopim patjetër, përndryshe rrezikojmë gjithë punën.

— Megjithatë pusët duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të thithin të gjithë njëlloj, — nguli këmbë Zaimi.

Lidja u mbajt e u mbajt po nuk e ndaloi dot gazin. Qeshën edhe të tjerët. «Ja ç'do të thotë të të bëjë zyra për vete, — mendoi Lidja. — Burokrat me teneqe!».

— Për të bërë siç thoni ju, inxhinierët duhet të jenë magjistarë, — u mundua të ishte serioze Lidja.

— E gjithë kjo pastaj është diçka e papërcaktuar...

— E si mendon ti, shoku Zaim? — pyeti xha Brahoja që ishte afruar pa u vënë re.

— Unë nuk mendoj asgjë. Unë vetëm kërkoj prova!

— Futu nëpërmes birës së pusit, të gjesh prova, — u tall dikush.

— Unë nuk lejoj të më fyeni, ju lutem, — vrenjti vetullat Zaimi.

— Epo na e prure në majë të hundës. Ke gjysmë ore që po flet kot. Prova! Pasiguri! Rregulla! Në djall të vesh me gjithë to! Ne bëhemi copë këtu që mos të na vejë dem një grusht çimento, ti kërkon prova! — foli me zemërim Bardh Shkoza.

— Pesëqind tonelata çimento! Të luajnë mendt e kokës!

— Mos u tremb! Këndeje është harxhuar pak, madje! Po kur të dalim në anën tjetër do të çuditësh më shumë. Atje do të punojmë tamam mbi shtratin e lumit dhe thithja do të jetë shumë më e madhe.

— Mirë, të bëjmë sikur e pranova, po si do të justifikohem unë me ata që do të ma mbledhin?

— Silli këtu të qëndrojnë një muaj me ne dhe do të binden, — qeshi Bardhi.

— Ku kini punuar më përpara, shoku Zaim? — pyeti Lidja.

— Në seksionin e financës së rrethit. Po ishte ndryshe atje... S'ka llafe atje... Çdo gjë me dokument, çdo gjë me shkresë...

Ai fliste dhe nuk ja ndante sytë sondave përtej.

— Ja, — thiri ai papritmas. — Ja si derdhet kot së koti çimentoja nga ai tubi atje!

— Nga cili tub? — pyeti i çuditur brigadieri i çimentimit.

— Ja, nga ai atje, te sonda numër tre.

— Po ajo është argjil, or i uruar, — u përgjegj tjetri, — argjil që del jashtë përdorimit.

«Vizione çimentoje, — mendoi Lidja, — ethe zyrtari për të gjetur shpërdorimet».

— Argjil? Argjil?

Shefi llogarisë ishte shumë i hutuar. Ai u kthye nga llogaritari që kishte marrë me vete, po tjetri uli kokën i turpëruar.

— Megjithatë kjo punë duhet parë, — mezi belbëzoi Zaimi. — Nuk mund të ecim kështu kuturu.

— Mullisi të vetën se të vetën, — tha Bardh Shkoza.

— Unë nuk jam mullis, po shef llogarie, — u ngreros Zaimi.

Pastaj u kthye nga inxhinierja.

— Këtu nuk duket asgjë, — tha me ton miqsor. — Megjithëse ka kaq muaj që po punohet, nuk duket asgjë. A nuk ju merr frika ndonjëherë?

— Nuk na merr frika, — tha Lidja. — Ne dimë ku vete çimentoja...

Shefi i llogarisë u largua me të shpejtë dhe kërcëu në «Gaz». Vështrimi i tij i pakënaqur mbeti disa gaste në xhamin e maqinës, pastaj «Gazi» u nis.

— Një shef llogarie koprac si Midha i Egjiptit dhe frikacak si Kreusi, — tha Bardhi, të cilit i pëlqente historia.

— Lëre historinë, Bardh, — e ndërpreu xha Brahoja. — Kjo është diçka shumë serioze!

— A thua se u bind? — pyeti brigadieri i çimentimit.

— As sa maja e thoit, — ja pat Bardhi.

— Do të ngatërrojë ndonjë gjë andej lart. .

— E njohin Zaimin. . .

Lidja mendonte për shefin e llogarisë. Frika e Zaimit nuk ishte diçka e thjeshtë. Ai i përkiste atij grupi njerëzish që nuk mund të rrojnë të qetë kur nuk e kanë të vërtetuar një pasuri që e kanë në ngarkim, kur nuk e shohin mallin me sy. Edhe mosbesimi i tij andej rridhte. Si frika, si mosbesimi i kishin rrënjët në mentalitetin e mykur të këtij njeriu. Myku hapet avash, avash, të mpin mendjen dhe s'të lë të lëshohesh me guxim përpara. Kështu ishte Zaimi. Lidja mendonte atë çast se edhe në mes të punëtorëve mund të ishte ndonjë që trembej nga e panjohura, ndonjë që të mos besonte se ç'ndodhte poshtë tokës. Kishte kaq muaj që punohet dhe asgjë nuk shihej me sy. Mund të kishte ndonjë që trembej se mos shkonte dëm gjithë kjo punë. I shkoi papritmas në mendje se në gjithë atë kohë nuk kishin bërë asnjë provë, veç provave të fillimit, provave eksperimentale jashtë digës. Duhej bërë një provë.

Kjo nuk ishte aq çështje teknike sa ishte çështje besimi. Kur e sheh si të ka ecur puna lidhesh më me zjarr drejt saj.

Lidja u kthye nga brigadieri dhe e pyeti se kur e kishte lënë për ta bërë provën e çimentimit Zef Mërtiri.

— Nuk e di, — tha brigadieri, — nuk më ka folur ndonjëherë për këtë. Ai në përgjithësi flet shumë pak...

— Duhet bërë një shpim prove, — tha Lidja.

— Pse, për «modën e vjetër» do të ngremë sondat ne?

— Jo, Bardh, kjo është brenda kërkesave teknike, madje shumë e zvarrësëm. Po ne kështu me një gur vrasim dy zogj... Po eja të shkojmë nga tanët, Bardh!

— X —

Betonimi ishte në të mbaruar. Bardhi dhe Lidja qëndronin krejt afër hinkave të mëdha.

— S'ma merr mendja se duhen më shumë se edhe tri maqina beton për pus, — tha Bardhi.

— Tri, katër...

— Me këtë mënyrë u shpejtua betonimi gjysmë për gjysmë, — foli Bardhi. — Kjo është diçka e madhe...

— Shojja inxhinierë, — thirri një punëtor, — kanë zënë të ngopen puset...

Lidja e përshëndeti me dorë.

Çdo gjë kishte shkuar si jo më mirë. Lidja u mbështet e lodhur dhe e kapitur pas kolonës së një UKS-je. Tani do të mbaronte betonimi dhe ajo do të shkonte të shtrihej nja dy orë krejt e qetë, pa telashe dhe mendime. Po vallë, a mund ta bënte këtë?

— Harrova të të them që na iku një punëtor, — tha Bardhi.

— Iku? Po pse?

— Nuk e di! Kishte ngulur këmbë të ikte dhe ata të kuadrit i dhanë librezën e punës.

— Kush është ai?

— Jashar Lica!

— Ai që kishte qenë në burg?

— Dora vetë!

— Nuk më pëlqente ai njeri.

Lidja dëgjonte Bardhin, po me sy ndiqte një «Zis» të ngarkuar me beton. Kamioni ju qas hinkës duke ecur praptas.

Karroceria u ngrit në erë dhe betoni zuri të rridhte dalëngadalë në hinkë. Tani pjesa më e madhe e punëtorëve ishin ulur lirshëm përdhe, të qetë, të kënaqur. Betonimi po mbaronte.

— Edhe një udhë, Bardh, edhe një udhë...

Tjetri e vështroi në fytyrë. Ja si ishte kjo vajzë! E veshur me xhup, me çizma të rënda dhe e ndotur me cirka betoni. Ai ja vështroi flokët e mbledhur top pas kokës dhe i hipi një dëshirë e pashpjegueshme t'ja prekte ata, t'ja hiqte cirkat e betonit nga fijet e arta. Vetëm kaq, vetëm për ta përkëdhelur për shpirtin e fortë që kishte ajo vajzë. Ja si ishte ajo vajzë...

— Mbaroi! — thirri Lidja e përkulur përgjysmë në hinkën e madhe. — Bardh, mbaroi! Të pastrohet vendi, të tjerët të pushojnë!

Një nga punëtorët lëshoi ujët me presion. Zorra e gjatë i lëpiu dhe i pastroi maqinat, pastaj kampatën e ndotur me llomishte betoni. Dikush zuri të këndonte:

Avni Rustemi

Lum ne që të kemi, aman, aman,

Lum ne që të kemi

Shqipnia mbarë.

Lidja i përsëriti pa vetëdije dy vargjet e fundit, e rrëmbyer nga kënga gjithë shpirt e punëtorit. Tek largohet i zunë sytë një malësor plak që sillej si i habitur rreth maqinerive të rënda. Vonë ju kujtua që ai ishte

ai plaku dukagjinas që kishte parë t'u printe aksionistëve.

* * *

Turni nuk kishte mbaruar akoma kur te «Zëri i masës» shpërthyen «fletërrufetë!» «Fletërrufe» të thjeshta, të shkrojtura mbi letra fletorësh, të shkrojtura shpejt e shpejt mbi arka, pas barakave, mbi gju.

Tetë copë për Lidjen dhe për betonistët dhe pothuaj po aq për brigadën e Llesh Kalisë, e cila, që ditën që kishin marrë inisiativën, nuk kishte mbetur një hap prapa. Në mes të të gjithave binte në sy një karton i madh, i bardhë; shkrojtur me germa të mëdha.

«Përshëndetje revolucionare shoqes Lidje dhe kolektivit të saj!»

«Përshëndetje revolucionare Llesh Kalisë!»

«Përshëndetje revolucionare minatorëve trima!»

«Përshëndetje...»

Lidja dukej e qetë, po thellë në shpirt ndjente kënaqësi të madhe. Ajo nuk i ndërronte me asgjë ato «fletërrufe» të thjeshta. Nuk e guduliste lavdia. Diçka tjetër... Ato tregonin se ajo qëndronte mirë, qëndronte me të dyja këmbët e ngulur në beton, në gjirin e fortë të punëtorëve. Tregonin se punëtorët e kishin kuptuar mirë, se ata e njihnin gjer në palcë, se ajo u përkiste atyre. Kjo e kënaqte Lidjen.

Edhe Xha Brahoja i kishte vënë një «fletërrufe». «Përshëndetje Inxhinierë Lidjes, shoqes dhe bijës sonë të dashur!...»

Kartoni i madh ishte nga sekretari i partisë së kantierit. Një «fletërrufe» e përbashkët për të dhe për Llesh Kalinë. Sekretari përshkruante me fjalë të gjalla ç'mund të bënte inisiativa e njeriut, kurajua, besimi. Gjithë «fletërrufeja» ishte një besim i patundur për të ardhmen.

Dikush e preku në sup.

— Xha Braho...

- Urime! Të lumtë, moj bijë...
 — Të falem nderit, xha Braho. Më vjen po aq mirë
 edhe për Llesh Kalinë.
 — Po, shumë mirë për Lleshin.
 — Po ç'do të ndodhi kur t'i vijë i dhëndrri?
 Brahim Jergucati tundi kokën.
 — Asgjë s'do të ndodhë, — tha. — Ja njoh zemrën
 Lleshit. Ai është një nga ata njerëzit që kanë shpirt
 fëmije nën krifën e luanit.
 Lidja i tregoi me gisht «fletërrufenë» e Zaimit. Era
 e kishte grisur, e kishte shkukur nga thumbat dhe po e
 vërtiste sa në një krah në një tjetër.
 — Ajo i përket erës, — foli i menduar xha Brahoja.
 — Erës... pëshpëriti Lidja.

KAPITULLI XXIII

Marsi solli me vete kohë të mirë dhe duhmën e pranverës. Mbi kantier zunë të dilnin ditë të bukura plot diell. Rrezet e arta hynin në çdo skutë, futeshin pjerrtas edhe në tunel. Të kish ënda t'i shihje mëngjezeve hijet e stërgjatura të sondave, hije që shtriheshin në gjithë luginën e Drinit. Ditë çuditërisht të nxehta, një pranverë e parakohshme. Toka lëshon avull të hirtë, të lehtë. Lugina e Drinit nuk oshëtinë më nga era; vetëm rrall e tek ndonjë gulsh ajri vjen e përplasat pas sondave pa fuqi, si e këputur më dysh...

Zef Mërtiri erdhi ditët e para të marsit. Erdhi me një pamje të qeshur, të shpenguar, si ai që vjen nga larg dhe është gati të hapi bisedë me të parin që takon në udhë. I solli Lidjes një tok fotografish dhe një palë këpucë me taka tmerrësisht të larta. Lidjes nuk i pëlqyen. S'kish veshur kurrë këpucë me taka aq të larta. Po atij nuk i tha gjë, se nuk desh t'ja prishte. U takuan me dëshirë me

njëri-tjetrin. Dukesh se të dy kishin menduar për shoqi-shoqin. Lidja mendonte për këpucët. T'i jepte të holla? Do ta fyente... Ai i foli aty në dhomën e saj për qytetin ku kishte qëndruar, për vendet nga kishte kaluar, për njerëzit. Fliste shumë bukur atë ditë, kështu Lidja nuk e kishte dëgjuar kurrë të fliste. Po për simpoziumin asnjë fjalë. U desh ta pyeste Lidja.

— Mendoj se qe pak a shumë i dobishëm, — u përgjegj Zefi, — pat koka të mëdha në atë simpozium. Po gjërat e rëndësishme askush nuk t'i nxjerr mbi tavolinë...

— Ç'gjë, për shembull? — nguli këmbë Lidja.

— Digat me hark, çimenton e plot të tjera. Ata i mbajnë thellë në dhe sekretet, si Harpagoni florinjte.

— Punë e madhe! — u përgjegj Lidja. — Ne po krijojmë teknikën tonë, teknologjinë tonë. Nuk ua kemi nevojën!

— Ashtu është, por andej ka gjëra të mëdha...

— Po t'i ndërtosh drejt raportet, këndeje nga ne ka edhe më të mëdha...

— Ata nuk e besojnë që ne do ta ndërtojmë këtë hidrocentral në një kohë kaq të shkurtër, — tha Zefi Mërtiri. — Me cilindo që flisja ma priste fjalën me një buzëqeshje ironike: Propagandë!

— E ti, çfarë u the?

— U thashë datën kur nisën punimet këtu dhe i këshillova të numërojnë vitet...

Pastaj heshtën të dy. Ai ishte ngritur dhe i kishte kthyer shpinën. Nga dritarja mbi udhë dukeshin tek lëviznin maqinat, njerëzit. Të gjithë shpejtojnë, të gjithë nguten... Dhe ai papritmas i tha se e donte... Fliste me rrëmbim, me hov, më shumë sikur po i drejtohej dikuj përjashta se sa Lidjes.

Ajo i shihte vetëm shpinën. Atë çast donte t'i shihte shumë fytyrën. Thonë se fytyra e atij që dashuron shpreh ndjenja që nuk të shlyhen nga kujtesa. Ajo donte t'ja shihte patjetër fytyrën. Njeriu nuk mund të

dëgjojë përherë fjalë të tilla, kjo është një dhuratë e rrallë për njeriun.

Ai fliste dhe fliste...

Ajo ndjente përrenjtë dimërorë që zbrisnin me furi nga malet, llokoçitjen e troftave nën tisin e hollë të akullit; ndjente lëmshe ortiqesh që mbledhin dhe shkatërrojnë borën e maleve, ndjente borën e butë mbi pushin vajzëror të faqeve të saja, që digjeshin si nga ethet. Pastaj pranvera, trumba zogjsh që shpërthejnë nëpër luginën e Drinit, cironkat që gëlojnë nëpër vaun e cekët, kundërmimin e vjollcave nëpër ferra. Ndjente natën e vakët, një qokth të trishtuar që të ngazëllen me atë britëm të çuditshme, ndjente trokun e kuajve. Të gjitha këto ishin të mjegullta, si të errëta, po për t'i parë i shifte. Ai u kthye dhe Lidja ndjeu se natyra u zhduk përpara syve të saj. Ajo e vështroi me ca sy çuditërisht të qetë, çuditërisht të thellë. Sa do të donte që ai të mos ishte kthyer! Do të kishte rendur edhe kaq kohë, do të kishte rendur...

Lidjes i vinte t'i thoshte të kthente shpinën edhe një herë, t'i fliste siç i flet diçkaje të largët, me zë të thellë, kumbonjës, me një zë që ndjell të ardhmen...

Asaj i vinte keq që nuk ishte e zonja t'i thoshte asnjë fjalë. Tani çdo gjë i dukej e rëndomtë, e zakonshme. (Të paktën në dashuri mos të hynin këto dy fjalë.) Pse u kthye ai? Pse? Mjegullimi ja mbuloi sytë si ajo bryma e ftohtë që vishte xhamat e dritareve kur zgjohej mëngjezeve. Oh, sa mirë që ai heshtte!

— Nuk e di, Zef, — tha vajza papritmas, — me këto gjëra nuk luhet. Unë nuk të premtoj asgjë, por edhe kundër teje nuk kam ndonjë gjë të madhe..

Ai doli pa folur.

Vajza u shtri mbi shtrat. Kujtime të fëminisë së hershme ju fanitën përpara syve. Një çupë e dobët me fustan të bardhë veror, një tufë flokësh të lidhur me një fjongo të kuqe pas shpinës... Ajo vajzë me fustan të bardhë i vjen përherë te koka kur është më ngushtë. Ja si qenka jeta...

Zef Mërtirit i erdhi inat kur pa sondën e parë në një pus të çimentuar. Ai mendonte se të vësh një sondë prove do të thotë të hedhish poshtë autoritetin e inxhinierit, të dyshosh për aftësinë e tij. Ai kishte një përulje si ndaj një shenjtori për mendjen krijuese të inxhinierit. Të gjitha veprimet e Zef Mërtirit, madje edhe sjellja e tij, përfshinin dhe ilustronin këto mendime. Ai dëshironte që të gjithë të mendonin kështu për inxhinierin, si për një qenje që krijon pa pushuar, si për një njeri që mund të nxjerrë vetëm punë të sakta nga duart. Kjo ishte një ndër arësyet që ai nuk ja hynte kurrë së panjohurës, asaj që nuk kishte shumë siguri, kjo ishte arësyeja që ai nuk u hyri puseve sekondare... Po ja që kishte nisur Lidja... «Po në fund të fundit ajo ishte inxhinierë e re, kishte të tjera mendime, nuk luftonte për sedrën e inxhinierit...»

Thellë në qenjen e Zef Mërtirit rronte mendimi për inxhinierët si për një kastë të veçantë njerëzish të paarritshëm, të paafroshëm.

Sonda e provës kishte bërë pesë metra shpim në vendin e çimentuar dhe ai nuk kishte si e hiqte. Pastaj për të kishte dhënë urdhër Lidja. Që ditën kur i shfaqti dashurinë ai ishte bërë më i matur me të, kishte fituar edhe ca të drejta. Ajo as kishte pranuar, as kishte qenë kundra. Zef Mërtiri kapej fort pas kësaj të fundit. Ai u skuq gjer në veshë një ditë kur Lidja e pa rastësisht me Palush Stajkën dhe u ngut të jepte shpjegime. Herë të tjera i kishte ndërhyrë Lidjes në punët e saja vetjake, ishte interesuar për të, madje e kundërshtoi për pjesëmarrjen në teatër.

Lidja kishte vënë re se të tjerëve nuk u pëlqente ky afrim i saj me Zef Mërtirin. Kjo rridhte ngaqë inxhinierin nuk e donin në kantier. Lidja nuk zemërohej me Zefin për afërsinë që tregonte, sepse ajo vetë kishte qejf të ndodhte kështu. Donte ta njihte nga afër. Nuk zemërohej me Zef Mërtirin, po tani nuk i linte më të kalonte asgjë që i dukej e padrejtë. Që kur u kthye ai nga jashtë shtetit ata të dy grindeshin vazhdimisht, grindeshin me fjalë të qeta, aspak ofenduese, një grindje

«me kulturë», që në një gjuhë më të përgjithshme merr emrin mospajtim mendimesh.

Zef Mërtiri as që ja përmendi novacionin në betonim; kalonte andej çdo ditë, takonte edhe në kohë betonimi dhe vështronte rreth si për diçka pa rëndësi. Po çështjen e pusit sekondar nuk ja la pa thënë. Kjo ndodhi pikërisht ditën që Lidja e shtroi çështjen e hapjes së sekondarëve në seri. Gjithë këshilli teknik që me të dhe e përkrahu nxehtësisht. Zef Mërtiri që i vetmi që nuk nxori zë. Jashtë ai u grind keq me Lidjen.

— Ti nuk duhet ta bëje këtë, — i tha ai, — nuk duhet ta kishe bërë. Kjo më bie mua si shuplakë surratit...

Lidja ju shkreh si mundi. E quajti mburravec, njeri me sedër të kotë, njeri që s'kuptonte nga shkon jeta. Ç'nuk e quajti! Së fundi i tha që aq poshtë dhe shtrembër mendonte ai, sa i vinte keq për të. Pastaj ajo iku me një ndjenjë të thellë zemërimi kundër tij.

Pikërisht atë ditë kërkoi leje dhe u nis për në shtëpi. Qe një ditë e keqe, koha ishte prishur prapë, kishte dy ditë që po binte borë.

Lidja vështronte kantierin nga sedilja e «Skodës» dhe nuk ndjehej e qetë. Po të mos i vinte turp nga shoferi do të kishte zbritur.

KAPITULLI XXIV

Në tunel kishin nisur të dëgjoheshin të goditurat anembanë. Llesh Kalia vinte veshin në shkëmb dhe buzëqeshte.

Dëgjohen, dëgjohen!

Lleshi bënte llogari me hamendje. Trashësia e gurit, që ndante dy frontet e punës, nuk duhet të ishte më e madhe se katër metra. Llesh Kalia kishte futur në

shkëmb një barominë tre metra të gjatë, po ajo s'kishte mundur të arrinte matanë. Vrima e hëngri të gjithë hekurin.

Llesh Kalia tërhoqte barominën dhe vinte veshin në vrimë. Që përtej vinte një zhurmë e mbytur, si një gjëmim i largët. Brigadieri kthehej nga shokët dhe i ftonte të dëgjonin edhe ata.

Minatorët afroheshin njëri pas tjetrit dhe vinin veshin në vrimë. Dëgjohej për besë, dëgjohej!

Llesh Kalisë i zinte syri të dhëndrrin dhe vrenjtej. I kujtonte të bijën ai njeri. Si do të ishte ajo tani? I kishte prerë gërshetat? A i bëhej prapë ajo gropëza e bukur në faqe kur qeshte? Po a qeshte ajo vallë?

Përpara se të vinte i dhëndrri, në tunel kishte arrihur sekretari i partisë së kantierit.

— Dëgjo, Llesh, — kishte thënë ai, — t'i lëmë pas krahëve ç'të kanë thënë e ç'u ke thënë të tjerëve për tët dhëndërr. Ai ka ardhur. Ç'të bëjmë me të? Si ta merr mendja?

Dhe Lleshi flakë për flakë: Puna asht e shtetit, ai mund të punojë ku t'jau marrë mendja.

— Ne nuk duam t'i lëndojmë njerëzit, Llesh, duam t'i bindim ata, për të parë të drejtën.

— Pse s'thua qi ta ka qejfi boll me ma prue në brigadë, shoku sekretar?

— Po, qejfi ma ka shumë ta sjell aty, sepse mendoj që duke u njohur së afri do t'i kapërceni meritë e vjetra?

Llesh Kalia tundi kokën.

— Atëhere ta sjellim?

— Për mua njisoj asht tash, — i qe përgjegjur brigadieri.

Dhe ai erdhi. Po ndodhi diçka e çuditshme. Punëtorët e pritën ftohtë. Kjo ndoshta sepse duke e njohur ndershmërinë e panjollësor të brigadierit të tyre, ata ja vinin fajin vetëm djaloshit. Kur e pa të dhëndrrin keq, te Llesh Kalia nxori krye prapë malësori, zakonet fisnike, mikpritja. Ai ju qas të dhëndrrit dhe i tregoi punën me shumë njerëzi. Ndërsa përbrenda i vlonte

deti me tallaze: «Ku ma ka çu vajzën?» «Ku e kam Gjelinën, ku?»

Llesh Kalia e varrosi thellë përbrenda shpirtit zemërimin, mllëfin dhe urrejtjen për atë njeri. Tani ai nuk kishte më përpara syve atë që i kishte rrëmbyer vajzën, po një punëtor, një minator me kaskë e vare në dorë.

Lleshi shtynte andej barominën. Herë e shtynte dhe e përdridhte me duar, herë i binte me çekanin e rëndë. Por një çast u duk sikur hekuri i gjatë nuk do të shkonte në asnjë mënyrë më tej, më pas ai u rras lehtë, sikur të përshkonte boshllëk.

— E përshkoi! — bërtiti brigadieri. — E përshkoi pasha bukën!

Ai bëri ta tërhiqte barominën, po nuk qe i zoti ta shqiste nga vrima. Pastaj ju duk sikur ajo kërkonte t'i ikte nga duart në anë të kundërt.

«Aha, ata të matanshmit! — mendoi:

— Muleni, burra se u koritëm, — bërtiti Llesh Kalia.

E rrokën edhe plot të tjerë hekurin dhe ja dolën ta heqin nga vrima. Llesh Kalia nga vrulli u përplas ballë për ballë me dhëndrrin e vet. Të dy ulën sytë përdhe.

— O Llesh Kalia, bre!

Zëri vinte si fishkëllimë lokomotive nga ana tjetër e tunelit.

— O, ç'asht zani, bre!

— O, duem me e djegë krejt sot, bre! O, u bashku tuneli, bre.

— O, për hajr na qoftë, bre! — ja pat Lleshi.

Frani erdhi me një frymë.

— Birat janë mbushë, — thirri fort për të mposhtur zhurmen. Të nap shenjën për ndezje..?

— Nepe qi ç'ke me te!

Punëtorët dolën me yrap nga tuneli. Edhe matanë u bë qetësi! Pastaj heshtjen e prishi një gjëmim i fortë. A plasën, a nuk plasën minat, dhe punëtorët u derdhën

si të marrosur drejt e në tunel. Nuk pyeti asnjëri për gazra, për tym e rrezik.

Plasja kishte shtyrë më thellë shkëmbin, po nuk kishte bërë ndonjë gjë të madhe. Vinin pak dinamit nga frika se mos dëmtonin pjesët e tjera të tunelit.

Minatorët ju përveshën prapë punës. Në hyrje tuneli u mbush me punëtorë të ndryshëm. Lajmi ishte hapur me shpejtësi vetëtime. Inxhinier Ilia hyri me vrap në tunel. Kishte qenë në drejtori. Vështroi vrimën, pastaj u puth tri herë me Llesh Kalinë.

— Gëzuar, o Llesh!

— Gëzuar, shoku Ilia! — u përgjegj dibrani.

— S'ka gëzuar «në të thatë», — i ngacmoi Fran mirditasi.

— Punë e kollajt, klubin e kemi mbas dere, — tha Lleshi.

Orët iknin. Asnjëri nuk e kishte mendjen te orët. Llesh Kalia mbushte vrimat me eksploziv pastaj thërriste fort: Gati! Mina-a-a!»

Gjëmimet vazhdonin me ndërprerje të shkurtëra, sa të hapeshin vrimat e reja. Ishin bërë pesë plasje gjer atëherë.

Turni po mbaronte. Llesh Kalisë nuk ja kishte marr mendja që do të zgjaste kaq shumë. Ndërkaq grykën e tunelit e kishin zënë punëtorët e turnit tjetër.

Lleshi bëri sikur nuk i pa. Edhe të tjerë po ashtu. Një marrëveshje e çuditshme, solidare. .

Brigadieri i turnit të dytë ju qas Llesh Kalisë dhe i kërkoi t'i dorëzonte punën.

Lleshi s'i dha përgjegje. Vazhonte të tijën, rraste nëpër vrima kallëpët e dinamitit.

— Ej, merr vesh ti, Llesh Kalia? Dorëzoma punën!

— Gati! Mina-a-a! — thirri sa mundi Lleshi në vend të përgjegjes.

Rendje nëpër tunel, pshtjellim.

— Kujdes, Llesh! — thirri Sandër Delia, — tash nuk i dihet së keqes, asht ba rrëmujë!

Një shpërthim i fortë tronditi vendin rreth e rrotull dhe një valë ajri doli me forcë nga tuneli.

Pas plasjes të dy brigadat nisën të ziheshin njëra me tjetrën.

Llesh Kalia bënte sikur jepte përgjegje, po në të vërtetë rrëmonte me qysqi copat e shkëmbinjve që ishin tronditur nga plasja. Pas brigadës së parë bënte zhurmë dhe grindej turni tjetër.

Llesh Kalia të vetën: rrëmonte me qysqi...

— Fran! Sandër! Mark! — bërtiti brigadieri, — ecni këndej.

Të katër zunë të shtynin me qysqi një copë të madhe shkëmbi, përmes së cilës kishte përshkuar Lleshi barominën. Shkëmbi lëvizte, por nuk donte të shkulej që andej. Hekura të tjerë u radhitën përbri atyre të katërve.

— Rueni duert, — thirri Fran mirditasi.

Shkëmbi u shkoq, lëvizi, pastaj u shemb në anë të kundërt.

— E jona! E jona! He na lumshin krahët! — dha kushtrim Llesh Kalia.

Ai pa dritë në anën e përtejme, më shumë dritë se këndej, sado që gjithë tuneli ndriçohet njëllëj.

— Nji hollak nga tanët këtu! — kërkoi ai. Të vijë këtu nji truphollë!

Sandër Delia kapi për krahu një minator të ri. Lleshi nuk priti që ai të zvarrisej në vrimë, po e ngriti pezull dhe e rrsi si ndonjë predhë topi në vrimën e hapur.

Djaloshit i humbi koka, supet, trupi, ai luajti nja dy herë këmbët pastaj u zhduk i tëri matanë.

— Jona! E jona! — bërtitën minatorët.

Të gjithë zunë të përqafoheshin me njëri-tjetrin, të puthen fort, të shtrengohen gjoks për gjoks.

Llesh Kalia rrokte e puthej me kë i delte përpara. Një simfoni të puthurash. U puth me Fran mirditasin, me Sandër Delinë, me Ilian, së fundi me... dhëndrrin. Vetëm kur i shqiti krahët nga djaloshi e kuptoi kë

kishte puthur. Po qe shumë vonë tani më. Lleshit i ranë krahët si të këputura poshtë. Tjetri qeshte nën buzë...

Llesh Kalia dorëzoi turnin.

— Ta paça borxh, o dibran, — i tha i zemëruar brigadieri tjetër. — Mos u tremb, se kemi me u takue prapë, Nuk mbarojnë tunelet nëpër Shqipni, jo! Ehu, se ka për të pasë...

— Ti mos u zemro, o Fiqiri! Me ba me ta pasë lëshue turnin, kishin me më coptue shokët. Folë të drejtën, si kishe me veprue ti?

Turni i parë doli gjithë gëzim nga tuneli. Po aty në të dalë të shtregut, Lleshi hoq kaskën, zhveshi xhupin dhe qëndroi në shesh si një ishull mes minatorësh.

— Sonte shkoi vonë, — tha ai, — asnjeri nga të jashtmit nuk ka ku vete. Do të rregullohemi si të rregullohemi!

— Nuk e lot gja, — u përgjegj Sandri.

— Hajt, pra! N'kapanon dhe ta tundim si duhet, — thirri Fran mirditasi.

Njerëzit thërrisnin, gëzoheshin, këndonin. Ishte fitorja më e madhe në gjithë hidrocentralin.

• • •

Punëtorët u rrasën si sardelet në dhomën e Lesh Kalisë. Për çdo çast vinin të tjerë: sondista, mekanikë, motorista. Erdhi Bardhi «sa një vinç». I pëlqen të shtyjë të tjerët, të bëjë zhurmë, të rraset si fishek në grumbullin e përgjithshëm.

— Ej Bardh, a kish me të xanë ajo bira që hapëm na?

— S'pyet Bardhi. Tamam buldozer, mos me e xanë e zgjanon!

Të qeshura, britma.

— Ngadalë, more vinç!

— E ke lëshu pa duer!

Erdhën sekretari i partisë i sektorit, sekretari i partisë i kantierit, xha Brahoja. Inxhinier Ilia kishte futur kokën në dritaren e hapur dhe buzëqeshte që jashtë. Te dritarja qëndronin plot të tjerë. Erdhi edhe Lidja.

Nata bën punën e vet, rreth e rrotull errësirë, vetëm përçark digës dhe tunelit pellgje drite që luhaten si deti me dallgë. Lidjen e pritën me brohori. Nuk dihet si u ep ai det njerëzish, vetëm se Lidja e pa rrugën të çelur gjer në mes të dhomës.

U ngrit Llesh Kalia.

— Dollia e parë i takon inxhinierit tonë, — tha,
— Ilias...

— Ilia brenda! — bërtitën. — Brenda Ilia!

Po nga të hynte?

I zgjatën duart Ilias dhe e tërhoqën përmes dritares. Tek e shihte inxhinierin të zgjatej, t'i luante duart e këmbët, të bënte shaka me të tjerët, Lidja mendonte për Zefin. «A do ta bënte këtë Zef Mërtiri? A do të hynte këtu ai përmes dritares?»

Ilia ngriti dollinë.

— Për partinë! Për shokun Enver! Për tunelin tonë, djersën tonë!

Lidja vuri në buzë rakinë.

— Llesh! Sonte mund të të padisin për anarki; e ke bërë gjithë kantierin lesh e li, — e ngacmoi sekretari i partisë së kantierit.

— Sonte le të më padisin për ç'ka të duen, — tha Lleshi, — po ku e kam Sandër Delinë?

— Këtu jam!

— Toke me mue, Sandër!

I futën krahun njëri-tjetrit dhe zunë të pinin ashtu të zënë për krahun. Rakia u rridhte më shumë nëpër mjekër, se sa në gurmaz.

— Ashtu, ashtu, minator...

Këto fjalë vlenin sa për një fletëlavdërimi për San-

dër Delinë. Kur të quan Llesh Kalia «minator», ta dish se diç je...

Në mes të zhurmës dhe të qeshurave u ngrit një këngë. Në fillim ngadalë, e zbetë, pastaj me shumë zjarr:

Hej burr^a i motit

Trim' i Kastriotit

O Enver, o trimi jonë...

Baraka buçiste nga njëqind zëra. Një kor i çuditshëm, një kor pa përvojë, po plot shpirt.

Një hije u qas te dritarja. Shefi i llogarisë, Zaimi... S'paska vajtur në qytet...

— O, shoku Zaim! Urdhno, urdhno brenda!

— Ju lutem! Ka shumë kallaballëk. Ç'bëhet këtu?

Brenda pushoi zhurma. Minatorët zunë gjithë dritaren.

— Hej, Zaim! Shoku shef! Eja brenda!

— Jo, ju lutem, kam punë!

I zgjatën shishen e rakisë. Shefi i llogarisë luajti dorën shpejt e shpejt.

— Jo, nuk pi, — tha ai.

— Pi! Thirri Frani. Festeje me ne hapjen e tunelit!

— U hap? Shumë mirë! Ç'do gjë në rregull, sipas planit!

— Çfarë plani, more! Thuaj më mirë nja tri javë përpara afatit, — bërtiti Ili.

— Shumë mirë, shumë mirë. Ju lutem... Nuk pi raki. Ai u zhdok ngadalë, ngadalë, si hije.

— Çdo gjë në rregull, sipas planit, — përsëriti dikush fjalët e Zaimit.

Një det të qeshurash pas atyre fjalëve.

— Ej, shokë! Menca ka mbyllur, — foli njëri.

— Në djall të vejë, do të bëjmë edhe pa të.

— Jo, — tha xha Brahoja, — ta zgjojmë kuzhinierin, do të na fali sonte...

— Posi, ta zgjojmë kuzhinierin!

Dolën një nga një prej barakës. Vetëm përjashta kuptuan sa shumë kishin qenë.

— Kur e ke turnin nesër, xha Braho? — pyeti Lidja kur po ndaheshin.

— Paradreke e kam. Mos ke punë me mua?

— Kam lënë një mbledhje me gratë në katër pasdreke. Do të vij në edhe shokë nga komiteti i partisë dhe nga drejtorja. A mund të vish?

— Patjetër që do të vij. Përse do ta bëni mbledhjen?

— Kryesisht për edukimin... Pastaj çështje organizative dhe përpilimi i një plani për aktivizimin e grave në jetën shoqërore.

— Po ç'kishim andej nga Vlora? Si i ke prindërit?

— Vlora ndryshon përditë. Aq shpejt ndryshon, sa që edhe ai që s'e nje mirë qytetin e dallon. Përfundoi fabrika e sodës, u hodhën themelet për një fabrikë të re. Prindërit mirë i kisha, xha Braho. Ato tri ditë që qëndrova atje, hëngra ajkën e qumështit, me nënën në këmbë pas krahëve.

— Ah, nënat...

— I dukësha më e rritur, më e fortë, më e ashpër... Heshtën.

Xha Brahoja e përcolli vajzën gjer përpara dhomës së vet.

— Falemnderit, xha Braho!

— Falemnderit nga ti, — u përgjegj kryesondisti, — bëre shumë mirë që erdhe te minatorët.

— Atëherë në katër pasdreke...

— Po, natën e mirë.

...

Sandri ndoqi ata që u drejtuan për në menci. Ndjen-te uri të madhe. Kishte punuar gjithë kohën pa pushuar. Tek shkante pas minatorëve, vështronte me çudi që nuk mund të ndahej nga ata. Nuk mund të ecte më në radhë të kundërt, as mund të punonte vetëm për hesap të

vet. Tani ndjente gëzimin e punës, i hidhej shpirti njësoj si të tjerëve. Sandri jetoi disa çaste përmallimi kur bërtiti Lleshi te vrima e tunelit. Ishte çasti kur fliste puna, puna e sa muajve. Këtë gjë ai nuk e kishte ndjerë në digë, atë kohë ai akoma ishte nën përshtypjen e zemërimeve të veta, nën peshën e hidhërimit që u nda nga maqina.

Po gëzimin e punës ai e kishte ndjerë edhe përpara, ja njihte shijën. Ndoshta edhe nga diçka e thjeshtë edhe nga diçka pa rëndësi... Një gëzim që shpërthente kur motori jepte e merrte për bukuri, kur i merrte kthesat lehtë, kur futej mes për mes qytetit me shpejtësi dhe shpërndante të trembura çiftet e vajzave, e i tureshin ato me të shara, apo ndërsa merrte pyjet e Krrabit në të ngrysur e pishat e larta haheshin me njëra-tjetrën për madhështi; gëzime kishte ndjerë edhe tek kalonte gropat me llucë, balestrat kërcisnin e maqina kapërcente udhën e vështirë. Zemra i hidhej kur qëndronte nëpër qendra të vogla, pinte një kafe në banak, pastaj nisej me një turmë laramane fëmijësh që e ndiqnin me vrap, kur hante drekë në ndonjë qoshe dhe i thërrisnin kamrierët, apo kur i binte mes për mes me fodullëk qendrës së vogël për të çmpirë këmbët...

Tani gëzimi i tij ndryshonte. Atë kohë kjo ndjenjë për të kishte qenë shumë personale, i përkiste vetëm atij. Kurse tani ai ndjente me një mënyrë të përbashkët me të tjerët, gëzohej si të gjithë, në mes të të gjithëve.

Atij i kujtohet papritmas një ditë janari me borë dhe me akull. Rruga për Fush Arrës është prerë. Po aty duhet vajtur patjetër. Varg «Skodash»... Karvan në shkretëtirën e bardhë... Sandër Delia vjen i pesti në radhën e maqinave. Udhëheq një ujk i vjetër, një shofer me nam. Dëborë ngrihet përgje-përgje në dy anët e udhës, akulli rrëshqet, nga Qafa e Malit frynë veriu si i tërbuar... Karvani i maqinave zvarriset mengadalë si ndonjë gjarpër drejt Veriut. Mbetet një, ndalon gjithë kolona. Duhet ndihmuar shoku. Dëborë, ngricë. Zinxhirët mezi mbajnë rrotat të mos shkasin. Diku prishet ndo-

një «Skodë», diku një maqinë tjetër shpëton për një qime pa rënë në hon. Dhe erë, erë e çmendur që përshkon edhe xhamet e puthitura fort. Po u hap dera nuk je i zoti ta mbyllësh, po u prish diçka shumë e thjeshtë nuk mund ta ndreqësh me duart e ngrira. Duhet ngrohur duart. Ah, ai konjaku... Po ashtu, duke luftuar me ngricën, me erën, me vetëveten, kolona arrin në Fushë Arrës. Maqinat i qasën njëra-tjetrës. Hapen dyert e tyre njëra pas tjetrës. Dhe Sandri kërcen përdehe në dëborë. Ndoshta kjo është lumturia. Një lumturi e përbashkët, diçka që ai e ndan me të tjerët, me shokët e vet.

...Minatorët trokasin në dhomën ngjitur me menden. Trokasin lehtë.

Asnjë përgjegje.

— Është në gjumë të parë, — thotë dikush, — bjerini më fort!

Si përgjegje çelet menjëherë dera e mencës.

— Hyni, o hamës të pangopur, — thërret kuzhinieri, — po ju prisja!

— Urra! Për kapon tonë!

— Lërinin urratë kur të shihni pjatat. Vetëm makaronat ka. Jemi vonë.

Minatorët thartojnë buzët.

— Ne sonte jemi për mish dashi dhe bakllava...

— Mbase gjenden edhe nga dy vezë syze sipër tyre?

— Edhe nga një tas të mirë me kos, — buzëqesh kuzhinieri.

— Urrah për kapon tonë!

Në digë punohej me ngulm. Pusi sekondar ishte gelur përpara dy ditësh dhe betonuar shpejt e shpejt. Puse të tjera sekondare po hapeshin në seri krahas kryesoreve, ndërsa andej nga çimentimi, sonda e provës kishte arritur thellësinë e nevojshme. Hidrocentrali përballonte me guxim sulmin e gazetarëve, të fotoreporterëve dhe të korrespondetëve të ndryshëm që kishin vërshuar për të shkrojtur për sukseset e atyre ditëve të fundit. Lidja po merrej me një sondë, që nuk ecte siç duhej, kur u dha Zef Mërtiri. Ata qenë parë tamam atë çast tek po zbriste Lidja nga autobusi që po e sillte nga Vlora. Zefi po nisej në drejtim të kundërt. Nuk patën rast të flisnin, se maqina e Zef Mërtirit u nis menjëherë. Atë çast të dy qenë të kënaqur që ndodhi kështu. Nuk kishin çfarë t'i flisnin njëri-tjetrit. Ai i mbante mëri që iku pa e lajmëruar dhe nuk mund të harronte bisedën e fundit me të. Ndërsa ajo ishte munduar ta harronte atje në Vlorë. Po nuk kishte qenë e mundur. Thellë në shpirt ajo e donte atë, po donte një Zef Mërtir të cilit i duheshin hequr shumë gjëra për ta bërë njeri.

Thonë se dashuria është qorre, po Lidjes po i ndodhte e kundërta. I kishte hapur sytë edhe më tepër... I kishte hapur aq shumë, saqë kishte arritur në një farë pedantizmi. Nuk i shpëtonte asgjë nga Zef Mërtiri. Ajo vinte re edhe si fliste, edhe si qeshte, edhe si ndizte cigaren dhe lëshonte gulshat e tymit. E kuptonte që kjo ishte marrëzi, po hec e ndaloje! Ajo sikur vërente pa vetëdije. E qortonte veten për këtë. Po sikur të tjerët ta vështronin dhe atë po me të njëjtin sy? A nuk do t'i gjenin një thes me të meta?

Zef Mërtiri e pyeti Lidjen nëse do ta bënin provën e çimentimit.

— Pse më pyet mua? Ajo punë të përket ty, — tha Lidja, — mund ta bëjsh kur të duash.

— Po meqë ti e nise...

— Mirë, e bëjmë menjëherë nëse është gati.

— Gati është.

— Do të desha të ishte dhe Zaimi, — tha Lidja. (Ajo ja kishte shpjeguar Zefit, posa erdhi nga jashtë, qëndrimin e shefit të llogarisë).

— Ta thërresim menjëherë! Ej, ti! Shko e thirr Zaimin, shefin e llogarisë. I thuaj se e dua unë.

«I thuaj se e dua unë! ushtoi në mendjen e Lidjes.»

Ajo «unë», për vajzën niste me tre «U» të mëdha.

— Sondisti ka punë, — kundërshtoi Lidja.

— E, e! Zëvendësoje!

Lidja nuk i kundërshtoi më tej. Dhe ata të dy kaluan në sektorin e çimentimit.

Pusi që gati, tubi i ujit aty pranë. Nuk duhej veçse të ktheje çelësin dhe ta fusje me presion aty brenda. Rreth e rrotull pusit plot punëtorë, ndër të tjerë edhe xha Brahoja me ndihmësin e vet.

Erdhi Zaimi me të shpejtë.

— Më thirrët, shoku Zef?

— Do të bëjmë provën e çimentimit...

— Mirëpo, ju lutem, ç'hyjë unë në provën e çimentimit?

— Qëndro këtu edhe mos na pengo me fjalë tani!

— A ta lëshojmë ujët? — pyeti Zefi Lidjen.

— Po! — u përgjegj ajo, pa kuptuar përse e pyeste atë.

— Çfarë presioni? — pyeti pompisti.

Zefi u kthye nga Lidja.

— Normal, — foli mekanikisht Lidja.

Samiu, që kishte ardhur të ndihmonte nga qejfi aty, ngriti tubin për ta futur në vrimën e pusit. Po presioni i ujit ja ndërroi drejtimin tubit dhe ujët spërkati pak Zef Mërtirin.

— Budalla! — e shau ai Samiun, — ku e ke mendjen?

Samiu nuk bëri zë, po xha Brahoja ju qas inxhinierit dhe i tha se nuk duhej t'i shante punëtorët.

Tjetri bëri sikur nuk dëgjoi.

— Me ju po flas, — foli i vendosur kryesondisti, — duhet t'i kërkonti të falur.

— E po le të më falë atëhere, — tha ai me mos-përfillje.

«E po le të më falë! — ushtoi në mendjen e Lidjes».

Pas pak nga gryka e pusit zu të delte ujët gulshagulsha. Pusi qe mbushur.

— Nuk thith më, — i tha pompisti Zefit.

Inxhinieri i ktheu krahët duke bërë me kokë nga Lidja. Vajza u drodh. E kuptoi shumë mirë Zef Mërtirin, kuptoi çdo gjë që ndjente ai, që mendonte ai. Kuptoi që ai me këtë mënyrë donte t'u tregonte të tjerëve se atë punë e kishte nisur Lidja, se ai nuk do ta kishte bërë.

— Presioni në maksimum, — bërtiti Lidja. e

Shefi i llogarisë kërceu përpjetë i trembur.

E tamponuan grykën e pusit.

Dhe u pa që pusi nuk mirrte më ujë sado që ta rrisnin presionin. Çimentimi ishte bërë me sukses.

— E shikon, shoku Zaim? — thirri Lidja. — E shikon? Çimentoja nuk shkuaka kot dhe ne e dimë ç'ngjet atje poshtë.

Gjithë zemërimin që kishte ndaj Zef Mërtirit e shkarkoi padashur mbi Zaimin, pastaj ajo u kthye nga pompisti:

— Ndall! — i thirri.

I ktheu krahët kampatës dhe u drejtua nga sektori i vet.

Zef Mërtiri e kishte treguar edhe një herë fytyrën e vet. Dhe gjoja e donte...

Ai donte vetëveten më shumë se këdo, sedrën e vet... Lidja nuk e kuptonte atë çast pse e përkëdhelnin në drejtorinë e ndërmarrjes dhe në qendër. Si inxhinier, Zef Mërtiri e kishte të metë të madhe mungesën e iniciativës, në shumicën e rasteve. Ç'kishte bërë ai? Me se mund të mburrej? Apo për ato veprat e «mëdha teorike», për të cilat mendonte se ishte krijuar? Po ajo puna shkencore? Lidja nuk ja kishte parë kurrë... Lidja zu të dyshonte gjer në sinqeritetin e dashurisë së tij. Po ai edhe mund ta donte, por... sipas mënyrës së tij.

KAPITULLI XXVI

Zaimi bridhte i shqetësuar nëpër dhomë. E ndara e vogël e bënte nervoz. Nuk kishte ku të vërtitej, nga dritarja gjer te dera nuk ishin as tri hapa. Zaimi vërtitej... Shtrati i mbuluar me batanije, dritarja gjithë pluhur, në tavan merimanga... Të gjitha këto i vështronte me sy të ftohtë. Dhjetëra herë kishte thënë me vete t'i jepte një dorë dhomës, por asnjëherë nuk e kishte bërë. Dhoma bënte përjashtim nga rregulli i përsosur i tij.

Bridhte dhe mendjen e kishte te llogaritë, te materialet, te borderotë e pagave.

Merimanga e shqetësonte. Kërkoj diçka ta prishte rrjetën. Po në shtrat ai nuk hipte edhe sikur ta vrisnin. Që aty nuk e arrinte. Lëvizti dorën poshtë me ngathtësi dhe e la atë punë. Doli jashtë. E mbylli derën dy herë me çelës dhe u nis nga zyra. Po errej. Orari zyrtar kishte mbaruar me kohë.

Zaimi nuk ndjehej i qetë pa vajtur edhe një herë në zyrë. Frika që ndjente përherë për materialet që kishte në ngarkim, për llogarinë, për dhjetëra probleme që kishte mbi shpinë, i zhdukej vetëm në zyrë mes regjistrave dhe dokumentave që i mbante për bukuri. Jashtë zyrës i dukej vetja lakuriq mes katër udhëve të fatit, sikur ishte fajtor dhe s'kishte me se të shfajësohej. Po atje brenda e ndjente veten në elementin e vet. Do të vinin për revizionim? Mirë se të vinin! «Ç'dëshironi, shokë? Regjistrin e materialeve? Ja «Hyrjet dhe daljet». Apo doni librin e pagave? Urdhëroni, ju lutem!»

Kthen çelësin e dritës. Zyra ishte siç e kishte lënë. Lapsat e mprehura me kujdes rrinin në radhë si ushtarë të gatshëm, letër thithsja në qoshe, po aty dhe shishja me zamkë.

U ul në karrige. Shqetësimi që i kalonte sa herë ulej në këtë vend nuk po i hiqej. «Ç'kam kështu? pyeti veten Zaimi».

«Dil një herë në ajër të pastër, Zaim, dil jashtë

mureve. Nuk të vret lopata, jo», — e kishte këshilluar xha Brahoja.

Ai i qe ankuar një ditë në klub kryesondistit se nuk ndjehej mirë. Tani i ardhën në mendje fjalët e tij. Lopata! Ai kishte një frikë të fshehtë nga puna e krahut. I dukej se çdo gjë do të mirrte fund me të zënë lopatën. Ai habitej qysh e përballonin punëtorët punën e krahut. Janë mësuar që në rini. Po ta zë unë tani me dorë, më këput më dyshë!» Përpiqej shumë në zyrë, jo vetëm se qe një nëpunës i rregullt, por edhe nga «frika e lopatës».

Shefi i llogarisë mendonte dhe ndjente si çdo njeri. E kuptonte për bukuri gjendjen, por s'arrinte t'i përshtatej asaj. Koha ecte revan, Zaimi kishte mbetur ai që kishte qenë shumë vjet përpara: një nëpunës me syza, me mansheta të zeza, me një sjellje tepër të matur, me mallin e kallamarit të mbushur dhe të regjistrave stivë! E ndjente fare bukur që diçka nuk shkonte në jetën e vet, në marrëdhënjet me njerëzit. E ndjente që ishte si një notë e huaj në një pentagram të mbushur, një notë që nuk përputhej me akordin. Mospërputhjen e kishte shkaktuar vetë me jetën e mbyllur që bënte. E çuditshme ishte se, kur donte të përqafonte ndonjë grimcë «të reje», gjente ca mënyra dhe veprime veçan të tjerëve, që e tregonin të ngathët, e bënin qesharak. Dhe kjo sepse shefi i llogarisë nuk guxonte t'i kush-tohej tërësisht së resë, donte «të ngjyente vetëm gishtin e vogël» në të. Vrulli, hovet, inisiativat e tronditnin, i prishnin qetësinë. Ai ishte për traditën, për të zakonshmen. Ai i vuri «Fletërrufenë» Lleshit për t'i mbushur mendjen vetes se po ecte me kohën. Po nuk e besoi askush, përkundrazi e dënuan. Gjithë kjo nga «gishti i vogël» që donte të ngjyente në vrullin e jetës.

«Mos duhet të dal me të vërtetë nga këto mure?» pyeti veten ai.

Asnjëherë nuk kishte qëndruar kështu pa punë në zyrë. Asnjëherë nuk kishte qenë kaq i ngathët aty në karrige. Më përpara, me të hyrë në zyrë, duart i lëviz-

nin vetë: shifra, vija të kuqe, maqina llogaritëse që kërciste, firma. Firma, një mrekulli më vete. Kur nënshkruante i ngjante atyre kopjuesve të papiruseve në lashtësi. Aq kujdes i vinte firmës. Zgjati dorën të mirrte një regjistër. Po e ktheu prapë. Nuk i bëhej të punonte. Ju kujtua se paradreke qe zënë me ata të planit. Natyrisht, jo për ndonjë gjë të madhe. Kërkonin të spostonin ca shuma për nevoja të paparashikuara. Zaimi nuk tundej. Shefi i planit mezi mbante veten. «Po ji një çikë elastik, shoku Zaim! Tërhiq pak nga ndërmarra, nga nevojat e punës. Janë elastike edhe ligjet, kur është për të mirën e përgjithshme. Tërhiq pak.» Zaimi i kishte nxjerrë një urdhëresë duke i thënë: Ja ligji! Po ta tërheq, grisjet!» Pastaj qe ulur shumë i kënaqur në vendin e vet. Tjetri kishte murmuritur dhe kishte dalë gjithë inat.

Tani rrinte dhe mendonte nëse mund të bëhej siç kërkonin ata të planit. «Ç'të keqe ka, kur është në dobi të punës? Mjafton të jesh i ndershëm...»

Sa për ndershmëri, atë nuk mund të mos e çmoje. I ndershëm gjer në thembër të këmbës qe Zaimi.

— Natën e mirë, shoku shef!

Zaimi u hodh nga karrigja i trembur.

— Natën e mirë! — i tha atij që po kalonte nën dritare.

Pastaj një hije zuri dritaren. Nuk e dalloj kush qe, po njeriu u largua nga dritarja dhe hapat e tij u dëgjuan në korridor. Në zyrë hyri Palush Stajka.

— Mirë mbrëma, shoku shef!

— Mirë mbrëma!

— Ja paske ndjerë erën rrezikut, hë? Po punon për t'i dalë përpara, hë? Po nuk të lëmë në baltë, shoku Zaim, jo.

— Ç'rrezik? — Çaploi sytë tjetri, duke u zbardhur në fytyrë.

— Mos bëj sikur nuk e di. Do të të sulen revizorët...

— Të urdhërojnë! Unë jam në rregull, çdo gjë në rregull është. — Zaimi kishte mbetur në këmbë në mes të zyrës. As ishte ai që dilte, as ai që qëndronte.

Tjetri u ul dhe ndezi cigaren.

«S'paska ndër mend të tundet ky, jo...»

— Do ta ndihmoj edhe unë revizorin që vjen nesër.

— Kemi gjetur belanë me ju, shoku Palush. Nuk dimë ku t'u fusim në bordero. Asnjë muaj nuk ju gjen në një vend të caktuar.

— Oho, vetëm mos më lini pa paguar, pa futmëni ku të doni.

— Nga vjen ai revizori?

— Nuk e di me siguri. Nga rrethi, mbase edhe nga qendra. Mund të punojmë te ju nja pesëmbëdhjetë ditë.

— Më duket sikur ju pëlqen puna e revizorit. Pse nuk mirreni drejtpërdrejt me këtë punë?

— Ehu! Ka telashe. Kur vete pas të tjerëve nuk e vret kokën. Mua nuk më pëlqen të mbaj përgjegjësi.

U kapardis në karrige dhe nxori një shtëllungë tymi nga goja. I kishte thënë Zef Mërtirit të ndërhynte për ta caktuar të ndihmonte revizorët. I kishte thënë se kjo punë e tërhiqte, se në të ardhmen shpresonte të mirrej me të. Po nuk qe nevoja për ndihmën e inxhinierit. Palushin e thirrën vetë për këtë punë. Ishin mësuar me të dhe, me të dalë ndonjë punë inventarësh apo revizionimi, ja behnin Palushit. Ai mezi ç'priste. Kjo ishte punë pa kontroll, vije kur të tekej dhe ikje po ashtu. Pastaj zgjate punën tërkuzë... Po kësaj radhe kishte edhe arsye të tjera.

— Ç'e vret mendjen, shoku Zaim? Ja mbyll sytë unë revizorit si të dua. Vetëm thuam ku je keq t'i të dal përpara.

— Ju lutem! Ç'është kjo gjuhë? — kërceu Zaimi. — Unë asnjëherë nuk kam dalë keq. Pastaj nuk dua që t'i mbylli sytë revizori.

— Ore, po lapës i thonë, llogari. Mund të digjesh. Pak veta e kanë grënë?

— Ju falem nderit, po s'ka arsye.

— Hë! ç'desha të them? — Palushi kruajti kokën.

— Ah, po! Kam bërë gjithato orë jashtë orarit mëpër

inventarizime dhe gjetkë, dhe akoma nuk m'i kanë paguar. Do të bëje mirë të m'i vije në bordero...

— Menjëherë, vetëm ju lutem më sillni dokumentat ku keni punuar.

— Dokumentat? Ku t'i gjej dokumentat? Kjo është punë e vjetër, që e kam lënë pas dore.

— Po drejtorëve besoj se u kujtohet ku ke punuar, le të lëshojnë një vërtetim.

— Kësaj i thonë burokraci me brirë, shoku Zaim. Dëftesë këtu, dëftesë atje.

— Pa dokument nuk mund të japim asnjë qindarkë, tha i vendosur shefi i llogarisë. Ju duhet të më kuptoni, mos ma mirrni për fyerje, ju lutem.

— Dëgjo, nuk mund t'ja hajë njeri hakun Palush Stajkës, or shoku Zaim! Vëre mirë në vesh këtë! Mirë, si të duash. — Fjalët e fundit tingëlluan si kërcënim.

Ai u ngrit dhe doli pa përsëndetur. Shefi i llogarisë nuk luajti nga vendi. «Jo, ju lutem, — pëshpëriti, — jo! Nuk e lë rrugëve unë paranë, jo!» U ngrit. **Shqetësimet** e kohëve të fundit zunë ta **turbullonin** prapë.

«Dil një herë jashtë mureve, Zaim, puno në ajër të pastër, — i tingëlluan në vesh fjalët e Brahim Jergucatit. Shojti dritën dhe doli në udhë.

KAPITULLI XXVII

Gjithë kohën e turnit Lidja qe e zënë. Kështu e kishte më lehtë. Dita e fundit kishte qenë e shqetësuar. Në trazimin e saj zinte vend Zef Mërtiri. Lidja herë mirrej me sondat, herë përvishte mëngët dhe bënte punën e mekanikëve. E ndjente veten keq po të mos mirrej me diçka.

Mekaniku vështron në këmbë si punon inxhinierja.

Çelësi anglez, pincat, kaçavidat dhe duart e saja që lëvizin me shpejtësi... Ndoshta ajo nuk e ka dorën e sigurtë të mjeshtrit, por nuk është aspak e ngathët. Duket që kësaj vajze i pjell mendja, nuk i merr gjërat kallëp. Koha e punës mbaroi shpejt. Lidja fshiu duart me pecen dhe u fut në barakën e vogël. Bardh Shkoza dhe normisti po plotësonin një evidencë.

— Bardh, — tha Lidja, — sikur të bisedonim pak për ato punimet tuaja. Sesionin shkencor e kemi mu te dera. Ilia me të vetët është përpara.

— Unë e kam përfunduar, — u përgjegj tjetri, — sig e di e kam pasë të lehtë. Më hëngri më shumë kohë grafiku i shpimeve. Për formën e «organizimit të punës» nuk u lodha shumë.

— Në mbrëmje jam në dhomë. Të lutem m'i sill t'i hedh një sy. Tani, po nuk përtove, më thirr Istrefin dhe Adem Likën.

Të dy sondistët u futën brenda.

— Ku jeni me ato punimet tuaja, shokë?

— Besa, bukur mirë kemi ecun, shoqja inxhinierë. Po kemi nevojë prapë për ndihmë. I kam shkruar ato çka më duhet me pyet. Ato që kemi bisedue herën e fundit më kanë dhanë shumë dorë.

— Edhe unë i kam shënuar nevojat e mia, — buzqeshi tjetri.

I pari kishte marrë të punonte temën «Eksperiencia ime në shpimet në zhavorr», ndërsa Adem Lika «Shërbimi i maqinerisë, kusht i dorës së parë për zgjatjen e jetës së saj dhe rritjen e rendimentit».

Lidja u hodhi një sy kërkimeve të tyre dhe pastaj zuri t'i analizonte një për një. Kërkimet e sondistëve i jepnin të kuptonte që ata ishin futur mjaft thellë në çështjet teknike. Ajo habitej sidomos për disa probleme shumë praktike dhe shumë të nevojshme që ngrinin ata. Kjo provonte tezën që shtronte partia për pjesëmarrjen e punëtorëve në eksperimentimin shkencor. Vetëm duheshin ndihmuar.

Dha e mori me punëtorët një kohë të gjatë. Ajo fliste ngadalë, ata mbanin shënime. Letrat e fletores së tyre ishin gjithë njolla nga duart me graso.

— Kur t'i hidhni këto në të pastër do t'i lexoj gjithë punimet, — tha Lidja.

— A mos po koritna? — pyeti Istrefi.

— Turpin ma lini mua. Në punën tuaj nuk ka fjalë të bukura, po ka shumë jetë, përvojë dhe zgjuarsi. Forca, shokë!

Lidja i përcolli sondistët dhe po bëhej gati të dilte, kur ja behu xha Brahoja.

— Të kërkova, — tha, — ora po vete për mbledhje...

— U vonova me dy sondistë. Për atë sesionin shkencor...

— Mirë që ma kujtove! Andej nga ne kemi marrë tri tema, po asnjë nuk e kemi gati.

— Keni biseduar me Zefin?

— Nuk ja var Zefi asaj pune. S'kam kohë sot, s'kam kohë nesër.

— Kërkojani më me ngulm, — tha Lidja.

— Ora katër pa pesëmbëdhjetë, kur do të hash bukë?

— E pat dreka sot, xha Braho. Shpejt në mbledhje! Do jenë grumbulluar gratë.

Morën kthesën pothuaj me të rendur. Kaloi një «Tatër». Lidja e ndaloi maqinën.

— Na çoj gjer te klubi, — tha ajo.

Në çastin që po hipnin në maqinë panë inxhinier Zefin.

— Po shkojmë në mbledhje, — tha Lidja.

— Aha, në mbledhje...

«Aha, në mbledhje...» ushtoi në mendjen e Lidjes.

* * *

Mbaruan andej nga ora shtatë. Gratë u larguan një nga një. Në oborrin e klubit mbeti vetëm Lidja, xha Brahoja, sekretari i partisë i hidrocentralit dhe kryetari i bashkimeve profesionale.

— Tani, marsh në menci! — qeshi sekretari i partisë. Dhe të gjithë bashkë u drejtuan për në menci!

Atje s'kishte asnjëri. Sapo ishte çelur dera.

— Ata që vijnë të parët janë më të uriturit, — qeshi sekretari i partisë. — Ç'thua, Lidje?

— Të them të drejtën, posa shkela këtu zuri të më ngacmonte stomaku...

— Refleks, — qeshi xha Brahoja.

— Ç'mendim keni për mbledhjen?

— Qe shumë e dobishme, — foli kryesondisti, — qe një sukses... Ku ke parë në qytet të pranojë gruaja me fëmijë të marrë pjesë në grupet artistike, apo në rrethet e studimit! Jeta po shkon përpara... Një sukses qe mbledhja...

— Më pëlqeu ajo aksionistja nga Velipoja, — tha sekretari i partisë. — Shpuzë e gjallë... Po edhe të tjerat nuk i linin gjë mangut. Këto vitet e fundit kanë zënë të zhduken topitja, mpirja dhe ndrojtja te gruaja jonë. Gjë e madhe.

— Vetëm kështu mund të futen në vallen e madhe të jetës, vetëm si kërcimtare të patrembura, — tha xha Brahoja.

— Mos e çeka pa vend krijimin e ekipeve higjienike për fshatrat? — pyeti Lidja.

— Aspak! Pse, a nuk është ky një aspekt i edukimit?

— Xha Braho, mendoj që edhe ti të mirresh me punën edukativo-politike të shoqeve. Për këtë do të flasim edhe në parti.

— Do të gjej kohë, — tha xha Brahoja.

— Koha ecën për ne, — foli i menduar sekretari i partisë. — Kudo në botë ecën për ne. Ne po e bëjmë kohën...

Në menci zunë të vinin punëtorët një nga një. Tik-taku i lugëve dhe krisma e pjatave...

Sekretarit të partisë i pëlqeu sa bukur e kishte vënë kuzhinieri kontornon me barishte rrotull mishit. Zgjati kokën dhe pa në tavolinat e tjera. Edhe pjatat e atyre ishin gatitur me po aq shije.

— E dini se edhe kjo pjatë e servirur me shije hyn në edukim? — tha sekretari i partisë. — Për këtë po mendoja tani.

— Estetikë! — qeshi Lidja. — Nuk e kemi më kot poet përgjegjës in e mencës dhe ish-kuzhinier të turizmit kapon tonë.

Hyri Zef Mërtiri.

— Eja, shoku inxhinier, — tha sekretari i partisë, — ulu me ne.

— Po ju qenkeni në të mbaruar...

— Ulu, s'ka gjë.

Zefi porositi darkën, pastaj u kthye nga sekretari.

— Më thanë se nesër do të vijë një delegacion i huaj këndeje, — tha.

— Po, miq nga Afrika, kongolezë nga të Lumumbës...

— Ky emër ushton si tambur kushtrimi, — foli xha Brahoja.

— Po, po, tambur!

Vazhduan të hanin në heshtje. Sekretari i partisë mbaroi dhe nderi një cigare.

— Sot më pyetën nga qendra për atë sesionin shkencor. Do ta mbajmë javën tjetër. Ku jemi me punimet?

— Të mitë besoj se do të jenë gati për atë ditë. — u përgjegj Lidja, — edhe punimin tim e kam mbaruar.

— Edhe sektorët e tjerë do të jenë gati.

Sekretari i partisë nxori një shtëllungë të madhe tymi nga goja.

— Po çimentimi?

Zef Mërtiri kishte ulur kokën mbi pjatë dhe nuk bëzante.

— Si të themi... Jemi ca prapa, — foli ai.

— A mendoni se mund t'i mbaroni për sesionin?

— Si të them!....

Sekretari i partisë u vrenjt, po nuk foli. U ngrit dhe shkoi andej nga sporteli.

— Nesër për drekë do të gatuj një ramstek për kokë të ramstekut, — i thirri kuzhinieri.

— Mirë, do të vij nesër të provoj ramstekun tënd.

U ngritën dhe të tjerët nga tavolina. Në të dalë të mencës u ndanë. Lidja e kishte udhën me Zef Mërtirin.

— Ku je me punimin tënd shkencor? — e pyeti ajo.

— Kam ecur diçka, po mbeta prapa kohët e fundit nga përpilimi i raporteve për simpoziumin.

— Do ta lexosh punimin në sesionin shkencor?

Lidja digjej të mirrte vesh të vërtetën.

— S'është për aty ai...

«S'është për aty ai», — gjëmoi në veshët e Lidjes.

— Punëtorët duhen ndihmuar. Mund të paraqesin mendime interesante...

— Shumë-shumë një shkëmbim përvoja praktike...

— Edhe kjo nuk është pak. Po unë mendoj se ata do të shkojnë më larg, shumë më larg. Dhe largësia e tyre do të rritet me kalimin e kohës dhe me vlerësimin që do t'i bëjmë në kësaj pune. Eja të lexosh nesër po të duash punimet e sondistëve të mi...

— Punimeve do t'u bjeri era Lidje, — qeshi ironikisht ai.

— Era ime aty është aq e parëndësishme, saqë nuk kundërmon fare. Po edhe po u ndje erë, kjo është njësoj, ose diçka më pak se sa kur përdor një qerre bibliografi ti ose unë për të hartuar vepra të mëdha teorike.

Fjalët e fundit i nxori me ironi të dukshme.

Për disa çaste ecën pa folur po Lidjes nuk ju durua prapë.

— Pse mendon se nuk mund të bëjnë gjëra serioze punëtorët?

— Duhet përgatitje e madhe, — tha ai. — Ka edhe inxhinierë që nuk janë të zotët për këtë.

— Këtu synon revolucionin tekniko-shkencor, — bërtiti Lidja me zemërim, — t'i bëjë të aftë të gjithë për punë shkencore. Nëse punimet e para nuk do të jenë mjaft të mira, aq na bën. Mjaft që të fusim në shpirtin e punëtorëve idenë e kërkimit, të eksperimentit. Kështu me kohë ne do të kemi një armatë të tërë shkencëtarësh dhe kërkuesish në vend të disa kokave të zgjedhura.

Edhe disa hapa të tjera pa folur.

— Domethënë ti nuk do ta lexosh punimin tënd?

Lidja zjente nga marazi dhe kërkonte shkak për t'u zënë me të.

— Jo, nuk do ta lexoj.

— Kjo do të thotë se ti na quan ne dhe punëtorët të paaftë për të kuptuar veprën tënde?

— Lidje! Ti më duket sikur kërkon shkak për t'u zënë. Unë nuk shpreha diçka të tillë. Ç'djallin kemi ne të dy?

— Po të duash të marrish vesh pse zihemi ne, duhet ta kërkosh djallin brenda vetes. Dhe, që ta dish ti, për mua ka më shumë rëndësi vepra e Adem Likës, që nuk pretendon asgjë, se sa veprat e tua që pretendojnë shumë por që s'po t'i shohim.

— Ti vazhdimisht po më fyen, — tha ai. Epo falemnderit!

Ajo iku pa i thënë as natën e mirë.

KAPITULLI XXVIII

Natë, turni i fundit. Sonda numër njëmbëdhjetë kishte arritur kuotën e caktuar. Kryesondisti urdhëroi ndihmësin të ndalte rrymën. Sipas grafikut kishin fituar katër ditë avancë. Ndihmësi, një kuqo gjithë prenka në fytyrë, u zgjat dhe ktheu çelësin. Zhurma aty pranë pushoi, pushoi edhe shtanga së rrotulluari.

Kryesondisti u ul mbi një arkë kampionesh dhe nxori paqetën. Nuk i kishte mbetur asnjë cigare për be! Kërkoi me sy andej-këndeje kujt mund t'i kërkonte duhan, pastaj e la atë punë. Të tjerët ishin të zënë rreth maqinave të tyre dhe asnjëri nuk po vështronte nga ai. Dhe kryesondisti do të donte që të gjithë tani të kthenin kokën nga ai. Jo për t'u kërkuar një cigare, jo, po ta dinin që e mbaroi punën katër ditë përpara.

Në turnet e ditës kështu do të ndodhte. Do t'i vinin, do ta uronin, dhe po të ishte ndonjë sukses jo i rëndomtë, do të bëheshin katër-pesë bashkë dhe do ta hidhnin në krahë sa t'i përziheshin zorrët.

E harroi duhanin; kënaqësia që kishte punuar mirë ja shoqti fare etjen e cigares. Po të përsëritej edhe disa javë ky sukses, sonda numër njëmbëdhjetë do të dilte në ballë të atyre që luftonin për rezultate rekord.

«Eh! Tani do të mbeten të kënaqur nga ti dhe çunat e tu, more Llambi, — i tha vetes kryesondisti.

Qe një burrë në moshë, i urtë e fjalëpakët. Njeri baballëk dhe i dhënë pas punës, ai nuk ja turbullonte ujërat asnjëri, nuk përzihej fort dhe shikonte vetëm sondën. Ishte nga Narta e Vlorës. Në fillim nuk i kishte ecur mbarë e pothuaj vazhdimisht do ta kritikonin. Ai ishte sondist i vjetër, por kishte punuar gjithnjë me hidrologët, në kërkime burimesh. Në hidrocentral nuk kishte më shumë se pesë muaj. Ra në sy që ditën e parë që erdhi. Punëtorët ja ngjitën aty për aty «baba-xhan» se, qe i ëmbël, i butë dhe e kishte fjalën e mirë në majë të gjuhës. Kishte zakon të përsëriste vend e pa vend fjalën «xhan» dhe kjo i gajaste punëtorët: «Mirë, xhan! keni të drejtë që më kritikoni. Do të përpiqemi, xhan!»

Mirret me mend si vlonte gazi!

E kishte keq sidomos me Zaimin dhe me Zef Mërtirin. Kryellogaritari «u ofendua» që ditën e parë nga ato «xhane» që i shpëtuan Llambit. «Ju lutem, — i tha ai me autoritet, — lërin këto xhane. Kemi punë shtetërore!» Po Llambit i shpëtonin se i shpëtonin dhe Zaimi, që druhej nga ato «xhane» si nga epidemitë, mirrte një pamje të rëndë sa herë takohej me kryesondistin.

Ndërsa Zefit nuk i pëlqente si njeri. I dukej leshko. Inxhinieri sillej nga sillej dhe te ai përplasej. Në fakt, në kohërat e para, kishte të drejtë, se sonda numër njëmbëdhjetë qe prapa, po edhe më pas, kur ajo ecte me shoqet, Zef Mërtiri do të gjente ndonjë yçkël për t'ju shkrehur Llambit. «Shoku inxhinier! Unë tani jam në

rregull, — ankohej Llambi, — ka të tjerë që janë prapa!» «Ç'rregull! — përgjigjej tjetri. — Vendi i punës lesh e li, grasatimi përdhe, ndihmësit bredhin poshtë e lart...» «I ka puna, shoku inxhinier, — thoshte babaxhani, — i ka puna... E sa për graso, e kam ngopur si duhet... E sa për ndihmësit...»

Punëtorët rreth e rrotull e mirrnin në mbrojtje kryesondistin: «Shoku Zef! Llambi doli nga prapambetja tani. Mos i bini në qafë kot!» «Shihni punën tuaj, ju! — përgjigjej i vrerët inxhinieri. — Mos ju duket mrekulli ju që sonda numër njëmbëdhjetë realizon grafikun? Kjo sondë është ndër më të mirat që kemi. Me të mund të realizosh edhe dy norma në turn. Po nga t'ja mbash, kur të mbushin sektorin me «të humbur...?»

Llambit ai i fliste sepse mendonte që tipa si ai duheshin mbajtur në tension që të mund të ecte puna. Ndërsa ajo çështje e «të humburve», që ata të drejtorisë ja rrasnin vetëm Zef Mërtirit, ishte një çështje më vete. Ishte një lloj llastimi apo përkëdhelje që i bënte vetëvetes inxhinieri. Kështu ai dilte më mirë në dritë.

Gjithë këto i shkante nëpër mend Llambi, i ulur aty mbi arkën e kampioneve.

I qëndroi pranë brigadieri i turnit.

— Llambi! Mbarove?

— Mbarova! Jepmë një duhan, xhan!

— Na, or «shejtan». — Brigadieri i zgjati kutinë.

— Nga t'ja mbaj tani? — pyeti kryesondisti.

— Për atë erdha, nuk di ç'të bëj. Inxhinier Zefi nuk më ka lënë gjë në plan sonte. Ai nuk besonte të mbaroje ti dhe, ç'është e vërteta, shkoi shumë shpejt sonte sonda yte.

— S'është tekniku këtu?

— Tekniku është me lejë. Inxhinier Saliu ka vajtur në Ulzë. Nesër duhet të vijë. (Inxhinier Saliu ishte një djalë i ri që s'kishte shumë që kishte ardhur dhe zëvendësonte inxhinierët kur kishin punë tjetër.)

— Atëhere të rri dhe të pi duhan unë?

Në fytyrën e babaxhanit pasqyrohej një keqardhje aq e madhe sa brigadieri u prek.

— E di ç'ke ti? Çmontoje sondën! S'e lëmë dot pa punë. Kjo do të ishte marrëzi. Do të vete të merrem vesh me inxhinieren andej nga UKS-të.

— Më të lumtë, xhan!

Llambi hoqi gozhupin dhe ju kthye ndihmësve:

— Lëvizni, djema! Do ndërrojmë fole!

• • •

Nga UKS-të vazhdonte betonimi që në mëngjes. Aty kishte shumë më tepër lëvizje dhe zhurmë se sa në sektorin tjetër. Brigadieri takoi Bardhin «sa një ving».

— Mos e pe inxhinieren, Bardh?

— Këndeje qe pak përpara, — u përgjegj Bardhi, duke ulur përdhe një hekur të rëndë.

Ai hodhi një sy përreth, pastaj tha: Mos ka vajtur të shtrihet. Që në shtatë të mëngjezit është në këmbë. Ç'ke me të?

— Duhet zhvendosur një sondë.

— Nga baraka do të jetë, pra.

— Hajt, shëndet!

— Shëndet!

Brigadieri u drejtua nga baraka. Aty kishte një dhomë të vogël dhe një shtrat për inxhinierët që rrinin herë pas here vetëm në kantier. Edhe Lidjes i kishte takuar të flinte kaq herë disa orë në natë aty. Më të shumtën kur kishte betonim. Brigadieri kishte rënë në hall. Po sikur të ishte në gjumë inxhinierja? Si ta zgjonte? Bardhi tha që kishte që në shtatë të mëngjezit që ishte në këmbë...

Brigadieri ju qas barakës dhe vuri veshin. Asgjë s'dëgjohej.

Lëre që ku të linin UKS-të të dëgjoje!

— Shoqja Lidje! Shoqja inxhiniere! — thirri ai lehtë.

.....

— Shoqja Lidje!

Ai i ra derës me pëllëmbë.

— Ç'është? Ç'ka ngjarë, Bardh?

Zëri erdhi i shqetësuar që brenda.

— Nuk jam Bardhi, — u përgjegj ai jashtë. — Jam brigadieri i çimentimit. Duhet zhvendosur një sondë, por inxhinier Zefi...

Atë çast zuri të bënte zhurmë të tmerrshme betonierja dhe brigadieri e la fjalën.

— Inxhinier Zefi nuk më ka lënë ndonjë udhëzim, — vazhdoi brigadieri kur pushoi zhurma.

— Ja, po vishem, — u dëgjua që brenda zëri i Lidjes.

Ajo doli duke fërkuar sytë.

— Më fal, — filloi brigadieri, — por...

— Lëri ato. E kishe për detyrë të më zgjoje. — Ajo pa sahatin. Agrepat me fosfor shënonin dy pas mesnate.

— Paskam fjetur afro një orë e gjysmë, — tha inxhinierja. — Cila sondë mbaroi?

— Njëmbëdhjeta, shyqyr, inxhinierë. Nja katër ditë përpara.

— Mrekulli! Kush punon te njëmbëdhjeta?

Ajo qëndroi një çast në udhë dhe desh të sillte ndërmend kryesondistin.

— Llambi, ai nga Narta.

— Oho, patrioti im! Zefi diç më tha se ka lënë atje në atë zyrën tuaj, — tha Lidja më pas, — po vendin nuk e mora vesh mirë, se nxitonte. Me sa më kujtohet, ka lënë grafikun e shpimeve për nesër, në qoftë se ai vetë nuk vjen. Më mori në telefon nga drejtoria.

Lidja u fut në barakë. Qe një zyrë e vogël dosido, që me zor nxinte dy tavolina dhe dy karrige.

Roja e natës, që po dridhte një cigare përpara stufës që bubullonte, u ngrit në këmbë dhe i liroi karrigen.

— Rri, rri, xha Selim, — tha Lidja duke zgjatur duart nga soba. — Këtu qenka nxehtë, — shtoi ajo pas pak. — Inxhinier Zefi i mban mirë njerëzit e vet.

Ajo kërkoi një copë herë nëpër sirtarë dhe më në fund e gjeti atë që donte.

— Ja tek është, — tha duke i hedhur një sy letrës gjithë vija të kuqe.

— Mirë, atëherë, — fërkoj duart brigadieri.

— Sonda njëmbëdhjetë nuk është planifikuar as për dy ditë më pas, — tha. — Megjithatë s'ka rëndësi gjersa dihet ku mund të fillojmë punën.

Duke dalë nga baraka ajo ndoqi me sy gypin e sobës dhe zuri nga supi brigadierin.

— Ore, po ju do të digjeni ndonjë ditë me gjithë zyrë!

Gypi i sobës i kishte ngrënë si me dhëmbë dhogat aty ku dilte përjashta. Rreth e rrotull dërrasat qenë djegur.

* * *

Sondën e kishin çmontuar.

Reflektori lante në dritë katër punëtorët që sapo kishin lënë veglat përdhe dhe qëndronin krahëlëshuar përpara maqinës.

Lidja i ra shpatullave Llambit:

— Patriot! Duhet lëvizur tani sonda.

— O të keqen! — ja bëri Llambi.

Brigadieri thirri edhe punëtorë të tjerë. Kush mori trekëndëshin, kush gypat dhe i lëvizi pastaj. Lidja desh të ngrinte Babin e rëndë bashkë me Llambin.

— Jo, xhan, — kundërshtoi babaxhani. — Ka kush e mban Babin.

Ai e hoqi dorën nga pesha e rëndë për ta detyruar Lidjen ta linte në vend.

Lidja qeshi.

— Epo mirë, — tha, — do të marr ndonjë shtangë.

Llambi i rراسi në dorë një çelës anglez.

— Jo shtangë, — tha, — jo! — Merr këtë sa për të mos vajtur duarbosh.

Pastaj u mblodhën të gjithë për të lëvizur trupin e sondës...

Njëmbëdhjeta do të fillonte shpimin pranë sondës ku punonte xha Brahoja.

KAPITULLI XXIX

Inxhinier Zefi erdhi ndërsa po ndërroheshin turnet. I kishte dalë gjumi shumë herët në mëngjes, andej nga ora katër. Qe rrotulluar sa në një krah në një tjetër se mos flinte edhe nja dy orë, por e pamundur. Atëhere qe ngritur dhe i kishte hipur autobusit të parë.

Ai përshkoi shpejt vendin e punës, me një fytyrë të zymtë dhe humor të prishur. Mërzinë e tij e shkaktonte dy aksidente sonda 13 dhe 17 që vërtiteshin si breshka (për të cilat e kishin kritikuar ashpër në rreth sepse Zefi s'ja varte sigurimit teknik), si dhe Lidja.

Kohët e fundit ai ndjente se edhe ata të drejtorisë së ndërmarrjes sikur ishin ftohur nga ai. Konkretisht nuk kishte asnjë shenjë, asnjë provë, po ai e kapte me intuitë, e nuhaste këtë. E gjithë kjo mund të përmbli-dhej kështu:

Ata kishin mbajtur shpresa të mëdha te ai, e kishin çmuar më shumë nga të gjithë. Kishin pritur e kishin pritur... Po ç'doli nga Zefi Mërtiri? Një inxhinier i zakonshëm. «E ç'presin të bëj këtu?» Mbronte veten ai.

Kohët e fundit i dukej se as punëtorët nuk ja varnin sa duhej. Meqë ai nuk kishte afërim me ta, me përjashtim të punës, ata sikur i tërhiqnin zvarrë urdhërat që jepte. Dhe mjaftonte që dikush tjetër të urdhëronte diçka që të zbatohet. Kështu edhe me inxhinierin e ri që e zëvendësonte shpesh Zefin! Detyrat që linte Zefi zbatoheshin, por pa entuziazëm. Gati si punë angari.

Zefi Mërtiri desh të futej në barakë, kur i vajtën

sytë te vendi bosh i njëmbëdhjetës. Ai vështroi i habitur një copë herë pa kuptuar ç'kishte ndodhur, pastaj pyeti një punëtor.

— E lëvizën mbrëmë, — u përgjegj punëtori, — Llambi realizoi punën. Sondën e zhvendosën përtej.

Për një çast atij i vajti nëpër mend të mbushte boshllëkun e dy sondave prapambetëse me përparimin e njëmbëdhjetës, po pastaj i kërcëu gjaku në kokë që ishin përzierë në kompetencat e tij. Përpara disa ditësh ai qe ngrënë me inxhinierin e ri për ca detyra që u kishte lënë punëtorëve pa e pyetur atë, tani dilte dikush tjetër dhe lëvizte sondën pa e pyetur. «Inisiativa personale! Duan të bëhen të gjithë heronj,» pëshpëriti ai.

U nis me nxitim nga sondat e kreut. Vlonte përbrenda sa nuk thuhej. Lëvizja e sondës nga vendi që vetëm sipërfaqja e zemërimit të tij. Inati i vërtetë ishte shumë më thellë, shumë më larg. Megjithatë ai vlonte: «Kush u kish thënë atyre ta lëviznin sondën? Kush urdhëronte aty? Ata apo ai?» Llambi po dorëzonte tur-nin. Babi i rëndë rrihte pa pushim. Kryesondisti tjetër seç po firmoste një letër mbi gju. Më tutje xha Brahoja thithte cigaren dhe vështronte duart e nxira. Rreth e rrotull dëgjoheshin fragmente urimesh mëngjezi. Mirë mëngjez! Mirë mëngjez!

Llambi i buzëqeshi inxhinierit, por kur e pa të vrenjtur si natë shëndreu, buzëqeshja ju zhduk pak nga pak dhe në tiparet e kryesondistit zuri vend një farë pikëllimi i përzierë me habi.

— Kush e luajti nga vendi sondën? — pyeti inxhinieri.

— Unë!.. Ne!.. — u ngatërrua Llambi.

— Kush janë këta «ne»?

— Brigadieri, shoqja Lidje, ne të tjerët, — shpejtoi Llambi. — Ja brigadieri...

Zef Mërtiri u hëngër me brigadierin afro dhjetë minuta. Në fillim ai nuk ju përgjegj, se Zefi as që e linte të fliste, po më pas nuk mbajti peris as ai. I tha se habitëje shumë. Atij ndoshta mund t'i kishte shkuar nëpër

mend se mund ta lavdëronin për këtë punë, por që ta shanin, kurrën e kurrës!

— Kjo që bëtë ju, shoku inxhinier, — tha së fundi brigadiëri, — s'është aspak e hijshme. Pastaj, edhe dëm sikur të qe, askush nuk ju lejon të silleni kështu. Lëre pastaj që kjo është në dobi të punës. Kështu e kuptoj unë kur nuk e lë sondën të rrijë pa punë. Pastaj unë pyeta inxhinieren...

— Këtu urdhëroj unë!

— Ju vetë se ç'kishit folur me të në telefon..

— Nuk i kam thënë të zhvendosi sondat, por vetëm të kontrollojë përparimin e punimeve sipas grafiikut! Sidoqoftë kjo s'të hyn në punë ty!

Rreth tyre ishin grumbulluar punëtorët. Por asnjëri, as tjetri nuk e kishin vënë re.

— Grafikun e punimeve të ditëve të fundit. mos e dorëzo, — i foli brigadierit pas pak inxhinieri me një zë më të qetë.

— Sapo ja dhashë njërit ta çonte në zyrën e planit, — u përgjegj tjetri.

Zef Mërtiri shtrëngoi dhëmbët. U zhduk shpresa për të mbushur deficitin.

— Idiot! — tha ai gjith mllëf. — Turrju prapa dhe ma sill këtu!

— Nuk luaj këmbë! — u përgjegj tjetri, — dhe për fjalët që më ke thënë sot, do të përgjigjesh.

Inxhinieri iku pa i kthyer përgjigje. Punëtorët u vështruan sy në sy. Për një çast sundoi një heshtje e nderë.

— Një tjetri do t'ja veshja turinjve, — tha brigadiëri. — Po çfarë t'i bëj se është autoritet i ndërmarrjes. Më ra në qafë, shokë. As e kuptova, as e kuptoj edhe tani pse m'u përvesh kështu. Mos ishte i dehur?

— Esull fare! — ja pret njëri.

— Ç'thua, xha Braho? Ti e dëgjove zënkën.

— Them se s'është fare në rregull dhe se duhet ta shohim punën e tij.

KAPITULLI XXX

Përpara «fletërrufesë» që i kishin vënë Zef Mërtirit kishte vazhdimisht shumë punëtorë. Ajo bëri përshtypje të madhe në kantier, se ishte shkruar me shumë forcë dhe nxirrte në shesh një varg dobësish të panjohura të inxhinierit dhe godiste tërthorazi drejtorinë e ndërmarrjes që e kishte përkëdhelur pa të drejtë inxhinierin. Një alamet «fletërrufeje», që zinte gati gjithë «Zërin e Masës». Punëtorët kishin marrë zjarr, sidomos pas sesionit shkencor që ishte mbajtur të premtën. Sesioni kishte patur sukses. Shokët nga qendra dhe nga universiteti kishin mbetur të kënaqur nga puna krijonjëse e punëtorëve, e teknikëve dhe e inxhinierëve. Pati rreth dyzet propozime të rëndësishme për rritjen e rendimentit të punës, pati probleme serioze të argumentuara shkencërisht, pati kumtesa me shumë rëndësi nga inxhinierët. Vetëm punëtorët e çimentimit nuk folën. Nuk foli as inxhinieri i tyre, Zef Mërtiri. Po të gjithë u çuditën kur regjistroi emrin për të referuar inxhinieri që e zëvendësonte, që posa kishte ardhur në hidrocentral. Zef Mërtiri asnjë fjalë...

Grumbull punëtorësh përpara «Zërit të Masës». Ata çuditëshin më shumë kur shihnin emrin e Lidjes poshtë atij kartonit të madh. Çudi, edhe Lidja...

— Ku është Palush Stajka? — pyeti një ndër punëtorët pasi ja lexoi emrin në «fletërrufe».

— Ja ka ndi erën. Asht avullue. Nuk e kam pa askund.

— Fliska edhe për ju, shoku Zaim.

Shefit të llogarisë ju muar goja.

— E kanë gabim. Nuk e kam përkëdhelur. Pastaj nuk e dija që paska qenë kaq i pazoti... Unë... Unë,,

— E kush shkruan se ai është i pazoti? Ai mund të ketë edhe talent, por nuk i është parë asgjë. Për këtë shkruhet.

— Ah, paska qenë me talent, — u ngatërrua shefi i llogarisë. — Atëhere pse?..

— Modë e vjetër!
— Asgjë s'kupton!
— Mos i harro ato dërrasat e transhesë së Bardh Shkozës!

— Ti do një letër më të madhe këtu...
Shefi i llogarisë u largua si i humbur.
Punëtorët bisedonin me zjarr njëri me tjetrin; atyre u vinte shumë mirë, sidomos që shihnin emrin e Lidjes aty.

— Si thoni, shokë? A do të shkojnë prapë mirë me njëri-tjetrin ata të dy?

— Nuk i dihet...

— Vetëm nëse Zef Mërtiri e kupton drejt.

— Si zor... Ka një kokë ai...

Njerëzit i fut në lëvizje, i fut në mendime ajo që është e rëndësishme, që është e drejtë. Dhe s'ka gjë më të madhe se sa kur mendimi shtjellohet bashkërisht, rrihet bashkërisht.

Kaloi edhe Lidja andej. Kaloi disa herë. Me bisht të syrit kërkonte përgjigjen. «Ja, kur të përmbysi me pak rreshta çdo gjë», mendonte ajo. «Po, po! Me pak rreshta dhe me fodullëk!»

Dhe i vinte keq... Dhe i vinte aq keq...

Po Zef Mërtiri nuk po përgjigjej. Lidjes i kishin mbetur të ngulura në tru ato fjalë që kishte shkrojtur për të: «Shoku Zef s'ka pikë inisiativë, s'bën asgjë me inisiativë. Është si një ushtar shahu që nuk lëviz nga fusha pa e ngritur lojtari!»

* * *

Lidja nuk kishte punë atë pasdreke. Ata inxhinierët e rinj që ishin shtuar e kishin lehtësuar ca.

Kishte një peshë në gjoks, dhe gjithë atë peshë vetëm për një fjalë, për «Ushtarin prej plumbi». Si ju kujtua ajo shprehje? Diku e kishte lexuar... I dukej se e kishte tepruar me ato fjalë...

Brodhi gjithë ditën anakand hidrocentralit, në digë, në tunel, në sektorë të tjerë, te motopompat që po nxirrnin ujët që kishte dalë në tunel. Aty i zunë sytë atë plakun dukagjinas, Gjeto Markun.

Plaku vështronte me habi të madhe gjithë atë ujë që nxirrte pompa.

— Heu, bre! Ç'ka ka krijue robi! As n'andërr s'e kishe pa...

— Çfarë, xha Gjeto? — e pyeti në tym Lidja.

— Qe kët send! Shkaf i thonë? Pumpë?

Lidja bëri buzën në gaz.

— Pompë...

— Me ba me e pas na qe kyt pumpë në katundin tonë, det kishim me e ba bereqetin...

— Edhe atë keni për ta pasur, xha Gjeto, prandaj po e ndërtojmë hidrocentralin ne, për këto gjëra...

U nda nga Gjeto Marku. Pas nja dyqind hapash ktheu kokën andej. Plaku kishte zënë merak e nuk i ndahej pompës. Lidja u fut në dhomë të vet. Mbylli derën dhe u mbështet pas saj e kapitur. Ndjente lodhje, rjëlloj topitjeje të përgjithshme që ishte rrjedhim i mendimeve dhe të shqetësimeve të ditëve të fundit. Zefi akoma nuk po përgjigjej...

«S'kam ngrënë as bukë, — mendoi vajza».

Atë çast dikush trokiti në portë. Lidja bëri prapa e trembur.

Zef Mërtiri!

— Nuk të pengoj, Lidje?

— Ç'thua, Zef? Ti nuk më pengon asnjëherë.

Dhe akulli u shkri; rrodhën ujërat... Rrëke pranvere poshtë këmbëve të tyre...

— Po ulu, — tha Lidja dhe zemra i rrahu fort.

Ai nuk u ul. U mbështet pas xhamit me fytyrën nga ajo. Dukej i lodhur, sytë i kishte si të tretur, megjithatë nuk dukej ta kishte lëshuar veten aspak.

«As krenari, as përlulje, — mendonte Lidja. Ai vetëm tani më duket në rregull. Si do të vejë puna e tij?»

Do të përmbysi çdo gjë apo... Pse nuk i jep përgjigje «fletërrufesë»?

Ai nuk e vështronte në sy. Vështronte në një qoshe të shtratit të saj ku kish nxjerrë cepin jastëku i bardhë borë.

«Gjersa ai erdhi, nuk më mban mëri, mendonte Lidja. «Po kushedi pse erdhi...»

Ndenjën një copë herë ashtu, pa folur, Herë-herë vështrimet e tyre takoheshin e shkrepnin si shkëndij.

«Jo, ai nuk mendon asgjë të keqe, asgjë...»

Ai ktheu kokën nga dritarja.

— Bora po shkrin, — tha, — kanë mbetur vetëm plloça plloça aty-këtu.

— Duken si dele që kullosin shpatit, — belbëzoi Lidja.

— Mos ke ndonjë libër të më japish të lexoj, Lidje?

— Ç'libër do?

Ai ngriti supet.

— Çfarëdo.

— E ke lexuar Majakovskin?

— Fare pak... Ato që kemi bërë në shkollë.

— E do?

— Nëma!

Ai i hodhi një vështrim kopertinës me portretin e poetit përsipër. Pastaj përshkoi me gisht sytë, flokët, mjekrën kryeneçe të Majakovskit.

— Poetët jetojnë vrullshëm, — tha i menduar. — Si duket, sikur po i digjen sytë zjarr...

Ai sikur ankohej për atë kohë që nuk kishte ditur ta jetonte me vrull.

Desh të dilte kur i shkuan sytë mbi një libër në tavolinë.

Ai e mori në dorë dhe mbet si i ngrirë.

— Po ky? Kur doli?

— Sondisti yt — tha Lidja. — E mora dje. Ka gjëra të vlefshme, përvojë të madhe...

— Nuk ma priste mendja kurrë, — tha tjetri i shu-

shatur, — kurrë! Ai më ka bërë fjalë për këtë, e mirrja për punë boshe...

Ai libër që si një goditje rrufeje në të kthjellët për Zef Mërtirin. Po ai nuk ndjente mëri. Vetëm boshllëk dhe që i pakënaqur nga vetja. Oh, çfarë mësimi kishte marrë nga një sondist i thjeshtë...

— Ai më ka kërkuar kaq herë ndihmë... Po unë... Unë...

Lidjes i erdhi keq. Ju afrua.

Po Zef Mërtiri doli me të shpejtë jashtë. Ju ndjen hapat që zhurmonin në korridor. E shtrëngoi diçka në gjoks...

Lidja vrapoi në dritare. Ai po ikte shpejt, shumë shpejt. Ajo nuk e kishte parë kurrë të ecte kështu. Ai sikur kishte krahë...

Doli edhe Lidja pas tij. Doli pa kuptuar, pa ditur ç'po bënte sikur ta tërhiqnin hapat e tija. Ku po shkon-te ajo?

Në udhë kishte njerëz, vështronin. Ç'kishte ajo kështu? Qëndroi te ura. Te ura i zunë sytë Gjeto Markun. Plaku drejt si plep në këmbë. Pranë tij trasta e rrobave, një trastë e madhe si hejbe e thurur me lesh të ashpër.

— Po iki, bijo, — tha ai. Jam koritë...

— Ç'thua, xha Gjeto?

— Po, jam koritë me këtë vend, me partinë; me tanë ju këndeje. A e din pse kam ardhë unë? Më ruejt çikat! Kam qenë keq me rradake... Koritë! Po këtu pashë se nuk kam ke me ruejt e prej kuj me i ruejt! M'plaçin sytë e ballit! Unë me punu s'muj, i kam kalue tetdhetat, prandej po iki mos me i hangër bukën kot hyqymetit... E ishalla tash xen mend edhe ndonji tjetër që mundet me kenë mendekeq si unë. Kanë ndrru kohnat, bijo!

Lidja u prek. I erdhi keq për plakun.

— Dhe kam me i kallxu kujdo ç'ka kam pas blujt nëpër mend, kujdo. I kam marrë mbrapa këndeje çikat si

i trenue. Mbrapa në punë, mbrapa n'kurse, mbrapa n'filëm: mbrapa n'fjetore. Po ani, se u binda që partia don me u çilë sytë, me u çilë sytë...

— S'ka gjë, xha Gjeto, mos ik!...

— S'ka burrë që m'ndalë, — tha ai, — due me ikë. Jam koritë. Ktu pash dyrnja tjetër, e gzoshi, bijo!

Ai i doli përpara një «Skode», duke tërhequr pothuaj zvarrë trastën. Pastaj hipi në kabinë me shumë mundim. Lidja i pa fytyrën e prefët përtej xhamit dhe u mallëngjye.

Ja si ishte jeta! Plot kthesa, plot të papritura, plot kontraste.

Në mes tyre e reja çante me vrapin e veriut.

KAPITULLI PA NUMËR

Tinguj çiftelie, buçimë e lodrës... pararoja e kushtrimit dhe e gëzimeve... Dhe përsipër kokës një copë qiell, një copë qiell që mund të matet me pëllëmbë, një copë qiell i rrethuar dhe si i prerë qark nga kreshtat e maleve ku dielli ngrihet vonë dhe perëndon herët.

Plot gjëra sjell ndër mend Lidja nga ato dy ditë që qëndroi në atë fshat të thellë malor.

Ajo rri shtrirë në shtrat dhe i mban sytë mbyllur. Në errësirë rrëshqasin imazhet e fshatit të vogël. Rrëshqasin ashtu siç i pa ajo, siç i ndjeu ajo. Po më pas turbullohen, përzihen me njëra-tjetrën. Një tingull i largët këmbore, një britëm shpat në shpat, një zjarr i vonë barinjsh, gjurmët e shpeshta të dhive në oborret mbi shpate, kundërmimi i plehut të ngrohtë... Të gjitha këto shkrihen përtej, humbasin dhe mbeten vetëm fytyrat e ashpra të burrave të këtyre anëve.

Asaj nuk i kish takuar ta shihte më përpara Ve-

riun. Gjithë ç'dinte ajo për të ishin këngët e kreshnikëve dhe lufta partizane. Kjo e fundit që më afër saj, e lidhte me të jatin... Edhe kjo nuk që pak, po përpara atyre kreshtave ku kaloi ajo, i dukej se nuk dinte asgjë. Ja pra Veriu, me tirq të bardhë, me blerim pishash, me sharapolle të braktisur, me duhmën e barrotit që vërtitet kullë në kullë, me etjen për dritë...

Dhe ti dritë po u shpie, Lidje!

«Ekipi vendos shtyllat, shtrin telat (këto fije lahute), bën shaka me pleqtë që pyesin a do t'u bëjnë ballë linjat dimrit dhe stuhive, u frynë llambave me vajguri aty mbi pragjet e oxhaqeve të vjetër. Edhe Lidja u fryn. «Mos, shitoftu zana, mos! Na le në terr!... «Po ai mallëkim kalon, e ndjek motet, u përket atyre. «Mos, shitoftu zana!.. Na le në terr!...» Plaka mallëkon motet, rininë e vet, çdo gjë që ishte parandej. Çdo gjë për të kishte qenë aq e errët. Me aq sakrifica kishte arritur gjer te llamba me vajguri, saqë ka frikë mos e prishi me duart e veta edhe at thërrmi drite... «Mos...»

Lidja vrapon te çelësi, vrapon... Partia nuk do që të presin më, Lidja nuk do që të presin më. Ja drita!

Ajo i vështron të gjithë me radhë. Të zotin e shtëpisë, gruan që përkund djepin, plakën. Djepi lëkundet edhe dy a tri herë, pastaj qëndron: Nëna ka harruar... Kush do t'i tregojë atij djepi kohën e kaluar? Lidja vështron plakën dhe atë çast dëshiron me gjithë shpirt që ajo të mos vdesi kurrë. Kurrë!

Plaka ngrihet në këmbë dhe i afrohet çelësit. Ngrihet në këmbë si ndonjë pishë e lartë. Kthen çelësin me dorën e pamësuar. Kthen kohërat me të sipas dëshirës. Errësirë, dritë! Errësirë, dritë! Një plakë magjistare...

«Dekën e kam pritë, kët jo...»

Lidja ngrihet në këmbë. Dielli i ka përflakur malet andej nga perëndimi, po disku i rrumbullakët nuk duket. Nga altoparlanti vijnë tinguj gazmorë. Dikush nga punëtorët i ka përshëndetur specialistët kinezë: «Lidja është e kuqe».

Lidja mendon për katër fshatrat e tjera që ka marrë përsipër të elektrifikojë ndërmarrja e saj. Edhe andej do të shkojë. Mendon edhe për betonimin që ka nesër, edhe për Zef Mërtirin që nuk po përgjigjet. Shkuan katër ditë nga «fletërrufeja». Ç'ngjet me të? Ajo ka tri ditë pa e parë...

KAPITULLI XXXI

Sa më shumë afrohej ora e fundit e turnit, aq më i shqetësuar dukej Sandri. Rrinte në përgjim të minatorëve. Nuk ishte i lodhur dhe ato shtatë orët e punës në tunel i kishte bërë pa u ndjerë, po ora e fundit i dukej se nuk do të kalonte kurrë. Sandri donte që ajo të ecte sa më shpejt, sa më shpejt... Do të shkonte në Tiranë. Kishte bërë fjalë me një shofer që të nisej posa të mbaronte turni. Shoferi nuk do ta priste asnjë minutë. Kështu i kishte thënë, ngutej për të sjellë eksploziv. Sandri mund të merrte leje një orë, madje edhe më shumë. Tani atij askush nuk do t'ja kthente kërkesën prapa, po nuk desh. Ai nuk i kishte kërkuar asnjëri ndonjë lehtësi, madje asnjë minutë leje. Kështu e ndjente veten më të qetë.

Sandër Delia po i kalonte si në ethe minutat e fundit. Në një gjuhë më të saktë «ethet» e tija përkonin me «tifon» e futbollit. Në Tiranë do të bëhej një ndeshje ndërkombëtare, prandaj po shkonte. Sandër Delia çmendej pas futbollit. Kur ishte shofer e ndiqte prapa «Vllazninë» gjatë gjithë kampionatit, si qen besnik. Shokët e tij thonin për të qeshur, se përgjegjësi i parkut, përpara se ta nisnin të shtunave apo të dielave Sandrin me ndonjë ngarkesë, vështronin kalendarin sportiv. Në qytet, Sandër Delia ishte si një pasqyrë e vërtetë që tregonte fatin e mirë apo të keq të «Vllaznisë». Ai kthehej

gjithnjë përpara skuadrës, fytyra e tij u tregonte gjithshka atyre që ende nuk kishin marrë vesh përfundimin e ndeshjes. Fytyra e tij dhe kabina. Kur ajo ishte plot, priste «Vllazninë» me fitore, përndryshe ai kërcente në kabinë si i çmendur dhe as babanë s'e merrte sikur t'i dilte në udhë. Në ato raste «Skoda» e Sandër Delisë merrte kthesat me tetëdhjetë kilometra në orë dhe ishte rrezik që patenta t'i dilte nga duart orë e çast. Ç'nuk flitëshin për Sandër Delinë! Thoshin se kur luajti «Levski» i Sofjes e bleu treqind lekë biletën, ndërsa për «Norçepingun» zuri vend në tribunë në orën shtatë të mëngjezit, në të njëjtën orë që rojtari hapte stadiumin!

Sandër Delia ishte edhe si një zyrë informacioni për sportdashësit. «Sandër, me çfarë date do t'i kthejmë ndeshjen «Partizanit?» «Më 17 Janar!» «Kur luhet finalja e kupës së kombeve?» «Të dielën e fundit të muajit. Po atë ditë do të luajë edhe Brazili me Çekosllovakinë, «Internacionali» me «Benfikën» dhe «Juventus» me «Junion Lids»...»

Kur erdhi në hidrocentral mendoi me zemër të plasur se nuk do të kishte mundësi ta ndiqte futbollin si më përpara. Por aty i dolën krahë shoferët e ndërmarrjes. Cilido prej tyre, që nisej në një vend ku do të luante «Vllaznia», do të vinte të lajmëronte Sandër Delinë. Gjatë gjithë kohës vetëm dy ndeshje nuk kishte parë, një në Korçë, tjetrën në Vlorë. Andej shkonin shumë rrallë maqinat e hidrocentralit.

* * *

Sandri nuk shkoi as për t'u larë, as nuk u ndërrua. Mori rrugën me vrap pa pyetur se do të nisej me kominoshet gjithë pluhur. Punë e madhe! Kush do ta shante një tifoz? Nuk po nisej për të shitur salltanet.

Kaloi kodrën me vrap dhe doli me një frymë te diga.

Kaluan dy maqina me rimorkio, pastaj një e tretë

me një shtyllë të vetme hekuri shumë të gjatë. Sandër Delia u tregoi grushtin gjithë zemërim shoferëve që nuk kuptuan pse ishte aq i xhindosur ky djalosh i pashëm.

Qëndroi edhe një herë më tutje, tek bëhej betonimi i puseve. Kësaj radhe askush nuk e pengoi. Qëndroi vetë. Qe prishur njëri nga riportablato. Sandri zuri të vështronte me nge shoferin dhe dy punëtorë që u këputën duke vërtitur manivelën.

— Ç'ka? — pyeti Sandri.

— Djalli e merr vesh! — shoferi ngriti fytyrën gjithë vaj, pastaj shtroi flokët me trinën e dorës.

Shoferi u mundua sa u mundua, pastaj u drejtua nga Lidja dhe nga Bardh Shkoza.

— Bardh, betoni! Me një maqinë nuk ja dalim dot!

— Mbase e ndreqim. Hë, or mik?

Shoferi ngriti krahët dhe vështrroi Bardhin si ndonjë fëmi i zënë në faj.

Sandri u mat një herë të ndërhynte. Pastaj u zbraps. Ai po mendonte të gjente mënyrën si të afrohej pa rënduar tjetrin. Ndërkohë shoferi u nis nga parku se mos gjente ndonjë maqinë tjetër. Lidja i shkroi shpejt e shpejt një copë letër për drejtorin. Po sikur mos të kishte maqinë atje?

— Shoqja Lidje, — tha Bardhi, — unë mendoj t'u lutem shoferëve që ngarkojnë zhavorr e rërë të bëjnë nga dy-tri rrugë për ne, po nuk gjetëm maqinë.

— Duhet bërë diçka, — u përgjegj ajo e shqetësuar, — përndryshe puset i mori lumi.

Sandër Delia u afrua instiktivisht pranë «Zisit». Gjer atëherë ja kishte ngulur sytë maqinës, e vështronte pa ndërprerje, vetëm atë vështronte. Ai sillte nëpër mend zhurmën e saj, rregëtimin e motorit, përpëlitjen e maqinës dhe përsëriste vazhdimisht me mend: Distributori! Distributori!

Hodhi përdhe çantën dhe ngriti kapakun. Gjeti një çelës dhe hoqi një nga kandelet. Pastaj kërceu në tokë dhe xhiroi manivelin. Ju përvesh punës për të kombi-

nuar fijet me pistonin. Pas njëzet minutash mbaroi punë. Hyri në kabinë dhe ktheu çelësin. «Zisi» regëtiu, motori u ndez. Ai i mshoi fort gazit, maqina shtoi xhirot. Sandër Delia nuk luante nga sedilja. Vështronte «Zisin», një «Zis» riportabël, i gjelbër, i ri fringo. Me një të tillë kishte nisur zanatin gati «fëmijë. Një «Zis» fringo, nëpër qoshet e pedaleve dhe kudo do të ketë akoma grason e fabrikës dhe sediljet do t'i kërcasin fort... Nuk i ka dalë ende era e fabrikës.

Gjaku zuri t'i zjente nëpër rremba. Ai mbeti i tëri nën pushtetin e vorbullës së zjarrtë që i vlonte brenda për brenda. Nuk pa asgjë tjetër më përpara syve, përveç kabinës së gjelbër të «Zisit», gjysmës së timonit të zi, që kishte vënë një push të hollë pluhuri dhe një copë qielli të murmë përtej derës tjetër. I mëshoi gazit.

Bardh Shkoza u kthye me vrap nga udha dhe zuri fort për krahu Lidjen. Riportabli po ecte! Ai bëri prapa, hungroi, u përplas në një gropë të thellë dhe vazhdoi udhën papritmas drejt nyjës së betonit.

Lidja rendi drejt maqinës. Rendi edhe Bardhi me ato këmbë të gjata si shtylla. Rënden edhe të tjerë. Asnjeri nuk e kishte parë Sandër Delinë të hipte në maqinë.

— Sandri?

— Po, Sandri.

— Djall, o punë!

Ish-shoferi e ndjen që janë afruar. Bën sikur shikon karrocerinë që po mbushet me beton Vështron ashtu i kthyer përgjysmë prapa, me një dorë në timon, me tjetrën të shtrirë në shpinën e sediljeve. I ka rënë ajo hija e zanatçiu të sigurtë në vetëvete. Sa i qetë që duket!... I lindur për shofer.

Po në të vërtetë nuk është kështu, nuk është i qetë. Ai pret që ta zbresin poshtë. Pret që edhe ta qortojnë. Vetëm shtiret si i qetë... Pret të vijë ndonjë tjetër të zërë sediljen e ngrohtë. Ani, ç'ka! Në mos e lënçin të punojë nxori mallin e timonit... Malli i timonit! Një mall i pakuptuar shoferësh, një mall i zjarrtë. Një mall

që e shtynte Sandrin t'u lutej shoferëve t'ja lëshonin maqinën vetëm dyqind metra, në ndonjë udhë të parratur të kantierit. Një mall shoferësh pa timon...

Po kur kishte kërcyer në sedile ai kishte ndjerë tjetër gjë. Kishte ndjerë ankthin e punës së ndërprerë, shqetësimin e Lidjes, sytë e të gjithëve të ngulur mbi maqinën e prishur...

— Sandri nuk ka patentë, — dëgjohet një zë.

Sandër Delia ngre veshët cub përplot.

— Po të ndodhi gjë do ta hamë rëndë. Ai nuk ka patentë...

— Ai e ka patentën me vete...

Ky është zëri i Lidjes. Sandri i fut marshin maqinës dhe bëhet erë.

— Patentën më të mirë që mund të bëhet, — vazhdon Lidja buzagaz.

Eh! Sa larg shkon me ato fjalë!

— Të lajmërojmë shoferin, shoqja inxhinierë?

Maqina frenon mu përpara tyre.

— Mos! Pash idealin, mos! — nxjerr kokën në dritare Sandër Delia.

Lidjes i vjen t'i hidhet në qafë, t'i hidhet në qafë.

Sandër Delia luan timonin: Zembrën e ka plot e përplot me ngashërim. I vjen të qajë. Dhe lotët e tija rrjedhin nëpër xhamat e përparme. Breshër. Shi me pikla të mëdha sa një kokërr lajthi. Ai harron të ngrejë xhamat e dyerve dhe shiu e lag, e bën qull.

Sa është maqina në ecje ai nuk ndjen asgjë. Jeton me të, merr frymë me të. Përpiqet ta ngasi sa më shpejt dhe nëpër udhën më të shkurtër, sado që atë ditë do të dëshironte të bënte një udhë shumë të gjatë, shumë të gjatë... Cila është rruga më e gjatë që ka bërë ai? Bunkeri zbraz betonin, karrocëria hidhet përplot. Ai tërheq marshin mekanikisht. «Ma në fund...» Ato dy minuta në ngarkim nuk i duron dot. Një «ma në fund...» që përsëritet sa herë del maqina nga nyja e betonit, që përsëritet qindra herë.

Karroceria kërceu lart, «ma në fund...» Riportabli hidhet si i xhindosur mbi gropat e kampatës.

* * *

Betonimi merr fund nja dy orë përpara mbarimit të turnit.

Pak më pas një «Gaz» i ri del nga garazhi prapa drejtorisë së hidrocentralit. Janë brenda sekretari i partisë së kantierit, Bardh Shkoza dhe tre të tjerë.

Sekretari i partisë kthehet prapa dhe vështron Sandër Delinë.

— Punëtorët kërkojnë ta shtrojmë në kolektiv çështjen tënde, Sandër. Të gjithë do të përkrahin të marrish prapë maqinën.

Sandrit i mbyllën sytë për gjumë dhe nuk përgjigjet.

— Pasi të marrish prapë patentën mund të punosh ku të duash...

— Nuk do të iki prej këtej, shoku sekretar...

— Jepi! Më shpejt! Përndryshe nuk arrijmë, — e ngut shoferin sekretari i partisë. Apo t'ja lëshojmë maqinën Sandrit? Hej, Sandër, nuk e kam parë at brigadierin tand...

Koka e Sandrit rëndon mbi supin e Bardh Shkozës.

— Lleshi ka dhjetë ditë që ka ikur me leje. Me të dhëndrin madje, — flet Bardhi «sa një vinç».

— Domethënë bënë paqë? — thotë i kënaqur sekretari i partisë.

— Paqë që ç'ke me të! Shkuan te e bija e Lleshit. Ka një javë kjo punë.

Bardh Shkoza mban si në prehër kokën e Sandër Delisë. Tani për tani ai i ka sytë mbyllur, po atje në stadium do t'i bëjë katër!

KAPITULLI XXXII

Kërkoi një konjak në këmbë.

— Korçe apo Tirane?

Zef Mërtiri ngriti sytë i habitur dhe vështroi banakierin. Po iu duk sikur të ishte njeri tjetër. Nuk ishte ajo fytyra e zakonshme, joshëse dhe e përzemërt që e priste gjithnjë.

— Ç'farë të të vijë ndoresh!

Tjetri u zhduk pas banakut pa folur asnjë fjalë. Ku ishte ai banakieri i mëparshëm fjalaman e shakaxhi? «Ç'kemi, shoku inxhinier? Mirë e kaluat sot? Djall ditë sot, apo jo? Të ftohtit të gudulis kockat... Jeni çmendur, ju me ato sondat, do t'i dilni dheut tejmbanë... Ju shijoi konjakun? Nuk di si më kanë ardhur tri arka të vitit 1960. I ruaj, i ruaj...»

Kështu solli ai ndër mend fragmente nga bisedat që ishte mësuar të dëgjonte.

Konjaku doli mbi banak si nga ndonjë dorë roboti.

«Paska harruar edhe që marr gjithnjë dopjo, — tha me vete ironikisht Zef Mërtiri. — Me ç'dukjet kanë lllapur shumë për mua këtu pas «fletërrufesë». Ndoshta mendon se më mori lumi tani dhe s'ja vlen barra qiranë të harxhojë kohë me mua. Hë.» Pagoi konjakun, po nuk luajti nga vendi.

— Ç'urdhëroni?

Fytyra e banakierit tregonte habi.

«Ik, ç'pret më? Muhabete s'ka!...» Ju duk Zefit se lexoi në sytë e buhavitur të banakierit. «Ç'të vras koken me ty? Ç'pret?»

— Reston, njëzet qindarkat!

— Ah!

Ja bëri me qëllim. Dhe sikur u lehtësua, kur futi në xhep ato njëzet qindarkat.

U kthye dhe i hodhi një sy sallës plot e përplot me punëtorë dhe me tym duhani. Ju bë sikur zhurma pushoi ndër tavolinat e para, posa u kthye ai.

Se kush u ngrit nga një tavolinë aty pranë.

— Ejani të pini me ne një gotë, shoku inxhinier!

— Ju falem nderit! Posa e piva! Ju falem nderit.

Nuk diti as vetë si i dolën ato fjalë kundërshtimi. Doli pa e vështruar mirë atë që e ftoi. As ai nuk e kuptoi pse doli ashtu me nxitim sikur të kishte frikë mos e ndalte njeri me zor. Kishte nevojë të rrinte vetëm. Po kush ishte ai që e ftoi? Zef Mërtiri qëndroi në vend. I shkuan mornica nëpër trup: Llambi, «babaxhani». «Ejani të pini me ne një gotë, shoku inxhinier». Zëri i babaxhanit i vinte i qartë në vesh, sikur ta dëgjonte prapë. Ai shpejtoi hapat. Nuk e priste nga Llambi. Si kishte jetuar ai gjer atëherë?

Pak përpara se të hynte në klub që krejt i qetë. Tri ditë e tri net kishte luftuar me vetëvete pas «fletërrufesë». Në atë luftë kishte patur edhe zemërim, edhe inat, edhe pendim, edhe mëri të amullt. Pastaj kishte ardhur batica...

Ai të vërtetën e ndjeu që në vështrim të parë, po kundra saj ngriheshin mijëra kundërshtime përbrenda qenjes së tij, që ai i rrëzonte apo përpiquej t'i rrëzonte.

Duke dashur të jetë parimor, ai u bë i rreptë me vetëveten. Ndoshta edhe e teproi. Po ky që një gjyq ndërgjegjeje dhe nuk do t'i takonte ndoshta të dilte tjetërherë përpara tij, prandaj vepronte ashtu. «O burra, nxirri të gjitha Zef Mërtiri, të gjitha!» — i thoshte vetes.

Si e pastronin ndryshkun e hekurit në lashtësi? Me zjarr? Hej, ç'digjej Zef Mërtiri!

Përgjegjen e vendosi pak përpara se të hynte në klub. Nuk u ngut. Thumbat i nguli mengadalë, i vuri edhe copa kartoni që mos të grisej (në këtë kohë prapa tij se kush zuri ta lexonte me zë duke bashkuar me zor germat), pastaj bëri një hap prapa dhe e vështroi me nge.

Mos do t'ja marrin për dobësi? Frikë? Servilizëm?

Në djall të venë! Ai kishte folur me zemër në dorë!

Me të vendosur përgjegjen ai u qetësua. Një lehtësim i këndshëm i pushtoi shpirtin, trupin, sikur i hyri thellë në skutat më të fshehta të qenjes. Ndjeu atë që

ndjen një i sëmurë rëndë prej kohësh, që zgjohet një mëngjez pa dhembje, pa temperaturë. Sikur i kishte hequr ngjyrën ajo «fletërrufe».

Po në klub ai e ndjeu veten ngushtë. Në fillim pas banakut, pastaj edhe më keq kur e ftoi ai tjetri.

«Ejani të pini një gotë me ne, shoku inxhinier...»

Si nuk kishte pasur kurrë sy të vështronte njerëzit e mirë? Më përpara as që i kishte vajtur në mendje t'i ndante në të «mirë» dhe në të «liq». I kishte parë vetëm si punëtorë. Ai u mallëngjye. «Ç'kam kështu? U bëra kalama fare. A nuk i dhashë fund me përgjegjen?»

Qëndroi. Kishte arritur mbi argjinaturën e Drinit. Si kishte ardhur gjer këtu?

Po perëndonte. Dielli përflakte malet dhe liqenin e vogël që kishte sajuar Gjadri. Mbi ujë zunë të dridheshin fushat e dritës së reflektorëve që sapo u ndezën. Njëpër kaçube mëllenjat kërkonin njëra-tjetrën me zë të mprehët. Tutje kantieri notonte në dritë.

Vazhdoi të ecte mbi argjinaturë. Pas tij se kush shpejtonte hapin. Në atë krah ishte qetësi. Lugina e Gjadrit e përcillte përmes saj zhurmën e kantierit, prandaj nga argjinatura ishte qetësi. Çapitja e tij prapë vinte krejt e qartë.

Ju duk se ndjeu zë. Nuk ktheu kokën, nuk qëndroi. Sonte nuk i bëhej të qëndronte gjëkund. Pastaj edhe në ishte dikush, nuk do ta kishte më të.

— Shoku Zef, inxhinier!

«Palush Stajka! — tha Zefi me vete.

— Shoku Zef! inxhinier Zef!

Ai përpara. Pa e vështruar, pa i vënë mendjen. Në mendjen e tij vetëm punëtorët dhe Llambi:

«Eja të pish një gotë me ne, shoku inxhinier...»

Sa e sa herë e kishte gostitur Palush Stajka po një zë aq të ngrohtë nuk kishte dëgjuar kurrë!

Padashur Zef Mërtiri përfytyroi si afrohej Palush Stajka te banaku dhe si porosiste dy dopjo...

«Qorr! Qorr! Qorr!»

I vinte të hante veten me dhëmbë kur kujtonte

gotat që kishte rrëkëllyer me të. Cila orë e zezë e pati afruar me këtë njeri? Ai gjithnjë i ngjitej, i ngjitej...

— Or shoku Zef! Jam Palushi!

Inxhinieri dëgjoi pas shpine dihatjen e rëndë të tjetrit.

— Ç'ke kështu, inxhinier? Mos e merr kaq me mërzi! Kush çan kokën për ata budallenj që mbushin muret me letra? S'jau var askush atyre!

«Ky nuk e paska marrë vesh përgjigjen time...»

— Të kërkova gjithandej, thash që të gjendesha pranë... Kthehu. Hajt t'i zbrazim nja dy të thata.

Zef Mërtiri qëndroi. U vështruan sy më sy.

— Dëgjo ti, Palush, — i tha me zë të qetë, — do të të jap një këshillë. Lërë hidrocentralin, ik. Këtu nuk ka vende tani më për parazitë. As përpara mjaft kohësh nuk ka patur, po ti ke jetuar nën hijen tonë. Tani mbaroi! Ma vër veshin, ik!

Dhe i ktheu krahët. Pas dhjetë hapash as që e pat më në mendje atë njeri. Tjetër gjë ju kujtua dhe vështroi orën. Tani duhet të kishte filluar mbremja e minatorëve. Po sikur të shkonte atje? Pse jo? «Eja të pish një gotë me ne, shoku inxhinier...»

Dhe ai mori majtas në drejtim të tunelit.

KAPITULLI XXXIII

Diçka sikur u ep, sikur u shemb; tuneli ushtoi nën gjëmimin e shuplakave. Një oshëtimë e zgjatur, valë-valë, që vërshoi pastaj jashtë në errësirë përmes portalit.

Sekretari i partisë së ndërmarrjes u ul. Mbajti një fjalim fare të shkurtër. Ai dinte të zgjidhte vetëm fjalët që nevojiteshin!

— Do të ndajmë tani medaljet? — pyeti pas pak nëndrejtori.

— Jo, më vonë! S'bëjnë një grosh ato mbrëmjet që fillojnë me një varg fjalimesh, pastaj dekoratat, pastaj kontrafjalime... Shkurt, u bie era rutinë. Ata shokët e bashkimeve profesionale m'u mburrën që sonte do të ishte ndryshe. Të shohim.

Tuneli shkëlqente nga dritat. Dy rreshta tavolinash zgjatëshin anës dhe rrethonin një hapësirë mjaft të madhe në mes. Tani që qenë ulur njerëzit, mund të shihej më mirë ç'përbindësh ishte tuneli. Njerëzit sikur kishin humbur brenda tij. Të gjithë ata ai i duronte fare lehtë në parzmin e vet të madh. Sado që e kishin bërë pëllëmbë e llambë elektrike, prapë qoshet e parrafshuara të shkëmbinjve mbeteshin vende-vende të errëta. Ky kontrast i jepte vendit një farë pamje të çuditshme. Dritat arrinin gjer në një farë vendi, pastaj fillonte errësira. (I kishin shuar dritat andej nga vazhdonte tuneli). Një kufi i ndarë mirë: dritë dhe errësi.

Për të gjithë kjo sikur ishte një mbrëmje e jashtëzakonshme. Ndjenin ndryshe këtë mbrëmje, ndjenin diçka të re brenda për brenda, diçka që i rinonte, u kthente vitet prapa. Lëvizje, gjallëri. Gjallëria sikur shket si ngjalë tryezë në tryezë, lëvrin, rrotullohet, kthehet prapë nga erdhi. Kështu vazhdimisht.

Nëndrejtori ktheu kokën dhe pa sekretarin e partisë.

— Ore, qenka mrekulli këtu! — i tha.

Sekretari i partisë u ngrit në këmbë.

— Dollinë e parë për partinë dhe për shokun Enver!

— Me fund!

— Me fund!

— Me fund!

Breshër duartrokitjesh. Llambat e varura mbi tela dridhen. Pastaj fillon orkestra.

* * *

Lidja kishte zënë një tavolinë nga mesi. Pranë kishte farkëtarin dhe në të djathtë Llesh Kalinë. Tutje vinin dy gollobordas dhe Frani nga Mirdita. Xha Bra-

hoja ishte ulur përballë tyre, në mes të dy sondistëve të çimentimit dhe të Ilias. Në një tavolinë më tutje zinte goxha vend Bardhi «sa një vinç».

Brahim Jergucati u kthye nga Lidja:

— Birrë do të pish?

— Ç'të pini ju, do të pi edhe unë, — qeshi vajza.
— Do të hahem me ju këmba-këmbës për llojin e pijes, po sa për sasi...

— Nuk dëgjova, — ndërhyri Llesh Kalia.

Ja shpjeguan çfarë tha Lidja.

— Oho! Për sasi asnjë nuk hahet me trimat e mi. Ku je, mor Fran Mirdita! Sa muejsh ke qenë kur ta kanë vu faqoren e rakisë te djepi?

— Faqoren edhe tytën e manzeres besa! — kërceu Frani.

— Çoje, farkëtar!

— T'paça, mor voc!

Llesh Kalia bëri «bromb» me farkëtarin, pastaj me të gjithë me radhë.

— Ç'kërkon kështu me sy, farkëtar?

— Plakën, ajo pastë faqen e zezë! «Du të rri sone me djelmt, du të rri me djelmtë!» «Hik, — i thashë, — dhe mo kthe ma ke lala!» Ç'nemelazëm kur e ka menen ke çunat?

— Ç'lazëm, ç'lazëm, po sytë i rrotullon si prozhektorë, — e ngacmoi inxhinier Ilija.

Qeshën të gjithë. Qeshi edhe farkëtari, me një gaz prej babaxhani sevdalli.

— Dëgjo, Lidje, sa mirë këndon ai sondisti yt, — foli Ilija.

Zhurma pushoi. Nga krahu vinte zëri i ëmbël i sondistit, po nuk dukeshin as ai, as orkestra. Zëri kumbonte, vinte si prej shumë larg, prej thellësisë. Kjo të joshte, të ftonte të ëndërroje.

— Bukur e kanë menduar, — pëshpëriti Lidja.

— Si the?

Farkëtari u anua nga inxhinierja.

Shëëët, moj farkë Burreli! — e kërcënoi Fran mirditasi. — Na len me ndigjue.

Lidja përpiqej të dukej e qetë. Gjer përpara pak minutash vështronte herë pas here nga kreu i tunelit. Po pas shakasë me farkëtarin nuk guxoi t'i hidhte më sytë andej. «Do të vinte ai?»

— Nesër sonda ime ndoshta i jep fund, Lidje, — i tha inxhinieres xha Brahoja. — Me sa duket po më ecën edhe këtë radhë.

— Sonte ndalohen muhabetet e punës! Sonte vetëm raki dhe qejf!

— E ka mirë mirditasi i keq! Raki dhe qejf!

— Çamarokë! Ju deheni me erë, ndërsa këtu më vrisni të trasha, — i kërcënoi me gisht xha Brahoja dy sondistët.

— Fran! — thirri papritur Llesh Kalia.

— Urdhëro, brigagjer!

Ai e shtrembëroi me qëllim fjalën. U ngrit në këmbë dhe mori një pozë plot respekt të shtirur.

— Sonte s'ka brigadier! — thirri një nga sondistët.

— Sonte s'ka urdhëra! — e pasoi Ilija.

— Sonte s'ka ligje! — u tall sondisti i tretë.

— Oho, mbiu anarkia! — tundi kokën xha Brahoja.

— Fran, nuk po tallem. Kemi harrue Sandër Delinë!

Ai duhej të ishte këtu sonte.

Heshtën të gjithë. Po, Sandri duhej të ishte aty.

— Nuk i kemi dërguar ftesë, Llesh?

— Kush mban mend, shoqja Lidje? Këtu është bërë «miting»!

— Po shkoj ta kërkoj...

— Mor po nuk e ke aty, — u hodh Frani, — po edhe sikur të jetë nuk mundet me e lanë maqinën.

Po kishte filluar orkestra dhe Llesh Kalia u largua me hapa të mëdhenj pa dëgjuar ç'tha Frani.

Bardh Shkoza u ngrit dhe i zuri vendin.

— Ej! — thirri gjithë gëzim Fran mirditasi, — u grumbulluan të gjithë shefat në një kotec!

Bardhi u suall nga Lidja, po atë e morën për të kërcyer.

* * *

— Fran, të duan andej lar!

— Nalt? Aha, shefat!

Buzëqeshi, u ngrit dhe ju afrua tavolinës së tyre.

— Urdhëroni, shokë shefa!

— Ulu, Fran, — ju përgjegj nëndrejtori, — andej poshtë janë mbledhur gjithë djajtë. Menduam t'jau prishim çerdhen pak...

— As kështu nuk kemi gja në vijë, more shoku nëndrejtor. Djalli e ban çerdhen kudo që shkel!

— Bëje, pra Fran! Prandaj të thirrëm.

— Si urdhnon, shoku Sadik, po e baj!

— Të pimë për Franin, shokë!

Përpoqën gotat.

Minatori zgjati pirunin dhe mori një copë sallam.

— Oho, na për lau!

— Na fiku!

— Na vdiq urie!

Nëndrejtori, sekretari i partisë dhe kryetari i bashkimeve profesionale u mblodhën kokë në kokë dhe vështruan me aq mallëngjim pjatën me meze sa nuk mbeti njeri pa qeshur.

— Jepni alarmin, shokë: Bjerini sirenës! Ruani sallamin nga dhëmbët e Franit!

— Ha! Ha! Ha!

— Na plasët, ore!

— Nëndrejtor, qenke antikë!

— A, kështu ja nisët? — Frani bëri sikur u zemërua. — Ruajuni atëherë nga Mirdita e kuqe!

Dhe ja nisi me ato të vetat.

* * *

Bardh Shkoza u për kul dhe i foli Lidjes.

— Po, Bardh, kalova nga «Zëri i masës». Përpara se të hyja këtu...

— Dhe nuk je e kënaqur?

Ajo e vështroi brigadierin thellë në sy. Pastaj erdh dhe u skuq, u skuq...

I erdhi inat për atë të kuq që i hipi në fytyrë, po ç't'i bënte. Ajo kurrë nuk kishte biseduar me Bardhin për Zef Mërtirin. Megjithatë ndjente sikur brigadieri ishte në dijeni edhe të hollësive më të vogla. Një gjë të tillë e kishte ndjerë gjithnjë, me rast e pa rast, me vend e pa vend. E kishte ndjerë kur bisedonin për punën. Kur kalonte pranë Zefi, kur e shanin apo e lëvdonin atë, kur bisedohej edhe për diçka të largët që kishte fare pak lidhje me inxhinierin, Lidja, në ato çaste, i hidhte vjedhur një vështrim Bardhit dhe pëshpëriste me vete: «Ky e di, e di!»

Po Bardh Shkoza sillej në një mënyrë që ajo nuk e ndjente kurrë veten të fyer. Ai ishte si një burim mirësie dhe Lidjes i dukej sikur e kishte marrë nën mbrojtje së largu. Ajo sikur kapte një notë shqetësimi të Bardhi për çështjen e Zefit. «Nuk ka besim Bardhi te ai. Nuk e do. Ndoshta druhet mos digjem unë...»

Pak a shumë kështu ishte e vërteta.

— Jam e qetë Bardh, ndoshta edhe mjaft e kënaqur. Po sonte njeriu nuk e kupton nga se mund të kënaqet më përpara.

— Ja, ai! — tha Bardhi, — Zefi po vjen!

Lidja u drodh. Ai po vinte andej nga kreu i tunelit. Muzika kishte pushuar. Qe një çast i përkohshëm qetësie. Lidjes i sëmboi në zemër. «Ç'erdhi kështu vonë? Do t'i duket se të gjithë atë vështrojnë!»

Po orkestra ja nisi prapë e Zef Mërtiri u ul andej nga kreu. Pastaj u kthye dhe përfshiu me sy tavolinë pas tavoline. Nuk po e shihte. Xha Brahoja qe ngritur në këmbë për të mbushur gotat dhe e zinte Lidjen me trup.

Se kush e toku gotën me inxhinierin. Ai, u mat ta ngrinte kur takoi vështrimin e saj. Dora i mbeti një çast pezull, pastaj e mblodhi veten dhe e zbrazi rakinë me fund.

«I marrë! — mendoi Lidja — Ç'është kjo?»

Po se mos e dinte ai...

Mund të pish kur të mbërthen brenga, mund të pish kur e ke shpirtin plot me ato dallgët e lumturisë së fshehtë që pret, mund të pish edhe me shpirt të patrazuar; pa kuptuar gjë rëkëllen gota dhe të pëlqen që diçka të nxit nga brenda, të josh, të përkëdhel. Mund të pish për të dashurën, mund të pish për të ardhmen e afërt dhe për të largmen që pret. Mund të pish edhe vetëm për të dëgjuar si tringëllon gota e shokut që ke përballë.

Zef Mërtiri ndjente pak nga të gjitha këto.

* * *

Papandehur u shuan dritat. Tunelin e mbuloi errësira e plotë. Përtej portalit u dukën yjet në hapësirën e zezë.

— Po kjo?

— Kanë rënë linjat?

— Avari te nënstacioni, ndoshta...

— Ndizni pishat, shokë! Nuk kemi hyrë kot në shpellë.

— Oj farkë Burreli! Mos ju ndaj plakës se ta grabitën.

Fran mirditasi nuk e bënte qejfin qeder.

Pastaj një si zhurmë makaraje, diçka zuri të vërtitej e nuk kaloi shumë dhe një fashë drite shpërtheu dhe u përplas pas faqes së tunelit. Mbi faqen e shkëmbit zunë të lëviznin imazhet e kinokronikës. Zëri i spikerit mbushi tunelin: — Jemi në ditët e para të çeljes së tunelit të devijimit të Drinit. Këto ditë brigadat e Llesh Kalisë dhe të Azis Çamit bënë një normë e gjysmë. Minatorët tri-
ma...

— Heu, Llesh Kalia, bre!

— Doli edhe në film, dreqi i Lleshit!

— Pse mos dali, kur e meriton?

Lleshi po kthehej tamam atë çast. Nuk e kishte gje-

tur Sandrin dhe qe i mërzhitur. Kur pa veten në faqen e tunelit shtangu një çast, i hipi një të nxehhtë dhe zemra nisi t'i rrihte me forcë. Kjo ishte kaq e papritur për të...

Ai mezi e gjeti një vend duke u penguar në të errët.

— Llesh, ti je? — E pyeti një zë.

— Po, unë. Nuk ma merrte mendja ta shifshë këtu në tunel këtë dokumentar:

— Shëët! Mos bëzaj!

— Lërna të dëgjojmë. Mos të rritet mendja! — e ngacmoi një zë, që ai nuk e njohu. — Aparati merr çdo gjë!

— Shif si ma mban pistoletën...

— Qetësi, shokë!

Pastaj një e qeshur si det mbushi tunelin. Zaimi që ecte në majë të gishtërinjve...

* * *

— Vallzim. Vallzim! Ku është orkestra?
Tre-katër të rinj u ngritën në këmbë andej nga fundi dhe rrahën shuplakët.

Orkestra ja nisi me shpirt. Vendi bosh u mbush me çifte.

Lidja vështroi nga Zefi. Ai po kuvendonte me sekretarin e partisë së ndërmarrjes. Ajo u kthye nga Bardhi.

— Vërtitemi?

— Vërtitemi.

— Unë e kërcej foksën si arinjtë. Mezi i urdhëroj këmbët.

— Si «king» që je kërcën mrekulli...

Bëmë tri-katër rrotullime në heshtje. Pastaj Lidja e vështroi Bardhin thellë në sy.

— Sikur po përtyפש të më thuash diçka, — i tha.

— Nuk e di; ndoshta nuk ka rëndësi...

— Jo, folë!

— Mirë, dëgjo pra! E kam fjalën te Zef Mërtiri. Ndoshta mund ta kesh kuptuar që nuk e kam dashur.

Po desha të të them që ne ngutemi ndonjëherë kur i gjykojmë njerëzit. Ja, unë kurrën e kurrës nuk do të besoja që ai t'i bënte një përgjigje të tillë «fletërrufesë».

Ajo dëgjonte Bardhin, rrotullohej dhe vështronte Zef Mërtirin. Ai nuk ja ndante sytë.

Muzika pushoi. Çiftet u drejtuan nëpër vende. Bardh Shkoza desh të fliste më, po e ndërpreu bisedën. Atë çast gjithë tuneli ushtoi nga një thirrje e vetme: Gjoshi! Gjoshi! Gjoshi! Një fragment estrade. Gjoshi beniamini i saj...

Gjoshi dhe një tjetër ecin vjedhur anës tunelit.

GJOSHI: Bukur i bëmë bisht mbledhjes, hə?

PUNËTORI: Me namë!

GJOSHI: (Vështron përreth) Qëndro! Na rrethuan!

PUNËTORI: Çfarë të bëjmë?

GJOSHI: Më merr në shpinë! Bëj gjoja sikur jam i sëmurë rëndë. (I hipën në shpinë. Tuneli ushton nga të qeshurat). (Duket një punëtore)

PUNËTORJA: Po ju?

PUNËTORI: Në spital! Në spital!

PUNËTORJA: Kthehuni! Këndej do të zbrazin minat!
(Gjoshi kërcen menjëherë nga shpina e shokut dhe ikën prapa)

PUNËTORJA: Po ti? U shërove? Pse kërcëve tani?

GJOSHI: Nuk u shërova, moj shoqe. Zbrita se nuk dua të vdes dykatësh nga minat. Më mirë të vdesim secili për vete... (Ikën)

Kush e mban gazin në tunel?

* * *

Ajo nuk priti atë «me leje» tradicionale, po u ngrit në këmbë posa u afrua ai. Muzika heshti për ta, hesh-tën njerëzit, heshti tuneli i madh. Ai mirrte frymë me zor, ajo ndjente parzmin plumb të rëndë. Një farë marrëmendje, frike dhe ngurrimi nga ana tij... Angushtia dhe pritje, ajo... Pastaj çast pas çasti angushtia kaloi,

dhe ata zunë të dëgjonin zhurmën, muzikën, njerëzit. Atëherë e ndjenë veten të lehtë dhe të shpenguar. Kështu u vërtitën pa kuptuar gjer përpara portalit.

— Lidje!

Ajo ngrin!

— Lidje!

Ajo nuk qe e zonja të përgjigjej. Frymëmarrja e tij u bë e rëndë, gati si e dikuj që gulçon.

— Lidje, yjet...

Ai kishte ngritur kokën dhe vështronte qiellin.

Vajza u drodh. Ndjeu dëshirën të mbështetej në gjoks, ta ulte kokën dhe të pushonte në parzmin e tij.

...Llesh Kalia dekorohet me medaljen «Urdhëri i punës» i klasit të parë, — erdhi që brenda zëri i sekretarit të partisë, — me këtë motivacion... — Ata të dy kërkuan duart e njëri-tjetrit. I shtrënguan fort.

Një cigare e ndezur lëvizi nga portali i errët drejt tunelit të ndriçuar, xha Brahoja që ngazëllehej për Llesh Kalinë...

89452

Tirazhi 10.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970